



# NAIMI



1



**Naim Frashëri**

Vepër e skulptorit Nehat Beqiri  
Vendosur në shkollën 8-vjeçare "N. Frashëri"  
Tetovë

25n 82  
18



# **Naim Frashëri**

**(1846 - 1996)**



**Argeta - Lmq**

Tiranë

1996

# **NAIMI 1**

*Antologji poetike*

Përgatiti  
**MEHMET GËZHILLI**

Recenzent  
**DRITËRO AGOLLI**

Korrektor letrar: LIRI KOSTA

Kopertina: BUJAR ZAJMI

© Të gjitha të drejtat i ruan Shtëpia Botuese

**Argeta - *Lmq***

Tiranë  
1996

***155 autorë  
në  
150 vjetorin  
e Naimit***

*Sponsorizues*  
**Rrapush Xhaferri**  
*President*  
*i Fondacionit bamirës*  
*"Demokracia Popullore -*  
*Xhaferri"*



*Biblioteka*  
**"Vëllezërit Frashëri"**



**Vëllimi I. - *Antologji poetike***

- “ II. - *Kujtime, përsiatje, reportazhe letrare*
- “ III. - *Artikuj, studime, esse.*
- “ IV. - *Artikuj studime (Për veprat e veçanta)*
- “ V. - *Gjuha e Naimit (Artikuj, studime).*
- “ VI. - *Naimi për shkollën shqipe (artikuj, studime)*
- “ VII. - *Autorë botërorë për Naimin*
- “ VIII. - *Biobibliografi*

# *Dritëro Agolli*

# Punove mirë, usta!

Naimi është fëminia e poeziës së sonë. Koha kalon, poezia rritet e maturohet, por për të mbetet e bukur fëminia. Dhe megjithatë Naimi nuk është vetëm fëminia e parë e poeziës së sonë, por njëkohësisht ai është edhe babai i saj. Kur nisi të ndërtohej kështjella e poeziës së sonë, ai ishte nga ustallarët e vërtetë që vuri gurin e parë të sigurt në themellet e saj. Për këtë gjithë brezat poetikë i kanë hequr dhe i heqin kapelën, se nga ai kanë patur ç'të mësojnë. Ai ka qenë, ndofta, punëtori zemërgjerë më i madhi i gjithë poetëve shqiptarë. Me punën e tij të rëndë krijoi në Shqipërinë e kohës së vet poezinë moderne, vjershërimin modern që gjë atëherë mungonte. Hoqi nga fjalori poetik gjithë vjetërsirat që ia merrnin frymën gjuhës së gjallë. Fjalënperlë e nxori nga pluhuri i kohës, e bëri të shkqëlqejë me tërë bukurinë e saj dhe tregoi se ç'mundësi të pafundme kishte shqipja për të shprehur në art mendime të mëdha.

Fjalën ai nuk e mbajti për të qëndisur stolira më vete, por e nxori në udhë të gjërë për t'i shërbyer idealit të tij të lartë, idealit të Shqipërisë së lirë. E çfarë s'bëri ai me atë fjalë! Shkroi poema e vjersha, shkroi këndime e punime pedagogjike, shkroi fjalë të urta dhe esse!

Naimi është një det i gjërë. Ky det ka ujra të kulluara e të turbullta, ka valë të mëdha e valë të vogla, ka shkumë të bardhë e shkumë të murme. Te Naimi mund të futesh si në një labirinth, në të cilin mund të ngatërrrohesh po mos njohe kohën naimjane. Krahas vargjeve të shkëlqyera, do të gjesh vargje naive gjër në bejte, krahas mendimeve

më të përparuara të kohës së vet, do të gjesh edhe mendime që nuk janë të denja pér atë. Por i padiskutueshmë mbetet ideali i tij i madh: lufta pér lirinë e Atdheut.

Kësaj lufte ai i fali gjithçka: krijimin, mëndjen, trupin. Unë gjithnjë e kam përfytyruar Naimin si një qiri që digjet pér t'u ndritur të tjerëve. Shqipëria i thërriste: "ndrit!" dhe ai digjej e ndriste. Nuk kish kohë as të ruante veten, as të ruante përsosmërinë e artit të tij. Shumë herë nga ky nxitim i madh, nga ky nxitim nën dorën e fuqishme të Shqipërisë që e shkundëte dhe i thoshte me ngut: "shkruaj", Naimi sakrifikoi artin gjënë më të shtrenjtë të tij. Ai ndofta linte përgjysëm një vjershë, që mund të bëhej e mrekullueshme, dhe shkruante një këndim pér çunat analfabetë të Shqipërisë së robëruar. Vjershën e linte me dhëmbje të madhe, por nuk kishte ç'të bënte. Vallë Naimi që ka bërë aq gjëra të mrekullueshme, nuk ishte i zoti të bënte lirika intime e peizazhe, e vjersha dashurie të përsosura, puro-art? Edhe këtë e bënte, por ai ishte militant dhe si militant kish një mision të lartë historik. Këtë militantizëm kanë mësuar poetët shqiptarë nga mësuesi i tyre i nderuar. Brez pas brezi kështu e kanë quajtur krijimtarinë poetike poetët tanë: punë militante. Ata që e kanë shkëputur krijimtarinë poetike nga misioni militant, nga shërbimi ndaj popullit, kanë dështuar si poetë edhe në se kanë patur talent. Në kohën kur jetonte ai, krijonte në Francë edhe Sharl Bodleri. Njëmbëdhjetë vjeç ishte Naimi, kur Bodleri botonte "Lulet e së keqes". Mund t'i shkruante edhe ai "Lulet e së keqes", por këtë s'e bëri, shkroi "lulet e verës", se kjo i duhej Shqipërisë.

Ne poetët kemi mësuar e mësojmë nga militantizmi i Naimit, po edhe nga ëmbëlsia e gjuhës së tij, nga tingulli i fjalës së pastër. Fjalën naimjane të duket sikur e prek me dorë, të duket sikur dëgjon jehonën e saj tek ecën nëpër male. Dhe ti duke vërvshëllyer e përsërit me vete. Kudo të ndjek ajo fjalë, se ai me punën e tij, do të thosha prej bualli, e pastroi nga ndryshku i huaj, e pastroi siç pastrojnë ustallarët mermerin pér të shkëlqyer.

Më kujtohet një shprehje e Rafaelit, afërsisht kështu: kur gjithë bota qan, ti nuk duhet të qeshësh. Kur Shqipëria qante, Naimi nuk qeshi me artin e vet, nuk u muar me cikërima dhe belbëzime poetike, por e vuri artin në shërbim të shoqërisë. Prandaj ne i heqim kapelen dhe themi: "punove mirë, usta!"



# *Autorët*

Koto Hoxhi .....	13	Mediha Frashëri.....	80
Lef Nosi.....	17	Syrja Minarolli.....	82
Visar Dodani.....	18	Perlat Rexhepi.....	83
Adham Shkaba.....	19	Mustafa Greblleshi.....	84
Dushi Jorgobaba.....	21	Azem Teferiti.....	85
Filip Shiroka.....	22	Ferit Vokopola.....	86
Shtjefën Gjeçovi.....	24	Ibrahim Hasnai.....	88
Thoma Avrami.....	26	S. Maqellari.....	89
A.Zako-Çajupi.....	28	Skënder Curri.....	90
Jani Vruho.....	29	Dhimitër Mino.....	91
A.S.Drenova-Asdreni.....	35	Myzafer Xhaxhiu.....	94
Hil Mosi.....	39	Dhimitër Shuteriqi.....	95
Petro Nini Luarasi.....	40	Edil.....	99
Mihal Grameno.....	41	Dritëro Agolli.....	100
Spiro Dine.....	42	Agim Shehu.....	107
Josif Bagëri.....	43	Jorgo Bllaci.....	110
Z.Prifti.....	44	Muharrem Gazioni.....	111
Anonim, (Korçë).....	45	Llazar Siliqi.....	112
Ramadan Duksi.....	47	Ismail Kadare.....	115
Sali Butka.....	48	Bilal Xhaferri.....	120
M. Përmeti.....	50	Niko Tyto.....	121
Ramiz Harxhi.....	51	Dhori Qirjazi.....	122
Kristo Floqi.....	53	Teki Dervishi.....	124
Lasgush Poradeci.....	56	Jakup Cerraja.....	126
Sejfulla Malëshova.....	65	Alfred Çapaliku.....	128
Et'hem Haxhiademi.....	66	Enver Gjergjeku.....	129
Tanush Ismailati.....	69	Klara Kodra.....	131
Petro Marko.....	70	Arif Kazo.....	132
Andrea Varfi.....	72	Sulejman Mato.....	133
Isuf Luzaj.....	73	Rrahman Dedej.....	134
Bardhyl Pogoni.....	78	Shefki Karadaku.....	138

<b>Qazim Shemaj</b>	141	<b>Demokrat Anastasi</b>	203
<b>Pirro Kuqi</b>	142	<b>Hamit Alija</b>	204
<b>Ndoc Pappleka</b>	143	<b>Vorejo Ujko</b>	207
<b>Katjusha Pogaçe</b>	145	<b>Musa Ramadani</b>	208
<b>Natasha Lako</b>	147	<b>Vullnet Mato</b>	209
<b>Roland Musta</b>	148	<b>Petro Çerkezi</b>	211
<b>Lefter Çipa</b>	150	<b>Xhevahir Spahiu</b>	212
<b>Aleksandër Çipa</b>	153	<b>Petraq Risto</b>	216
<b>Luan Rexhepi</b>	154	<b>Llazar Rumnici</b>	217
<b>Pertef Liçi</b>	155	<b>Koçi Petriti</b>	218
<b>Fluturak Germenji</b>	156	<b>Rudolf Marku</b>	220
<b>Sadik Bejko</b>	157	<b>Halit Shamata</b>	222
<b>Luan Qafëzezi</b>	158	<b>Lindita Ahmeti</b>	224
<b>Simon Vrusho</b>	160	<b>Ibrahim Gani</b>	225
<b>Agim Vinca</b>	161	<b>Pirro Tase</b>	226
<b>Bardhyl Londo</b>	163	<b>Petraq Ballabani</b>	228
<b>Skënder Buçpapaj</b>	166	<b>Murat Isaku</b>	231
<b>Hamdi Meçe</b>	168	<b>Sherif Zeqiri</b>	232
<b>Agim Mato</b>	169	<b>Halil Qendro</b>	233
<b>Hasan Hasani</b>	170	<b>Vehbi Skënderi</b>	235
<b>Llambro Ruci</b>	179	<b>Myslim Pasha</b>	237
<b>Lauresha Çarçani</b>	181	<b>Mojkom Zeqo</b>	239
<b>Zenel Anxhaku</b>	182	<b>Allaman Hysa</b>	243
<b>Adem Istrefi</b>	184	<b>Fatri Sulejmani</b>	244
<b>Fatos Arrapi</b>	185	<b>Valbona Gaçe</b>	246
<b>Muharrem Jakupi</b>	187	<b>Albert Abazi</b>	247
<b>Ndoc Gjetja</b>	188	<b>Pandeli Koçi</b>	248
<b>Zeqir Gërvalla</b>	189	<b>Bardhosh Gaçe</b>	249
<b>Agim Isaku</b>	190	<b>Vasil Dilo</b>	250
<b>Konstandin Dhamo</b>	193	<b>Arben Kondi</b>	251
<b>Petrít Ruka</b>	195	<b>Nase Jani</b>	252
<b>Sabri Hamiti</b>	199	<b>Skënder Blokaj</b>	254
<b>Iliriana Sulkuqi</b>	200	<b>Basir Bushkashi</b>	256
<b>Sami Milloshi</b>	202	<b>Martin Cukalla</b>	257

Mumin Zeqiri.....	258
Novruz Dervishaj.....	261
Ali Podrimja.....	262
Arben Duka.....	263
Odhise Grillo.....	265
Pano Taçi.....	266
Kalosh Çeliku.....	268
Skënder Sherifi.....	269
Idajet Jahja.....	271
Qerim Skënderi.....	273
Zhaneta Ogranaja.....	275
Jaho Margjeka.....	276
Hiqmet Mehmetaj.....	277
Ferhat Çakërrı.....	278
Paskal Zoto.....	279
Arjan Kadiu.....	281
Abdyl Krasniqi.....	282
Flutura Ačka.....	284
Petraq Kolevica.....	285
Riza Lahi .....	286
Farruk Myrtaj.....	287
Visar Zhiti.....	289
Sherif Bali.....	292
- More Naim Shqipëria!....	296
- Letra nga studjues.....	303
- Jehonë dhe vlerësime.....	311
- Intervistë (Autori).....	347
- Përherë mirënjoyhe të shenjtit Naim! (Rrapush Xhaferri).....	354



**Koto Hoxhi**  
**- Mësues i Popullit -**  
**(1824-1895)**

Lindi dhe vdiq në Qesarat të Gjirokastrës. U shkollua në vendlindje më pas në Stamboll, ku pati kontakte me vëllezërit Frashëri dhe udhëheqës të tjerë të Lëvizjes Kombëtare. Iu kushtua çështjes kombëtare dhe si pasojë provoi torturat më të mëdha si në burgun e Gjirokastrës dhe atë të Stambollit. Përgatiti dhe hapi shkollën shqipe në Janinë. Shkroi vjersha patriotike, shumë prej të cilave i batoi në përbledhjen e Spiro Dines: "Valët e detit", "Mjalt" e bletës" të Visar Dodanit, etj. si dhe në shtypin e kohës. Ai organizoi çfaqjen e parë teatrale "Dasma lunxhiote".

## **Tre djem nisurë prej arit**

**Të** të them, o bir ca fjalë  
me lot ndër sy duke qarë  
vura veshnë radhë- radhë  
mos humbt kjo farë  
gatova ca djelmëri

Prej belit të një sorkadhit,  
Të Halit bej kordhëtarit,<sup>11</sup>  
tre djem nisurë prej arit,  
si kokrra margaritari;  
i zgjodha nga Frashëri

M'i madhi i tre këtyre  
leu Abduli me gëzime  
dollë pas fjalësë sime,  
si Leka me kërcëllime,  
mbi Toskri e Gegëri.

"Mblidhi shokë, të bëjmë benë,  
që të gjithë të ngrihenë,  
të ngjallimë mëmëdhenë,  
një të huaj të mos lemë  
gjykatës mbi Shqipëri!"

Ashtu u mbëlodhë e thanë  
në Prizren u ngritnë e vanë.  
Në Europë anembanë,  
me Mehmet Ali Beranë,  
shëtitë i varfëri.

Me fjalë e me mend e tija  
u çudit gjithë Frëngjia;  
një djalë nga Pellazgja  
si Abdul bei Frashëri?"

Dhe nga Samiu me Naimnë  
armiqt' i zuri një drithmë,  
se duall si vetëtimë,  
nga rrënja zunë mësimnë  
me mend e me dituri.

U përpoqnë natë e ditë  
mësuan dhe historinë  
e përtrinë, e bënë ditë,  
nxuarr në shesh Pellazgjité,  
që quhetë Shqipéri.

-Unë jeshë ajo farë<sup>2)</sup>  
pellazg quhesha më parë;  
më së fundi, duke u ndarë,  
u bën 'latinë e grekarë,  
unë mbeta Shqipri.

Për të mos humbur kurrë,  
të mos më bëjnë rrëmuje,  
vunë djemt' ca shkronja mb'udhë,  
që të mos harrohem kurrë,  
si shoqet me dituri.

Shoqetë kur e dëgjuan,  
nga mendtë prap u marruan,  
thanë "neve nuk i duam!"  
Tradhetorët kallëzuan,-  
t'i humbisnin përsëri.

Dhe lejënë që u dhanë,  
 me vrap “mbylleni!” u thanë,  
 “se ju çojmë në hapsanë,  
 pa ju humbasim vëllanë,  
 Abdulë me trimëri”.

Të dy djemtë m'u lavosnë<sup>3)</sup>  
 me këto fjal' u plagosnë,  
 njeri me jatërin llafosnë,  
 faqetë me lot i qosnë,<sup>4)</sup>  
 që më humbi emëri.

Këto të këqia punë  
 që hoqa dhe po heq unë  
 s'i duron as det, as lumë.  
 dhe kush t'i shohë në gjumë,  
 do të tretet si qiri!

Po e kam zemrënë shkëmb  
 këto plagë i kam si gjëmb,  
 po të ishte tjatër komb,  
 do pëlcit të bënte bomb,  
 do shuhej dhe emëri.

Po më qëndron me një shpresë  
 me farën q'u hodh në qersë<sup>5)</sup>  
 them, po nuk mbiu, për besë,  
 me zë të madh do thérres:  
 “Zgjohu Abdul bej Frashëri!”

-Mëmë! Sihariq një fjalë:  
 ti Abdulë e ke të gjallë!  
 Do zgjohet dhe ndonjë vallë,  
 të nderojë Lekëmadh  
 me mendje dhe trimëri?

Dhe Naimi me Saminë  
Vretoja me shoqërinë  
Orhani me Pandelinë<sup>6)</sup>  
Korçarët me mësimnë,  
të ngjallin me dituri.

Si këta edhe të tjerë,  
trima, burra kanë lerë,  
me mundim duke të nxjerrë,  
me shumë emër të ndjerë,  
s'të lemë në zgjedhëri!

**1879**

"Mjalt' e mbletës" (*Visar Dodani*) - 15 dhjetor  
1897, f.127-131.

- 
- 1) *Haliti, babai i vëllezërve Frashëri: Abdylit, Naimit dhe Samiut.*
  - 2) *Flet Shqipëria.*
  - 3) *Naimi me Saminë u lavosnë - u plagosnë*
  - 4) *i qosnë - i mbushnë*
  - 5) *qersë - vend djerr, i papunuar*
  - 6) *Orhan Pojani e Pandeli Sotiri, dëshmorë të luftës për liri kombëtare.*

## *Naim beut*

“**U**mbyll dita, u zu nata”,  
Qenka mbyllyn goja-shpata!

Rreja e zez’ na ka rrethu,  
Çilni goj’ ju gur e dru!

Thonë se deka Naim beu  
Nuk ka dek, aj’përsërit leu.

U bubu! se qysh na gjet!  
Si t’ia bajmë na të shkretë?!

Një nga një të parët shkojnë  
Gjakun tonë të kërkojmë

Oh i mjeri Naim Bek  
E un’ ashtu jem tuj hek,

Mir’ luftove zemër bardh  
En’ ke ti jem tue ardh!

**25, vjesht e dit’, 1900 në  
Elbasan**  
**“Albania”, Nr. 12, 31 dhjetor  
1900**

## *Lef Nosi*

- Mal' i Tomorrit-  
(1876-1946)

Ka lindur në Elbasan, në  
një familje të pasur  
tregtare. Aktivitetin politik-  
shoqëror e ka filluar që në  
vitin 1900. Në qeverinë  
provizore të Vlorës, më 1912  
u zgjodh ministër i Post-  
Telegraf. Ishte njeri me  
kulturë të gjërë dhe ka  
meritë të veçantë në  
grumbullimin dhe ruajtjen e  
dokumenteve arkivore dhe  
etnografike. Gjatë luftës II-  
Botërore ishte anëtar i  
Regjencës Kuislinge. Vdiq  
në vitin 1945, pas  
persekuimit të regjimit.

56368





### **Visar Dodani**

**-Naido-**

**(1857-1939)**

Lindi në Korçë dhe vdiq në Bukuresht. Në vendlindje kreu shkollën fillore dhe atë të mesme. U inspirua nga vepra e Thimi Mitkos "Bleta shqiptare". Më 1880 emigròn në Rumania dhe vendoset në Bukuresht.

Këtu iu bashkua shoqërisë "Drita" si gazetar dhe më vonë u bë redaktor i kësaj gazete, si dhe i revistës "Shqipëria" në vitet 1897-1899. Më 1915, shkon në Gjenvë, ku emërohet sekretar i Komitetit

Kombëtar Shqiptar. Botoi përbledhje me poezi, përktheu operan e Xh. Verdit "Traviata", vëllime me kujtime e dokumente. Veprat e tij janë: "Mialt i bletës", "Memorjet e mia".

## **Zotit N...Naim Begut**

Një natë pe behari  
ku qielli ish kulluar  
ku gjelbëronte bari  
atje isha qetuar.

Dhe sytë për qiel ngrita  
në mijë yje po mblidhnja  
për vjeshëtor'e ditur  
nji kuror të lidhnja.

M'e mendjen ne yjtë  
me krahë prej mejtimi  
në çast m'u mbyllë sytë  
në qiel vajta si trimi.

Dhe posa e zgjat dorën  
të mbledh yjt me serë  
të thur me ta kurorën  
për mundin që kam bërë.

Dëgjoj një zë që thotë  
me shumë ëmbëlsi:  
O! mos u mundo kot  
të thurësh më të mirë.

Kurorën Ay Beu  
e ka gati që moti;  
për të çuditur Dheun<sup>1)</sup>  
ia thuri vetë Zoti!"

**Toska(Misir-Egypt)  
Nr.2, Nëntor 1901, f.11**

**1). Dheun -Botën (shënim i Red.)**

## **Lutje**

**O** Zot një me Perëndinë!  
 N'ini të vërtetë si thonë,  
 Kini kujdes Naimn  
 Se punoi për kombin tonë.

Sa gjalloi në këtë jetë  
 As një orë nuk pushohti  
 Punoi për një të vërtetë  
 Kombin ton' ay e xgjojti!

Thirri: shokë me dëshirë  
 Me një bashkë të punojnë  
 Shqipërisë t'i bëjmë mirë  
 E shqiptarët t'i zgjojnë.

U mbluadh' e u mejtuan  
 Dhe mejtimit fund i dhanë,  
 Shkronjat që kemi i shkruan  
 Pastaj zunë e i përndanë.

Shkronjat me shok' i nxori  
 Po shokët iknë e lanë  
 Na mbeti vetëm i gjori  
 Përveç se me të vëllanë.

Të vëllanë po e njihni,  
 Librat ja kini kënduar;  
 Emrin fort mirë ja dini

**Adham Shkaba**  
**(1871-1946)**

*Lindi në Stratobërdhë të Vakëfave në rrethin e Korçës. Vdiq në Sofje. Familja emigroi në Bullgari. Me themelin e shoqërisë "Dëshira" në Sofje merr pjesë në të. Dha kontribut për ngritjen e shtypshkronjës "Mbrothësia". Mori pjesë në Kongresin e Manastirit si përfaqësues i emigrantëve shqiptarë të Bullgarisë. Krijimet e tia poetike u botuan në shtypin e kohës. La një dorëshkrim me titullin "Vjersha të Adham Shkabës".*

Se si ecte nënshkruar.  
Shokët s'ikën nga e mira  
Po ju larguan rrezikut,  
U trembën nga egërsira  
Se qenë pranë armikut!

Naimi krahët vuri  
E nga vendi nuk e lojti  
Punënë me penë e zuri;  
Istori e vjersha shkrojti.

Librat' e Zotëris' së tija  
Njeriut i apin shpresë,  
Rrëfejnë ç'është gjithësija  
E bëjnë njeri me besë.

E sëmurin e e shërojnë  
E vdesin edhe e ngallin!  
E djegin' e e gëzojnë  
Prej të gjithave e ç'mallin!

E mbushin dhe me dëshirë  
E bëjnë të urt' e të qetë,  
Rrëfejnë bukur' e mirë  
Zotn' e Madh e të vërtetë!

Emri kurrë mos j'u harroftë  
Vjershëtorit, Shqipërisë!  
Shpirti i tij për herë qoftë,  
Në dritë të Perëndisë!

**“Kalendari Kombjar”, 1901.**

## **Vajtim për Naim Benë**

Ç'është kjo gjëmë e madhe  
 Që platoi zemërzen t'ime  
 Moj e thënë flamëmadhe  
 Ma bëre mijë thërrime!

Burri at' i vjershërisë  
 Pendetari trim me fletë  
 Profet i Shqipërisë  
 Nuk gjendet më ndë jetë!

Shkove! O shpirt i uruar!  
 Vajte në të mirën tënde,  
 Po ne na le dëshiruar;  
 Më t'u bëfsha asaj pende!

Vdiqe!...Po ç'e them?  
 Ti vdiqe?!

Dushi, këtë mendje hiqe!  
 Nuk vdiqe, je i gjallë!

.....

Je i gjallë e i vërtetë  
 Sa të jetë këjo jetë!

Pranë Budës, Moisiut,  
 Në atë birt'it Perëndisë,  
 Pranë Muhamet-Aliut,  
 Lëçin shpirt i Zotnisë!

.....

Komb'i kombeve do ngallet!  
 Sado që është sot i vdekur,  
 Drit'e Zotit do të çpallet!  
 Se e vërteta dërmon hekur!

**Dushi H.Jorgobaba**  
*(1878-1903)*

*Ka lindur në  
 Vlorë. Gjyshi i tij kishte  
 ardhur nga Voskopojë.  
 Ishte mjaft i talentuar vdiq  
 25 vjeç. Ishte shumë i dhënë  
 pas çështjes kombëtare,  
 përhapte abetare të gjuhës  
 shqipe. Prej tij kanë mbetur  
 pak shkrime, por që  
 tregojnë për  
 atdhedashurinë dhe talentin  
 që u shua para kohe.*



**Filip Shiroka  
(1859-1935)**

Lindi në Shkodër  
dhe vdiq në Bejrut. Mësimet  
e para i mori në vendlindje.

Më 1880 mërgon në Egjipt.

Nga 1887 fillon të botojë  
vjersha në shypin e kohës.

Përdori pseudonimin Gegë  
Postriba. Ishte mik i  
ngushtë me Çajupin. Botoi  
më 1933 vëllimin me poezi  
"Zani i zemrës".

**Ne vdeken  
e ndritshmit  
shkronjtar shqiptar  
Naim Frashërit**

*Lugete...mortus est.  
Catullo*

Nji za i trishtueshëm erdhi tui  
gjimue,

nis prej Stamollet, porsi rrfe  
kaloi,

N'qytet të Korçës u hap tuj  
vajtue:

-Vdiq Naim Begu që Shqipënин  
lulzoi!

Ky za i përvajshëm, andej tui  
flutruar

malet e Shqypnis tek e tek  
depërtuar

-Naim Beg Frashëri ai që ka  
nderuar

Shqypnin, ka vdekun, e shqyptart  
mjeroi!

Lkund, prej ktij zanit të  
helmuem, Shqypnia  
zij e vesh e kryet me pëlhir t'zez  
mlor;

qan me lot, si qan nji nanë q'i  
vdes fmia:


-Naim Beg, tha, vdeka e yte  
m'shëmtoi!...

-Naim Beg, tha, ti që shum' ke punue  
me m'ngjallun gjuhën shqype, që shkjepoi;  
gjuhën e vjetër timen ke lulzue...  
e... fat' i zij' imi, sot mejet t'largoil!-

E...me dor të dridhun, në at' rras t'lumnue  
që shkrun Birt e Mdhai, këta fjal' i shkroi  
“Naim Beg Frashëri, Shqyptar i Nderue  
Atdhetar i vërtetë, unë kurr'nuk t'harroj!”  
1901

---

**“Zani i zemrës”, Tiranë, 1986, f.101-102**



**Shtjefën Gjeçovi**  
*- Mësues i Popullit -  
(1873-1929)*

Lindi në Janjevë të Kosovës. Mësimet e para i mori në vendlindje. Gjimnazin e filloi në kolegjin Françeskan të Troshani dhe e kreu në Bosnje. Studimet teologjike i kreu në Kreshovë të Bosnjës. Më 1896 emërohet meshtar në Tiranë. Më vonë shërbeu në shumë fshatra të Klinës, Pejës, Kurbinit, Mirditës, Durrësit, Vlorës, Shkodrës, në Zarë dhe në fshatrat e Hasit të Thatë, ku vritet tradhtisht. Zhvilloi veprimitari të gjithanshme shkencore, kulturore, letrare. Përgatiti e botoi veprat "Dashunia e atdheut", "Jeta e Shën Luçisë", "Agimi i qytetënise", "Një argëtim arkeologjik", "Sébaste n'Armeni apo n'Arbëni", "Trashëgime Thrake-Iliriane", "Kanuni i Lekë Dukagjinit", si edhe la një sërë veprash në dorëshkrim.

## **Naim Bujar Frashërit**

1.

Prej sysh po m'derdh'n lott e idhta,  
Nji dhimt në zemër po m'mundon.  
Mendt s'i shof, si pë'r her' të kfillta.  
Shpirtin n'jet, as 'i send s'm'a gëzon.

2.

Rreth përreth i shof t'errue  
T'gjitha male t'vobeks Shqypni  
Rrezet dilli s'a tuj lshue,  
Zemrat si p'rher m'na pértri!

3.

Asht zburit, 'dhe drit'e hanes,  
Krajatën ton, tuj mjerue,  
I asht hup gaz i mirakanes,  
Gj'mimet tona tij veshgue

4.

Burr shpirt-madhi, na ka vdekun:  
NAIM FRASHERI trim bujar;  
Vdek' e Tij mbar na ka thekun,  
-Ç'n'u dur q'i madhi Atdhetar.

5.

O Drit' e bardh, shpejt prendove,  
 Ne na la me i derdhun lot:  
 Me t'duk'nin Tand, na vorfnove  
 N'vaj do t'na shkojn ditt n'ket bot.

6.

Dashtnia t'shtyni, vdek'n me shkel  
 Për pshtim t'Shqypnis,jeta s't'u dhimt;  
 Tash Shqypnia pa Ty ka ngel,  
 Me krah t'kput, e me zemër gjymt.

7.

Na vdiqe, Drit, na la o Vlla,  
 T'met'nat ç't'man, i lum' aj dheu!  
 Punt' ç'i nise, s't shkuen vra m'vera,  
 N'bot t'njifen, t'i njef Atdheu.

8.

Për Ty kjan e kndon Shqypnia  
 Kjan për Ty, qì s't'i ka ma n'jetë;  
 Zemra i kndon, përse dia  
 Mas vdeks ate n'jet ka metë.

9.

Emn'i Jot, s'ka m'u harrue,  
 Sa koh t'ndrrohet gjithësia  
 T'gjith Shqyptart kan me t'bekue,  
 Se p'r Ty. Shqypnis i erdh dia.

10.

N'dashtni t'vendit qe shum i xet  
 Me shpirt për gjuh' u mundove  
 N'pushim na qofsh! Se gja s'la met  
 Për lulzim t'gjuhs, mjaft punove.

11. E kur t'vin koha ç'p'e presim...  
 Vorr'i Jot ngrehet n'pomendar  
 Kto, fjal, ktij, n'ball do t'ja njesim:  
 "NAIM FRASH'RI A KTU SHQYPTAR!"

***Lkeni i Hasit***

**23.VIII.1901**

**"Albania", Nr. 10. 1901, 15 tetor, f. 146-147**



Thoma Avrami

Lindi në Korçë. Bashkëpunoj me organet e shtypit në mërgim. Drejtoi gazeten "Përlindja shqiptare" në Bukuresht më 1903 dhe revistën "Besa" në bashkëpunim me Milo Duçin në Kajro më 1904. Shkroi vjersha dhe i batoi në revistën "Shqipëria" të Bukureshtit dhe "Albania". Më 1908 ishte delegat i Korçës në Kongresin e Manastirit. Shumë vjersha të tij u botuan nga Visar Dodoni në përmblehdhjen "Mjalt' e bletës" më 1898 në Bukuresht.

## **Vajtim mbi var' Naimit**

Po, vdes dhe shuhet kandil'i jetës'tija!  
Lulja q'e këndonte sot, e venitur bie,  
Mbi fytyrën e verdhë; dhe vetëm shkëndija,  
E yllit ti q'i ndritte në çkëlqim i shtie!  
Mbi var'e ftohtë, ku, trupnë e ti le  
Ta haj i zi dhe!

Të têra ju fusha, dhe ju male të lartë,  
Bashkë që të gjithë zini sot me qa,  
Vjershëtor'e urtë që si lul'e thatë,  
ler mbi dhe ka rënë dhe jetë më s'ka!  
Qani! qani gjithë! qani me vajtim

Se shkon pa gëzim!  
Shkon! Shkon dhe ikënë, ku fati e shpie,  
Veç një lam-tu-mirë, për jetë ne na le,

Me buzën e dredhur, që sot s'i ka hie  
 Se nuk' ësht e qeshur si ç'ishte dhe die!  
 Ikën edhe më s'kthehet! ndahet fare nesh,  
 Buza më s'i qesh!

Ah! nu'i qesh buza i ç'i queshte nj'herë,  
 Po fort të helmuar duket që ta ketë,  
 Se dëshirën që kish për Mëmëdhen'e mjerë,  
 S'mundi ta mbaronjë sa që kishte jetë!

S'mundi! S'mundi i mjeri! se n'i ndyr, Dhespot  
 S'e e la të vejë dot!  
 S'e la të mjerin Dhespot'i mérzitur  
 S'e la dhe në hare të shohë atë vend,  
 Shqipërinë e dashur, vendin ku ish,  
 Që ne shumë mall për herojtë i sillte ndër mënt!  
 Me mall!... dhe zemrën e kishte të zhuritur.  
 Për vendin q'ish rritur!

Qani ju o brigje! Qani ju moj kodra  
 Qani e vajtoni vjershëtorin e mjerë  
 Që me shumë gaz e me shumë lodra  
 u kish xhatitur, kaq mijra herë  
 Qani mikun tuaj, qani pa pushim  
 Se shkon pa gëzim.

*"Drita" -Sofje, 1902, kollozhek, 5/19.f.314*



## Naim Bej Frashëri

Vdiq Naimi, vdiq Naimi,  
moj e mjera Shqipëri!  
Mëndje larti zemërtrimi,  
vjershëtori si ai!

Vdiq Naimi, po vajtoni  
Shqipëtarka, Shqiptarë!  
Naimnë kur ta kujtoni,  
Mos pushoni duke qarë!

Vdiq Naimi, Naim Beu,  
vate te zot i vërtetë!  
Qysh u nda nga mëmëdheu  
dhe iku e la për jetë?

Vdiq Naimi, gjithë thonë,  
qani turq, qani kaurë!  
bilbil' i gjuhës tonë  
s'do të dëgjohet më kurrë!

Vdiq Naimi, që këndoi  
trimërinë, Skënderbenë;  
vdiq Naimi që lëvdoi  
dhe nderoi mëmëdhenë!

Vdiq Naimi, po ç'të gjeti,  
o moj Shqipëri e mjerë!  
Vdiq Naimi, po kush mbeti?  
Si Naimi s'ka të tjerë.

Vdiq Naimi, vdekje e shkretë,  
pse more të tillë burrë?  
I ndritë shpirti për jetë  
mos i vdektë nami kurrë!

**"Baba Tomorri", Kajro, 1902**

## Andon Zako Çajupi

(1866-1930)

Lindi në Sheper të Zagories në rrethin e Gjirokastrës, vdiq në Heliopolis, qytet pranë Kajros. Mësimet e para i mori në vendlindje, gjysëm të mesmet në Nivan. Më 1882 shkoi në Misir pranë të jatit ku kreu Liceun në Aleksandri. Në Zvicër mori studimet e larta dhe titullin e Doktorit në Drejtësi. Hartoi dhe botoi veprat "Duke kërkuar një alfabet", "BabaTomo-rrri", "14 vjeç dhëndër", "Klubi i Selanikut", "Burri i dheut", "Kënga e vome", "Pas vdekjes". Ai zhvilloi dhe një aktivitet të gjërë patriotik dhe shoqëror në mbrojtje të çështjes së lirisë dhe pavarësisë së vendit.

*Një i vogël  
shpërblim për të  
madhin punëtor*

Udha jote gjëmba e ferra  
Hoqe mundime sa i qërove  
Shkarpa, mërqinja, driza të tjera  
Si trim me fletë përmbi to shkove.

Udha që zure qe plot mundime  
Plot thashetheme plot ngatressa  
Të kundërshtonin nd' ato qëllime  
Po të dhanë dorë guxim e shpresa

Donje të hiqje një errësirë  
Prej vendit tënd që kish mbuluar  
Prej mëmëdheut që kishe mbirë  
Ti ndizje dritë për ta ndrituar

Si një shëronjës i mirë shumë  
Që të sëmurit i rri mbi kokë  
Po si bariu që rri pa gjumë  
E ruan dhënt vetëm pa shokë

Prej të Vërtetit jeshe urdhëruar  
Që ti shërbenje kështu njerëzimit  
Moti ty radhën ta pat lëshuar  
Që të ndesç dritën për Shqipërinë

Vendi që rrinje qe i mërzitur  
Lodhje e ndalime të sillte shumë  
Prehjen tënde ta kishte ngritur  
Sa gjithë natën rrinje pa gjumë



**Jani H. Vruho**

(1863-1931)

Lindi në Vërtop të Beratit.  
Shkollën fillore e kreu në vendlindje. Pas shtypjes së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit u detyrua të emigrroi. U vendos në Egjipt ku u njoh dhe bashkërendoi veprimtarinë e tij patriotike me shumë patriotë të tjera. Deri më 1910 ai botoi 3 gazeta, "Shkopji", "Spata", "Rrufeja" me titujt e të cilave krijoi shprehjen proverbiale kundër armiqve: "Me Shkop t'i godasim, me Sopatë t'i presim, me Rrufe t'i shfarosim". Me shkrimet e tij fshikulluese si dhe me poezitë e tij luftarake që botoi në "Kalendarin Kombiar" dhe "Liria e Shqipërisë", ai u bë një pengesë kryesore ndaj armiqve, prandaj dhe ata e dënuan me vdekje në mungesë.

Po s'është thënë pér trimn e jetës  
Që ta ndalojnë ato ndalime  
Dëshërimtarët e së vërtetës  
I ndih Perëndia nd'ë ato qëllime!

Prej gojës sate buronte mjalt  
Shkrimet e tua kudo shkëlqejnë  
Fjalët e tua qëllimi i nalt  
Shpirt-mirësinë tënde dëftejnë

Dëftejnë shpirtin zemrën'e gjerë  
Dhe dhemshurinë pér njerëzinë  
Çudi e fisit çfaqet e tërë  
Që të kish dhënë pér Shqipërinë

Çudi e madhe fuqisë së lartë  
Punët e saj asajt tregohen  
Ndritin, shkëlqejnë si yll i zjarrt...  
Hapen mbi botë dhe më s'harrohen!

Në jetë kurrë shpirtmadhësia  
Jote s'harrohet, o burr i flakt  
Gjersa të jetë gjallë njerëzia  
Do ta kujtojn qëllimn' e nalt

Çudi e madhe! Pse më të rrallë?  
Si ti njerëzia dalin ndë bot  
Nuk është thënë së larti vallë?  
A errësira i le të ftohtë?

Ah! E padia bushtër e vjetër!  
Me robrinë shoq është bërë,  
Po i ka tharë e i ka tretur  
I ka mahnitur njerzin e tërë

Përrallat' e shuma fjalët' e kota,  
 Mbi njerzinë apin e marrin  
 Prrallat gënjeshtrat shpikjet e plota  
 Gjinden e mjerë në balt' e ndalin

Me thashetheme kohën e shkojnë  
 Me prallat shpresojn të gjejn dritë  
 Kshtu njerzinë e ngatrrojnë  
 Nata të zezsvet u duket ditë

Uthull e thart mjalt u duket  
 Dhe bari i miut plot ëmbëlsirë  
 Pa fanatizma në palc u futet  
 Shpirtin e tyre ua bën shëllirë

Driza dhe ferra për njerëzinë  
 Dit për dit sa mundin shtojnë  
 Punë të mbarë fatkeqsinë  
 Përveç ksaj pra gjë tjetër s'bojn

Gjer kur pra vallë njeriu i mjerë  
 Këta të çmendur do t'i nderojn  
 Pse vetvetiu e shton tmerr  
 Dhe vetveten s'do ta shpëtojë?

Njerzi e mjerë! Veç *dituria*!!  
 Në të shpëtoftë në këtë jetë;  
 Pa prallat s'nxjerrin veç të këqia  
 Kurre s'tregojnë gjë të vërtetë.

Fuqia e lartë shtiftë një ditë  
 Për njerëzinë që të ndritojë  
 Se kanë rënë shumë në shkitë  
 Tjetër veç mësimit s'mund t'i shpëtojë

Për këto vove me kombin tënë  
 O beu ynë burri i vërtet  
 Që gjumi i rëndë e kishte zënë  
 E në errsirë i gjori kish mbet

Me një dëshirë Naimi ngreu  
 Këto qëllime të mëdha shumë  
 Gjum e rëndë këshu e zbërtheu  
 E zgjoi Kombin se la në gjumë!!!

**Drita 1902**

## Vjershë (Vajtim)

U mbushën tre vjet për katër që Naimi  
 Frashëri ndroi jetë, sa shqiptarë kanë ligjëruar  
 librat e të madhit vjershëtor. Pa dyshim bota e ka  
 kuptuar që Naim Beu e meritonte të quhej "i madh".  
 Çdo shqiptar detyron ta kujtojë Naim Benë se ky  
 qe dhe është laudimi i gjendjes shqiptare të  
 shekullit të shkuar. Duke kënduar shkrimet e të  
 madhit vjershëtor, shpirtërisht sheh që shfaqet  
 para sysh një njeri kombdashës, liridashës, i  
 dhëmshur, i qetë, urtësiplot, njerzidashës, i drejt  
 dhe i qëllimnalt.

I madhi vjershëtor mbaroi një rrojtje të  
 turbulluar dhe plot breng, d.m.th. shoi ditën e  
 shtunë më 7 vjeshtë e dytë 1900. Kjo e vështirë  
 vdekje le që të afërmisht e Tij e fëmijën e shpirtmadhit  
 Naim Beut i pikëlloi po shtiu në zi edhe shumë  
 zemra shqiptare që kishin kuptuar vlefthen e tij.

*Sido që e dobët pena ime s'mund ta çpaguaj asnjë përmijë mbi vlefshen e paçmuar të tij; por me sa m'u dha bëra këto të pakta radhë që t'i ap ndjesë t'et të vjershërisë shqiptare.*

**Autori**

**O** vjesht' e dytë, o mot i tretë,  
Që na përmbyse një shpirt të bukur,

Ku vallë e shputë? Ku vallë e fshehtë?  
Në gjë të Zotit! A ku ësht' futur?

Mbetëm të shurdhër, s'dëgjojmë Naimnë  
Që të vjershëtojë si kish zakonë.

Të përkëdhelnj pra Shqipërinë  
Vent' e Perëndishëm, vendlermin tonë!

O shpirt' i dëshpëruar! Qysh na harrove  
E na le vetëm të dëshpëruar!

Qysh s'të edhi keq? Po u ngrit' e shkove,  
Për Shqipërinë qe keshe vuar!

I dhe shpirt gjuhës, prapse të ligën,  
Udhën e drejtë njerëzis' i mësove.

Pa reshtur fare, gënjeshtrën -shtrigën,  
Sa jeshe gjallë shum' e leftove.

Gjuhën qerove, i dhe shpirt kombit,  
Dhe vjershërin' e ngjalle për jetë!

Zog i Zotit! Kish' e Dodonit!  
Penë Pellazgu, burr' i vërtetë!

Shumë u mundove për Shqipërinë  
Sa gjithë natën rrije pa gjumë,

Ngrite në qiell, lart vjershërinë,  
T'ecim të gjithë, mbi tënden gjurmë!

Unë me sorrat<sup>1)</sup> qëshe përzjerë,  
Uthull' e thartë më dukej mjaltë,

Nga udh' e shtrembër, Ti më ke nxjerrë;  
Ti ma tregove shenjën e naltë!

Sa jesh gjallë, me sy s'të pashë  
Po me të shkruar, të kuptova

Si Naim beu ndë botë thashë,  
Do mos ketë!- Dhe s'u gabova.

Fort më të rrallë, me të vërtetë,  
Të tillë burra i shikon dheu,

Pra nga të rrallët dhe pa të metë  
Për Shqipërinë qe Naim beu!

Shokë e vëllezër, o Shqiptarë!  
Ky shpirt i shenjtë s'duhet harruar,

Se na tregoi udhën e mbarë,  
I ndritët balta, ku është mbuluar!

**Egjipt, 1903**

**“Kalendari Kombiar”, 1904, f.99-100**

## Naim Bej Frashëri

**S**i një yll shum' i çkëlqyer  
Që natën ndrit me ëmbëlsi  
Dhe çon dritë të pëlqyer  
Kudo që është errësi;

Porsi lule bukur çfaqur  
Tërë kopshtin që zbuluron,  
Natyrën duk' e kënaqur  
Me erën e saj që lëshon;

Ashtu dhe Naimi ndriti  
Mi qiellin e Shqipërisë,  
Errësirën ia ngriti  
Gjuhës edhe Kombësisë.

Qaje, Shqipëri e mjerë,  
Lulen e bukur q'u shua,  
Atë vjershëtor të ndjerë  
Që këndoi trimnit' e tua!

Me një zë të perëndishmë  
Ty të lëvdoi mirësitë,  
Të dha jetë të dobishme,  
Të solli një rreze dritë!

Me një mall të pashtëruar  
Të ngjalli e të dha jetë,  
Për gjuhën duke punuar  
Si shqipëtar i vërtetë!

Përandaj kombi i tërë  
Qan me lote pa pushuar,  
Për shërbimet q' i ka bërë:  
Për jetë duk' e kujtuar  
**Rreze Dielli, 1904, f.94-95**



**Aleksandër  
Stavre Drenova  
Asdreni  
(1872-1947)**

Lindi në Drenovë të Korçës. Vdiq në Bukuresht. Gjimnazin e kreu në Korçë. Më 1889 shkoi në Rumani. Ai është autor i "Hymnit Kombëtar" si dhe i vëllimeve poetike: "Rreze dielli" 1904, "Endrra e lotë" 1912, "Psallmë murgu" 1930 - Bukuresht. Vepra e tij është ribotuar në Tiranë dhe në Prishtinë

## *Fyelli*

*Kushtim dëshirës së pa shuar të Naim Frashërit  
për Bagëtin e Bujqësin' e Shqipërisë*

**O** fyell, t'adburonj me mall e besë,  
Se bashk' me zërin t'end hyjnor jam rritur  
 Që kur se njoha djalëri,  
 Se ti në shpirtin t'em ke derdhur vesë  
 Në kulme gazi ndjenjat duk' n'i ngritur  
 Me një të rrallë dhembshuri!

Me tyn' e ndjeva mallin e pa-shuar  
 Të dashuris së tokës arbnore,  
 Q'e kam për dita n'ëndërrim,  
 Me tingëllin t'end kujtim- i kohës shkuar  
 Nër mentt më shkon me plot flladi verore  
 Dhe me të thellë ngazëllim!

Ti kur i-a mbush me plot e kur i-a thua  
 Sa zërat ven e vinë, palë-palë,  
 Si valle vargut ëngjëllor,  
 Si shok në ze ke kodr, e mal e prua  
 Porsi prej gojë Zane t'jet' i dalë  
 Prej njej pallatit madhështor!

Qysh drit' e hyllit shket mi rreze hënë  
 Me faqet e liqenit duk' u çmallur  
 Mi drithma droje si dashnor.

Dhe verbi-i yt, lajmtar i njëj së Thëne  
të bukurës së Dheut me zë të çpallur  
Blaton n'er në fullim veror!

Kurse prendvera gjiret nis t'i çelë  
Dhe me t'i hapur krahët e saj të gjërë  
Na jep fuqi dhe hir qjellor,  
Dhe ti, kur gishti gamat nis t'i shkelë  
I jep të re fytyrë botës tërë  
Krijon rrëth nesh një kor gasmor!

Bariu me ty ner bjeshkat del e çmallet  
Me vaje tingllesh, vaje plot magjije,  
Ç'do zjarr të zemrës që j'a tret,  
Me ty të rintjtë radhas heqin vallet  
Të shtyrë prej së shenjtës dashurije  
Në gjinjt' e saj gjithmon' q'i pret!

Sikundér gjethet hollë dridhen n'erë  
Aq' sa nga drithm' e tyre këngë çpallen  
Duk trajtuar harmoni,  
Dhe zërin t'end kushdo q'e ndjen për herë  
Kujtimet e harruar prej' i ngallen  
Mu si nj' e qjelltë symfoni!

Del bujku ngul parmëndën, shpinë thyer,  
A korr kallinjt' e pjekur bukë-prurës  
Q'as vetë s'di për kë dërsin,  
Me ty çdo brengë' i shkon duk' u shdëfryer,  
Sikundr' i shkon edh'etja n'ujt' e gurrës  
Q'e kap me grusht edh' e përpin!

Dhe prindërit t'an' e kohës së larguar  
Me ty në brest; e shpatë që përdornin  
J'a mbushnin këngës plot me zjarr,  
Nër luftrat trimëri duk' e flakruar

Gjithmon' kurorë mundëje të korrnin.  
Si ç'korre Leka Legjendar!

Plot andje dhe Minerva, Perëndesha,  
Me tyn' e shkonte kohën nér dëfrime  
Lart tek Olympi shkrepimtar,  
Dhe Nymfat rrëth e rrötull si Hyllesha  
Me valle çap-ruthmike dhe kërcime  
Ndërsenin Bakhun<sup>1)</sup> zilitqar!

Virgjili, mjeshtër, këngëtor me famë  
Nér shekuj aq' të vjetër e qysh Mozarti  
Prej teje bëjtin shenjt alltar;  
Me tyn' endrijtnë popujt q'as i panë  
T'ushqyer idealesh që së larti  
Prej një Burimit shpëtimtar!

Sado të tjerë sot t'a zunë rendin  
Si shenjt' e re të njëj qytetërimi  
Që s'njeh në botë kundërshtar,  
Por vjershëtorët hymne ty prap't'endin  
Se mi të gjith' prap' ti plot forcë-trimi  
Qëndron, o fyell, magjistar!\*)

*“Naim Frashëri”, (Graz) Austri 1925,  
f.36-38*

*1)Bakhun.. Baku, një prej emrave të Dionisit të grekëve të lashtë, perëndia e bimësisë, mbrojtës i rrushit dhe i verës, një nga perënditë më popullore në Greqinë e vjetër.*

*\*) Nga shënimet që janë në original dhe janë ripunuar në disa variante, (mbi katër) del se poezia është shkruar më 1924, bila ka mundësi edhe më herët. (Shënim i Red.)*

### **Hil Mosi (1885-1933)**

Lindi në Shkodër e vdiq në Tiranë. Mësimet e para i mori në vendlindje. Shkollën pedagogjike e kreua në Klagenfurt të Austrisë. Botoi me pseudonime Zog Sokoli, Lek Dushmani, Liriasi. Më 1900 kthehet në Shkodër. Merr pjesë në Kongresin e Manastirit. Në Korçë themeloi shoqërinë "Vëllazëria". më 1910 punon në Stamboll si redaktor i gazetës "Shqiptari" dhe më 1911 merr pjesë në kryengritjen e Malësisë së Madhe. Në Shkodër nxjerr gazeten "Shqipnia e re", iniciator dhe pjesmarrës i "Kombsisë letrare", delegat në Kongresin e Lushnjes, përfaqësues i Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve, u ngrit deri në detyrën e Ministrit të Arsimit. Botoi veprat "Këngat shqipe", "Zani i atdheut", "Lotët e dashtnis", "Libër këngësh", "Lule prandvere".



### **Naim Beut**

**N**jashtu si shqypja nalt tue fluturue  
Që përmbi re çohet me krahët e veta;  
Kshtu ti, Naim gjuhën ton' nalt ke çue,  
Sa me u ngall' filloi, e me i dalë jeta.

Vjershat tueja han' njikaq mir' rrjeshtue,  
Sa shpeshherë gzue e habit mbeta,  
Kur un' rrishe me gëzim tue i kndue;  
Se ti mjaltën ke mbledhë porsi bleta.

Ti diqe, edhe ksaj bote je largue,  
Që e vështrishme e rrjeshme asht e shkreta...  
Por ti prap mundesh me u kundene

Se vjershat tueja janë nji kaq të nxehta,  
Sa prej shqyptarëve nuk ka me u harrue  
Emni jot, deri sa të sosetjeta.



**Petro Nini  
Luarasi  
-Mësues i Popullit-  
(1865-1911)**

Lindi në Luaras të Kolonjës  
dhe vdiq në Ersekë i  
helmuar nga shovinistët  
Më 1882 filloi të mësojë  
fëmijët në gjuhën shqipe në  
shkollën e Bezhani. Ishte  
një nga mësonjësit e  
"Mësonjtores së parë  
shqipe". Eemigroi në ShBA  
ku ishte nismëtar i  
shoqërisë "Malli i  
mëmëdheut". Më 1908  
kthehet në Atdhe ku  
vazhdon punën e tij  
atdhetare. Botoi poezi,  
poema, shkrime  
publicistike dhe që të gjitha  
trajtonin çështje kombëtare  
shqiptare.

## Vëllezërit Frashëri

*(Fragment)*

O Dritari me tri krye,  
Abdyl' e Naim Frashëri  
Dhe Samiu q'u përdëllye  
Janë vëllezër Shqiptarë.

Abdyli, burr' i shënuar  
Rrëzoi nyjin e Berlinit;  
Naimi poet i lëvduar  
I vuri kufi rrëzimit.

Sami shkronjës i rrallë,  
Shqiptarët për të zgjuar  
Shkroi një profet të gjallë  
Që duhet për të kujtuar.

U ndritët shpirti në quell  
Edhe qoftë për ne ndihmë  
U bëfshi dhe Diell,  
E ndritofshi Shqipërinë!

**"Petro Nini Luarasi, Jeta e vepra"  
1958, f.111**

**Mihal Grameno****-Hero i Popullit-****(1872-1931)**

Lindi dhe vdiq në Korçë. Mësimet e para i kreu në vendlindje. Që fëmijë emigroi në Rumani. Ishte sekretar i shoqërisë "Drita". Mori pjesë aktive në kryengritjet e zhvilluara kundër pushtuesve të huaj. U burgos disa herë. U hë i njojur si publicist, poet, dramaturg, novelist etj. Drejtoi disa gazeta dhe botoi disa libra si: "Mallkimi i gjuhës shqipe", "Vdekja e Pirros", "E puthura", "Oxhaku", "Varri i pagëzimit", "Këngëtore shqipe". Libri "Kryengritja shqiptare" është një nga librat më të mirë të letërsisë dokumentare shqiptare.

**Naim Frashërit**

**Si ty o Vidhehem, e Mek' e Arabisë  
Që kini lerë Muhamet, e Krisht të krishterisë  
Eshtë për mua Frashëri, vent i Perëndisë  
Atje ka lerë Naim beu, zemr' e Shqipërisë!**

Ay ish ëngjill rënë mi dhe për ta ndritur kombinë  
Edhe ta nxjerrë në liman, si Moisiu me shkopnë  
Vëllazëri e dashuri, t'u apë e kërkojnë  
Nga gjumi Shqipërinë, t'zgjojnë e lirojnë.

Të qofshim falë atje ku je, o egjell' i pavdekur  
Ty që eshtrat kurrë-kush, s'janë për të tretur!  
Gëzo ti zemrën e dëfre se farën që ke hedhur  
U rrënjos mirë e lulëzoi, një pemë fort të celur

Mi gjitha anët nuk dëgjon, përveç se muziqinë  
Duke kënduar emrin tënd, ashtu si Perëndinë!  
Se ti, o ëngjell tinë na le, të njohëm kombësinë  
Edhe të vdesëm me gëzim, për mëmë Shqipërinë.



## *Që kur dolli Naim Beu*

Që kur dolli Naim Beu  
Ra një vesë e u zbuti dheu,  
Edhe fara që ka mbjellë  
Shumë lule do të pjellë.

### *Spiro Dine*

(1844-1922)

Lind në Vithkuq të rrethit të Korçës dhe vdiq në Misir të

Egjiptit. Ish nxënës dhe bashkpuntor i Thimi Mitkos.

Mbas tij është një nga folkloristët më të shquar të vendit. U morr gjerësisht me veprimtari atdhetare. Mblodhi folklor dhe shkroi vjersha të cilat i përmblodhi në vëllimin "Valët e detit" e botoi më 1908 në Sofje.

- *Nga parathënia në dorëshkrim "Valët e detit", që gjendet në Bibliotekën e Korçës. -*

## *Prej një letre...*

Zoti A.Çajupi më rroftë, Që me një letre më thotë:  
"Kaq dita, kaq thashë;  
"Të kujtosh shqipen si mjaltë,  
Me zë të mir'e të naltë.  
"Si Naimi të këndosh,  
"Të zesh vendin që la bosh;  
"Dhe t'i thuash Shqipërisë;  
"Të zerë udhën e Lirisë!  
Sado rrojti nënë zgjedhë,  
"Do t'i thuash të na mbledhë;  
Të shpëtojmë vendin tënë  
Të jemi si kemi qënë..."

"*Valët e detit*", Sofje (Bullgari), 1908, f.197.

## *Para fëtyrës Naim Frashërit*

Fëtyr, o fëtyr, hie gjeniu!  
 Ti s'kie mish as'kie gjak...  
 As'që je mvhesh në korp njeriu,-  
 Për me hap gojën e me m'fol pak.

Nuk të kjemi me. ah! nuk gjallon;  
 Oh! keq të ndrypi mordja e zezë!  
 Po Shqypenia kurrë s'të harron,  
 Se me t'vërtet Ti e ki ndezë...

Kush mund me msheh shërbimin  
 Tënd?  
 Liberat me vjersha, Ty predykjon;  
 Ton Shqypenia me kta u trond!...  
 Dhe ty gjithnjë kenk do  
 t'këndoijnë...

Ka me u hup, dora tradhtor;  
 Po emni yt, kurr s'harrohet;  
 Vjershat ç'ke shkru,  
 Ti o vjershtor!

Dhe tradhtori sot pendohet...

"Shqypje e Shqypnis", 1.7.1909, f.4.



**Josif Bageri**  
**(1870-1915)**

Lindi në fshatin Nistrovë të Rekës dhe vdiq në Prishtinë. Më 1887 emigroi në Bullgari ku punoi si këpuçar. U shqua për veprimtari patriotike në gjirin e kolonisë të shqiptarëve të Bullgarisë. Është një ndër themeluesit e shoqërisë "Dëshira" dhe "Afron dita". Gjatë viteve 1909-1911 drejtoi gazetën "Shqypja e Shqypnis". Më 1914 kthehet në Atdhe dhe drejton gazetën "Ushtima e Krujës" që botohej në Durrës. Krijimtarinë letrare e përmblodhi në veprën "Kopsht malësoni" që e botoi në Sofje më 1910.

*Z.Prifti**Naim Bej Frashërit*

**F**rashëri katund i bekuar  
 Zoti ty të ka uruar  
 nga ty dolli yll me dritë  
 qe i ndriti Shqipërisë.

Naim engjell i vërtetë  
 që punon pa të mettë,  
 si të miret për njerin  
 edhe ti për Shqipërinë!

Gjithë të mirat tanë  
 se vërtet as kujtim lanë,  
 dhe Naimi i shenjtëruar  
 kurrë në jetë s'do harruar

Zotërinj u qofsha falë  
 për të drejtën kusur s'latë  
 të vërtetën e ngjalltë  
 kush me fjalë e kush me pallë.

Dhe Naimi kështu punoi  
 për Shqipërinë dëshiroi  
 shpat e tij na qenka penda  
 tiraninë seç e trembka.

Si ti vjershtar i ndjerë  
 mund të ketë dhe të tjerë  
 por për mua Shqipëtarë  
 si ti janë fare të rrallë

*Buenos Aires*

*Kalendari Kombëtar, 1908, f.120*

*Anonim**Kujtim*

*Kjo vjershë u qjet në zyrë të gazetës  
"Korça" në Korçë*

O Zot i madh i vërtetë  
Të falemi madhësisë  
Se tjetër Zot s'ka në jetë  
Ti je at'i gjithësisë.

Ma kini kujdes Saminë  
Dhe Abdylë e Naimnë  
Që punuan për lirinë  
Që nderuan Shqipërinë.

Abdul, trim i madh me fletë  
I vllaj Samiu me pendë  
Naimi si qengj i qetë  
Kishin të tre një kuvend.

Mendje tyre fort e lartë  
E ndriturë e çkëlqyer  
E mprehurë si sëpatë  
Në gjithë botën e pëlqyer.

Nat'e ditë gjith' punonin  
Edhe te drejtat kërkonin  
Rrytbe, nishane s'veshtronin  
Ligësitë largonin

Të gjithë ne Shqiptarët  
Më të dashur këta kemi  
Këta janë më të parët  
Rrop'i tyre neve jemi

Në hijetë të këtyre  
Flasim gjuhën edhe shkrojmë  
Dëbuam jetën mynxyrë  
Të drejtat po i fitojmë.

Ngrini duart edhe thoni:  
“O Zot i gjithësisë!  
I botës, i Shqipërisë!  
Këta tre rophit’ e dashur

Këta mirë vetijes patur,  
Lumtëroji n’atë jetë  
Siç qe janë të vërtetë,  
Tregoju vendin më të parë  
Të jenë nga shoket të ndarë”

Na përpara gjuhën tonë  
Se mendjetë na i ndriço  
Mos na lerë si kemi qenë  
Udh’të dreqtë ne na trego.

**“Kalendari Korçës” viti 1911,  
f.22-23**

***Ramadan Duksi******Naim Bej Frashëri***

Qaj moj Shqipëri e mjerë,  
 Për atë vjershëtor e ndjerë,  
 Që iku e të la,  
 E një fjalë dot s'të tha,

Se i miri shum' ka punuar  
 Shum' ka hequr e shum' ka vuar,  
 Për ty moj Nën' Shqipëri  
 Po nashti iku e të la në zi

Qani të gjithë ju shqiptarë  
 Ju të vërtet trima atdhetarë  
 Qani se ai iku e na la  
 E një fjalë dot s'na tha.

Zemrat shum' na i helmoi  
 Se për jet' na la e shkoi  
 Të gjithve shum' na ka helmuar  
 E asnjë s'ësht i gëzuar.

Shum' në helm jam për at' njeri  
 Që ishte shumë i ndjerë në Shqipëri  
 Çdo njeri qan me lot shum'  
 Që iku e na la për lum.

Qaj moj zemër imja qaj me lot  
 Se me atë vjershëtor s'piqem dot  
 Se për jet' un u ndash  
 E me sy dot nuk e pash.

Po vetëm në fotografi kam parë  
 Dhe syt me lot m'u mbushën për të qarë  
 Lotët un' s'mundem t'i mbaj  
 Po me zë zura të qaj.

***Në mërgim, më 17.X.1911***  
***Kalendari Kombiar viti 1913, f.99-100***



**Sali Butka**  
**(1852-1938)**

Lindi në Butkë të Kolonjës. Ishte një nga luftëtarët e shqar përuajtjen e lirisë, pavarësisë dhe tërësisë tokësore të vendit; luftoi në krye të çetave patriotike kundër pushtuesve turq dhe shovinistëve grek, shkroi dhe një sërë poezish, të cilat u botuan në shtypin e kohës si dhe një pjesë u kthyen në këngë popullore. Veprat letrare e tij është përbledhur nën titullin "Ndjenja për Atdhe" botuar në Korçë më 1920 dhe ribotuar mbas çlirimit.

## *Ngreu o Abdyl, sot nga varri!*

**N**greu, o Abdyl, sot nga varri,  
se t'u mbarua qëllimi,  
koha u kthyen së mbari,  
hidhi syt, nga perëndimi.

edhe shiko Shqipërinë,  
se nga gjum' i rëndë u zgjua,  
përmend Samin' e Naimnë,

ta shohën që u lulëzua,  
te prehen se ishin lodhur,  
më çdo vend që janë ndodhur,  
se përhapën këtë drithë.

Ka detyrë Shqipëria,  
që eshtrat e shenjta tuaj  
t'i ngrenë shpejt nga Turqia,  
mos treten në dhe të huaj.

Në Tomorr t'u përgatitim  
varret një orë e më parë,  
dhe eshtrat atje t'i ngjitim,  
të mos jesim ndënë barrë,

Ndryshe si t'ua shpërbujejmë  
veçse n'atë vend të lartë,  
më mirë s'kemi ku gjejmë  
për ju tre zemërzjarritë.

Dielli për herën e parë,  
m'atë majë shkreptin,  
dhe me sytë e tij të larë  
i ndriçon, u jep shkëlqim.

Edhe ndaj të perënduar,  
dielli prapë i ndriçon,  
Shqipëria e liruar  
dit' e natë iu lavdëron.

*Staraveckë, 25 dhjetor 1913*

*“Ndjenja për atdhe”, Tiranë 1972, f.48-49*

***M.A. Permeti (M. Vejsiu)******Naim Bej Frasheri***

**H**ën' dhe Diell' dhe ti Qiell,  
 Naim Frashërin a e njihni?  
 Për liri ay përpinqej,  
 Ç'kini tani, pse e mshihni?

Të lutem o Balt' e Varrit,  
 Mos i rëndo, lehtësohu,  
 Bëji nder shqiptarit,  
 Dimër verë lulëzohu.

Dhe ti Shi, Dëborë e Erë,  
 Kini mendjen kur xërmoni,  
 Varrin e atij të mjeri,  
 Shqiptarë mos e trazoni.

Ju mbi të kurrë mos shkelni  
 Se keq i vjen njerëzisë,  
 Rreth e rrötull lule çelni  
 Atij Shënjtorit Shqipërisë.

Dallëndyshe kur do shkoni,  
 Prej qytetit ku ka rënë,  
 Përmbi varr rrini këndoni,  
 Këngët shqipe q' ka thënë.

Të ndëgjojë dhe të zgjohet,  
 Të shohë, që Shqipëria,  
 S'mbet njeri nga kush i duhet,  
 Të këndoje librat e tija.

***Ironia botërore******- Idealistik -***

**T**i kur shok ke idealë  
 Dhe punon me aq dëshirë  
 Të pengojnë ca brutalë  
 Gjak prej njerzish për të pirë.

S'u përfille përmbi botë  
 Si dhe Zoti - Krishti i shkretë,  
 Do kujtohesh, po më kot  
 Kur do vdeç e s'do jesh vet.

Krishti lindi për njerinë  
 Nga njeriu u kryqëzua,  
 Ti tregove dhembshurinë  
 Neveritja t'u tregua.

Kshtu pësoi dhe Muhameti  
 Dhe kushdo i drejtë burrë,  
 U shqelmua i vërteti  
 U godit, u ndoq me gurë.

Kujt që gjeti Amerikën  
 Atë vënd pjellor dhe shpresë  
 Me zinxhir ja lidhnë grykën  
 Kur sot bota jep ndjesë.

Dhe për Francën kur përpinqej  
 Një francez e vrau Danton  
 Një kandil askurr s'i digjej  
 Sot nderohet përgjithmonë.



**Ramiz Harxhi**  
**(1897-1966)**

*Lindi dhe vdiq në Gjirokastër. Studioi në vendlindje dhe në Stamboll. Emigroi në ShBA ku punoi dhe zhvilloi aktivitet atdhetar për disa vjet me radhë. Më 1917 botoi në Boston Mass librin me poezi "Ndjenjat e zemrës" i cila u ribotua pas Çlirimt.*

Ja dhe shembull Naim Benë  
Sa ish gjallë ish neveritur  
Por nga vjershat për Atdhenë  
Qëndron lart si yll i ndritur.

Me dyzina atdhetare  
Janë quajtur tradhëtor  
Pasi vdiqn' a janë vrarë,  
Sot vajtohen si therorë.

Te kjo botë shumë hajdute  
Gjejnë raste përfitimi  
Grusht e shqelm për aq të mirë  
Dhe një rojtje prej mallkimi.

Do kujtohet dhëmbja jote  
Po pas vdekjes si i ngratë  
Do të kesh dhe vaj prej bote  
Të vaditet varri i jot.

*Gjirokastër, 1922  
"Valët e Vjosës" Tirana 1923, f.69.*

## Vëllezërve Frashëri (Fragment)

Ish Abdyl Beu fryma-fuqja,  
Dhe shpresë e madhe për Atdhe,  
Po ti Naim Dituria,  
Frashr' i madh për ne.

Ish njeri krahu e kraharori  
Grushti i çeliktë e titan,  
Po kombi dritë nga ju mori  
E sot e ka, e mban!

O ndjesë paçi kryelartë,  
Ndër mëndje frysë e fuqisë,  
Të kombit tonë dëshmitarë,  
Që s'pat shok njeri.

Qofshi për jetë të nderuar,  
Statujat t'uaja në Shqipëri  
Ndrithsin e qofshin adhuruar  
Abdyl, Naim, Sami!

**"Valët e Vjosës", Tirana 1923, f.35**



**Kristo Floqi**  
(1876-1951)

Lindi në Korçë. Mësimet e para i mori në vendlindje, të mesmet dhe ato universitare i kreua në Athinë. Më 1899 u doktorua në drejtësi. Disa vjet e ushtroi avokaturën në Greqi dhe në Shqipëri. I ndjekur nga pushteti turk emigroi në ShBA ku drejtoi fletoren "Dielli", dhe bashkë me atdhetarët e tjera themeloi Federatën Panshqiptare "Vatra". Drejtoi edhe të përkohshmen "Agimi", pastaj fletoren e Amerikës "Zëri i popullit" dhe "Independencën" në Tiranë. Ndërkohë, u mor aktivist me krijimtari letrare. Atështë autor i veprave poetike e dramatike, disa prej të cilave janë vënë në skenë.

## *Mbi ardhjen e eshtrave të Naim Frashërit*

**N**aim mir' se n'ardhe n'Atdhé, q'e dëshrove,  
 Në tokën e shenjtë, te mëma Shqipëri,  
 Ku vjete ëndrronje të shohsh një liri,  
 Që gjall s'e shijove!

Bilbil i Pranverës me Zëthin e naltë,  
 Që kaqe këndove pa çlodhj' e pushim  
 Burrninë Shqiptare, vllazri e bashkim  
 Sot çlodhu, goj-artë!

N'atë arqivolin, të vogël, të çmuar  
 Përmblidhen, ah, eshtrat e shkreta që lë  
 Gjith' ëndrat q'ushqeve për Komp e Atdhé  
 Q' i pate përshkruar!

Poet krye-naltë, profet, që s'harrohesh  
 Me mendjen e thellë të gjithve na the  
 Se toka Arbrore, i shenjti Atdhé  
 Një dit' do lirohesh!

Qé, shkrepi dhe dita, fatbardh' e bekuar,  
 Ku flamur' i shenjtë u ngrit e valoji,  
 Q' u tret por si vesa, u zhduk e kaloi  
 Robri' e mallkuar!

Ah, fjalët e urta, të buta fisnike,  
 Të ëmbla, të kjarta, plot frym' e fuqi,  
 Tinglojnë akoma në zemër, në gji,  
 Si shëmblla jetike.

Si një manushaqe Shqiprin' e përshkrove,  
 Të zhytur në shpendra, në hithra, në vaj.

Po prap' i dhé shpresë, shpëtimin e saj,  
Ja pé, ja diktove!

Robrinë si dimbër të math e lëçitte,  
Po brenda dëshprimit një dritë e pé,  
Që shpirt' i Shqiptarit një dit' për Atdhé  
Me zhurm' do buçitte!

E di se s'të mbanin as gjëmba, as fletë,  
At' frymën e naltë ndaj neve t'a falsh,  
Si ëngjell prej Qielli lirinë t'a ngjallsh,  
Lirin' e vërtetë!

"Atdhé" fjal' e fundit, "Atdhé" fjalë jote,  
Në orën e vdekjes "Atdhé" tjetër s'thé,  
Me 'të e dhe shpirtin, që vetë s'e pe,  
Q' e qave me lotë!

Tani hij' e shenjtë n'Atdhé le të prehet,  
Se malli, dëshirat të shkuant në vend,  
Për ty u mallngje ç'do cep e çdo kend,  
Sa s'mund të rëfahet!


Kujtimi të qoftë, Naim, i pavdekur,  
Ç'do zembër Shqiptari për ty sot loton,  
Dhe veprat e gjalla gjithmon' i kujton,  
Ah!... sa jé i përpjekur!

**"Drita", 6 qershori 1937, faqe 3**



### *Lasgush Poradeci (1899-1987)*

Lindi në Pogradec dhe vdiq në Tiranë. Mësimet e para i mori ne vendlindje, te mesmet në Manastir dhe në Athine, ndersa studimet në Akademinë e Arteve të Bukura ne Bukuresht. Më 1924, me bursen e Qeverise se Fan S. Nolit, Studioi filologjinë romane dhe atë gjermane në Universitetin e Gracit. Më 1934 kthehet ne atdhe dhe punon profesor ne Liceun e Korçës, e më vonë edhe në Gjimnazin e Tiranës. Mbas luftes e gjejmë të punojë në Institutin e Shkencave dhe në Shtëpinë Botuese "Naim Frashëri", ku u mor me përkthime. Që nga viti 1915 nisi të shkruajë vjersha, ndersa me 1921 i botoi vargjet e para. Periudha më e fryshtme e krijimtarisë poetike janë vitet tridhjetë. Botoi shumë vjersha si dhe një jetëshkrim për Nikolla Naçën me titull: "Një fatos i veteransisë shqiptare". Ka përkthyer veprat e Pushkinit, Hajnes, Mickieviqit, Brethit etj. Veprat e tij: "Vallja e yjeve" 1933 - Konstancë, "Ylli i zemrës" 1937 - Konstancë. Vepra e tij është ribotuar disa here.



BIG. 1. LASGUSH PORADECI: Një nga dorëshkrimet e para të vjetërta "NAIM FRASHËRIT".

Dorëshkrimi i Lasgush Poradecit, i poesisë "Naim Frashëri"

## **Naimit**

**Ku** psherëtin dëshir' e djegur,  
 Në shesh të kuq të Qerbelasë,  
 Mes trimërish stërgjyshërishte  
 Të shoh tek po m'i bje xhurasë.

E më të lum, më të përmallshme  
 Të sjell në dritën e mendimit  
 Tek fërfëllon si yll me flakë  
 Prej shkretëtirës së harrimit:

Qëndroj në tmerr ndërgjegj' e botës  
 Se më s'u lodhe dyke ndritur,  
 Se më s'të treti prush' i vojtjes  
 Në kraharorin e zhuritur.

Po ti me vrap të piraustit  
 Që fluturon në zjarr e flakë,  
 Therorësin' e vetëvetes  
 E pate dhembjen më të pakë...

O, sikur vaj' e zemrës s'ate  
 Që ligjëroi n'aq hov të kotë,  
 Që veç me fjalë dhembshurije  
 Krijoi më t'urtat lot në botë.

Në gji të çdo mëmëdhetari  
 të mund t'a përtëritte mallë  
 Dhe një të tërë varg dëshirash  
 Q'i thurri mendja jote- e rrallë,

Me ç'zë të pastër adhurimi  
 Do kish bekuar varfëritë!

Helm' i një çasti-i këngës s'ate  
Përjetësisht do dil në dritë!

Po t'u pat thënë short' e verbër  
Të përvëlohesh nér padije:  
Me mijëra rreze shkrepëtimi  
Mezi të ndritësh po një fije...

Dhe'aher' i dehur n'hov të fatit,  
Në mall të math të këngës s'ate  
Kaq silitar këpüte zemre  
Ç'më të paçmuarshmë ti pate.

Dh'u ngrite për në të Vërtetën  
Në fluturim të artit mjeshtër:  
U droth alltari jon' i moçëm  
Sapo t'a ndjeu të shenjtën eshtër...

Se ngashërim' e vjershës s'ate  
Ish mall i fell' e pa të ngjarë,  
Posi një krue pastërsije  
Këndimi yt nér ne pat rarë;

U pat têrhedhur shpirt' i kombit  
N'atë vajtim aq të lënduar  
Q'e thurri gjuha jote- e prekur,  
Dhe balli yt i frymëzuar;

Se bukurit' e vetes s'onë  
Mendimi yt desh të na falë,  
O! Fjal' e pikave qiriri,  
E pika lotëvet o Fjalë!

...Q'ahere dyke shpënë sytë  
Nga Toskëri e Gegëria,

Shpesh e më shpesh patm' ëndërruar

Si ndrin në famë Shqipria.  
 Mes ligësish armiqësishte  
 Stolismë lulen e vullnetit...  
 Zbuluam gur margaritari  
 Prej fundit thëthimtar të detit...

E m'i çkëlqyer sesa dielli,  
 M'i lum se kohët që më s'janë  
 Filloi për ne ndryshim'i motit  
 Më një të pritme të pa anë:

Ti, fjalçtor i mallëngjer!  
 Ti, këng' e rritur ndaj selivisë!  
 Ti o rapsod i lasht' i komit...  
 Ti pate pjes' urgjin' e zisë!-

A, po n'u trete prej mendimesh  
 Me tëmbla t'heshtura në duar:  
 Në ç'qiell të larg pat gjetur prehje  
 Kjo zemra jote- e përvëluar?

Nga fluturoj bilbil finoshi  
 Q'e fryri era posa fletë?  
 Ku vanë pendët e pëllumbit  
 Q'e shtiu në dhet mërgim' i shkrertë?  
 .....

Sëkur të shoh, i tmerrshme Frashër,  
 Tek po mban zi për gjithmonë,  
 Ti më besniku trashëgonjës  
 I dashuris' së vendit t'onë.

## *Naim Frashërit*

*E ku shkruhenë në kartë  
Fjalët e gjuhës së zjarrtë...*

**Naim Frashëri: "Fjalët e Qiririt"**

**N**ë çetele të kujtimit, që dhëmkoset pak nga pak  
Ja shënova kohës sonë fluturimin vraparak,  
Se mi gropën e shkretuar ku dremit që kur ke rare  
Pas njëzet-e katër vjetësh sot po shfaqet mot'i parë...

Vallë dergja jote-e fellë pat pushim e lumturi?  
A t'ju zhduk dobare gjumit e përjetëshmeja zi?  
N'atë varr ku për së fundi mort' i keq të zu në rrasë,  
Të shkëlqeu pakmos së largu fush' e ndriçm' e

Qerebelasë?

Të këndoi me këngë malli Drini plak e i kulluar?-  
Zot, o Zot, të qofshim falë që Naimi pat pushuar!

Sepse Hije-e shenjtëruar nér të gjallët sikur t'ishte...  
...Sikur t'ishe nér të gjallët, Ti, Xhûraja dhembshurishte,  
Ti rapsod që pranë shqipes dit' e nat' i lodhe ballët,  
Ball' i zbet'e- i adhuruar sikur t'ishe nér të gjallët:  
Që nga tumb' e përmivarrshe ku do shihje për-matanë  
Vallë-a mos u ndreq të folët në Devoll e në Bujanë,  
Do të dukej i skëterruar me një mjegull zemërate  
Horizont' i madhërishme nér kufi të Tokës sate:  
Bukuri' e Mëmëdhethit do të ngjante - e pashjuar...

E atje, ku zër' i kthiell s'diti ç'është fjale e shkruar,  
Me dëgjimin tënd fisnik e me vërrejtjen e pasharë

Gjuh' e ëmbël e stërgjyshërve do të dukej gjuh' e vdarë:  
 Humbi radhën çdo të folur, çdo kuvend e ndyti shijen,  
 Ligjérata pleqërishte sot ka vrarë vetëdijen.

Aq sa me t'u mëshiruar në kaq helm e kaqë prishmë,  
 Më të kot do të vërente veshi yt i harmonishmë  
 A mos gjejë i tepërlumtur midis fjalëvet barbare  
 Tingëllimin q'i dha zërit frym' e gojës shqiptare...  
 Nuk di, është fshehtësira që kalon me fat në duar;  
 Eshtë njoll' e zez' e qiellit që lë pas një yll i shuarm  
 Eshtë krism' e vetëtimës kur funtet në fund gremine,  
 Heshtj' e këngës që pat qarë me një harmoni divine;  
 Po nér bijt e Mëmës s'ate -yll i ndritur yll! me zjarr!-

Vetëtim e harmonishme që pushove nënë varr!  
 Por nér bijt' e Mëmës sate, me gjyrmadhë e me stërnipër,  
 Shkatërrim' i shpejt i gjuhës sot qëndron në vepr' e sipër,  
 Sot po humb kuvend i zogut ç'gjithë bukuri që kishte  
 Po lëngon e nis të shembet folja jonë pleqërishte,  
 E në breg të kaq rrëmuje, psherëtiu dhe'u shua fare  
 Dyke rënë posa pika këng' e orës shqiptare.

Kush u tall se pasuria është rrob' e lar' n'ar?  
 Se një mendj' e palëmpirë zbukuron një trup bujar?  
 Në fjalim të shqipëtarit kush përqeshi? kush gjazë?  
 O ta njoha prej së largu buzëqeshjen e shëmtuar,  
 Ti, demon i shkretëtirës, që kalon me vaj në duar.

M'i përdredhur se zilia t'u pat shfytuar shtati,  
 Mund në fund të vetëdijes ty të ndrin një sy lugati;  
 Je njeri, e papandehur sikur ngjan me sprije zalli,  
 Flet me gojë,- e papandehur sikur ulërin çakalli,  
 Qan e jeq në të kënduar, zë këndon në zi të madhe,  
 Vdes kur hapet zemr' e gjuhës posa lulja nér luadhe;  
 Ha! Se në kaq ndryshmësira m'u duk vetë Shqiptari  
 Ndaj shëmton fjal' e të folur nga padija, nga nakari.

...Të përbysim vetëdijen kur na fton mburim i jetës?!  
 ...Të mendojmë kaqë errët mun në mes të së vërtetës?!  
 ...Ta mjerojmë kuvendimin me kaq helm e kaqë prishme  
 Kur fillon t'ja thotë shqipja me një hir të perëndishme??!

Perëndishmë kish kuvendi yt, Naim,  
 Ajo këng, e tepërlumtur që më s'pati shembëllim;  
 Se mendimi yt kish flakën e kuptimit të kulluar  
 Goja jote vjershëtore kish një zë të pastëruar;

Ol sa bukur që rrjedh fjala nëpër brigj' e nëpër sheshe,  
 Nëpër mal kur merr kullotën tuf' e bardh' e një bareshe...  
 Çëmbëlsir; e lumturuar n'atë zëth aq të mahnitur  
 Ku një trim i falet vashës dyk' u shtrir' e venitur...  
 Rreth murishtës së qytezës zu po zjen një zi mizore,  
 Fryhen grykët e shëndosha në bërtitje trimërore...  
 E mes tempujve të qetë, pranë pikash prej qiriri,  
 Dyke njohur vetëveten dal-nga-dal zë vuan gjiri,  
 E si tretet dyll' i djegur e pikon e merr kullimin  
 Shpirti yt në kraharuar i bën mendjes shoqërimin,  
 E më shpejt se shkrepëtima kur godet mbi shkëmb  
petriti,

Bie përposh në fund skëterre...fluturon në kulm zeniti...  
 E pse dot më s'gjen të prehur as mi dhet, as nën'etere,  
 Mërmëron e qit prej helmit mjaltë blete parëvere...  
 Këngëtor i pazemruar qit prej ferrash trëndafil...  
 Bëhet erë-e-i hyn në gushë gushë -dehurit bilbil...

Ajo është këng' e shenjtëruar e kuvendit tënd lotak!  
 Ambrozi q'u shrtydh nga zemra dh'u përzje me vaj' e  
gjak.

E kjo fjal' e perëndishme, ky kanisk pa shembëllim,  
 Kjo valle diamantesh na-u pat lënë trashëgim.  
 Po kaq fortë- i pru shkëndijat rrez'e ndriçim e ti ndaj neve,  
 Sa, të mundur nga shkëlqimi , humbmë fillin e ideve,

Nga çudia patnë humbur dlirtësin' e syrit vet  
 E në ngjau se zuri perde dh'u verbos e mbet i shkret.  
 E kështu, kur hën' e plotë lakuriqin e ka prekur,  
 Ai ngeci nd'anë muresh dh'u çukit e ra i vdekur.  
 Ra e shtrirë mes pishtari me qepallë të këputur  
 E shatsisur po nga flaka pendë- shkruarëza flutur.  
 E kështu- i javiti kryet një shfrerim edhe një bujë,  
 Ku thesar' i shenjt' i gjuhës bëhet lodër e rrëmujë,  
 Ku çdo goj' e djallëzuar, mbledhur fshehur në klikë,  
 Me një fjalë barbaria zë një vend në politikë:  
 ...Se ç'u mbush plot kapedanë- po me mendje- cilimi...  
 Ç'ndriti Lushnja trimërore<sup>11</sup>- po çu err dhe vetvetiu...  
 Se me zemër prej luani mbrohet Toka- po me skistër  
 Kruhet ajk- e majm' e gjuhës në Kongres<sup>21</sup> të saj sinistër;  
 Pastaj rrugësh arratije bje gjykimi- e gjëma shtohet,

Pa zë ç'bëhet ç'u pat bërë ç'u godit zë shkatërohet;  
 Ç'u ndërtua brez pas brezi, bje greminë më një ças,  
 Ku këndoi bilbil' i kombit, grifsh' e huaj cirret pas.  
 Me përbrendjen e shkrumbosur një poet, një deputet,  
 Flet e çflet e vret e pret pér një të vet vigjinitet...

Prej blatishtash tradhëtie shkumbëzon një farmason  
 E me ton që të shurdhon dënon një renegacion...  
 E nj'aty një tru- venitur që mban dije pér një fije,  
 Lajkatar a dërdëllitës nxjerr lëveshga gjuhësije,  
 Dyke lojtur maskaradën si kasneci në pazar,  
 Me dy sy të zgurdulluar, me një pedantizm barbar.  
 Se pat humbur prej qëkuri shpirt' i gjuhës së atyre  
 Që në fat të lum të kombit janë shembëlla myzyre;  
 Se pér shqipen pleqërishte- pér çudin' e mosfjalosur.  
 Vesh' i tyre- i shushulluar ka timpanin e rrëgħhosur.  
 E kështu- i kaptisi kryet ekzotizmi orë-lik,  
 Vijëza mërshe e ngjyrë dheri mori shtat' i saj fisnik.  
 E kështu filloi të ngrihet nga varrishtat e çdo ane  
 Përmi gjuhën shqip të gjallë një mumie-egiptiane.

Po ti dridh-u,o! komb i lashtë, me -atë zemërën e gjerë  
 E në gaz të drithmës sate le të tundet bot e tërë!  
 Le të ndritet Shqipëria nën bregor-e nér fushore  
 Si buçet me zë të thjeshtë frym' e gojës stërgjyshore;  
 Si flet shqip' e lumturuar e bekon me gjithë bekimin  
 Vajzërinë- e virgjërinë...- zemërimin...renegimit  
 Gjuha:shpirti i shenjt' i kombit, që kalon dyke kënduar!  
 Gjuha: zjarr djeg me dritë një mendim i frymëzuar!  
 Gjuha: afsh' i gjall' i jetës! shpat' e ndritur e lirisë!  
 Gjuha: yll' i vjershërisë! Gjuha: Verb' i Perëndisë!

Po ti mbeç me hir të shenjtë, bard i lindur nér pallate,  
 N'atë varr ku të pat mbyllur dhembshuri' e Mëmës sate!  
 Pranë tumbash ku rrin myshku, nënë shtyllë ku del  
gjembi,

Sa'sht' e rëndë balt' e huej mos u qaj a mos të trembi!  
 E në larg nga Shqipërija, nuk do jesh pakmos i shkret  
 N'ato plaja ku këndove atë Burrin e vërtet!  
 N'ato pyj ku pate qarë (për kujtim të zi të motit)  
 Si u tret në dhe të fellë, zemr' e gurt' e Kastriotit.  
 Sepse-yll i përvëluar n'horizontin shqipëtar-  
 Ç'ë pat pamjen aq të largë syri yt vetëtimtar?  
 Ç'dashurove- aq fort Atdhenë, sa të ndritish më të kot  
 Një qëllim të vrerësuar veç me vaje e pika lot?  
 Se mendimi yt i pastër desh të lanjë- e gjoks e kokët  
 Me floririn e virtytit gjithë eskrokët edhe trokët;  
 Se guxove të na thuash me kalem të zi në kartë  
 Mall' e Madh që të pat djegur: Fjalët e Gjuhës së Zjarrtë.

*“Naim Frashërit”... “Austri (Groz) 1925, f. 23*

***Sejfulla Malëshova  
-Lame Kodra-  
(1900-1971)***

Lindi në Malëshovë. Shkroi vjersha, të cilat i botoi me pseudonimin Lame Kodra. Ka studiuar në Itali. Shumë vjet i kaloi jashtë atdheut. Më 1924 u bë sekretar personal i Fan S. Nolit në Qeverinë Demokratike. Mori pjesë aktive në LNÇ. Pas luftës ushtroi shumë funksione politike e shoqërore. Organizoi Kongresin e Parë të Shkrimitarëve të Shqipërisë. Më vonë qe larguar ngajeta shoqërore e politike. Botoi: "Vjersha" 1945 - Tiranë; "Flasin udhëheqësit tanë" (artikuj dhe fjalime), 1945.



***Inedite***

Me fyell e me xhura këndoi Naimi  
Sa duf e mall që kishte ligjërimi.  
Pastaj rrëmbeva me duf vigani  
Lahutë Fishte- -Lirë Theofani  
Pastaj me mandolina e me saze  
Dëgjoi Shqipëria ca avaze;  
Mandolinat e sazet unë i theva  
Dhe bririn e Dianës e rrëmbeva  
1925.

*"100 poet për Naimin" Tiranë,  
1995, f.43.*



## *Et'hem Haxhiademi (1900-1965)*

Lindi në Elbasan dhe vdiq në Burrel. Mësimet e para i mori në vendlindje, të mesmen e filloj në Leçe të Italisë dhe i përfundoi në Innsbruk të Austrisë. Studimet e larta dega e Shkencave Politike i filloj në Berlin dhe i përfundoi në Vjenë. Pas studimeve shërbeu në administratën shtetërore në Tiranë si dhe nënprefekt në disa rrethe të vendit. Në vitin 1936-1939 pushohet nga puna. Më pas u mor me veprimitari të ndryshme. Nga viti 1946-1947 punon si profesor i gjuhës shqipe në Normalen e Elbasanit. Më pas provoi burgje dhe persekutime. U muar me veprimitari letrare që kur ishte student të cilat i batoi në shtypin e kohës. Ai batoi kryesishtr tragjedi si "Ulisti" (Berlin), "Akili" (Vjenë), "Aleksandri" (Lushnjë), "Tri tragjedi", "Leka" "Pirrua", "Skënderbeu", "Diomedi", "Abeli", "Lyra" në Tiranë.

## *Naim Frashërit (Fragment)*

**O** kangëtor, hyjnor, a po qetsohe  
Në pellgun e vorrezave të shkretuemë,  
Prej kohës së harrueme,  
Qi pasqyrohen n'ujin e Bosforit?  
Përpjetë nuk ke si çohe  
Përpjetë vendit ku ke mbetur,  
Se zemrat t'u ka tretun  
Atdhen të shohish qi aq shumë e deshe  
Edhe me bukuri të mdha e veshe!

Të shohish plangun t'and me breza t'raja  
Qi s'rijnë barijt me dhen ma ndër kullota  
Se ka ndryshue krejt bota  
Qysh atëhere qe prej nesh u ndave.  
Ah, sot me pun e të mdhaja  
Dhe tokat po u djerren

E ferrat lulzojn mbi to e bari  
 Kur qaf' e tyne xixillon nga ari!  
 Po kur kjo tok' me ajk' tē kangve t'ueja  
 U ngjom pēr deri lulet sa i çeli,  
 I yti trup tē ngeli  
 Nē rendin e anmikut qi luftove?  
 Tē tretesh n'balta t'hueja  
 E lark prej nesh tē jeshë  
 Dhe as një vorr t'mos keshë,  
 Qe aq dëshir' t'a shohish t'lir' ti pate,  
 Kur sot n'kurris tē saj ngrihen pallate?

Ngre syt një her' tē paktën pēr me pamun  
 Sa madhshtore duket Labëria  
 E ku shkrepi liria  
 Gërmjenji me Çerçizin n'brov u ngallën!  
 Por mendjen s'e ka ndamun  
 Njeri pēr ty tē sjelli  
 Lirisht ku shkëlqen dielli,  
 E n'vorr gjarprinjt t'rreshqasin ty kular  
 Qi me tē Febir lyr' vdiqe Shqiptar!

.....  
 Hei! turp i ardht' mbarë kombit turp pa masë,  
 Kur s'të kujton shërbimet, o kangtar,  
 Qi dhe si luftëtar  
 Ma fort kunora e liris t'dhurohet!  
 Po as nji s'don t'pikasë  
 Nga koha e kalueme,  
 Se gjindja e hutume  
 Asht tyke korrun farën qi ti mbolle  
 Dhe ka harru qi qe mu par' n'kasolle,  
 Po ç'shembëll do tē marri djalërija,  
 Kur s'adhurohet lyra dhe shpata?  
 Në kohët ma tē gjata,  
 Nuk do tē derdhen fli n'altar t'atdheut!  
 Ty nuk tē çmue fuqij

E t'jer nuk do t'guxojnë  
 Shtëpin e vet t'a shkretojnë,  
 Por veç me fli qëndrojn' tokat të lira,  
 Prandaj në vend t'zymbylit do t'binj fira.  
 As do guxoi' njeri harpën t'a preki  
 Qi vetë Orfeu nji herë e tingëlloi  
 Dhe lisat i gëzoi  
 Sa të lëvizin vendit nëpër prozhme;  
 Edhe Erinat theki  
 Ay me këng' të veta  
 Sa rishtas iu kthye jeta  
 Të shoqes qi qe zhdukun e qe mbyllë  
 N'mbretni t'errsinës ku s'vështrohet yll.  
 E kur Orfeu me kang' skëterrën zbuti,  
 Sa Euridicen prap e pruni n'jetë,  
 Për ty nuk paskan mbetë  
 As njerës qi me vargun tand t'mallngjehen?  
 Ma par' se ti kush luti  
 Guxueshëm për me ardhë  
 Te na kjo ditë e bardhë,  
 Sa zog' i shqipes t'endet nëpër pllaja,  
 Të vendit t'on lirisht me kraha t'mdhaja?  
 Dhe ju qi dini vlerën e t'harrumit,  
 Aviti pranë të gjithë e të mendojmë,  
 Se s'duhet të vnojmë  
 Në themelim t'faltores s'on' të kombit;  
 Përkundra ma prej gjumit  
 Gabimin me qindisun  
 dhe prap me e stilisun,  
 Se si ç'do kombi qi i erth profeti,  
 Nj'ashtu për gjendjen t'on' do t'jetë poeti.

*Tanush Ismailati**Mirë se erdhe Naim*

Ligjëro! dallëndyshe  
 Këndo! bylbyl  
 Çohuni! gjysh e gjyshe  
 se po vjen një idyl  
 që ju këndovi  
 me za tingëllimi  
 me duf e afsh  
 mallimi.  
 Djem!  
 Thurnji lule.  
 Vasha!  
 Mblidhni pekule  
 dhe mbi ato kocka.  
 bashkë te vajtojmë  
 dhe këngët Naimit  
 prap t'ja kujtojmë.  
 Gjëmo!Adriatik,  
 Ushto! o Bujanë,  
 Thrrit! Ti o Shkodër,  
 Kujto! Të moj Tiranë,  
 Dhe mbarë, o Shqipëri  
 kënd e për anë  
 atë bir Shqipërie  
 që larg mbeti  
 dhe ndër ne u kthyte.  
 Krenohu! Tomorr,  
 Gëzohu! Myzeqe,  
 Shkumbëzou! O Vjosë  
 se birin tënd e pe.  
 Erdhi  
 të qetohet  
 mbi tokën tënde Shqipëri,  
 U kthy...  
**Në gjirin tënd**  
 djalëri!...

## **Frashërit**

(Tre vëllezërve)

Ligjërimin e përlotur  
të bilbilit zall- mbi zall  
lot i skllavit e ka shkrojtur  
ndaj o fshat priti me mall  
ato vargje që gjithkush  
i këndon me krenari  
se prej teje o baltëprush  
lindi fjal' e lir' LIRI!

*Athinë, 1934*


*Fragment nga poema "Lotët e  
mërgimit"*  
*"Horizont", Tiranë 1959, f.51*

## **7 Prilli**

**Kushtrimi Çlirimtar**  
(*Fragment poeme*)

**Dhe** Çajupi dhe Naimi  
nisën vallen nga agimi,  
mali e fusha po këndonte,  
pranvera po afronte,  
ngrohej zemra shqiptare,  
ndizej zemra shqipëtare,  
ndizej flaka çlirimtare,  
zgjuhej kombi, ngrihej fisi,  
u ngre Gërmjeni, Çercizi,  
u mblodh grushti, u ngre dora,  
fushëkuqi bëri fora;  
fluturoi që nga Vlora,  
popullit i erdhi ora  
ta flakëroj' urinë e zinë,  
ta gëzojë Shqipërinë.

*Grenoble, prill 1939*  
*"Horizont", Tiranë, 1959, f.112-113*



**Petro Marko**  
(1916-1991)

Lindi në Dhërmi të  
Himarës. Shkollën fillore e  
kreu në vendlindje, të  
mesmen tregtare në Vlorë.  
Bashkëpunoj me shumë  
gazeta të kohës Mori pjesë  
në Luftën e Spanjës, provoi  
burgje dhe internime nëpër  
kampe të përqëndrimit. Pas  
Çlirimt u muar me  
publicistikë, punoi në shtyp  
dhe me krijimtari letrare.  
Ka botuar vepra që zënë  
vend të nderuar në letërsinë  
shqipe. Është autor i:  
"Hasta LaVista", "Horizont"  
"Qyteti i fundit" "Shpella e  
piratëve" "Rrugë pa rrugë"  
"Stina e armëve" "Urata,  
dhia dhe perëndia" "Ara në  
mal" "Halimi" "Ultimatum"  
"Fantazma dhe plani tre  
plus katër" "Të thjeshtët"  
"Griva" "Nata e Ustikës"  
Eshtë vlerësuar me çmime  
të ndryshme.

## ***Bagëti e Bujqësi***

### ***Parodi***

O malet e Shqipëris dhe ju deputetë të gjatë  
 O kulltuqe të bekuar që për ju qan dit'e natë  
 Çdo ministër i harruar qi ngadal bëhet lugatë,  
 Ju vetura shum' të shpejta e ju napolona t'arta  
 Pleq të majm'e të shëndoshë që me urdhëra të zjarta  
 Kishit vën në gjumë të thellë lum' e detë edhe fusha  
 Ju o deputetë t'uritur që mënd u pëllcet dhe gusha  
 Pa filloni duke britur, çirrni pak fytin e trashë.  
 Nis ti "Besë" si vitore merrja pak e me javashë  
 Se Tekiu si pallua me xamaren duke qarë  
 Po ja thotë, o i përlotur për atë kohën e parë.  
 O ministra të mallkuar, ti Musa efendi Juka  
 Që marazin t'ënd e kishje te kultur'edhe tek buka,  
 Dhe tani i neveritur me çubukun e argjend  
 Ndez cingaren edhe thua "Ah që s'dogja dhe kët vënd!"  
 Do t'a hajsh'e t'a coptojshtë as me pallë po me dhëmbë  
 Bën të ngrihet'or nga Besa por çe do që nuk ke këmbë  
 Ndaj i nxehur dhe pa lehur po hedh dorën nga pisqolla  
 Edhe nis të baj posulla po e mbush kartën me njolla  
 Si Tekiu përmbi "Besën" që bërtet si sarahosh  
 Dhe kërkon, o bagëti, të zë diellin me shoshë.  
 Do të këndojoj "Besaxhijntë" bagëtin'e bujqësinë  
 Bankat, tabella, pallate dhe lista për regjistrim.  
 Ti o Besë më jep ndër, më jep emrin atdhetar  
 Zemërën m'a mbush me vrer edhe xhepet plot me ar.  
 Sa të desha "Bes" e dashur!... Por ç'e do lëre tani  
 Le si po këndojojnë kartrat s'do të kesh më as tagji.  
 Oh sa bukuri ka tufa sa gas bie Musa Juka  
 Vijnë po si blet'e plotë, o u zëntë syt' buka.  
 Se ç'dalën cjept nga vatha, s'gjejnë më dot temenara  
 Ja dhe dashi Koço Kotta me këmborën shkon përpara  
 "Un mërzitem thot nga puna dilni o kope ndër arat  
 Ose mshihuni ndër pyje se na duallnë të palarat!

1934

***Naim Frashëri***  
***(Petro Marko)***



## *Andrea Varfi (1914-1992)*

Lindi në Qeparo  
të Himarës dhe udiq në  
Tiranë. Shkollën fillore  
e kreu në vendlindje, të  
mesmen tregtare në  
Vlorë. Studioi për  
shkenca agrare në  
Peruxhia të Italisë.  
Filloi të botoi që në vitet  
30, kryesisht poezi dhe  
shkrime publicistike.  
Përveç krijimtarisë  
letrare ai përktheu  
përshtati veprën e disa  
shkrimitarëve  
arbëreshë. Veprat e tija  
letrare janë: "Dielli i  
jetës sonë" "Në zgjim"  
"Një histori e lashtë  
stërgjyshore" "Blerim  
nëntori" "Poezia  
shqipe". Veprintaria e  
tij letrare është  
përmblodhur në dy  
vëllime.

## *Naimit*

**E** nxinte qielli  
e skuqte dheu  
në llohe e tramundanë,  
e loti nënës nuk i tretej...  
Po trimat zjarr edhe barut  
i ndezën këto anë!

At'here ti m'i hape sytë  
edhe m'u rrite  
kur ushtima  
akoma ish e gjallë:  
e këngët ku këndohen trima  
e brigjet mbushur varre  
e brengë e ahe shqiptare,  
të ndezën zemrën frysëzim,  
e çurg notat të gufuan,  
e male e çuka ushëtun:  
"Bilbil, këndo  
në pambarim  
dhe për liri:  
ti je kushtrim!"  
Derdhet fjala jote drejt në  
kraharor  
se të dogji prush  
malli shpirtzhuritur!  
Pa nisi t'ia thotë zhuraja  
në pyje, hone, gërxhe, majë  
e blegëriti bagëtia:  
ta dogji zemrën Shqipëria.

**"Vepra letrare", Vell.I.Tiranë,  
1968, f.69-71**

## **Isuf Luzaj (1913)**

Lindi në Kaninë të Vlorës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje ndërsa gjimnazin në Shkodër. Gjatë viteve 1933-1935, studioi në Sorbonë të Francës. Mbas kthimit në Shqipëri punoi si mësues i gjuhës frëngje në Normalen e Elbasait, në Liceun e Korçës, në Institutin Tregtar të Vlorës. Më 1940 burgoset në Itali dhe 1941 kthehet në Atdhe. Më 1944 mërgon në Itali dhe



1948 në Argjentinë. Umuar me punë letrare dhe shkencore në fushën e filozofisë si në Institutin Fréng për studime të larta, këshilltar i Direktoriumit i Ministrisë së Arsimit të Argjentinës. Më 1965 emigroi në ShBA. Punon si profesor i filozofisë frëngje në Universitetin e Nju Humpshire-s si dhe profesor i letërsisë spanjolle frëngje etj. Ka bashkëpunuar me shumë revista në Angli, Spanjë, Peru, Kolumbi, Kili, Guatemale, Itali, Brazil, ShBA etj. Jeton në ShBA. Në vitin 1938 botoi vëllimin poetik "Rrëfime në Korçë" për të cilin u dënuau nga regjimi i kohës me 3 muaj burg. Në vitin 1954 në Buones Ajres botoi vëllimin "Lumenjtë derdhen të kuq". Në Tiranë këto vitet e fundit janë botuar disa nga librat e tij.

## **Naimit!**

### **Sonatë**

#### **Allegro**

Kur bota përgjunjur nën vese t'njerezimit e prapështije, si natë thellimit  
Cip' e zezë jetën me thonj e dërrmonte,  
Kur kuçedr' e egërsuar e ferrës s'Osmënët  
Prej cepit në cep t'botës thonjt e qënit  
viganë ndrythte, gjak thithje e helmonte,  
Kur zogushi shqipo i gërxhit të prerë  
Tulitej me frikë në re e në erë  
Se mos duke folur një fjalë shqip ndërgjohej

Atëhere o i shenjtë dolle si Orpheu  
 O Naim! E guxove  
 Me notën shqip shqipen këndove  
 Dëshmitar të janë qielli e dheu  
 E Zoti q'e ndërgjoi lutjen q'i drejtove.

\* \* \*

Erdhë embël Parnasit at-bot nota jote  
 Tingëllói lyra nëpër erë shqyptare  
 shpejtsije rrufeje, si këngë legjendare  
 E la tek çdo shpirt ç'kish marrë tek zotrote  
 E shpirtër të tjerë ngjalli  
 Emrin shqyptar i a mësoi shqyptarit  
 Ndezi dëshira të reja; atdhetarit  
 mall për atdhe kënga jote i kalli  
 Zemër në zemër e sy në sy  
 Rilindja e kombit të detyrohet ty.  
 Si kulme e Orpheut të Tebës ndëgjuar  
 Si skena e shpirtit të madh të trishtuar  
 Si goja e embël që ent në përralla  
 Lëvizje dëshira e ëndrra të gjalla  
 Herojt, ja t'humbur ja po fitimtarë  
 Porsi Zot i ndjenjës shënjtruar  
 Burimi të ertë parajse kthjelluar  
 ent përjeti ç'do shpirti në vete  
 Ashtu o i shenjtë pa fije të mete  
 Ndjenjën e ënde  
 E e mbolle kudo ashtu si t'a kish kënde  
 Rracën e shqipes e mblodhe rrëth teje  
 E gjaku i pastër që lëvrinte ndër deje  
 Të Skënderit Math, provën t'a dha  
 Pse djemt e leht si gjeraçina,  
 Prej veriut në pyje ty erdhë e t'rrethuan  
 Fringëllói shpata e gjëmoi martina  
 E për ku i udhëhoqe ata t'ardhuruan!!!

\* \* \*

Fluturimi yt pindarik të shkrin  
 Vargu i shenjt të pikoi platin  
 Jeta të gjalla  
 Ti ndeze me ndjenja ndjenja bujare  
 Flutrove malit t'shenjt nëpër qieje  
 Shpirtit i dhe krahë rrufeje  
 Shqipen lëmove në varg margaritar  
 E njëhershi  
 Kushtrim më i madh në botë kurr s'është  
 ndëguar  
 As ndër popujt që njeh historija  
 As në bota zotash ku përralla  
 me gojë të fëmijve ëmbël piktuori  
 Se sa kushtrimi yt, q'i frënglluar  
 Deri n'palc shqiptari u ngrit  
 E u derdh si rrebeshi

### **Adagio**

Në trëndelinë të malit mërmëroi vargu  
 Bariu bariut i vu gishtin në sy:  
 -Vështro ky tingull si e ndoqi myxyrën  
 Një dorë nënëdheu pa dukur  
 Nisi ndërtoi e zbukuroi natyrën  
 Ndryshe që mbrëm më të mukur  
 E sa ndryshe e sa bukur  
 Sot në mëngjes  
 Kjo ëndje kaq e plotë kureshtare  
 Ja se rilind bota, ja po Perëndija  
 Kërkon të dënojë ndonjë rrac grabitqare  
 Këto tha bariu me shokun e tija.  
 Shtazët në gjunjë e ndëgjuan  
 Muarrën frym rrallë e si kur rënkuani  
 Çakalli në shkëmp pështetur mban vesh  
 Njerzit sytë fërkojnë e zgjohen  
 Për një jetë të re kujtohen

Shoqi shoqin drejtojnë n'udhë të mirë  
me sa hare  
e me sa dëshirë  
Nota jote një komb udhëzoi,  
Ngurruar në brigje t'Azis një bish po rënon.

\* \* \*

### **Scherzo**

Një endje gas e mall të ri mbolle  
Në fytyr të bukur në kraharor prej molle  
Dashurija në çifte këngës s'ate u dhurua  
Nën emrin e femrës Shqiprija u këndua  
e melodi e shtrenjt  
e një fyelli të shenjt  
Shekujt do të t'a kenë kujtim  
Shpirt gjerë i pa vdekur shenjtor, o Naim!

### **Allegro Finale**

Ç'qe or Zot ti me lyrë të Orpheut  
Tingujt e shenjt i a përndave këtij dheut  
Zonjë e lirë Shqipja vet u tregua  
Pse q'at-her u kujtua  
Burri shqiptar që vitet mallkuan  
e futën në shpellë të vait e mjeruan  
pse mëshirë nuk pati barbari,  
u ngrit nga shtrofkulli i egërsissë  
Hoqi nga balli lëveren e zisë  
Në kallkan kërkoi e ngjeshi pallën  
që gjyshin fitimtar ia kish kurorëzuar  
e me zjarr vullkani q'i digej në deje  
më jeh shenjtësije q'i erdhi prej teje  
Me burräri rrace që nota jote mbolli  
Si panter shqiptari u lëshua  
Egërsira barbare atëher u dërrmuia

Gjithë kush gjeti vendin e tija  
 Tymin e rëmujës e shpërndante shkëndija  
 Shqipërija zonjë e lirë në vete dolli  
 Edhe sot këndohet nëpër sy  
     të kulluar që ka djalërija  
 Rilindja e kombit të detyrohet Ty.  
 Të falem Apostull i këmbit shqiptar.  
 Ti që u linde u rrite e u shkruive në zjarr  
 Që Fata shqiptare t'gërshtoi dafin  
 Shenjtor shtat herë i shenjt i Parnasit  
 Ndër sfera bujare me krahë të Pegasit  
 N'vargje t'kristaltë që pikuan platin  
     Ngrite Arbërin  
     Bilbila të ri  
     Kan zën e këndoijnë  
     E për shenjtësi  
     Ty t'adhurojnë  
     Shenjtor, o Naim  
 Të falet Shqiprija e brezi i ri i Saj!!!

**“Rrëfime”, Korçë”, 1938, f.250-253**

***Bardhyl Pogoni***  
**(1924-1985)**

Ka lindur në Tiranë dhe vdiq në ShBA më 1985. Poet, përkthyes një nga orientalistët më të shquar të vendit. Në vitin 1944 botoi vëllimin poetik "Drithmë dëshire" Në vitin 1949 botoi poemën "Fytyra e Kombit" "Drejtoi" "Kushtrimin e Lirisë" "Punoi" në radion "Free Europe" dhe në "Dielli" (Boston).

***Të falem Naim...***

Ashtu si dikur hyjnisë Prometeu  
Nga Zeusi e mori ashtu jo për re  
Naimi u ngrit atje tej sipër ne,  
Si zok, bilbil, me krahë fluturoi  
Ndaj Zotit pranë flagën e rrëmbeu  
E kombin kështu për vjet e këndoi.

Prej gjuhës së Tij, rrodhi vetimtare  
Një varg i perëndishëm me plot kumbim  
Kur e këndojeti pa fund Skënderin trim  
Se, një ëmbëlsirë të pa treguar  
Ja derdhi vargje margaritar  
Ku shpirti i qetë aty pushoi.

Humbur tej në për grykat e Bosforit  
Në zemër e shtrëngoi Naimin me mall  
Atëherë u drodh së brendi u ngjall.  
Një poem i lashtë në frymë dhëmshurie  
Se kurrë nuk shuhet malli i të gjorit  
Që rron tej ndër toka robrije.

Dhe vashë e bukurië së kulmit u ngjall  
 Një i ëmbëlsuar frymëzim kur këndon  
 Një këngë të dlirë që nuk mënoi  
 Pa vijnë të qajnë me qindra femra,  
 e djemtë zemërgu i thërmoi malli.  
 Sa s'la pa lindur të thelbit zemra

Një fe të pastër “N’Qerebelanë” formoi  
 Sa po’t’ndrydhën në kokë një mendim,  
 Dh’ë atë të pa fe e bëri të ulet flijim  
 Se dijti aq bukur të këndozi  
 Sa në vargjet e Tija dje të ndriçoi

Shkroi sa mundi me penë në dorë  
 Ngeli përgjithnjë përbys përmbi fletë  
 Ku vargu i tij kumbojti aq i qet  
 i lirë, e ëmbël, me zë të qetuar.  
 Atë që nga gjuhën ngriti një permendore  
 kështu që nga gjumi na pati zgjuar

Iku trupi i tij në qiejt e amëshuar  
 u çduk përnjëherësh po vepra e tij  
 s’humbet jo kurrë së gjalli në Shqipëri  
 me kulm bukurie emri përlavdohet.  
 Oh! po se e ngriti i dëshiruar  
 ndërtesën kantier që kurrë s’rrëzohet.

Unjur së toku nga qielli në duar  
 T’i falemi atij që aq bukur këndoi  
 q’aq ëmbël e hidhur kohërinë vajtoi  
 E veprë së Tij tmaj shëmbëllesë  
 Këngët që shkroi le të jenë kënduar...  
 Çdo shekull që të vijë, emri të mos vdesë.



## **Mediha Frashëri (1919-1983)**

Lindi në Frashër të Përmetit Që e re filloj luftën për emancipimin e gruas shqiptare. Në periudhën e pushtimit fashist ajo rreshtohet në radhën e luftëtarëve pranë çetës së Pezës. Për kontributin që dha gjatë Luftën Na.çl, është dekoruar me Medaljen e Kujtimit, të Trimërisë dhe të Çlirimt. Ka botuar shkrime në revistat "Shkëndija" "Gruja shqiptare" "Shqiptarja e re" në të cilat trajton probleme atdhetare dhe të emancipi- mit të gruas. Ajo ishte motra e Artistit të Popullit Naim S Frashëri. Shpesh i thoshte: "Të dua dy herë, se të kam vëlla, dhe vëllai dihet se çështë për motrën, por edhe se mban emrin e poetit tim të adhuruar Naim Frashërit..."

## **Hijes së Naimit**

**H**ij' e shenjtë më je çfaqur Para syve, ndaj të gdhirë, Kur të pashë jam kënaqur, Të të njoh kisha dëshirë.

Më je dukur si një dritë Drit' e madhe që më zgjove, Natën ti ma bëre ditë Mendjen time ma ndriçove

Tek Ty pashë gjithë Botën Se ti s'ngjanje me njerinë, Pashë Diellin, Detin, Tokën, Edhe gjithë Shqipërinë.

Tek ty pashë Perëndinë Fjala jote ngjan Kur-anë Emër kishe Shqipërinë, Edhe strehë Qerbelanë.

Ti je Kisha, je Xhamia, O bashkim për njerëzinë, Je i ardhur nga Perëndia Një Profet për Shqipërinë.

Para Teje u gjunjëzova, Si përpara një altari, Dhe një lutje të drejtova Si Shqiptar' e bij Shqiptari.

Psherëtite dhe s'më folë,  
 Lot si breshëri të ranë,  
 Zemërthyer u largove  
 Syt' e mi më nuk të panë.

Një rrëth ëngjëjsh kordhëtarë,  
 Ty mbi kryelart të ngritnë  
 Ishin burra Shqiptarë  
 Tok me Ty në Qiej u ngjitnë.

Na ke lënë gjurmën tënde,  
 Fjala jote nuk vdes kurrë,  
 Të kujtojnë këto vende  
 Për Ty qajnë gur e drurë.

Për Ty qan gjith' Shqipëria  
 Manushaqeza me erë,  
 Blegërojnë bagëtia  
 Qan bilbili në pranverë.

**“Shkëndija” Nr.8-9, 1942, f.352**



### *Syrja Minarolli (1920)*

*Ka lindur në Pogradec. Kreu shkollën Normale të Elbasanit dhe fakultetin Gjuhë e Letërsi në Tirane, ku ka punuar për disa vjet me radhë mësues letërsie në shkollat e kryeqytetit. Ka botuar përmblledhjet poetike "Erdhën dallëndyshet" dhe "Mirëmëngjes o diell".*

## ***Kujtimit të Naimit një Lot!!***

**Po** qan penda për një burrë!

U bashkove me shkëndijën, që pikoi nga gjiri i zjarrit  
E u ngjite lart në sfera, ndërmjet Yjesh të vargëzuar  
E at'here zer' i Shqipes. Nën' e vojtur e Shqiptarit  
U ronit, me sy përlotur, për një Bir të ngashëruar  
Ngashërim! Na mbylle sytë, më s'po flasim dot një  
fjalë

O kujtim!...që rënkon rëndë, si një det që vjen me valë  
Ti o Mall, i pashterurar, që na del me mall të rëndë  
Regëtin ndër funde shpirtrash...pa buçet në quell  
si këngë.

O Naim! na bije dritë...mall të madh e ngashërim  
O Naim! m'u përcolle nga një zjarr pa shembëllim  
O Naim tē shkoi tē ritë, atje ku është tjetër natë  
O Naim! tē vështroj pyllit, ndaj ve veshin mbi xhurat  
Kur mbaroi...një regëtimë, i tha Zotit

Po tē vim'

Si Bilbil zemër-copëtuar... si një Bir  
si një NAIM!

*"Tomorri" 1942, 7 tetor, f.3*

**Perlat Rexhepi  
Hero i Popullit  
(1919-1942)**

Lindi në një familje patriote në fshatin Vajzë të Vlorës. Kreu shkollën fillore në vendlindje, shkollën tregtare në Vlorë si dhe mbaroi shkollën teknike në Tiranë në degën e ndërtimit, ku u diplomua për gjeometër. Kishte shumë dëshirë të merrej me projekte rrugësh dhe ndërtime, por me pushtimin e Shqipërisë nga fashizmi, ai u hodh plotësisht në luftë për çlirimin e vendit. Është një nga tre heronjtë e epopesë së Shkodrës që u zhvillua më 22 qershor 1942. Kishte qejf artin, ku ka interpretuar në shfaqjet e shkollës në dramën "Lulja e Kujtimit", po ai kishte pasion dhe poezinë. Prej tij ka mbetur vetëm poezia e mëposhtme.




**Shqipërisë t'i thur lavdi**

**Një** Pushkin dua të bëhem,  
Një Majakovsk padishim,  
Si Migjeni dua të ngrihem  
Si gojëëmbli Naim.

Shekspir të arrij në dramë  
Enrik Hajne n'poezi,  
Si Aligeri me famë  
Shqipërisë t'i thur lavdi.

**Flakëron me ngjyrë gjaku, Tiranë, 1980,**



**Mustafa  
Greblleshi  
(1922-1986)**

Ka lindur në Tiranë. U muar me krijimtari letrare që në rininë e tij. Është autor i romanit të njohur "Greminë e dashurisë", "Albumi i një bojaxhiu", "Shalli i kuq". Ai ka përkthyer me mjeshtëri të rrallë një nga kryeveprat e letërsisë arabe "Një mijë e një net".

## *Naimit*

-*Në përvjetor të vdekjes-*

Të vajtojmë,  
Të kujtojmë  
O Naim përgjithmonë,  
Se na zgjove  
Na i lëmove  
Veçse Ti shpirtrat t'onë!  
Ti na k'nelle

Na mbështjelle  
Me dashni për këtë Tokë  
Na urdhnove  
Na mësove  
Që të jemi të gjithë shokë...

Ti na the  
Për kët' Dhe  
Që ta lajmë me tonin gjak  
Kur anmiku  
Dhe rreziku  
T'na afrohet nenë gjak!

Ti e shkrove  
Dh'e këndove  
Bukurin e Shqipërisë  
Lyra jote  
Magjiplote

Dhe avazin e burrnis!  
Pra në botë  
Me të plotë  
Do të falemi, o Naim!  
Fmijve tonë  
Dhe ma vonë  
Do t'ia lamë kët' trashëgim!

**"Njeriu" Nr. 4(16), 1943, f.6**

## Azem Teferiqi

### **Pse Naim?...**

**P**se Naim, fytyrat t'ande e zbehtë  
 As në Parajsë s'asht e qetë?  
     Ç'asht vall shkaku  
     I këtij meraku?  
 Ku janë zanat me atë lyrë  
 Që të frymzuen, të praruen në f'tyrë?  
     Mos u trembën, u arratisën  
     Dhe të braktisën?  
 Jo Naim, Martir i madh, i larë n'ar  
 Sot ty të gjunjëzohet çdo Shqiptar,  
     Të kujton me nderim  
     Dhe mallëngjim.  
 Na pikllohemë se Shqipnia Plakë  
 E mbytur, e zhytur nëpër tym' e flakë  
     Nuk lindi tjetër Naim  
     Që të përmendet me nderim!

*“Njeriu”, Nr.16, 1943, f.4*



**Ferit Vokopola  
(1887-1967)**

Rrjedh nga Vokopola e Beratit. Arriti të kryejë detyra të rëndësishme në administratën shtetërore deri në Minister Bujqësie. Është marrë vazhdimisht me krijimtari letrare. Gjatë viteve '40 ka qenë kryeredaktor i revistës "Njeriu".

**Të falem Naim!**

**Të falemi, o Dritë, o Yll i Perëndisë!**  
Që me veprat tua, i dhe shije jetës;  
**Të falemi, Naim, o bir, i Shqipërisë!**  
Mësonjës' i lart' i shkollës së vërtetës.

Qenia jote, Naim, burim i drithës' Djellit  
Shpirti Yt' shprehja e frymës shenjtëruar  
Mendja jote e gjerë tej kufijve të qiellit,  
Ndriçon edhe sot, nuk ka perënduar,

Ti ke qen' njeri po jo njeri si tjetër,  
Në qënien t'ende mysteri i shpehur,  
Bëri mrekullitë mbi ret e në erët,  
Në vjershat e tua me lot' është dehur.

Një bot' Shqiptare e rën' në robëri,  
Në vargje dredhije e shtrirë përdhe,  
U derdhën si e çmendur në luftë për Liri,  
Për truallin e stërgjyshërve, për kët, Atdhe.

Kush, Naim! at'here guxonë aq sa Ty,  
 Të vajtonte hallet e Shqip'ris së mjerë,  
 Rrezikun e jetës duke marrë në sy,  
 Zërin e shpëtimit në dritë ta nxjerrë?

Oh! Sa fat i madh ky, se sa një lumtëri!  
 Qe Zot i Madh të desh dhe trimëri  
 Me dritë të pajosi të dha dhe trimëri  
 Nga vjershat e tua një Atdhe shpëtoi.

Net' të zeza shkuan prehu e mos vuaj!  
 Ja, u vërtetua ajo që kërkon  
 Sështë më Shqipërija në zgjedhën e huaj.  
 Flamuri kuq e zi, shiko po valon.

Të falemi, Naim, o Yll' i Shqipërisë,  
 Kujtimi Yt' qoftë amëshimi i jetës,  
 Të falemi, o Dritë, Dritë e Kombësisë,  
 Qofshë pranë Zotit, burim i së vërtetës.

**“Njeriu”, Nr.4(16), 1943, f.7**

***Ibrahim Hasnaji  
(1912-1995)***

*Ka lindur dhe vdiq në Tiranë. Ka botuar në shtypin e kohës; ka punuar në revistën "Djersa", të komunitetit bektashian. Eshtë marrë me Studimin e krijimtarisë së autorit Zenel Bastari dhe autorëve të tjera.*

***7 Tetuer 1900***

**P**ushoi dora, u shue zani, pa rritt syu vëzhgimtarë,  
Vdes Naimi i Mamëdheut na mbulon i madh mjerim;  
Zhytet thellë tingëllim i fjalës nëpër shpirtnat në mërgim,  
Zhytet thellë vështrim i lotit nér të gjithë shpirtrat shqiptar.

Larg këtij dheu frym' e fundit t'u shpërnda dhe shkoi në Qiell,  
Randë t'u mbyllë kapak' i syut larg Shqipnis qi ke vajtue;  
Për t'a njom m'nji shi t'pa njoftun, për t'a ngrof m'nji tjetër Diell.  
Sa lot derdhe e vajtove pa pushim veç për ket dhe,

Zonjë të madhe desh t'a shofish mort' e shkretë veç t'u afrue  
Nuk të la t'i mbërrish dëshirës, nuk të la me u gëzue  
Me nj'at Flamur me nj'at Zhgabë qi andrrove dhe s'e pe!

Por qetsahu pse n'Shqipni përmbi t'gjitha fjal' e jote.  
Thellë ka hy në fund t'çdo shpirti qi ka emnin e Arbnorit,  
Tue fillu n'kérthi t'njomë, me mbarue në gjoks t'malsorit  
Pa dyshim do t'na udhëheqi sa t'ketë rruzulli stin' e mote!

**S. Maqellari**

## **Vaj e Zi**

**Nëpër qiejtë shqiptar po ndigjohet ngashërimi,  
Ulurinin vetëtimat që ngjalli fronti n'amëshim:  
Kudo ndihet vaj' e tmerr se mbi tokë mbyll  
  sytë Naimi,  
Vdes Poeti i Mëmëdheut i vetauar në mërgim!**

Vajtojnë Zanat Shqipëtare nëpër pyje  
  e bregore  
Ushton kënga edhe vaji tej-më tej në Shqipëri  
Ndihet veç mjerim' e zi në tërë tokën Arbërore,  
Nap' e zezë ka lëshuar krahët an' e kand në  
   gjithsi...

Shuhet Ylli i ndriçuar në horizontin e Atdheut,  
Kthehet m' një nat' e kobshme, nat' pa hir  
  e pa dritë,  
Ndalet penda e pavdekshe e përshkrimit

t'Skënderbeut  
Q'i këndoi dhe i lartësoi racës s'Arbërise  
  trimëritë!

**“Njeriu Nr. 4(16), 1943, f.7**

*Skënder H. Curri*

## *Naim Frashërit*

Çsot, o bir i ksaj Shqipni!  
Dheu i huej ma n'ty s'rëndon,  
Ma ty zemra nuk t'rënkon,  
Për ty Shqipnia s'mban ma zi.

Përse lulet po t'rrethojnë,  
Përse je nën diell t'Shqipnisë,  
Përse je mbi fllad t'lirisë,  
Përse eshtnat k'tu pushojnë.

Emri yt për ne kreni,  
E skolisë me shkronja ari,  
Në krahnuer t'çfardo Shqiptari,  
N'za do t'jetë, sa t'ketë gjallni

*Tiranë, 1937*

*Në kohën kur erdhën eshtrat  
e t'Madhit Naim në Tiranë, nga Stambolli.  
"Lidhja e Prizrenit", 1944, 18 qershor.*

## **Dhimitër Mino**

**- Dëshmor -**

**(1920-1944)**

Lindi në Bubullimë të Lushnjës. Ishte bir i një fshatari të varfër. Mbasi kreu shkollën filllore në vendlindje me vështirësi të mëdha ekonomike mundi të mbaroi shkollën Normale të Elbasanit. Për aktivitet revolucionar përjashtohet nga shkolla dhe diplomohet një vit më vonë më 1942. Punoi mësues në Lorishtë të Prizrenit të Kosovës. Kthehet prej andej në vendlindje më 1943 ku shkoi menjëherë partizan dhe luftoi me armë në dorë deri në shkurt të vitit 1944, ku bie dëshmor në përpjekjet me nazistët gjermanë në Tomorricë të Skraparit. Ishte njeri me mjaft talent si në poezi dhe në prozë. Me krijimtarinë e tij poetike është botuar përbledhja "Po të pres agimi i qeshur".



## **Naim Frashërit**

**Sumbullojnë lulet me ngjyra qëndisur  
tej ja thotë bilbili me mall të pashuar  
ku na lindet dielli rreze kuqëruar  
atje napë e zezë thotë është grisur!**

Thonë është grisur nga dorë e Naimit,  
që si dorë e rrezes gris një errësirë,  
atje lart në qiell, porsi yll i ndrirë  
të shoh kryelartë, o shpirti Naimit!

Ku ka qiell të ndezur në botën e tërë,  
ku shihen dhe yjet që zenë e  
shkëndijojnë  
sikur thurin valle, sikur pëshpërijnë,  
është fron i Naimit mu në kryesore.

Fjala porsi fllad me ëmbëlsirë

# Naimit! . . .

Sunibullojné lulet me nijyra gëndisur,  
 Tek ia thot' bilibili me niall té pashuar.  
 Ku na lindet dielli preze-kuperrukat,  
 Atje nafé-e zezé thoné éshtë grisut!

Thoné éshtë grisut nga dore-e Naimit,  
 Që, si dore-e rrzes, gris një errésitë;  
 Ali, lakt' në qiekk, portsi yll i udritë,  
 Té shoh kryelartë, o shpirt i Naimit.

Ku ka qiekk té ndezur në botën e tere,  
 Ku sunien dhe yjet, eë zënë-e shkëndijné,  
 Sikur thutin valle, sikur pëshpërijné,  
 Ésht' froni Naimit munë kryesër.

ndehet nëpër male, zbret fushash, luginash,  
 ku ndez dhe bilbilin çerdhesh trendelinash,  
 se shpirti i bilbilit, bilbil éshtë shkrirë.

O shpirt i Naimit, shkrirë si qiriri,  
 gjuha jote e briskët belbëzoi liri!  
 Hej liri e shkretë pa vëllazëri  
 éshtë-degë e tharë pa një syth kalliri.

Ti ndeze një dritë buzën e venite,  
 sytë mi përndite, gjuha t'u shkurtua;  
 me këngën në buzë kandili t'u shua;  
 por me atë këngë jetën përtërite.

Kënga mori dhenë si valë e agimit  
që ndez valë deti me rreze përflakur  
dhe i teri lotët në syt' e rrëgjakur;  
u ngjall Shqipëria, pema e Naimit.

Me zemër drobitur ngryse këtë jetë  
shpirt, o shpirt Naimi, kujtim i skalitur  
zemrës së shqiptarit, për të je venitur  
luftove me malet, me qiellin, me retë!

Buza jote djegur mbolli dashurinë,  
për të shembur natën që na plasi sytë  
me pranga në dorë, me litar në fyt,  
ti e hape qiellin, rrëfeve lirinë!

Rrëfeve lirinë me këngë xhuraje,  
kur ia thek stopani nëpër majë mali,  
si bilbil agimi i ndezur nga malli,  
melodizë e njomë më bën të derdh vaje.

Shqipëtari i lashtë, dergjur e kapitur,  
e dëgjon me mall këngën valë-valë  
porsi valë e detit, kur rrëshqet ngadalë,  
shkumb' e saj e bardhë po vjen duke rritur!

**Gusht 1942**

**“Po të pres agim i qeshur”, Tiranë, 1986, f.88-91**



**Myzafer Xhaxhiu  
"Bendo Bardhi"  
(1926)**

Ka lindur në Gjirokastër më 15 maj 1926. Mbasi mori arsimin fillestar dhe të mesëm në vendlindje kreu studimet e larta jashtë shtetit për letersi. Që prej mbarimit të shkollës u emërua pedagog në Universitetin e Tiranës. Prej vitesh jep letërsinë botërore. Krahas punës së tij pedagogjike ai është marrë gjëresisht me krijimitari letrare, shkencore dhe përkthime. Ka botuar vëllimet: "Lirika", "Rapsodi magjari", "Vargje për dashurinë", "Ujrat e pranverës", "Kritikë e studime letrare", "Shkrimitar vepra dhe dukuri letrare", "Dite maji", "Vesë loti" (përkthime letrare").

## Naimit

**U**shuan hën' e dielli, yjt u shuan:  
U tretën nëpër hon' e kumbor e zile,  
Në kopshte nuk po çelin trëndafile  
As kronjër të poshtë nuk buron...

E Zerat nëpër bjeshkë më s'kënduan,  
E Rrez' e diellit s'puthi më zimbile;  
Mbi gjeth' e lule s'ndiheshin bilbile:  
Gëzimin, dashurinë e harruan!...

Kur ja! mes errësirës shqiptare,  
Më i bukur'ri Yll në botë zë e ngjizet,  
Pa hedh mbi tokë rrezen shkëlqimtare...

Nga mall' i tij ngjiren yj' të tjerë  
Nga mall' i tij botë e tërë ndizet  
Dhe Napën e flamosur ze ta çjerrë...

## **Dhimitër Shuteriqi (1915)**

Lindi në Elbasan. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen në Liceun e Korçës, ndërsa studimet e larta i kreu për drejtësi e filozofji në Grenobël të Francës. Mori pjesë në Luftën Nacnl. ku ju ngarkuan detyra të rëndësishme. Mbas Çlirimit ka punuar në shkollat e mesme dhe në Universitetin e Tiranës. Prej shumë vitesh drejtoi Lidhjen e Shkrimitarëve dhe të Artistëve të Shqipërisë. Është anëtar i Akademisë së Shkencave. Fusha e veprimitarisë së tij letrare dhe shkencore është e gjérë. Ka botuar vëllime poetik, shumë vëllime me tregime e novela, por një fushë e veçantë e aktivitetit të tij është studimi i historisë dhe të teorisë së letërsisë. dhe zbulimin e dokumenteve të gjuhës shqipe. Ai ka shkruajtur dhe një sërë monografish për personalitetë të kulturës artit dhe të letërsisë, midis të cilave edhe "Naim Frashëri jeta dhe vepra". Krijimtaria letrare e tij është përbledhur në 8 vëllime.



*"Ky poem s'ka pretendime artistike. U shkruejt tri duersh gjatë viteve 1936-37 dhe muer formën e sotme natën e 27 Nandorit 1937 në Gjenevë. Atje, në darkën e shqiptarëve të Svicrës, shtrue me rastin e 25 vjetorit t'Indipedencës kombtare, ky poem u këndue për të parën herë. Asht nji kujtim i dashun. Andaj po e botoj nën këtë ditë të lavdishme të Flamurit si ç'asht kjo e sivjetçmja."*

*DH.S.SH.*

## **Naim Frashëri, këngëtar i ri, qan për lirinë e Shqipnisë**

1

**Liri, Liri!**  
 N'errsine të papërshkueshme  
 nga drita e syve t'mi  
 je tretë  
 dhe ne jetojmë po ditë të  
 mbushme  
 tanë helm dhe landë të qelbun  
 n'skillavëri.  
 Në pyje e shkrepia t'thatë  
 në fusha e dete e re,

kurr s'e ka lshue  
natyra ndoj "ahl!" dhimbje.  
Atje  
pa datë,  
ti rrон nji jetë t'panjoftun  
si në zgjedhë  
të plogështisë s'urrejtun  
qi t'ka vjedhë  
nga zemra e jonë qi t'lindi tue gulçue  
dhe t'humbi për gjithmonë.

Ah! zemra e jonë.  
Ah! zemra e jonë,  
kjo e marrë, qi vjen vërdallë  
shpeshherë ndër andrra e shpresa pa dobi,  
urrejeje anmik, po pate mall!  
Ajo ndër andrrat t'veta do Liri,  
dhe kur do ajo, shqiptar, do ti!

Liri,Liri!  
Ti kangë e pakëndueshme,  
qi na shkëlqen nji jetë vallesh të reja,  
në lumtëni t'vertetë e ndër beteja  
gjithëmonë e ma t'madhnueshmë,  
ndriço në sytë e mil!  
Se zemra e eme do vec një shkëndi  
nga ti,  
e mbasandaj  
të ngrihet përmbi jetë e mos ia mbajë  
asgja kangët e veta për ngadhnim  
deri n'amshim.  
Ndriço në syt e mil!  
Se zemra e eme do vec nji shkëmbi  
nga ti,  
e mbasandaj  
të them:"Sot jam njeri!  
Jam ngadhënues!"  
...Dy drita t'lartga n'zjarre përvëlues  
kërkojnë të çajnë errsinën qi i ka da.

Oh! sa kam frikë se bebja m'u ka tha  
në syun e shkretë dhe flakën ngadhënuese  
nuk ma ndes gja ma n'zemër.

At'herë ti do jeshë frikë për syt e mi,  
Liri,  
e për gjithmonë  
do jetë shum vonë  
Oh! tepër vonë.

Ah! zemra e eme, zemra e jonë.

Rini pa flakë gjallnuese  
asht, vlla, rini e atij qì nuk e di  
se ç'asht Liri.

Rini pa jetë.

Rini?

Ha-ha!

Sa keq, o vlla!

Se a mund t'i thuesh sot vehtes burrë?

A mund ta quash njeri?

Jo! s'të ka hije, jo! Jo, besa, kurrë!

Sikur t'u them sot disa shokëve t'mi:

“Përpara, o burra, përpara!

Për ne ashtjeta e ne për te të jemi!”

Ata do m'shofin me i sy gjithë dyshim  
e çudi, dhe të friksuem.

Se skllavëria turke u mbylli sy dhe zemër.

Ata i dinë gjithënji t'njoma e t'pamësueme  
duert e tyne, përshkue nga gjaku i ri,  
krijestar jete, dashunije e lumnije,  
oh! krijestar drite.

Po unë do i shof dhe i herë

drejtë në sy:

do jenë të pakë ata qì nuk do e ulin  
kryen e randuem nga përtacnija e frika.

At'herë do u them:

“Ju lumtë, o vllazën, ju lumtë!

Ju e kuptuet dobësinë t'uej.

Do ju vlejë fort.  
Dhe bahi ma burra se ne,  
gjelat e çdo ore,  
me fyt tē çjerrë nga kanga e pashterueme,  
se na duket tē jetë gjithëmonë po agim".

Përpara o burra!  
Ne jemi t'rijtë  
le me sy gjithë shëkim t'prefët  
n'errsiniën ku n'shekujt e shkuem,  
lenë e iu shuen krijestarët t'onë t'verbuem  
n'padituni edhe fëmini t'pashembull.  
Nuk dimë ne sot se ku tē shkelim?  
Nuk dimë ne sot se ku tē herrim  
e ku t'qerojmë?  
- Ja ferra, turku!  
Duhet pre e djegë,  
Duhet farue këndej.  
Ja dhe garricat e mollët e egra,  
thanat e prrojeve, larushku i pyllit,  
duhen sharrtue.  
Ja e arthmja: atje përtej na pret!  
Ajo t'na e ndriçojë rrugën,  
t'na falë hovin  
për t'kapërxye kte errsinë,  
për t'lanë kte jetë  
ku kalbsina e qelbsina na zanë frymën,  
na mbysin që n'rini.  
Mjerimi s'asht për ne.  
Rinija asht gjallnija.  
Dhe ne si krymba t'mos rrojmë mbi tē vdekun.  
- Gjallni e ndyet! Gjallni e vdekun!  
ndërtimi e lumtënie  
- e t'gjithë do hudhin me liri  
vallen e re  
me dashuni.

***E d i l******Naimit***

**L**indi ylli e na ndriti,  
na dha jetë edhe gjallni  
lindi shqipja mendimtarin  
që iku larg në arrati,  
ku i shkreti mbeti vetëm,  
fill i vetëm pa njeri

Dhe atje nisi të këndojoë  
kangë malli dhe mërgimi,  
Kangë lufte, dashunie,  
për kët vend e për kët popull  
që po hiqte dit të zeza,  
dit të zeza robënie.

Sa ka vuejt e asht mundue  
për kët vend, për kët atdhe,  
nat' e dit' ai ka këndue  
der sa vdiq, u mbulue me dhe...

Ai ende asht ndër ne.

*Pionieri, Nr.46, 1 qershori 1946, f.7*



### Dritëro Agolli (1931)

Lindi në Menkulas të Devollit. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, gjimnazin në Gjirokastër, ndërsa studimet e larta për gazetari në Universitetin e Peterburgut (ish BRSS). Punoi mbi 15 vjet gazetar në "Zëri i Popullit". Për shumë vite drejtoi Lidhjen e Shkrimtarëve dhe të Artistëve të Shqipërisë. Vjershat e para i botoi që kur ishte nxënës në shkollën e mesme, prej vitit 1958 kur botoi vëllimin e parë poetik "Në rrugë dola" dhe deri tani ka botuar me dhjetra vëllime me poezi, tregime e novela, romane, drama, shënimë kritike si dhe ka përkthyer nga letërsia botërore një sërë autorësh. E gjithë krijimtaria e letrare është përbledhur në dymbëdhjetë vëllime. Ajo vazhdon të mbetet e hapur duke patur një krijimtar të bollshme. Ka qenë deputet në Kuvendin Popullor dhe jep një kontribut të veçantë në fushën politike, shoqërore të vendit në zhvillimin e proceseve demokratike. Ai është përkthyer në shumë gjuhë të botës dhe është nderuar me një sërë çmimesh.

(Qirizi)

Në mes trajnam qëndruar  
she jam duke përvëlnar

Naim Frashëri antologjinë)

(shkruar  
enkas  
për

E mdejën qiriz përmigjet,  
Qirizi bënte drithë dhe qante,  
Ashtu sic qan edhe gjë që bërr drithë".

Në fazat e verdha lotët i ngrini,  
Nga ditë qante she veton e hantë,  
Përmes qirizit vësltroja Naimi:  
Bënte drithë dhe qante...

15 tetor 1985

Dritëro Agolli

## ***Nderim për “Fjalët e Qiririt”***

**Nuk** ndez qiri në çast trishtimi,  
 Kur errësira më pushton,  
 Dhe them “gjersa jeton Naimi  
 Këtu Qiriri i tij mjafton”...

**Nëntor, 1994**

**“Lypsi i kohës”, Tiranë 1995, f.24**

## ***Frashërit***

**O** Frashër, ty të përshëndes,  
 Ku ngrihen shpate të thepisur,  
 Ku skuqet maja në mëngjes  
 Nga dielli i kuq i porsalindur

I përshëndes përrenjt’ e tu,  
 Shkëmbinjt e plasur nga tërmeti,  
 E përshëndes çdo gjë këtu,  
 Ku lindi ylli e poeti.

E përshëndes burimin tënd,  
 Që zhurmëron përposh te shkrepi,  
 Se ndofta ulur n’atë vend  
 U çlodh dhe ujë piu poeti!

**1956**

**“Në rrugë dola”, Tiranë 1958, f.10-11**

## *Naim Frasheri*

Vargjet e tua me thërrimet e dheut janë përzierë  
 Ne na duket sikur me qënien tonë janë shkrirë,  
 Se i kemi thithur mes qumështit, frutave, erës  
 Dhe në burime me ujin i kemi pirë.

Çdo rrokje e varg e poemë është rritur  
 Tok me lisat e gjatë e me barin në gurë  
 Dhe në kurorat e pishave është ngjitur  
 Dhe si në pisha, s'humblimi kurrë.

Ti, si bujk i mirë, lërove arën e fjalëve,  
 Arën e fjalëve të stërgjyshërve mbetur djerrë,  
 Mbuluar nga barrëra të liga maleve;  
 E lërove që të mos mbetej djerrë asnjëherë...

Dhe tek lëroje këtë arë në vapë dhe në shqotë,  
 Gabove kur the se Perëndia na qenka kudo;  
 në lulet e lisat,  
 Po s'the që vargjet e tua do të ishin kudo: në tokën e  
 ngrohtë.  
 Në lulet, në barin, në plisat...

Vargjet e tua me thërriemt e dheut janë përzierë  
 Dhe na duket sikur me qënien tonë janë shkrirë  
 Rrugën marrin në male e në buzë i mbajmë ngaherë:  
 "O malet e Shqipërisë!..."

**"Mesditë", Tiranë 1969, f.75**

# Trëndafilit e Turkeshës

*(Fragment)*

## 1. Kënga e parë

**M**armaraja bojëgjelbër, bojë e çallmës së sulltanit,  
Ndrit nën gjunjet e Stambollit, portës plakë të vatanit.

Cipë e trupit tënd të bukur e lëmuar si tespije  
Shket në varkën e përgjumur, feks me naze dashurie.

Ti më tha se për varka, s'bëj dot vjersha unë i ziu,  
Sipas teje vargje thurte veç poet Orhan Veliu.

Të përgjigjëm se Orhanin e njoh mirë e ma ka ëndë,  
Ky përvarkat bukur shkruan, unë këndoja çka  
varka brenda!

Ti zë qesh e thua prapë:"Ka poetë Arnaut-stani"?  
Të përgjigjem:"Kish poetë që kur priste jatagani.

Nën Stamboll nën jataganin ngrinte këngë e ligjërimë  
Një sulltan i poezisë, Naim beu i tokës sime!"

Marmaraja bojëgjelbër, bojë e çallmës së sulltanit  
Përkund varkën tek turkesha i këndon Arnaut-stanit.

## **2.Këngë e dytë**

Yzmetçi me enë turke si kapela të mëdha  
Tundet si patok i majmë dhe sjell “Elbasan-tava”.

Erë e viçit turk të pjekur i lëmon perdet e tylit,  
Unë turkeshën myslimanë e vështroj me bisht të syrit

“Kjo tava është vepra jonë, e pëlqente dhe sulltani  
E krijoj një mendjehollë, një qefli nga Elbasani”!

Deh! turkesha rreh shuplakët, gisht i vogël nxjerr inxhi - "Arnaut shejtan me brirë, qenke tepër shakaxhi"!

Ndizem prush si shpatë e turkut, një mendim më vjen  
nga larg  
- "S'lamë vetëm emra gjellësh në Stambollin tëndi të  
madh.

Ndofta zonjëz të kujtohet arkitekti bash Sinan,  
Në Stamboll i ngrenë vithet dy xhamitë e tij me nam.

Mbase ish nga Tepelena, mbase nga Librazhdi ish,  
T'i ka ngritur dy xhamitë që të falesh arabisht.

Dhe kur falesh s'ke mendjen tek një hoxhë me kuran,  
E ke mendjen në kupolat, ku fton arti sinanian.

Në Stamboll ne kemi pasur tri armata, tri ushtri..."  
U gajas kunadhja turke:"Qenke tepër shakazxhi"!

-Dale, dale!- them me vehte tek fshin djersën yzmetciu:  
- "Një armatë ish Abdyli dhe një tjetër ish Samiu

Dhe e treta-gjenerali, gjeneral poet Naimi,  
Që lëshonte nga Stanbolli divizione vjershërimi!

Dhe të tri këto armata nuk i preu dot jatagani  
I mëkonte turku vetë fshehur turçë nga sulltani.

E dëgjon një zë armate si përhapet valë-valë?  
Vjen nga larg e më merr mua dhe më mban me shpirt të gjallë:

"O malet e Shqipërisë dhe ju o lisat e gjatë,  
Fushat e gjëra me lule, që ju kam ndërmend ditë e n'atë!"

Top Kapija humb në mjergull, Marmaraja flet në paqe,  
Mua katër pikë loti më vraponjë nëpër faqe.

Dhe turkeshën e rrëmbejnë tri armata, tri ushtri,  
Yzmetciu patok i majmë vjen e sjell "Jeni Rak!"

## *Fshehtësitë e Qiririt*

Qiriri ka vërtet diçka të fshehtë,  
 Diçka që s'mund ta marrësh thjesht me mend  
 Qiriri derdh me dyllin lot të nxehthë  
 Dhe ti vështron tek tretet si një shenjt.

Sjell frymë e tij një mirësi mistike  
 Dhe qënien tënde ta pushton në çast.  
 Pastaj ti humb mes ëndrrave biblike  
 Dhe kotësitë e jetës mbeten pas.

Të zgresin tok me dyllin nga shandani  
 Fytyra fisi fshehur në ngujim...  
 Të shfaqen varg Buzuku, Budi, Bardhi dhe Bogdani,  
 Të shfaqen lotët e të treturit Naim...

Dhe zbutesh krejt si shënjt që del nga hiri, -  
 Nga shkrumb i viteve që shkuan varg e varg, -  
 Ti s'flet dhe pret të flasë veç Qiriri,  
 Siç pret një mendimtar që vjen nga larg.

*"Vjen njeriu i çuditshëm", poezi,*

*Shtëpia Botuese "Dritëro", Tiranë 1996, f-97*



### *Agim Shehu (1934)*

Lindi në Progonat të Kurveleshit. Shkollën fillore e kreua në vendlindje të mesmen në Gjirokastër ndërsa Institutin e lartë pedagogjik në Tiranë. Ka punuar për një kohë të gjatë mësues letërsie në Gimnazin "Asim Zeneli" dhe më pas ka punuar në organet e ndryshme të shtypit. Ka drejtuar gazeten "Lira" dhe "Arberia". Ka botuar vëllimet poetik "Horizonti i kaltëri", "Vite pa thinja", "Vallja e kalldrëmeve", "Fjalë nga zemra", "Çeliku dhe lira", "Një tregim për katër shokë", "Gura e fjalës", "Arkitektura e zemrës", "Zëri i gjakut" etj.

1

*Nanushaftja e Naimit*  
Një manushafje, shqipëz jimi në  
mi fshihur mër gëmushë t'i lutx.  
Zgjaz derën... nuk i ngjinte kujt  
thiria, pret Naimi t'a bëpurtë,

### *Ai rroi edhe shkroi për Atdhenë*

*Ai rroi edhe shkroi për Atdhenë*  
Dhe rreziqet kurrë vullnetin nuk  
ia prenë  
Gjuhën t'onë të gjall'e mbante të  
kulluar,  
Ditë e natë për të punonte, dhe  
mërguar.  
Ligjërues si bilbili ç'ja ka thënë  
Mbres të thell' në zemrën time më  
ka lënë;  
Lark Atdheut se sa bukur që  
vajton  
Arbërin' për pun' e madhe e  
këndon;  
Në mërgim, si zog i mbyllur në  
kuvli,  
Rri brengoset për natyrën  
Shqipëri  
Por s'ka krahë të ngrihet të  
fluturojë

Arbërinë e tij të dashur të shikojë.  
 I drejtohet dallandyshes shtegtare  
 Për atdheun, për natyrën Shqipëtare.  
 Dhe një herë këto bjeshka të shikonte  
 Se nga gjoksi mall'i zjarrtë e  
 përvëlonëte.

Në kto pyje dhe lugina, fusha kodra  
 Që prej Jugut, Vjosa, Korça gjer te Shkodra.  
 Të qëndronte në lumenjtë si kristali  
 Që zbresin andej nga majat, rreposeh mali  
 Edhe vashëzat shëtisin në luadhe,  
 E në vapë në lumë freskohen si sorkadhe,  
 Këto shpreh Naim' i ëmbël dhe i shquar,  
 Që gjith' jetën lirisë ja ka kushtuar.  
 Bir' i tij, unë sot Naimin përkujtoj  
 Dhe atë vjershën e bukur s'e harroj.  
 Sa, kujtime, mallëngjime më ka sjellë  
 E për jetë më ka lënë mbres' të thellë

.....

Fli i qetë, pëllumb i bukur arbëror  
 Zoti penës, o bilbili vjershëtor.

*Pionieri*

*Agim Shehu*

*Gazeta "Pionieri" Tiranë, 1949*

## **Poeti**

Këtu Naimi ish dikur  
 Në këtë mol, nëpër barangë  
 E din' kë mbajtën këta gurë,  
 Vallë ç'bënte rrrotull tij Saranda!?

Poet'i madh, këtu mënjanë  
 Përkulej n'ato vjetë të mjerë;  
 Ç'i mbeti dyelli i doganës  
 Në gishtërinjtë e tij të verdhë!

Dredhonin ujërat- rubinë,  
 Përpara murmurinin valët,  
 Por pas, poetit përmbi shpinë,  
 E ndjente, i rëndonin malet.

Dhe deti i rrihte përkarshi,  
 Nga pllaj e dallgëve rrebele  
 Me blegërimë drejt Atij  
 Vraponin shkumbët posa dele.

Zëri i tyre në hapsira  
 Hapej nga uturim' e erës;  
 Afroheshin ato, të mira,  
 Për në lëndinat e poemës.

Mbi valë dielli thërmohej,  
 (Ç'qirinj të ndezur, - thosh poeti,)  
 Agimi me liri afrohej,  
 Me mall në gji po gjëmonte deti.

I lozni ujrat në sy  
 Si delet e thërrisin valët;  
 Mbi shpatulla të tij, ai  
 E ndjente, i rëndonin malet.

## ***Një udhëtim i Naimit në Totor***

Në totor gjethet po i rrëzon thëllimi  
Atë muaj Naimi s'vdiq,  
S'iu nda jetës;  
I hyri tokës në gji të lidhte marrëveshje  
me blerimin,  
për pranverë tjetër.

*“Drita”, 1987, 22 mars f.8*

**Jorgo Bllaci**

1938

Kalindur në Gjirokastër. Kambaruar Fakultetin për Gjuhë Letërsi Shqipe. Vëllimin e parë poetik "Ligjërimet e pyllit" e ka botuar në vitin 1964. Vitet e fundit ka botuar një sërë vëllimesh. Është një nga përkthyesit më të njohur. Në vitin 1995 mori çminin përkthimin e poezive të Eseninit. Në vitin 1966 u dekorua me urdhërin e miqësisë nga Presidenti i Federatës Ruse për kontributin që ka dhënë në afrimin e kulturave ruse dhe shqiptare.

*Kënga jote kujt si zgom dëshirën  
T'i flijohet Mëmës Shqipëri?  
Shpirt i Kombit, zgjohu rrëmbë  
Përvëlona gjokset përsëri!*

**Zëri i Rinisë, 1959, 27 qershori, f.3.**

*J. Bllaci*

## ***Shpirt i Kombit, zgjohu!...***

**Bir i madh i Kombit që s'u shemb  
Nga rrebesh' i egër shekullor,  
Ti me zjarr tē ligjërimit tēnd  
Ndeze flakë shpirtin arbënor**  
.....

**Brezat tanë trashëgim e kanë  
Hovin tēnd tē pastër e krenar  
Ti e ndave nëpër gjoksin tonë  
Zëmrën tēnde t'art' o këngëtar!**

Rron ti, rron i dlr' e i fuqishëm!  
Kënga jote që cdo gjë zhurit  
Po gjëmon si hymn i madhë rishëm  
Nga ky shtrat ku ti tani dremit...  
.....  
Kënga jote kujt s'i zgjon dëshirën  
T'i flijohet Mëmës Shqipëri?  
Shpirt i kombit, zgjohu rrëmbë lirën,  
Përvëlona gjokset përsëri!

## **Muharrem Gazoni**

*Ka lindur dhe jeton në Kavajë.  
Prej vitesh merret me krijimtari poetike.*

## **Busti i Naimit**

**Me ballin nalt, në mes të gjelbërimit,  
me vështrim tretur - tej në hapësi,  
madhnisht qëndronte busti i Naimit,  
poetit e luftuesit për liri.**

E m'u duk busti sikur t'ish i gjallë,  
e syni i bronxët sikur vetëtiti,  
e sikur rrudhat iu thelluan në ballë,  
e buz' e heshtun sikur pëshpëriti:

"Djalosh i mbarë, ç'bën me libra n'dorë,  
nga je e ku qëndron - a nuk më flet?"  
"Nga Bjeshkët e Veriut, jam malsor,  
studjoj këtu, në Universitet."

E syni i bronxët prap i vetëtiti,  
(s'kuqtoj në jet' një çast kaq shum' të rrallë),  
e buz' e heshtun prap i pëshpëriti:  
"Ndonse kam vdek', mes jush jam prap i gjallë".

**Me ballin nalt, në mes të gjelbërimit,  
me vështrim tretun tej - në hapësi,  
gjithmon' madhnisht qëndron busti i Naimit,  
poetit e luftuesit për liri.**

**Nëntori. 1963,**



*Lazar Siliqi  
(1924)*

Lindi në Shkodër. Shkollën fillore dhe të mesmen klasike i kreu në vendlinje, ndërsa studimet e larta për letërsi në Institutin e Letërsisë "Gorki" në Moskë. Vjershë e parë e botoi me 1943 në organin e rinisë antifashiste të Shkodrës, në revistën "Liri". Për veprimitari revolucionare gjatë luftës u burgos dhe u internua në kampin nazist të përqendrimit në Prishtinë. Pas Çlirimt, ka qenë kryeredaktor i revistës letrare "Nëntori" dhe "Drita". Punoi në Lidhjen e Shkrimtarëve dhe të Artistëve. Ka botur një sërë botimesh poetike, skenarë filmash artesitikë e dokumentar si dhe libretin e operas së parë "Mrika"

*Atdheu*

*(Fragment)*

Adriatiku qesh- Valët e tija  
përkhëdhelin bregun leht' me dashuni...  
Malet vigane shtiellen në ajri...  
asht vendi im, asht vendi im-

Shqipënia!

Shqipëni, atdhe i shtrenjtë! Pa kursim  
Stoli të rralla ty natyra t'dha!  
Më thuaj: cili prej nesh ty të ka pa  
dhe zemra s'i ka rrahë me gëzim?...  
Për ty, për ty këndojmë na,  
Për ty këndoi gojë-ambli

Naim...

*"Këngët nuk mbeten kurrë të pakëndueme",  
Tiranë 1959, f.97*

## **Sytë e Naimit**

**(Fragment)**

Duke vizituar shtëpinë-muze të Tre Vëllezërve të  
mëdhenj Abdyl, Naim e Sami

I.

**Tek Tre Vëllezërit sot ishim miq.**

Tre burra,

tre viganë

reshtuar pranë e pranë,

tri majë të vargmalit,

tri flakë të idealit,

që nëpër mote nuk vdiq.

tek Tre Vëllezërit sot ishim miq.

U ktheva fill në rrugëzën e varfër  
të Shkodrës,

ku poeti fluturoi

sa të shikonte Drin' edhe Bujanë...

Porse në dhomë përherë më ndenji pranë.  
qëndronim ballë për ballë.

Nga muri

Poeti kuvendonte si i gjallë

me mua- djaloshin zemërvale.

M'i ngulte sytë

e gjuha s'mbetej belbër

çdo dru i tharë më bëhej fill i gjelbër.

U lind në malësinë e Dangëllisë,  
jetoi në çdo vis të Shqipërisë

bilbil i tokës arbërore.

7.

Kaluan partizanët  
edhe panë-

shtëpia s'kish mbetur as gërmadhë!  
Te guri ata u vunë në radhë  
dhe thanë;  
- Këtu sot 'le të miellim tre fidanë!  
Dhe emrin e Naimit,  
që lart e ngriti Shqipërinë,  
që shkroi për Bagëtinë e Bujqësinë,  
që thuri Historinë e Skënderbe-kryetimit,  
me gjak të kuq ta shkruajmë në flamur!  
Ta ngremë flamurin, shokë, mbi shkëmb e gur,  
sot Shqipëria pret prej nesh lirinë,  
...Ditët e mira,  
paskëtaj vijnë!...

***“Ju flet Tirana”, Tirana 1974, f.85-91***

## **Ismail Kadare** **(1936)**

Lindi në Gjirokastër. Mësimet e para dhe ato të mesme i mori në vendlindje, ndërsa studimet e larta, Dega Gjuhë Letërsi Shqipe i përfundoi në Universitetin e Tiranës. Kreu specializim për letërsi në Institutin e Lartë të Letërsise "Maksim Gorki" në Moskë. Punoi për një kohë të gjatë në organet letrare të Lidhjes së Shkrimitarëve dhe Artistëve të Shqipërisë si dhe drejtoi revistën në gjuhën frëngje "Les Lettres Albanaises" në Tiranë. Krijimtaria e tij është e gjithashme, në poezi, tregim, novela, romane, esse, libra me përshtypje udhëtimesh dhe memuare. Vepra e tij është botuar dhe ribotuar disa herë si në Shqipëri ashtu dhe në shumë gjuhë të botës. Ajo është përmblledhur në 12 vëllime në Shqipëri dhe njëkohësisht po botohet e plotë në gjuhën shqipe dhe frëngjisht në Paris. Lauruar me disa çmime dhe kandidat për çmimin Nobel. Eshtë antar i disa Akademive shkencore.



## **Gjuha shqipe**

**Kur** në sulm hodhën turqit  
Hordhitë e pambaruara,  
Kështjellat e sintaksës  
S'i muar, që s'i muar

Në bedena poemash  
Popullore mbetën  
Kufoma divanesh e  
Kufoma bejtesh

Kur panë se gjuhës  
S'i hodhën dot prangat,  
Lëshuan drejt saj  
Gjithfarë merimangash.

Parashtesa e pjesëza  
E lidhëza së prapthi,  
Të bukurën gjuhë  
Ta bënин lesh arapi.

Në përcartje ta kthenin,  
Në delir në jerm.  
Ishin vite të rënda,  
Ishin shekuj plot helm.

Të të bënин ty, donin,  
Shqipëri memece,  
Por ja, erdhi Naimi,  
Si yll mbi ty ecte.

Dorën e zbehtë  
Mbi ballë të vuri,  
Të të hijte zjarrllékun  
Prej të sëmuri.

Dhe vdisnin pjesëzat,  
Thaheshin merimangat,  
Ndriste si perlat  
Poezia e madhe.

Kjo gjuhë, që provoi  
Akrepët e shkretëtirës,  
Çdo të thotë përcartje  
E di, oh, e di mirë.

E di ç'do të thotë  
Kllapi, hermetizëm,  
qoftë e ardhur nga Roma,  
qoftë e ardhur nga Parisi.

Kjo gjuhë martire,  
Lehonë e përjetshme  
Që lindi mes dhembjesh  
Art të pavdekshëm.

## ***Shpjegim për librat Besianës së Vogël***

***-Fragment-***

**M**eqë ti do diçka të grisësh patjetër  
Në bilbiotekën time,  
Po të shpjegoj ç'ka këtu.  
Këta libra janë shkruar gjatë shumë e shumë  
vjetësh  
Rresht pas rreshti janë mbushur me a, i, u.

Ja, për shembull, ky këtu është xhaxha  
Homeri,  
Për gjithë ne shkrimtarët ky është babazot.  
Ku i ka sytë? Jo, s'ia ka ngrënë macja,  
Por, me sa duket ajo ç'ka parë në botë.  
Ky mbi kalë është xhaxhai Don Kishoti, vërtetë  
i marrë  
Po më vonë jam i sigurt se për të ti do të qash.  
Kurse këta janë xhaxhi Migjeni me Naim  
Frashërin,  
Që nën jastëk besoj gjithmonë do t'i mbash.

Sikur Zog e Sulltan të mos kishte atëhere  
Dhe në vend të tyre penicilinë të kishte  
Ata më shumë do të rronin dhe prej tyre së  
paku  
Ca ditë më të bukura në jetë do t'i kish.

***Vepra letrare, V.1.Tiranë, 1981, f.340-341***

## **Monologu i Naimit**

**Në mest tuaj kam qendruar**

**E jam duke përvëluar**

**Fjalët e Qiririt**

Në natën plot acar një zjarr desha tē ndez  
 Por nata ish e ftohtë ah, ç'tmerr i zi që ish  
 Ndaj që tē mbahej gjallë ky zjarrth n'atë rrebesch  
 Diçka pérherë kérkon te, kérkonte vazhdimisht.

Ndaj si shtegëtari murg që shkarpat mbledh në terr  
 Unë hidhja n'atë zjarr gjymyrët pa pushim  
 Por ishin pak ato, ndaj fill pas tyre resht  
 Mbi tē nisa tē hedh copëza tē shpirtit tim.

Se s'bëhej ndryshe, dot, se s'bëhej ndryshe, eh,  
 Se duhej që dikush ta mbante atë flakë.  
 Në flakëzën -delir që veç vajosja sjell  
 Tē frikëshme pamje ndritnin e dridheshin përqark.

I shihnit vallë ato, dallonit vallë diçka  
 Ndërsa rrëth meje nata me terr e ujq u mbush  
 Se donin tē gjitha ta fiknin atë zjarr,  
 Dikush me ligësi e me padije dikush.

Tē tjerë majë kodrash ku dielli kishte rënë,  
 Tē tyret zjarre ndrisnin dhe qeshnin që përtej.  
 Se s'donin tē kuptionin se ç'bëhej këtu brenda.  
 Se ç'fli kérkon një flakëz që lindet në një terr.

I lodhur nganjëherë kam thënë: shuhu pra,  
 Në qoftë se nuk tē duan, tē bjerë natë e pafund,  
 Tē verbërit sytë tuaj kështu ndofta do t'jenë  
 Në terrin absolut pa shqetësim kurkund.



Po prapë diçka më shtynte të ngrihem si somnambul  
 Si murgu shkremtimatar që shkarpat verbtaz mbledh  
 Dhe sipër zjarrit prap' të hedh gjymtyrët akull  
 Dhe copërat një nga një të shpirtit tim të madh.

**1984**

*“Festë në studio”, Tiranë 1990, f.41-42*



**Bilal Xhaferri  
(1936-1986)**

Lindi në Ninat të Konispolit  
dhe vdiq në Çikago të  
ShBA. Shkollën fillore e nisi  
në vendlindje dhe e  
përfundoi në Sarandë. Kreu  
shkollën teknike dhe punoi  
në Tiranë, Durrës Krujë,  
Laç e në Malësi të  
Shkodrës. Për pikpamjet e  
tij disidente internohet më  
1969. Arratiset në ShBA.

Atje botoi revistën "Krahu i  
Shqiponjës". Ka botuar  
libra "Njerëz të rinj - tokë e  
lashtë" (tregime), "Lirishta  
e kuqe" (poezi), si dhe la në  
dorëshkrim romanin  
"Krastakraus" i cili u botua  
pas vdekjes"

**"Qiriu" i Naimit**

Në vitrinën e librarisë me llampa  
neon  
bën dritë "Qiriu" i Naimit  
E sjell në shtëpi dhe, gjer natën  
vonë,

njëlloj ai bën dritë edhe në  
dhomën time.

Dhe flakë e tij e ëmbël nuk  
zbehet asnjë thërrime  
përballë abazhurit me dritë  
elektrike.

Pastaj, kur zbardh dita, e shoh  
përsëri:  
as në dritën e diellit nuk zbehet  
flakët e tij,  
që digjet në përjetësi.

**"Lirishta e kuqe" Tiranë 1967  
(Libër i ndaluar dhe i asgjësuar)**

## Naimit

Gojëembël  
fjalëzjarrtë,  
ligjërove si bilbili.  
Pena jote,  
mendjeqartë,  
fllad pranvere, lule prilli.

Mall i zemrës  
si qiriu  
pika, pika rodhi lot.  
Kënga jote  
trumbetë lufte  
zemra prush, flak' e baret.

Naim kënga  
mençuria  
mbete shpat' e poezisë.  
Trëndafil  
i gjuhës mëmë  
kurorë nderi  
e lavdisë.

**1969**

**Botohet për herë të parë**



**Niko Tyto**  
**(1936)**

Lindi në Malëshovë të Përmetit. Mësimet e para i mori në vendlindje, shtatëvjeçaren në Elbasan, pedagogjiken në Gjirokastër dhe studimet e larta për gjuhë e letërsi i kreu në Tiranë. Ka shërbyer si mësues i letërsisë mbi 30 vjet në shkollat e mesme Përmet e Këlcyrë. Ka botuar vëllimet "O ti yll", "Jam krenar", "Në fshatin e lumtur", "Rritem unë e rrithesh ti..." éshtë marrë me studimin e folklorit të rrethit të Përmetit, éshtë bashkautor i përbledhjes folklorike "Kënga popullore Përmetare" (Botim i Institutit të Kulturës Popullore i cili ndodhet në proces botimi).



**Dhorı Qiriazi**  
(1933)

Ka lindur në Kolonjë. Mbaroi fakultetin Cjuhë Letërsi në Tiranë dhe për shumë vite ushtroi profesionin e mësuesit. Ka botuar disa vëllime poetikë si dhe është marrë me përkthime njëkohësisht ka kryer një sërë studimesh në fushën e letërsisë. Është një nga poetët tanë lirikë më të shquar.

## *Naimi dhe bejtexhinjtë*

Nën fenerë digjej lart Berati,  
digjinin penxheretë.  
- Për një vetill si agrep sahati  
digju xhan i shkretë! -  
Dhe daullet binin dhe zurnatë,  
kafja ndër filxhane,  
Nga një bejte lindëte në çdo natë  
dridhej mbi qemane.  
Bejtexhinjtë këndonin në mejhane  
këngë ashikërije,  
- Ç'kish kjo zemër thyer si gastare,  
si tel violije?!  
Në penxhere rrinin prisnin gratë,  
digjej xhan' i shkretë,  
Trupi i bukur digjej nën çarçafë  
prush e mal e djersë...  
Erdh Naimi, në mejhane hyri,  
lehtë diç pëshpëriti,  
Si një zjarr i madh i digjej syri,

thellë i digjej shpirti.

Bejtexhinctë Naimin sa e panë  
në tryezë e thirrë:

- Hixhetiu këndoi Hadikanë  
ti këndo Alinë.

Dhe poeti ndali pak në derë  
Sytë i vetëtinë

E kujtoi Hasan Zyko Kamberë,  
edhe Hixhretinë.

Në fytyrë Naimi ish i zbetë  
larg mendimi e grishte;

Allajbejtë thithnin nargjiletë,  
tymin nëpër shishe.

Dhe u tha ai me duf poeti:  
merrjani njëherë,

Me një zë të madh sa gjithë rrëmeti,  
për verinë në verë.

Për kodrinat, fushëzat pjellore,  
zëthin e bagëtisë,

Nga buron si ujët, nëpër kroje  
fati i Shqipërisë.

Pastaj doli, eci anës lumit,  
qeshën bejtexhinctë;

Gurgullonte ujët tek Osumi,  
dridhej si inxhitë.

Dhe mbi kokë ju var një qiell me yje,  
er' e vëndëthtit vetë,

Që ju shfaq me çuka, gërxhe, pyje  
si një mal i blertë!



### *Teki Dervishi (1943)*

Lindi në Gjakovë. Shkollën fillore e kreua në vendlindje, gjimnazin në Pejë, studimet universitare dega gjuhë e letërsi shqipe i përfundoi në Universitetin e Prishtinës. Punoi arsimtar në fillim dhe më pas redaktor në gazetën "Flaka e vllazërimit". Për shumë vjet punoi në ndërmarrjen botuese "Rilindja". Ka shkruar kryesisht tregime, novela, drama, ujersha, kritikë letrare, të cilat i ka përbledhur në vëllimet "Nimfa", "Pirgu i lartë", "Herezia e Dervish Mallukës", "Bregu i Pikëllimit", "Nimfa II", etj.

### *Fjalët e Qiriut (Naimit)*

**Një** gazelë e gjunjëzuar atje ke kroi atje ke lumi na e lodh Orfeun e zgjuar mbi dhembka gjumi.

As ujtë i bekuar, i helmtë as prehje as ilaç as të detit ujtë e njelmtë shpirtit s'i bën paqë.

Ajo brengë e kënduar me barë me vesë seç e çel plagën shpluar të bërë me ndjesë.

Jo, jo kurrë s'e besoja me derte me halle seç qelli lartësoja një këngë me mallë.

Seç digjem, përvëlohem si bari si mali si druri n'flakë shkrumbohem e shtirrem malli.  
Por në pluhur trëndafili seç na çeli

seç na lulëzoi  
 edhe drit' e shenjtë e qielilit  
 mbi shandan ndriçoi

Atje tek kullosin bagëtia  
 me qingja  
 me shqerra  
 atje ku lartëson selvia  
 shkrin një dritë e verdhë.

As inxhinjtë më të çmuar  
 as floriri  
 as ari  
 s'janë më mirë të zbukuruar  
 se fusha me barë.

Verë e duf, flakë e shkrirë  
 mos pandeh  
 mos friko  
 s'e fik shqota këtë dëshirë  
 veç lartëso.  
 Seç ka falur hardhia rrush  
 ç'begati  
 o fryt i pjekur  
 shportën me këngë do e mbush  
 lis i djegur.

Bari i gjorë, zog me fletë  
 bjeri fyellit  
 nur i diellit  
 bëma dhembjen më të lehtë  
 n'behar t'prillit.

Bilbil që thua mijra fjalë  
 do i ruaj në gji  
 si inxhi  
 gjersa t'nisin për t'më kallë  
 ti je gjallë, ti je gjallë.



### **Jakup Ceraja (1934)**

Lindi në Cerajë të Shalës të Mitrovicës. Shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në Mitrovicë. Shkollën e lartë dega gjuhë letërsi shqipe i kreu në Gjakovë dhe fakultetin filozofik në Prishtinë. Për një kohë punoi si mësues dhe më pas punonjës në administratë. Ka botuar përbledhjet "Përkushtime", "Djersa dhe gjaku", "Pranvera po të bëhet verë", "Ngjarje që s'duan shpjegime", "As duket as humbet", "Udhëton me erëra", "Fund me diell" etj.

### **Naim Frashërit**

**M**argaritarët vetë nuk i kemi trillue -  
andërr e pambërrijtshme nuk janë ma:  
shkëlqejnë para nesh, shkëlqejnë në ne-  
ata nga askush na i ka dhurue  
bylbyli me ma 'amblin za!

Margaritarët për ne andërr nuk janë ma,  
varg e vistër i kemi, si rreze dielli janë;  
I miklojmë me sy, i dashunojmë me shpirt-  
dritë janë për sy, ushqim janë për shpirt'  
begati e madhe që forcohet për vjet e ma.

Njeri dhe vjershëtor i ri  
hapi ato dyer me gëzim,  
me etje pi  
gjithnji, gjithnji,  
n'atë burim!

## ***Tinguj për Naimin***

**P**ërkulu ndaj këtij emri t'amshuar:  
një dorë dhe një sy i la peng në Veri,  
një dorë dhe një sy i la peng në Jug  
e zemrën mbi Tomorr e hodhi  
e gjuhën ku rrök dieli i shqipeve e mbolli;  
qiri u bë para syve të të verbtit,  
fyell u bë në vesh të të shurdhtit,  
e u dogj u poq në zjarr të vargut.

***1 dhjetor 1970***

***“Kur dhemb zemra”, Tiranë 1977, f.74***



### **Alfred Çapaliku (1952)**

Lindi në Shkodër. Ka debutuar në shtypin letrar që në shkollën e mesme. Kreu studimet në Universitetin e Tiranës, dega Gjuhë-Letërsi. Ka botuar vëllimet: "Kënga e kantiereve", "Për njerëzit e punës", "Java pa ty" dhe së fundi botoi monografinë "At Vinçens Prenushi -jeta dhe veprat" me të cilën mbrojti doktoratën dhe mori titullin Doktor i Shkencave. Është pedagog i letërsisë në Universitetin "Luigj Gurakuqi" Shkodër.

## **Naimi në Muzeun e Vjenës**

**Në Belvederë në Vjenë  
Sikur pashë Skënderbenë**

**Naim Frashëri**

Cili ishte ai njeri me shpirt poeti dhe pamje poeti  
Që pas katër shekujsh vinte të shihte shpatën  
e kryetrimit?

Kumbonin nën kollonat e muzeut, mbi pllakat  
e mermerit

Dhe para stendës së thjeshtë e të dashur,  
hapat e Naimit.

O kjo pallë, e madhërishme pallë,  
Që turq e tradhëtar griu e preu!

Dhe shpatën desh ta puthë se kish mallë,  
Por e pengoi xhami i ftohtë i muzeut.

Shpata e madhe në dorën e tij të fuqishme...

Por pasardhësit rrojnë, Shqipëria është gjallë  
Dhe vetëm një varg në ato çaste përsëriste!

"Tjetër përgjigje Turqia nuk do, pëveç me pallë"

Dhe i kumbonin në shpirt ujëvarat e frysëzimeve lirike,  
I shtohej dashuria për çdo lis e mal të Atdheut  
Dhe kompozoi aty fillimin e poemës epike  
Mes heshtjes së mermerit, "Historinë e Skënderbeut". .

**"Nëntori", Nr.5/1971, f.8**

## **Enver Gjergjeku (1929)**

Lindi në Gjakovë. Arsimin fillor dhe normalen i mori në vendlindje, ndërsa fakultetin filozofik dega gjuhë dhe letërsi shqipe i kreu në Beograd. Për një kohë shërbeu si profesor në normalen e Gjakovës, të Prishtinës dhe nga viti 1962 punoi në Fakultetin filozofik të Prishtinës deri sa doli në pension. Ka bashkëpunuar në shumë gazeta dhe revista dhe së fundi ka qenë kryeredaktor i enciklopedisë për Kosovën. Ka botuar një sërë vëllimesh poetike, studime, ese etj.



## **I ngjeshur në zjarr (Naim Frashëri)**

**I**ngjeshur në shkëndinë e përgjërimit të vatrës sate-  
Të zjarrit tim të trashëguar nga bebzat tua hirpolote,  
Ndër stinë më shoqëroi tingulli yt, e dorën ma zgjate,  
Kur vehten e lëshova në stuhi dhe u bëra strall

Ndër mote.

Brezin e ke të ngjeshur me rrufena edhe kur buza  
të qesh

Hije na ka në ballin tonë flaka e qiririt tënd  
të djegur

E kur dashurisë ja ke lëshuar frerat e n'gjak e ke  
veshë,

Guri dhe druri është përtrirë sa herë me te i ke prekur.

Vetëm n'fjalën tënde nuk jam betuar e nuk betohem  
kurrë,

Se betimi ushqehet me thërmija të padukshme  
t'dyshimit.

Na ke mësuar: tek çdo fëmi të kërkojmë edhe nga  
një burrë

Dhe na tē mēdhejt ta ndjejmë veten bij tē amëshimit.  
Sa herë zemrën ta kemi matur, kufitē e saj na janë  
zhdukur

Dhe ne n'atë truall tēndin gjetur kem'një krenari.  
Kemi qenë mē tē lumtur dhe, beso, shumë mē  
tē bukur,

Kur damarët me ngjyrën e gjakut tēnd i kemi  
pērtri'

Tē ngjeshur nē flakën e pashuar tē mallit e fjalës  
sate

Tē zjarrit tonë tē trashëguar nga bebzat tua hirplate,  
Ndër stinë na shoqëroi zëri yt dhe dorën kudo na  
zgjate,

Kur veten e gjetëm nē stuhi dhe u ringjallëm ndër mote.

***"E di një fjalë prej guri", Tirana 1972, f.92-93***

## *Naimit*

**N**ga telat e zemrës sate  
ti nxore tinguj në hapësirë  
qenë si flutura delikate,  
qenë si shqiponja krahëlirë.

Dhe fyelli këndoi porsi lirë,  
Flak' e Qiririt u bë diell  
Dhe "Manushaques" në errësirë  
sikur iu shfaq një copë quell

**"Ne rendim" , Tiranë 1974, f.15**



**Klara Kodra**  
**(1944)**

Lindi në Tiranë. U arsimua  
në Universitetin e Tiranës  
dhe prej vitesh punon në  
Institutin e Gjuhë Letërsisë  
në Tiranë. Krahës punës së  
saj studimore-shkencore  
është marrë dhe me  
krijimtari letrare. Ka  
botuar vëllimet "Era e  
revolucionit",  
"Buzëqeshje", "Ne rendim",  
"Vepra poetike e Zef  
Serembës", "Bisedë me  
vëllezërit", "S'jam  
lulebore", "Poezia e De  
Radës". Ajo ka ligjëruar  
dhe në shumë konferanca  
shkencore duke qenë një  
nga njohëset më të mira të  
letërsisë arbëreshe.

***Arif Kazo  
(1940)***

*Ka lindur në Fushë Bardhë të Gjirokastrës. Në vitin 1967 mbaroi Fakultetin e agronomisë dhe tani punon në NB Llakatund të Vlorës. Ka botuar vëllimin poetik*

***Vargjet e Naimit***

**E**cin vargjet mes kopeve të dhenve  
me krrabë në dorë...  
ngjiten rrëpirave,  
pyjeve,  
monopateve,  
gërxheve  
shkëmborë;  
pranë lapidarëve,  
oxhaqeve,  
grunjave  
larg rrëmujave feudale,  
qyteteve orientale,  
xhurasë shqiptare i bien  
në atdheun e tyre;  
dhe shtrohen në biseda të gjata  
me vargjet e sotme...  
Tek unë,  
pas udhëtitimit 16-rrrokësh,  
çlodhen e rrinë.  
*"Flora e vargjeve", Tiranë, 1973, f.30*

## **Sulejman Mato (1941)**

Lindi në fshatin Fterrë të rrethit të Sarandës. Shkollën fillore dhe atë të mesme i kreu në vendlindje përkatësisht në Sarandë, ndërsa studimet universitare, Dega Gjuhë e Letërsi Shqipe, në Universitetin e Tiranës. Ka punuar mësimdhënës në Tiranë, pastaj në organet e ndryshme të shtypit, si: "Drita" e "Nëntori" etj. Me krijimtari letrare merret që nga vitet gjashtëdhjetë. Shkruan kryesisht vjersha për të ritur dhe për fëmijë si dhe drama. Sulejman Mato jeton në Tiranë. Vepra letrare: "Shtegu i blertë", "Nën dielline jugut", "Mbi glob fryjnë erëra", "Në stinën e poezisë", "Bukë në shkëmb", "Ankhi", "Mesi i jetës", "Kryengritësit", "Drita e syve", "Roni bëhet yllkë", "Fjalët"



## **Vëllezërít Frashëri**

**H**ipur përmbi mushka, për ku shkojnë vallë  
Kapërcejnë gryka, hedhin vrahe, valë...

Për ku shkojnë vallë, ata tre vëllezër?...  
Tokën e Shqipërisë mbajnë thellë në zemër.

Shqipëri e zhveshur, pa bukë e pa ujë  
T'i dërgojnë djemtë larg në dhe të huaj.

Trak e truk patkonjtë, trok i mushkave  
Qielli me re, përmbi mëmëdhe.

Trak e truk patkonjtë, mbi baltë e shkëmbij,  
Tre vëllezër sipër, të tre Frashërllinj.

I madhi, Abdyli - në mushkën e parë,  
Si yll mbi humnera - errësirën çan.

I dyti, Naimi - kjo zemër poeti,  
Qysh do rrjë larg, tokës që e rriti?

Mbi të tretën ti - shemshedin Sami...  
Kokën e mban lart, dhe bën profeci.

Iki... Vallë si ikin? Janë këtu, brenda  
Largohen djemtë, po s'largohen zemrat

...I kish të tre bij prej gjaku, prej gjiri  
Tre bij si tre yje dashuri të pavdirë.

Eh, moj Shqipëri, netëve ç'të mundon?...  
Tre yje mbi ty si kostelacion.

I pari hedh pushkë në male për ty,  
I dyti thur këngë për ty Shqipëri,

Po ç'bën më i vogli? Po bën profeci...  
Shqipërinë e sheh nën llohë, nën rrebesh..

Ç'mëmë ishte ajo që në djep i tundi?  
Ç'qumësht ish ai që me të i mendi?

Ç'dashuri ju dha ky breg e ky mal?  
Ç'krenari ju dha emri shqipëtar?

Rend Abdyl mbi kalë, ec e vetëti;  
Lësho fjalë burrash në kuvend tek rri.

Ja ku vjen Naimi si yll nëpër det,  
S'shkruan me bojë shkrimi, po me gjak të vet.

Do ta mbrojmë mëmën, ku do ta lemë?  
Që të vijë i huaji ta shkëlasë me këmbë?!

Jo! S'do lemë kurrë kush të na sundojë,  
Shqipërinë tonë trime, kryezonjë!

Rend Abdyl mbi kalë, ec e vetëti  
Lësho fjalë burrash në kuvent tek rri.

Niset për Prizren, ligjëron në Mat,  
Pë liri i digjet, Zemra ditë e natë.

Shkon në Gjirokastër, niset në Berlin.  
“Prishe Avdyl, prishe një barrë flori”

Sos i prish për vete, por për Shqipëri.

Shaluar mbi kohra kush po vjen kështu  
Ç'ka që gëzon toka çdo gur e çdo dru.

Kush të kthehet vallë nga kurbet i zi?  
Tokë e Shqipërisë ç'gëzim fsheh në gjë?

“Ja m'u kthyen djemtë, nga kurbeti i shkretë,  
Ju kish pritur nëna eshtrat kaqë vjet.

Djemtë i sjell kënga, djemtë i sjell malli,  
Djemtë i do nëna që t'i puthë te balli.

**“Zëri i Rinisë” 3 shtator, 1977 f.3**



### **Rahman Dedaj (1939)**

Lindi në fshatin Penuhë të Podujevës. Shkollën fillore e kreu në Podujevë, Normalen në Prishtinë, ndërsa studimet e larta, Dega Gjuhë e Letërsi Shqipe, në Fakultetin Filozofik të Prishtinës. Ka punuar gazetar e redaktor në Radio Prishtinë, në Sekretariatin Krahinor për Arsim, Kulturë e Shkencë, në Redaksinë e botimeve "Rilindja" redaktor i poezisë, drejtor i përgjithshëm në "Rilindja" dhe së fundi përsëri redaktor në Ndërmarrjen Botuese "Rilindja". Ka botuar: "Më sy kangë" "Mëshehtësia", "Medaljoni", "Dy ligej", "Simfonia e fjalës", "Baladë e fshehur", "Zogu dhe kulla", "Etje", "Poezi", etj.

### ***Me Naimin në gjimnazin Zosimea të Janinës***

**K**rejt ç'ndodhi më vonë u murua në antikë e u pagëzua si fat.

Në Janinë as hije, as harrim.  
As koka e Ali p.Tepelenës.

Kaq i gjallë e askund s'je ç'bën kujtimi në Zosim?

As i tretur, as i venitur,  
lis i gjatë në malin e rritur.

Vetëm ty s'të pranon harrimi,  
historisë s'po i vdes mallëngjimi.

***Janinë, gusht 1978***  
***"Poezi" Tiranë 1989, f.263***

## ***Qiriū***


*Duke kujtuar Naimin*

**U**dogje gjer nē fund qē tē lindësh përsëri  
 Dhe ashtin na e ndeze tē bëjë dritë-  
 Fyellit edhe me një gjysmë mushkërie i ke fry'  
 Zemrën e këngës pér ta rritë.

U dogje gjer nē fund dhe prap Qiri,  
 Dashuri kurrë e djegur-  
 Fjala tē bëhet verë me kalli'  
 N'arat e malit tē pjekur.

Pas këngës kur vdes Orfeu  
 Thonë, fjala murohet me legjendë  
 E vargu qē ashtin na e nxeu  
 Emrin n'amëshim ta gdhendë,  
 U dogje gjer nē fund dhe përsëri fyell,  
 Nëpër vrima dhembën ke kaluar  
 E një hark ylberi nē qiell  
 Nga zjarri yt është lëshuar.

Tani, një Qiri ia djeg harresën  
 Fjalës qē nē magji na nxe,  
 E n'amëshim ia bën qëndresën





## *Shefki Karadaku (1941)*

Lindi në qytetin e Elbasanit.

Ka mbaruar studimet e larta në Fakultetin Histori-Filologji. Për njëzet vjet me radhë që nga viti 1971 ka punuar si gazetar dhe redaktor në revistën enciklopedike "Ylli". Sot është shkrimtar profesionist. Ka botuar librat: "Kënga e karrove të drithit" (poezi), "Rrugët e para", "Meloditë e Shkumbinit", "Kur kërcasin boçat e pishave", "Ylberi", "Sokol Marini", "Mozaik lirikash", "Toka e etërve", "Ujëvarë", "Feniks", "Puthja e ngrirë", "Arkadia e largët", "Njëmijë vjet dashuri", "Perëndim i gjatë", "Argonantët", "Gjenerali nuk dëshiron të vdesë kot", "Lumi me njëqind zemra", "Vila e magjepsur", "Krillat e shiu".

## *O ju maja të Kokojkës!*

*(Fragment)*

*Janë ata në mesin tonë,  
janë në Kokojkë...  
Vargje nga një rapsodi e  
kohëve të fundit*

1.

**O**ju maja të Kokojkës,  
O ju maja plot me bredha!  
Ku ju lamë, ku ju gjetëm!  
Koha s'na e treti mallin!

Vijmë tek ju të përmalluar  
Larg nga malet e Azisë,  
Dardanelet e Bosforit  
vijmë njëqind vjeç të vjetër.

Ku ju lamë, ku ju gjetëm!

Erë, moj erë e Atdheut  
përqafona me gëzim,  
krahëlehtë si thëllëzë  
kokën, ballin ta mbështetim  
në argjilën e Ogrenit,  
trupi, sytë na i çlodh  
me mistralin e Nemërçkës.

Fluturuan tej Kokojkës  
tre pëllumba krahëlehtë

në lirikat Naimjane.

2.

Sa të gjata na u dukën  
netët tutje në mërgatë,  
sa të gjata vjeshta, dimret,  
deti, gjuha e Azisë.

Eh, ju male, eh, ju male,  
nën tre kaçe qesh bilibili!  
Sa eëmbël kjo pranverë  
përmbi kupat e qiellit,  
sa iëmbël maji, lulet  
e atdheut gjyshëror,  
fshatra, udha qumështore  
e lirisë pendëkuqe.

Ne vrapiuam nëpër supet  
e Bosforit të stuhishëm,  
duke bredhur si dikur,  
por tani drejt tokës mëmë  
që të tre në vig të popullit.

.....

6.

Një poet i madh i diellit,  
i lirisë dhe i shqiptarëve  
udhëton përkrah të vllezërvë  
si balad'e Kostandinit  
nëpër hark të horizontit.

Flok' i bukur kokoridhka  
i ka rënë përmbi gur  
si një dredhëzë e kaltër.  
Sy i qartë i poetit  
është ngjitur mbi lirinë  
si një dritëzë e njelmët.

O ju vargje të Naimit

fluturuat drejt agut  
dallandyshe krahèlehta.

Ku ju lashë, ku ju gjeta!

Sa e bukur toka mëmë  
kur e puth sërish me ledhe,  
kur puth kulmet amëtare  
në kulloshtren diellore,  
udhës, tragën e lirisë  
që vrapon mbi breg' e bukur.  
O ju ditë të lirisë  
që ju pashë vec në ëndrra  
puilëbardha keni zbritur  
mbi të lashtin bredh të mëmës  
Përmi pendët e argjenta  
diell paska maji, lulet,  
paska ngazëllim Atdheu  
treqind kilometra tutje  
dhe njëqind këtejza detit.

Ikin kohët vrap si lumi!

Eshtë me ju, o njerëz miq  
përsëri Naimi plak  
“mos më shihni kokëbardhë,  
se jam tretur nga mendimet,  
por mërzinë sot e ktheva  
në tre kupëza të kuqe”.  
8.

Ecën një karvan i bardhë  
tre pëllumba përmbi të,  
ecën drejt kryeqytetit,  
tre pëllumba përmbi të,  
ecën një karvan i bukur...

***Qazim Shemaj******Naimit***

**M**alet e Atdheut larg...  
oh, ç'po tretesh qiri,  
edhe kënga mall i zjarrtë  
të pikonte si flori.

Kënga e tokës erë plisash  
vinte na shëronte zemrën;  
herë fërfërimë lisash,  
herë si xhura e ëmbël.

Çukat e gërxhet me brymë  
ndër poema vijnë e venë  
si kreshnik poeti ynë  
ngrite malet në poemë.

Digjeshe ti flakë e bardhë.  
tek i bëje ze pranverës,  
kur Atdheu s'kish behar,  
Ti na dhe "Lulet e Verës".

**"Kush ma mësoi këngën",  
Tiranë 1979, f.18**

*Lindi në Tepelenë. Ka  
mbaruar Fakultetin Histori  
Filologji Dega Gjuhë  
Letërsi Shqipe në Tiranë.  
Ka punuar për shumë vite  
mësues në fshatrat e  
Tepelenës dhe për një kohë  
punoi në redaksinë e  
Revistës Hosteni ku ka qenë  
për një kohë dhe  
kryeredaktor i saj. Ka  
botuar këto përbledhje  
poetike: "Daullja e  
festivalit", "Kush ma mësoi  
këngën", "Përroi që rrjedh  
ndanë strehës sime". Jeton  
në Tepelenë*



## Piro Kuqi

(1939)

Ka lindur në Rehovë të  
Kolonjës. Jeton në  
Tiranë.

## *Naimit*

**T**i vjen nga larg në ditët tona,  
Nuk mund të rrosh ti në mërgim  
Me rritme vargjesh plot jehona  
Të shpirtit tënd plot frymëzim.

Ky zëri yt sa vjen e rritet,  
Një lot gëzimi ta njomifaqen:  
Portretin tënd e gdhendën vitet  
Me mall e shpresë për  
“Manushaqen”.

Oh, prehu pak, i shtrenjti Naim;  
Pranë deleve, mbi bar të njomë,  
Dhe kraharorin mbushur thellë  
Me aromën e luleve të kohës  
sonë.

Oh, prehu pak në fëshfëritjen  
E degëve që i rreh era!  
Në shpirt e ndjen ti përtëritjen  
E kohës që lulëzon pranvera.

“*Nëntori*”, nr. 5.1979 f. 7



## **Ndoc Pappleka (1945)**

Lindi në Lekbibaj të Tropojës. Studimet universitare i kreu në Dëgën Gjuhë Letërsi Shqipe në Universitetin e Tiranës. Punoi si arsimtar për shumë vite në qytetin Bajram Curri. Më pas punoi si skenarist në Kinostudio "Shqipëria e Re" dhe tanjore punon si bashkëpunë-tor shkencor në Institutin e Kulturës Popullore. Ka botuar një sërë vëllimesh poetike dhe në prozë: "Zëri im" "Ecim", "Nja tjeta diell", "Arkitektura e dritës", "Në gjurmë të heroit", "Rra-thët e lisit", "Gjaku i tokës", "Poezi", "Lumi e di ku buron", "Dedalia dhe Katallani", "Gjethnaja në trup", "Qypi me florinj"

## **Naim Frashërit**

**M**und të kesh në emër imazhin e drurëve  
Por kjo është fare pak për të qenë i blertë

Mund të kesh në vargje malet e lisat e gjatë,  
Lumenjtë, barin dhe lulet e verës,  
Por s'mjaftojnë vetëm kaq për të qenë i blertë.

Të jesh i blertë  
Në kohën tënde dhe të gjitha kohrat,  
Do të thotë të kesh diçka nga malet e nga lisat,  
Të bësh prej fjale lumenjtë, barin dhe lulet e verës.

Do të thotë t'i bësh vargjet e tua breza pyjorë  
Për gjuhën tënde të gërryer nga përrrenjtë  
                                e huaj,  
Të mbrosh vatrën e lashtë të kombit nga erërat

Të jesh i blertë, do të thotë të kesh në vetvete  
Mundësinë e përtëritjes së vazhdueshme si drurët

Të lësh zemrën tënde si një lëndë te fjalët  
Dhe midis tyre të shfaqet nëpër mote i blertë.

**1979.**

**"Arkitektura e dritës", Tirana 1981, f.47.**

## **Katjusha Pogaçe (1951)**

Lindi në Picar të Gjirokastër trës më 11 shkurt 1951. Arsimin e ultë dhe atë të mesém e ka kryer në Gjimnazin Asim Zeneli në Gjiro-kastër. Më pas mbaroi me rezultate të larta Universitetin e Tiranës në Fakultetin Histori Filologji, Degën Gjuhë Letërsi. Mbrojti diplomën "Elementë tragjik dhe heroik në poezinë tonë populllore", punim që u hapi rrugën një sërë shkrime dhe studime mbi folklorin dhe letërsinë bashkëkohore. Ka punuar si redaktore dhe gazetare në organe letrare dhe kulturore të shtypit si: "Nëntori", "Skena dhe Ekran", "Spek-tër". Punon si gazetare në Radio Tirana. Botonartikuj kritik, poezi, tregime. Ka botuar vëllimin poetik "Fjala jonë".



## **Duke lexuar Naimin**

**S**i një pyll i madh që digjet e s'shuhet  
Me zjarre të kuq në lindje e në  
perëndim

Mbi zjarrin e vargjeve shqipja e bukur  
Çan rrugët,  
Përgjaket,  
E merr fluturim

Në flatrat e saj shqiponja rri zgjuar  
Kërleshur me erë,  
dallgë e përmallime  
Mbi sytë e kohës ndizet e shkruhet:  
"Shqipëri, o mëma ime!"

Këtij lumi perlash  
Sado të shkojnë vitet  
Brigjesh do t'i ulem,  
Do t'i falem brigjesh,  
Humbur si një çupëz  
Si një foshnjëz habitur,  
Endrrën duke zgjuar,  
Zgimin duke pritur.

Këtij lumi perlash  
sado të shkojnë vitet  
brigjesh do t'i ulem  
do t'i falem brigjesh,  
humbur si një çupëz.  
si një foshnjëz habitur,  
endrrën duke zgjuar  
zgimin duke pritur.



## Vëllezërit Frashëri

Sa herë ngjitem këtu lart në  
kodër,  
Ku rrinë tre vëllezër gdhendur  
në gur,  
I gjej fëmijët gjithnjë në një lodër,  
burimin që rrjedh nga toka e  
butë.

Dhe them: a mundem ndonjëherë  
në vjershë  
të fus unë tre vëllezër kaq të  
mëdhenj,  
ata që tokën mëmë e mbrijtën,  
dhe sipër i vunë qiejt?

Dhe them se a mund t'i  
mbajë një vjershë  
tre burra kolosë sa më s'ka,  
derisa dhe barku i një  
nëne të thjeshtë  
i mbajti një herë e një kohë ata.

Dhe them urimin më të shtrenjtë  
që na lanë vëllezërit për  
Shqipërinë:

Mbafshi, o nëna, në barkun  
e shtrenjtë  
Bija dhe bij të tillë!

**“Drita”, 1981, 4 tetor, f.8**

### Natasha Lako (1948)

Lindi në Korçë, ku kreu shkollën fillore dhe atë të mesme, ndërsa studimet universitare i kreu në Fakultetin e Shkencave Politikoshoqërore të Universitetit të Tiranës.

Punoi për disa vite arsimtare në vendlindje, më pas punoi si skenariste në Kinostudion Shqipëria e Re, në Revistën "Shqiptarja e re" si dhe pranë Lidhjes së Shkrimitarëve dhe të Artistëve të Shqipërisë. Është autore e disa vëllime poetikë, romane dhe skenarë filmash.

**Roland Musta  
(1946)**

Lindi në Tiranë, mbasi ka kryer shkollën e mesme, ka mbaruar shkollën e lartë për oficer. Shërbeu për 30 vjet si oficer trupe dhe kryesisht në shtypin ushtarak dhe sektorin e kulturës. Ka mbaruar Fakultetin Histori Filologji, Dega Gjuhë Letërsi. Krijimtarinë poetike e ka përbledhur në vëllimet "Nëpër agime", "Jetë" si dhe është autor i një sërë antologjive për ushtrinë dhe mbrojtjen.

**Naim Frashëri**

*Atë kohë, Naim beu u mbyll për ditë e netë  
të tëra e jepte e merrte me vete...*

**Nga një gojëdhënë**

**K**ur poeti ynë u mbyll në kullë,  
se e gërryente nervi i krijimit,  
gojët e liga nga mekamet e udhët  
thanë, u duk dhe pun' e Naimit...

S'është mirë e flet me drurët e pyllit,  
flet rrugës me gurët e barë,  
flet me karvanet e yjet e qiellet,  
I ziu djalë!...

Dhe rri i parruar  
dhe s'di ç'bën,  
e mjekër lë nga mërzia,

ndërsa poeti  
si kaminë u përvëlua  
e harroi dhe dhembjet e tija...

Se Naim Frashëri, nuk ish i marrë,  
megjithse foli me lulet, pyjet, lisat e bagëtinë,  
megjithse foli me të vdekur e të gjallë,  
gjersa kombit i ngriti Historinë...

Dhe la pas këngë, brenga e dëshira,  
dhe për njerëzit e kësaj toke u shkri,  
e për ta shkroi me qindra vargje të mira  
dhe eposin e përjetshëm:

“Ti Shqipëri...”

**“Jetë”, Tirana, 1978.**



### *Lefter Çipa*

(1941)

*Lindi në Pilur të Himarës.  
Ka punuar vazhdimisht në  
vendlindje dhe është marrë  
me kulturën. Shumë poezi të  
tija janë kthyer në këngë  
popullore dhe janë barë  
mbarëkombëtare.  
Krijimtarinë poetike e ka  
përmbledhur në vëllimet  
"Bejkë e bardhë", "Shqipëri  
moj ballëhapur", "Bilbilat e  
vendit tim", "Dheun tim  
përsipër mbaj".*

### *Naimit sërish një këngë*

Midis maleve menduar  
Mendimet larë nga bora;  
Midis vargjeve të shkruar,  
Vargun për këngën ta zgjodha.  
Midis këngëe të tua,  
Zemrën e gjirit ta hodha.  
Midis lumiit të kulluar,  
Shpirtin tënd kudo ta mora.  
Midis lisave lartuar,  
Gjuhën tënde e kërkova.  
Midis Qiririt pashuar,  
Syrin e ndezur shikova.

Në mes qiellit qëruar,  
Shpirt e ndjenjë shenjtëruar.

- *Botuar për herë të parë -*

### *Gjaku ju bë këngë*

Ngrihu si të rrihet,  
balta kullon mjaltë,  
lulet nën diell,  
hedhin shtat të lartë.

Shpirtin plot revoltë,  
dorën te shpata,  
vjen një këngë e fortë  
avaze të zjarra.

Kohë të vështira,  
dimri s'kish të sosur,  
mëma nga uria  
këngë s'kish të ngopur.

Sytë e saj panë  
një qiri të ndezur,  
ish drita e parë,  
për dritë e ish e etur.

Naimi i saj  
ç'ia nisi e shkroi,  
shqiponja nga krahët  
një pendë i dhuroi.

Gjaku iu bë këngë,  
Vjersha gjithëshpirt  
Shqipërisë mëmë  
krahët lart ja ngriti.

Vargu i Naimit  
fletëborziloku,  
gjerdani i trimit,  
për luftë së toku.

Vargu ditë e dritë  
në zemrat e zjarra,  
pishtar i pashuar  
për të dalë nga nata.

Sa më i egër deti,  
shkëmb mbi det Naimi  
zu përkulej djepi  
çeli trëndafili.

Çarku i dyfekut  
zu lëshonte flakë,  
nëpër flakë Naimi  
hidh'dritë të zjarrtë.

Fushat, malet, lisat  
bashkë kuvendojnë;  
arat, vreshtat, plisat  
shpirtin ia gatuan.

Ndezur nëpër shekuj  
sa shekuj do shkojnë  
ti për kombin s'vdiqe,  
gjallë të shkojmë.

Vendin e stërrallit  
dil shih të stolisur  
Manushaqen tënde  
kryelartë ngritur.

Ngrehu, si të rrihet,  
balta kullon mjaltë,  
lulet në diell  
hedhin shtat të lartë...

*“Shqipëri moj ballëhapur, Tiranë 1981, f.59-61*

## Aleksandër Cipa

(1967)

Ka lindur në Himarë. Mbaroi shkollën e lartë për filologji (dega Gjuhë dhe Letërsi Shqipe) në Universitetin "Ezra Çabej" të Gjirokastrës. Poet, publicist, analist i jetës shoqërore dhe politike. Është kryeredaktor i gazetës "Java" dhe korrespondent i Shqipërisë së Jugut për emisionin shqip të radios britanike BBC.



## Dhënia e Naimit

"Na diellin e shpirtit  
në Qiri",  
Na tha Naimi

"Na diellin e shpirtit"  
Nga i imi  
Nga-i-im  
tha Na-i-mi.

*Botohet për herë të parë.*

## Naimi në Sarandë

**N**ë shtëpinë e vogël,  
buzë detit ti s'fjete  
Vargu yt më thotë:

Rrinin pranë  
dy dete.

**"Nëntori", Nr. 10/1990, f.42**



### *Luan Rexhepi (1934-1985)*

Lindi në Vajzë të Vlorës.  
Kreu studimet për Histori Filozofji jashtë shtetit. U emërua në Institutin e Historisë si bashkëpunëtor shkencor. Për shumë vite punoi si redaktor në Shtëpinë Botuese të Librit Shkollor. Përveç krijimtarisë së tij artistike, një punë të madhe bëri dhe me përkthimet, duke e sjellë Majakovskin në shqip. Veprat e tij letrare është përbledhur në vëllimet: "Kryelartë, Shqipëria ime", "Po ngjitet dielli në Zenit", "Rrugë dhe këngë", "Motive nëntori", "Udhëtimet e ardhshme të Gentit", "Fletët nga ditari i atdheut", "Yje dhe yllka", "Emra të dashur", "Letër nga kufiri".

## *Kopshtari i madh i poezisë Naim Frashëri*

Lexojmë vargjet e tua  
dhe në qìell krenaria na ngrihet  
ku shohim të lulëzojnë  
malet, gérxhet,  
shpatet e trimërisë...  
E ka kaq gjëra sa tek ti  
farërat e dashurisë mund të  
rriten,  
kopshtar i madh i poezisë?...

S't'u ndanë gishtërinjtë nga fyelli,  
dhe sytë nga Shqipëria  
mbështetur te një pemë  
mendja jote  
ikte me vrapijn e erës,  
të ngriheshin flokët përpjete  
kur kujtoje dhimbjet e robërisë,  
të shërohej shpirti,  
kur të dilnin përpara  
“Lulet e Verës”

Tani  
një qìell i tërë me lule të qëndron  
mbi kokë.  
T'i prehesht i qetë  
mes flladit të tyre  
e freskisë...  
Eh, sa shumë lule  
mbolle vet për këtë tokë  
kopshtar i madh i poezisë!

## *Çajupi te Naimi*

**U**në e kam parë dhe Sheperin  
Dhe Frashërin e kam parë,  
ca vargmale ata i lidhnin,  
ca lugina në mes i ndajnë.

Kaq afër ishin në vitet e  
fëmijërisë,  
dhe dete të mëdhenj pastaj i  
ndanë.

Çajupi u nis prej Aleksandrisë  
e gjeti në Stamboll poetin e  
madh.

Kështu i ngelën ata historisë,  
ngelën te secili nga ne;  
asnje mal nuk kanë midis,  
asnje det me dallgë dhe re

*“Në udhën e këngës” Tiranë 1985, f.155*



### *Pertef Liqi*

*Ka lindur në fshatin Lulaj të  
Tepelenës. Ka mbaruar  
studimet për Gjuhë Letërsi  
Shqipe në Tiranë. Punon në  
filialin e telekomit Tepelenë.  
Ka botuar vëllimin poetik  
“Lëndina e yjeve” 1989.*



### **Fluturak Germenji (1948)**

Ka lindur në Tiranë. Kreu Shkollën Ushtarake "Skënderbej" dhe Fakultetin Histori Filologji. Dega Gjuhë-Letërsi, si dhe ka kryer kursin pasuniversitar për gazetari. Ka punuar për shumë vite në sektorin e kulturës si dhe në shtypin ushtarak. Është kryetar i shoqatës "Miqtë e Tomsonit". Krijimtaria e tij përmblidhet në poezi, monografi, reportazhe letrarë si dhe skenarë të cilët janë vlerësuar me çmime të ndryshme. Ka botuar vëllimet: "Korriku ynë", "Valët e detit", "Urim ushtari", "Përse nuk fle" (novelë), "Tomsoni dhe Shqipëria" (monografi).

### **Çast nga Naimi**

**Ai gjithnjë i kërkonte ato male me vështrimin që i kalonte nëpër muzg.**

**Kërkonte nga larg peisazhet shqiptare,**  
pyjet që bisedonin plot zhurmë.

Era sillte nga larg aromën e luleve.

Ai dallonte erërat që vinin nga Shqipëria...

Kështu një ndajnate me fyejt e barinjve drejt vendlindjes nisej "Bagëti e bujqësia".

**"Urim ushtari", Tiranë, 1973, f.39**



## **Sadik Bejko**

Ka lindur në Tepelenë. Punoi për disa vite arsimtar dhe më pas redaktor në Radio Tirana. E larguan nga radio për "edukim" në Minierën e Memalias ku punoi nëntokë si minator për gjashtë vjet *freshit*. Ka punuar mësues në rrëthin e Gjirokastërës. Tani është deputet në Kuvendin Popullor. Ka botuar vëllimet poetike: "Rrënjët", "Ku e ka folenë bilbili".

## **Naimit**

**B**rinjët e dala  
në gjoksin e Naimit  
qenë flatrat e Shqiponjës së Flamurit  
mes këtyre brinjëve rridhte gjaku ynë  
i vjetër që nga koha e gurit.


Përmes këtyre brinjëve të holla  
fare lehtë mund të shiheshin mushkëritë,  
kur thithin burimet dhe kaltërsitë.

Mund të shihje si rriteshin  
të forta dhe të bukura  
motivet që lëviznin brenda gjirit.

në ato brinjë  
mavija e thellë e maleve,  
në atë gjak rrezja e pritur e agimeve.

Brinjët e dala të holla  
në gjoksin e poetit  
u bënë flatra për Shqiponjën e Flamurit,  
me ato flatra ai udhëton drejt nesh  
në zemrën e foshnjës dhe të burrit.

**"Ku e ka folenë bilbili", Tiranë 1982, f.697**



**Luan Qafëzezi  
(1922-1995)**

Lindi në Gjirokastër, por aktivitetin e tij e zhvilloi kryesisht në Berat dhe Kuçovë. U përfshi tërësisht në Luftën Antifashiste Nacçl., ku u ngarkua me detyra të rëndësishme në formacionet partizane. Mbas Çlirimit punoi në shtypin ushtarak dhe në detyra të ndryshme. Vazhdimisht u muar me krijimtari duke botuar poezi, poema, tregime dhe drama. Krijimtaria e tij letrare është përbledhur në pesë vëllime.

## **Përmendorja<sup>1)</sup>**

**-Abdylit, Samiut, Naimit-**

Të tre ata- syrgjyn larg atdheut,  
Të tre ata- u shkrinë si flakë zjarri,  
Të tre ata-pasqyrë e Prometeut,  
Për vendin mbenë, nga i mbrami tek i pari.

Ndaj fol për ta, o mjeshri nga Koblara<sup>2)</sup>  
Sa herë Frashrit ne na gjen agimi,  
Atje ku foshnjë lozë ndër ara,  
Abdyl'i madh, Samiu edhe Naimi.

Eh, duararti Ziso, ai vit,  
Me sa mbaj mend na ish i pesëdhjetë,  
Që kur larg vendthit drita iu venit  
E Shqipërizën dot s'e pa poeti...

Trego për ta, atje ku s'hesht xhuraja,  
Sa herë mblodhëm pllakëza mermeri,  
E në kërkim sa herë në ato pllaja  
Kokojkës pamë si prush ndizej ylberi.

Po bjeri Ziso, bjeri ti mermerit,  
 Skalit, Ziso, sa tē mundesh mirë,  
 Tē marrë guri ngjyrat e ylberit,  
 Tē shprehë guri t'zjarrtëzën dëshirë!

Eh, usta Ziso, Zisua nga Komblara,  
 Ti kryezot i daltës e mistrisë,  
 E kush si ti me futëzën përpara,  
 Diti aty mermerin ta qëndis?

Dhe dalta s'hesht, rreth teje pleqtë grumbull,  
 Trtegojnë për Ta e s'dijnë tē pushojnë,  
 Ndërsa si zogjtë, vogëlushët faqekumbull,  
 T'poetit vargje shpesh na cicërojnë.

Te ai truall sot hijeshëm tri shtatore,  
 Ngrihen ballëlartë, o mjeshtëri nga Koblara,  
 Po mot e jetë do thotë: Kjo përmendore  
 U ngrit për Të<sup>3</sup>, u ngrit për Ta<sup>4</sup>e para...

**“Veprat letarare”, V.2, Tiranë, 1987, f.197-198**

---

1- Me rastin e ngritjes së përmendores së parë në Frashër në vitet 1950

2- Ziso Koblara nga Koblara e Kolonjës gurskalitës, mjeshtëri për përmendore guri.

3-4 Naimin, Abdylin e Samiun.



### ***Simon Vrusho***

(1950)

*Ka lindur në rrrethin e Beratit. Ka punuar për një kohë të gjatë mësues. Është marrë me publicistikë dhe krijimtari poetike. Ka botuar vëllimin "Rrugëve të Mangalemit".*

### ***Për Bejtexhinjtë***

**Kur** Naimi shpatë e bënte vargun dhe rrobërinë godiste mes për mes, murmurinin ata me zë të zvargur bejte në mes të kafenesë.

Kur ata lotonin për sy vajze  
dhe për vdekjen ngrinin rubai,  
në sy Naimi shihte malet  
e Skënderbenë në sy e kish ai.

E vinte Skënderbenë prapë në Krujë,  
që lufta të nxiste ashtu si dikur,  
kurse bejtexhinjtë binin në gjunjë  
e mekeshin për Mekën, për një gur.

Kur mbi supet e poemave të Naimit  
binte e binte pluhur lufte,  
pluhur binte dhe mbi bejtexhinjtë,  
por ky ishte i harrimit pluhur.

***"Rrugëve të Mangalemit", Tiranë  
1983, f.35***



### **Agim Vinca (1947)**

Lindi në fshatin Veleshnjë të Strugës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, gjimnazin në Strugë, ndërsa studimet universitare, dega gjuhë e letërsi shqipe në Universitetin e Prishtinës. Kreu studimet pasuniversitare. U magistrua dhe u doktorua në temën "Struktura e poeziës së sotme shqipe 1945-1980". Ka punuar mësues dhe më pas profesor në Fakultetin Filozofik të Prishtinës. Ka botuar një sërë vëllime poetike, studime letrare, monografi si dhe vëllime me publicistikë midis tyre përmendim: "Feniks", "Shtegu i mallit", "Aspekte të kritikës sonë", "Buzëdrinas", "Arrna dhe èndrra", "Orët e poeziës", "Populli i pandalur", etj.

### **Abetarja e parë**

**- Fejzi Vincës -**

**Dhe** vinte Fejziu nga Selaniku  
dhe sillte në fshat Abetaren e parë,  
sillte idetë e Naimit  
dhe këngën “O trima luftëtarë...”

Dhe mblidheshin mbrëmjeve fshatarët  
të mësonin shkronjat e alfabetit,  
ndërsa jashtë lehnin qentë e fshatit  
dhe përgjonin spiunët e mbretit.

Dhe mblidheshin mbrëmjeve fshatarët  
nën dritën e zbehtë të kandilit:  
të mësonin “Historinë e Skënderbeut”,  
të dëgjonin “Fjalët e Qiririt”...

Dhe mblidheshin mbrëmjeve fshatarët  
nën dritën e zbehtë të hënës;  
të mësonin gjuhën shqipe  
të mësonin gjuhën e nënës.

Dhe vinte Fejziu nga Selaniku  
dhe sillte të parën Abetare  
ndjekur nga turku dhe fanatikët  
mallkuar nga hoxha në minare.

Dhe vdiq në mërgim Fejziu,  
larg vendlindjes, i vetmuar,  
po mbeti në fshat Abetarja  
dhe kënga "O trima..."  
e paharuar.

**"Buzëdrinas", Tiranë 1984, f.62-63**

### Abetarja e parë

*Dhe mblidheshin mbrëmjeve fshatarët  
nën dritën e qelitë të landit  
të mësruin "Historinë e Shqipërisë"  
të degjoni "Fjalët e gjinisit..."*

## **Poetët e mi**

**Këtu jam vetëm**

Po me mua janë:Naimi,  
Mjeda, Noli, Migjeni, Agolli,  
Kadareja...  
Shpirti me ta fluturon i lirë  
E trupi shpëton nga vdekja.<sup>1)</sup>

1) Kjo poezi së bashku me një cikël,  
autori i krijoj pa laps e letër në  
burgun e Prishtinës ku policia  
famëkeqe sërbomadhe e Beogradit  
e mbajti për 15 ditë në burg në  
vetmi të plotë për arsy se vite më  
parë kishte kaluar kufirin për të  
ardhur në shtetin amë pa vizë  
dalëse. Poezitë autori i kishte  
regjistruar në mënd dhe mbasi doli  
nga burgu i hodhi në letër.



## **Bardhy Londo (1948)**

Lindi në Lipë të Përmetit. Shkollën fillore e të mesme e ktheu në Përmet. Studimet universitare i kreu në Fakultetin Histori Filologji Dega Gjuhë Ruse në Universitetin e Tiranës. Për disa vjet punoi mësues në rrethin e Përmetit dhe më pas në Gazeten "Drita" në Tiranë, ka vite që është kryeredaktor i saj. Është zgjedhur kryetar i Lidhjes së Shkrimitarëve dhe të Artistëve të Shqipërisë. Ka botuar vëllimet poetik: "Krisma dhe trëndafila", "Hapa në rrugë", "Emrin e ka dashuri", "Si ta qetësoj detin", "Hap po deshe kalendarin", "Dite njërezo".

## **Midis meje dhe teje** -Poetit N. Frashëri-

**M**idis meje dhe teje..

Të shuanin Qiriun tënd  
eolët e gjithë kohrave kacekët shfrynin  
Po unë mbi kalin e baladës  
drejt teje kam vrapuar  
mijra herë me besnik se Konstandini.  
Vrapoja  
me gjyshin,

stërgjyshin.

Në konturet e fytyrës tënde  
konturet e kombit fiksuar ishin.

Midis meje dhe teje...

Mbretër të shitur  
dimra pushtimi  
të rrush apo të mos rrush belbëzonte

Manushaqja netëve

Po unë kam qenë shpata që jam ngritur  
për t'u hakmarrur për gjithë Hamletët.  
Këpurdha katedralesh,  
pyje xhamish  
vet Kullën e Babilonit na ngritën ardhës të huaj  
në shteg.

Po unë kam qenë ajo dallandyshja që drejt teje  
kam vrapuar  
me dy thrrime balte mëmëdheu në sqep.  
Po unë në fytyrën tënde  
malet e Shqipërisë shikoja  
si në një hartë të rrinin,  
Në një ulluk të rudhave kërkova Vjosën,  
në tjetrin  
Drinin.

Rendja,  
thërrimet e dheut si farë e pamort binin  
dhe mbinte mbi to jeta.

Unë rendja, rendja, rendja  
dhe ja ku të gjeta.

*“Emrin e ka dashuri”, Tiranë 1984, f.57-59*

## **Vdekja e Vajzës së Naim Frashërit**

**P**oetit i vdiste vajza. Dhe s'kishte tjetër pasuri  
veç detit të dashurisë për mëmëdhenë.  
Në mbrëmjet e trëndafilita vajzat e mehmurëve  
për një katedrale në Paris ëndërronin, për një kopësht në  
Vjenë.

Poetit i vdiste vajza. Dhe s'kishtë tjetri parut,  
 lëc detrit të dashurisë për mëmët.  
 Në mbrëmjet e trinadëlfiftë vajzat  
 për një katedrën e mehmurëve  
 për një kopësht në Vjenë.

Poetit i vdiste vajza. Dhe s'kishte për të ilaç,  
 një shtrat në spital për të nuk kish.  
 Për një puçër në pulpë vajzat e mehmurëve  
 niseshin në Vjenë, iknin në Paris.

Kthehej poeti nga mërgimi. Në doganë  
 një grusht shkronjash shqipe i ngrohnin gjirin.  
 Me bizopheritë e Vjenës, me dantellat e Parisit  
 vajzat e mehmurëve kalonin kufirin.

Poetit i vdiste vajza. Me një abetare të thjeshtë.  
 sa kishte filluar të çukiste abecenë.  
 Vajzat e mehmurëve me bursë niseshin  
 universiteteve në Paris, auditorëve në Vjenë.

Poetit i vdiste vajza në një shtëpi të thjeshtë  
 mes varfërisë, mes katër mureve.  
 Atdheu thinjej nga dhimbja për të,  
 thinjej nga "vakancat" e vajzave të mehmurëve.



### ***Skënder Buçpapaj (1953)***

Lindi në fshatin Pla të Tropojës. Ka kryer shkollën e mesme dhe shkollën pedagogjike. Punoi arsimtar në fshatin Berishë të Tropojës. Për një kohë punoi redaktor në Gazetën "Drita" si dhe drejtës në Radiotelevizionin Shqiptar. Është marrë me poezi si dhe me shkrime kritike. Ka botuar vëllimet poetike "Zogu i bjeshkës" "Poezi" (1986).

### ***Naim Frashërit***

**M**e abetaren shqipe të poesisë në duart e njoma

u kam trokitur maleve prag më prag e derë  
më derë.

Një erë e padukshme si të gjithë fisi i erërave,  
fletët e abetares m'i merrte nga duart. Ajo  
erë....

Kam pyetur udhë më udhë, kam thirrur qiell  
më qiell

fletët e blerta të kaltëra mos vallë më kishin parë.

Kam pyetur pleq treqind vjeçarë, barinj,  
rapsodë lavërtarë,

kaprollë të hutuar, arinj me flokë, lauresha  
pëllumba të bardhë

Në ato udhë, Naim, kishe shkuar më herët,  
kishe lënë emrin në rrasha të krojeve,  
në qafa të kojrrillave e kishe varur si mesazh.  
E belbëzonin fëmijët në shtroja, e ngjyjenin  
hënati në djepa,

e ndillnin delet në ëndrra, e blegërinin  
gurët e bardhë..

Kishe fjetur dhe ishe zgjuar nëpër shpella,  
në gërdhata ku gjashtë muaj në vit kullotnin  
kecat,  
në ahishtat ku filtrohen dita dhe nata  
të manushaqta si qumështi i kulluar në vedra.

Në ëndërr e në zhgjëndërr jam pritur e  
përcjellë  
në viset e poezië sate. Kam vënë në gaz  
buzën e detit.  
Kam vënë në mendime ballin e rreptë të malit  
Kam vënë në melodi zëri prej bilbili të bjeshkëve.

Prandaj më ngjan se edhe unë i kam shkruar  
poezitë e tua me bar, lule, zogj, flutura, vesë.  
Autorësinë tënde kanë poezitë e mia  
me ndeshje klasash, qytete industriale, kibernetikë,  
elektricite.

Ti je kudo: në fjalë, në erë, në dritë të diellit. Zot,  
atje ku e përfytyroje ti praninë e Zotit.  
Prej çdo guri, lisi dhe plisi të rikrijoj,  
të jap shpirt,  
poet i pavdekur dhe idhull i gjallë i kombit.

Besa e fjalës sate sa fort na u dashka.  
Ylberi i fjalës sate të na bjerë mbi udhët,  
mbi strehët e shtëpisë.  
Me fletë të bardha, të kaltra, të blerta plot  
mësuesi ynë i madh i abetares shqipe të poeziës.

### ***Hamdi Meçe***

*Ka lindur dhe jeton në Krujë. htë marrë  
kryesish me letërsi për fëmijë. Ka botuar mjaft  
vëllime, disa prej të cilave janë vlerësuar me  
çmime.*

### ***Dashuria e Atdheut***

**Vështrimi i mësueses mbi klasën e vet:**  
**-Çudi! - sikur flet,- Çudi! - sikur flet.**

- Kjo nxënësja aty të kaltrën e syve  
e paska krejt si të Teutës ilire:  
Ky nxënës këtu, në bankën e parë  
si të Skënderbeut e ka atë ballë;  
Kjo vajza vetullat si lastarë shëndritës  
i paska si të motrës së Gjergjit, Mamicës;  
Ky djali aty, në rreshtin e dytë,  
si Naim Frshëri, i ka të dy sytë.  
Kjo vajza gërshetat e zinj e të gjatë  
ngjan si prej Shotës t'i ketë dhuratë;  
Kësaj tjetrës dy buzët e ngjyer me agim,  
sikur Margarita t'ia ketë dhënë kujtim!

***“Një shportë me pranverë”, Tranë, 1986, f.26***

## **Naim Frashëri**

**Të gjithë ata**  
 që na servirin  
 në një pjatancë hëne  
 pastat e thartuara  
 të romantizmit,  
 u harruan.

Vetëm ari që ti, Naim,  
 le me testament  
 në shpirtit tonë  
 u shumfishua.

Dhëmbët i kemi me bukën e  
 fjalëve të tua.

**“Buka e fjalëve” Tiranë, 1986, f.19**



## **Agim Mato**

(1947)

*Ka lindur në Fterë të Sarandës. Ka studiuar për letërsi. Punoi për një kohë të gjatë mësues.*

*Krijimtarinë letrare e ka përmbledhur në vëllimin poetik "Jug", "Buka e fjalëve".*



## **Hasan Hasani (1947)**

Lindi në fshatin Jabllanicë të Dushkajës rrëthi i Gjakovës. Shkollën fillore e nisi në vendlindje dhe e mbaroi në Baran, normalen në Gjakovë. Studimet e larta Dega Gjuhë Letërsi Shqipe i kreu në Universitetin e Prishtinës. Ka punuar në gazeta dhe revista "Bota e re", "Shkëndija", "Fjala", "Pionieri". Poezinë e parë e ka botuar më 1965 dhe prej atëherë ka botuar një numër të konsiderueshëm vëllimesh poetike, studime monografike etj. Më 1995 botoi "Leksikon i shkrimitarëve shqiptarë". Punon dhe jeton në Prishtinë.

## **Kurorë Tingëllimesh**

**(Para busteve të Vëllezërve Frashëri)  
I**

Acar e afsh shpirtin ma mbajnë të valë  
Kur dashurojmë rrjedhën e lumiit nën tokë,  
Buzët e thara etit i njomin n'atë bokë  
T'pérulur para kalorësit t'bardhë në kalë.

Martirë fjalë qemë - mbetëm martirë bese  
N'këtë ishull zjarresh n'gojë ujkonje pre  
Reumën e gjymtyёve herët e mbuluam me dhe  
N'vend se buzët t'i freskoje një pikël vese.

Thellë në ne frymojnë do të ikura stinë  
Me një gulf stuhie të përvjedhur shqim.  
Që maje bjeshkëve tonë kangën ta përtrinë.

Heu, qëndresë martirësh, kush atje jeton?  
Tre yje frashnjotë të dehur në gjakim-  
Brenda gjakut tonë që shekujve gjëmon!

## II

Brenda gjakut tonë që shekujve gjëmon  
 Ngritëm përmendoren e një fisi t'fikur  
 Nga gurshkrepat n'log s'kemi për të ikur  
 Anipse një korb thellë n'gryka mallkon

Rruja gjemba-gjemba, fyelli madhon lugjt  
 Barinjtë humbën grigjën moti nëpër pyll,  
 Si flut'rake ndrit skaj më skaj një yll  
 Duke përshëndetur heshtas ne edhe muzjet.

Bij shtrëngatash qemë me një diell në ballë  
 Dhe stolisëm gjoksin me do t'kuqe plagë,  
 Edhe atëhere kur amshimi na dogji në mall.

Hije lashtësie pérherë n'ëndrra sogjon  
 Si fëmijë që n'shpirt i ndryen ca vërragë-  
 Dritë e mendjes martire po na ngushllon!

## III

Dritë e mendjes martire po na ngushllon  
 Me këto tingëllima n'shekullin ardharak.  
 E jo gjeth i rënë vjeshte, gjethi verdharak  
 Si fantazmë netëve që trishton.

Gaz i shuar ndër bebza shpesh po përvidhet  
 O martirëtë fjalës - të gjuhës madhështi!  
 Erdhën e ikën ushri- sa t'marra mbretëri  
 O gjak i këtij fisi, o trung që nuk dridhet.

Fjalët u rritën me rrufe, shtrëngata, duhi  
 Si gërshetë n'atë faqe t'hepisur guri  
 Pa thyer shtatin krenar në t'egrat stuhi.

Ç'djallë e mallkuar kohë, o kohë e përdalë  
 Bjtë e kësaj toke jetën mbaruan në huri-  
 Yjet duke zbritur nëpër t'zjarrtat fjalë!

**IV**

Yjet duke zbritur nëpër t'zjarrtat fjalë  
Zérat e tre vëllezërve u bënë përmendore  
Çmallem duke puthur të bronztat shtatore  
O kohë e përdalur, kohë e rrëshqitshme njalë.

N'atë vetull bjeshke flamujt po valojnë.  
N'maje t'Tomorrit e Rrafshit t'Dukagjinit,  
Këngë t'gjakura po pëcjellë valë e Drinit  
E t'zjarrtat fjalë e vargje që po marshojnë.

Dhe shkruan historinë me faqe t'përgjakur  
N'ket shekull bishë që shpesh na hyri n'hak  
N'qiellin tonë blu, n'qiellin e përflakur.

Anipse diçka si hije vetveten po e vjedh  
Para botës një ditë ka për t'rënë në lak-  
Lum i mendjes sonë për këta martirë rrjedh!-

**V**

Lumë i mendjes sonë për këta martirë rrjedh  
Kur mbi pullazin tim këndon një bylbyl,  
I këngës dhe i fjalës o i shenjtë Abdyl,-  
Stuhive s'iù përule si n'bjeshkë ai bredh!

Shuhet zjarri n'vatër lind tjetri n'kodr  
Shuhet fjala n'bjeshkë lind tjetra n'kreshtë  
Shuhet kalli n'vjeshtë lind xixa si eshkë  
Shuhet kënga n'bebza lind tjetra në lodër.

Ca kuçedra gjaku na përshkuani qiellin  
Krahët e shqiponjave u qepen maleve lart  
Coca-cola n'tokë për ta zbritur diellin.

Hap e mbyll kanale, rrëno e ngrit murë  
 Gdhihej edhe ngrysej ne duke na bart,-  
 Nga një epitaf e kem' ballasamosur n'gurë!

## VI

Nga një epitaf e kem' ballsamosur n'gurë  
 Dëshmi e një trishtimi kudo n'vatrat tona,  
 Pesë shekuj n'kështjella u lëkund Sentona  
 Duke fshehur thneglat gjysmëhëna në zgurë.

Me kokë nën shpatë frashnjotët u gdhinë  
 Pa iu trembur vdekjes as sulltanëve n'fron  
 Rrufetë i mbanin n'gjoks si zjarrin që vlon,  
 Këngën e fisit tonë mbi kulla ta përtërinë.

N'shamijat e vashave kujtimin e shkruajnë  
 Për martirët e kombit dhe të gjuhës sonë  
 Që n'gur t'kullave tona emrat ua ruajmë.

E nuset faqegjak me kërrabza në pëlhirë  
 Qëndisin luleverat t'ëndërruara gjithmonë -  
 Amshitë e fjalëzjarreve tona përvidhet nën  
 urë!-

## VII

Amshtë e fjalëzjarreve tona përvidhet nën urë  
 Si dasmorë të dyndur atje poshtë ndër sheshe,  
 Duke u ndesh n'erëra duke u ndesh  
 n'rrebeshe  
 E strall i gjallë të ndrit majebjeshkë e gurë.

Suferinë e natës herët më bekoi pa gjuhë  
 Mua dhe etërit në kulla atje në cikol,  
 Lëkura na mbet si gjarpërit në të errtin hol  
 Suferinë e natës herët më bekoi pa gjuhë.

Kudo kushtrim kah shkel këmbë frashnjote  
 Duke shtyrë agimet t'lindin fjalë qiriri,  
 T'i shtrojë n'rrezedritë udhët e kësaj bote!

Gjyshi im në kullë si shiu në fjalë u derdh  
 Kur mes burrash fliste, o, ai far martiri-  
 I shenjtë qe mendimi që n'atë degë u zverdh!

## VIII

I shenjtë qe mendimi që n'atë degë u zverdh  
 O Naim be' Zemrat zogjve ua lamë peng.  
 Që n'kala t'besës dhembjen ta lidhin deng  
 Si bleta polenin kur n'për lule e mbledh.

Krenaria ngrihet kur ai shpirt kombi venitet  
 Si kallam n'oazë - n'atë t'mjeruar ishull,  
 Kulla e gjyshit ngryset e zgjohet si udhull  
 Që këndon me gjuhë gri e pastaj çmeritet!

Emri i kullës sonë po njallej ngadalë  
 Si do thnegla lisash- t'tokës ëndërrimtare  
 Feniks i blertë n'gurzjarresh ringjall'.

T'gjithëve ndër kohëra na mundon një brengë  
 Cili shoqishoqin n'ball ta puthim më parë-  
 Mëshirë kërkuam n'çerdhe, zogjtë dehur  
 n'këngë!

## IX

Mëshirë kërkuam n'çerdhe, zogjtë dehur  
 n'këngë  
 Rritin brezat dhe lisat thellë diku n'zabele  
 Ngadhnjimtarë muzgjesh të varur në çengele  
 Si lecka lysash zvarë mëkatesh n'atë mëngë.

Krua i cemptë gjaku në bjeshkë u bë akull  
 I besës sonë. Gjithçka trashëguam nga t'parët

Besë e gjuhë lashtësie- i mallkojmë mëkatarët  
Që n'beteja motesh mbollën trupat shakull.

Mikrob i ri mushkërie herët rrëmoi n'themele  
T'gurkështjellës vëllazërore. Lejleku u tremb.  
N'oxhakun e kullës gjyshit tirqit me kordele.

## X

E përcollën mallkimin si tymin n'për oxhaqe  
Dhe zërin tonë miturak strehuar në damarë,  
Ashtu vdiqet si vdiqën frashnjotët bujare  
T'dënuar e më pranga n'duar pa lot pér faqe.

Ndoqe rrugën e Dylit, vëllait tënd të madh  
Atomin e fundit e shpenzove pér atdhe.  
Idhull mbi idhuj motesh o frashnjot Naim be  
Gjerdan bari e fluturash n'këtë timin livadh.

Fyejt e gjakut kanë shpuar bjeshkë e diell  
Deri n'Urë t'Gallatës - atje në Stambollë  
Fanar duke shëndritur mespërmes në qiel...

Me vesë i njomin buzët si dikur me këngë  
N'gji qëndroi e fshehur pesë shekuj një bollë-  
Si jehonë kohe shpirtin gjithmonë brengë...

## XI

Si jehonë kohe shpirtin gjithmonë bregë  
E harruam n'tela t'çiftelisë varur n'mur  
As lahitën s'e hoqëm gjurit që ndrit nur  
Dhe lindëm, u rritëm e do vdesim me këngë

Si tre yje hytë thellë në malin thinjosh  
Q' moshës sonë qerpikët moti ia ka zbardh'  
O tis i butë kënge, o i urti frashër trimosh.

Aromë blirësh kohën atëbotë e kanë vrarë  
Me shtiza helmit t'varur tinzisht n'qepalle-  
T'madhrueshmin në quell shpesh e kemi sharë

Që ndanë drejtësinë dhe atë e shkel me  
thembra  
Kur thneglat në zgavra lisash hidhnin valle-  
Arë e farë ndër mote mbollë ziarr ndër zemra.

xii

Arë e farë ndër mote mbollën zjarr ndër zemra  
Si vashat e Ilirisë muzgjeve t'kuqe krehemi  
T'i tregojmë botës ç'ishim, ç'do bëhem  
Nga giysh-stërgiyshët- nga koka e te thembra.

Armë vdekjeprurëse patët diturinë o  
mendjeartë  
Dhe mbollët butësinë e barit ndër meteorë,  
Si shqipe n'kreshta t'ashpëra, këta malësorë,  
U rritën me trungun nga i cili jemi bart'

Kuajt jelëbardhë i shalojmë meridianeve  
O Sami bei Frashëri, o mendjendritur  
Si dasmorë dielli kur ikim horizonteve.

Frashër- dhe i lashtë- Urë me Tri Harqe  
Ç'shejtënor n'tokën tonë t'ka zbritur?-  
Mespërmes hullive t'ballit- flamui n'bairaqe!

XIII

Mespēmes hullive t'ballit - flamuj n'bajraqe  
I dhamē betimin gurit pēr kēta martirē,  
Qē u bēnē yje drite dielli ende pa għdir  
Si ato t'merdheżżeat e vashave ilire fage...

S'di pse fatit t'fisit tim koha iu bë nepërkë  
 As pse shekujt më parë emrat na i ndërruan,  
 Ardhësit nga thellësitë tinzisht depërtuan-  
 S'di pse fatit t'fisit tim koha iu bë njerkë!

Zëri juaj frashnjote sot qëndron mbi nulla  
 E ne me xhelozи ruajmë kujtimin e mërdhirë  
 E librat tuaja n'raftt e shtëpive me tulla.

Urë me tri harqe që u lidh me tonat zemra  
 Fjalët fluturake të gjuhës sonë plot hirë-  
 Ishte këngë gjaku ajo e zgjuar ndër shemra!

#### XIV

Ishte këngë gjaku ajo e zgjuar ndër shemra  
 Që udhëtoi stuhive e rrebesheve të motit,  
 E bindur n'vetvete e jo n'marshim të lotit-  
 Ishte këngë gjaku ajo e zgjuar ndër shemra!

N'këtë skaj t'Ballkanit ky ishull s'u dha dot  
 Krenar n'gji t'Tomorrit rri Fromba, Medauri,  
 Bindi e Sentona që ndrisin si vitore muri-  
 Ashpër gjuajnë rrufetë e s'njohin kë për zot!

Andaj unë po heshti para kësaj tingëllime  
 Kur shoh martirët si flutura djegur n'dritë-  
 Gjuhë e gjak s'shuhet në erëra e fërshëllime!

E mbi të gjitha, përmendore mbet kjo fjalë  
 E besëvëllezërve frashnjotë n'guri ngulit'-  
 Acar e afsh shpirtin ma mbajnë të valë!

## ***Magjistrali***

**Acar e afsh shpirtin ma mbajnë tē valë  
 Brenda gjakut tonë që shekujve gjëmon,  
 Dritë e mendjes martire po na ngushllon  
 Yjet duke zbritur nëpër t'zjarrtat fjalë.**

**Lum i mendjes sonë pér këta martirë rrjedh  
 Nga një epitaf e ke'ballsamosur në gurë.  
 Amshëtë e fjalëzjarreve tona përvidhet në urë-  
 I shenjtë qe mendimi që n'atë degë u zverdh!**

**Mëshirë kërkuam n'çerdhe, zogjtë dehur n'këngë  
 E përcollën mallkimin si tymin n'pér oxhaqe-  
 Si jehonë kohe shpirtin gjithmonë brengë!**

**Arë e farë ndër mote mbollën zjarr ndër zemra  
 Mespërmes hullive t'ballit -flamuj n'bajraqe-  
 Ishte këngë gjaku ajo e zgjuar ndër shemra!**

**Jeta e re, 19, f.789-796.**

*Martirë fjale gemë - mbetim martirë bese  
 N'këte ishull zjarrash n'gojë ujkonyje jone',  
 Reumën e gjymtyrije herët e mbuluam me dhi  
 N'vend se Gurit t'i freskojë një pikël vese.*



**Llambro Ruci**  
**(1946)**

Lindi në Dhërmi të Himarës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, Politeknikumin në Tiranë. Ka punuar në Hidrocentralin e Bistricës. Ka kryer studimet në Fakultetin e Shkencave Politike Juridike në Universitetin e Tiranës. Ka punuar në organet e shtypit si në Revistën "Nëntori", kryeredaktor i revistës "Ylli". Ka botuar vëllime poetike, monografi letrare si dhe ka bërë një sërë përkthimesh kryesisht nga gjuha greke.



**Dyert e Zosimeas  
në Janinë**

Nëpër Janinë shkelim natën  
mes trotuarëve të lagur.  
Si mund të iknim pa prekur  
një peng fëmijërie të dashur?

Mes hijeve Zosimea hijerëndë  
e heshtur pas kolonash rri,  
po ne presim Naimin gjimnazist  
me lirikat e Shqipërisë në gji.

Ç'pëshpëriti Frashëri pas kangjellave,  
ç'frymë i dërgoi Tomorri nga afër e larg  
do t'i mbarte si Moisiu i Biblës -librat  
nëpër shkretinë e kohës Naimi i madh.

Me një qiri që i shkrihej duarve  
do të ndriste të nesërmen e Shqipërisë,  
kur të tjerë fatin e tyre e të fisit

do të ndritnin me tringëllimë  
florinjësh.

Nga Zosimea do të nisej nëpër botë  
me një manushaqe nëpër gishta.  
Ish udhë me pusi e vetëtima  
kur koha shtronnte gjemba jo  
trëndafila.

*Janinë, dhjetor 1987*

*Botohet për herë të parë*



*Biblioteka në Janinë, ku studluan vellezërit Frashëri*

***Laureta Çarçani***  
***Gjimnaziste nga Gjirokastra***

## ***Vargu naimjan***

Muzgu me velat e tij ngjyrë vjollce  
 ndali lundrimin diku në Dangëlli  
 vesa, si sy i kristaltë mbi bar  
 mban vargun naimjan që ka mbirë aty.

Bagëtia zbret hareshëm nga Tabori  
 me zambakët e këmborëve vargun naimjan  
 unë gjej,  
 pak lirizëm në këngën e çobankës së gjuar  
 dhe në gurgullimën e lumit që zalleve rrjedh.

Dhe lisat hijerëndë me buzët e gjetheve  
 fërshëllejnë të ëmblën freski,  
 si mund të mos jem un' sot romantike  
 kur vargu naimjan më rreh si zog në gji?...

***“Pararoja”, 1988, 23 korrik, f.4***



### **Zenel Anxhaku (1955)**

*Ka lindur në Përmet. Mbaroi fakultetin për gazetari 1977. Disa vjet punoi në Korçë në gazetat lokale. Nnxori gazeten "Nektari i Korçës", si dhe ka botuar vëllimet poetike: "Valët", "Rëkezat e pranverës", "Lisi i jetës".*

### **Shtëpia muze e vëllezëve Frashëri**

**Një** e nga një i sollën fshatarët këta gurë  
të çmuar

Për këtë shtëpi të rrallë,

Si foshnja të sapolindura i mbanin ndër duar  
-Kujdes ustallarë!

Dhe ja tani...

Dikush pluhurat fshin ngadalë,

Dikush me manushaqe odën e stolis,

E dikush tjetër reciton ngadalë:

“O malet e Shqipërisë!”

Tani është gati muzeu,

Le të vijnë vëllezërit në shtëpinë e tyre

Dhe vetë dielli vizitor ja behu

Malet, gëxhet, fushat, pyjet...

Oh, po këta vëllezër Muzeu  
Qenka i madh sa Atdheu...

***"Ylli, Nr. 10, Tetor, 1989, f.29***





## *Adem Istrefi (1942)*

Lindi në fshatin Strelc i Epërm, rrethinë Pejës. Shkollën fillore e kreua në vendlindje, ndërsa të mesmen dhë studimet e larta, Dega Gjuhë e Letërsi Shqipe, në Tiranë. Qysh në moshën 14 vjeçare emigroi në Shqipëri. Një kohë të gjatë ka punuar në redaksinë e Librit Shkollor në Tiranë, redaktor në revistën "Nëntori" etj. Shkruan kryesisht poezi e prozë për të rritur, e herë pas herë edhe kritikë letorraine. Ka botuar vëllime me vjersha, tregime, romane. Disa nga veprat e tij janë: "Net kosovare", "Mëngjesi i së nesërimes", "Dritaret e fjalës", 'Gjerdan lirie', etj.

## *Kush ishte ai që erdhi?*

Mos ishte kopshtari i Luleve të Verës, mos ishte kopshtar i vetë diellit, a lajmëtar i lindjes, yll drite i zgjimit?

Ai që erdhi mbi ferra terri qirinjt e dritës ndezi, si mëngjes rreze zérash shkrei...

Ai që erdhi, erdhi dhe tha:  
Si mund të harrojë dielli rrugën e vet, më herët se ne prej dritës kush është larë, më herët se ne ky dhe kë ka parë?

Pas diellit, pas dritës udhën e mbarë të zemë!

Dhe ai që erdhi e s'iku më prej nesh,  
Shkurt e gjatë Naim i thamë, herë Naim Poezia e herë Naim Shqipëria.

Mbiemra të tjerë më të bukur, thua të gjenim!?

**Qershori 88.**

*"Një zog midis meje e diellit", f.102*



## **Fatos Arapi (1930)**

Lindi në Vlorë. Shkollën fillore dhe atë të mesme i kreu në vendlindje, ndërsa studimet universitare, Fakultetin e Shkencave ekonomike, në Universitetin e Sofjes (Bullgari). Një kohë ka punuar profesor në Universitetin e Tiranës, pastaj në Lidhjen e Shkrirtarëve dhe të Artistëve. Ka botuar tregime, novela, romane, dramë, kritikë letorraine etj. Po ashtu merret edhe me përkthime nga gjuhët e huaja në shqipe. Fatos Arapi jeton në Tiranë. Vepra letrare: "Shigje poetike", "Poema dhe vjersha", "Ritme të hekurta", "Patat e egra", "Dhjetori i shqetësuar", "Dikush më buzëqeshte", "Poezia shqipe", "Drejt qindra shekujsh shkojmë", "Shokët", "Poezi", "Deti në mes", "Kënga e moçme shqiptare", "Fjalë për poezinë", "Duke dalë prej ëndrrës", "Ku shkon ju statuja", "Më vjen keq pë Jagon" "In-tenebris..." etj..

## **Drejt Shqipërisë**

- Me vendim të qeverisë së Ahmet Zogut,  
në vitin 1937 eshtrat e Naim Frashërit  
u sollën në Shqipëri të shoqëruara  
nga një kolonel xhandarmërie-

**Bosfori** ishte i kaltër- ndryshe si do të ish?  
Po vinte Naim Frashëri drejt Shqipërisë.

Në bordin e anijes së huaj vetëm dy shqiptarë.  
Nën sqetullën e xhandarit arkëz e poetit të madh  
Europa shtrihej përpara, Egjeu, deti Mesdhe-  
tek bregu diku aty pranë vendit të Homerit qe.

Babai i madh i poetëve, ai që krijoi tragjeditë,  
e ndjeu se edhe i verbër po i errësoheshin sytë  
Akullonte kërcënëm i xhandarit mbi vdekjen  
e poetit  
dhe ishte dreqi ta marrë!- vëretetë ish  
shekulli XX  
Naimi në arkëz të vogël - Naimi dhe qiejt  
shqiptarë.  
Dhe fjala -fat i Dodonës. shpresë agimi të  
bardhë  
shpirt shqiponje i lirisë, ndezur për jetë të  
jetëve;  
kënga-atdheu qiellor i pavdeksisë së poetëve

*shikonte kupen piellore -  
mbi fatin tragjik te popujve,  
mbi fatin tragjik te kombeve.*

Naimi nga arkëz e vogël shikonte kupën  
qiellore.  
mbi fatin tragjik të popujve, mbi fatin tragjik  
të kombeve  
Prap, shtrinte krahët-sgalem liria e  
pavdekshme  
dhe kënga...  
Dhe bota e madhe frymë merrte e mirë, e mirë  
si zemër  
Bosfori ishte i kaltër-ndryshe si do të ish?!

Po vinte vetë Naim Frashëri drejt Shqiprisë.

***Muharem Jakupi******Kur ikën nga  
Frashëri***

*Ka lindur në Selenicë të  
Vlorës. Ka kryer studimet  
për gjuhë e letërsi shqipe.  
Punon pedagog në  
Universitetin "Eqrem  
Çabej" në Gjirokastër.*

**B**redhat e Hotovës  
Pyll a mrekulli?!  
Si në Purgator  
Po shkove mes tij

Përmes Frashëllinjtë,  
Kaluan kur ikën,  
Shtatë rrathët -  
                                burime  
Ua pastruan shpirtin.

U bënë të dlrë  
Si njerëz Parajse  
Po argjil' e kuqe?!  
O...Frashër, çfarë balte!

Një herë që isha  
E provova vetë  
S'mu shqit nga këpuca  
Në katër qytete.

Po Samiut, Naimit...  
Qe zbathur e shkelën?  
Iu bë epidermë...  
Dhe zë i Atdheut!



### *Ndoc Gjetja (1944)*

Lindi në Shkodër. Shkollën fillore dhe atë të mesme i kreu në vendlindje, ndërsa studimet universitare, Dega Gjuhë e Letërsi Shqipe, në Universitetin e Tiranës. Një kohë punoi në Tiranë, ndërsa tash në Lezhë. Ka drejtuar për një kohë të gjatë revistën "Skena dhe ekran". Që nga fundi i viteve gjashëdhjetë merret me krijimtari letrare. Ka botuar vëllimet: "Rrezatim", "Shqiponja rreh krahët", "Qendresa", "E përditshme", "Caste", "Poezi".

## *Bukolike*

"Vijnë posa bletë e plotë, i bekofte perëndia..."

Ne s'do t'ju lemë kurrë t'ju hajë Industriat

Kjo koha jonë moderne që ka pushtuar dhe Bjeshkën po doli kundër jush do të hajë vetveten.

Gjithë qytetet gjigande do vuajnë nga nostalqja dhe do të shohinë endrra veç me bishta dhie dhe miliarda qytetarë nëpër kontinente në qafë do të varin medalione qengjash.

Dhe do dëgjojnë përditë kaseta blegërimash dhe në treg do shiten ca video pëllitjesh me prapanicën mbi sfunjjer ditë për ditë njeriu do adhurojë si Budën një ministatuje bariu.



## Zeqir Gërvalla (1942)

Lindi në fshatin Lupç të Poshtëm të Podujevës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje. Normalen në Prishtinë dhe Mitrovicë, ndërsa studimet universitare, Gjuhë e Letërsi Shqipe, në Universitetin e Prishtinës. Punon në gazetën "Bota e re" në Prishtinë. Me krijimtari letrare merret që nga viti 1957, kur edhe e botoi vjershën e parë. Shkruan poezi për të rritur e për fëmijë. Jeton në Prishtinë. Vepra letrare: "Prania e Sfinksit".

## *Ne paqedashësit e Ballkanit*

*Sami e Naim Frashërit, ideo logëve të Shkollës  
së Parë Shqipe në Korçë, hapur më 7 mars 1987*

me një shekull drite

të përgjysmuar

i mundëm shekujt e shkuar

tashti me shekujt e ardhshëm po përleshemi

me një gjysëm opinge

me një gjysëm lapsi

me një gjysëm qiriu

emrin e plotë nëpër flakë po e shënojnë

në ballin që na ndrinë.

dhe po barazohemi me të gjithë popujt e botës  
që e duan dritën-lirinë.

Kujt t'i vijnë rëndë

lehtë mund të kalojmë

kujt t'i vijë rëndë-

dorën ia shtrëngojmë.

***"Det e moçal ballë për ballë", Shkup, 1993, f.60***



### **Agim Isaku (1954)**

Lindi në Korçë. Shkollën fillore dhe atë të mesme i kreua në vendlindje, ndërsa studimet e larta, Dega Gjuhë e Letërsi Shqipe, në Universitetin e Tiranës. Punon si mësues i gjuhës dhe i letërsisë shqipe në Lezhë. Emrin e tij e takojmë në periodikun letrar që nga fillimi i viteve shtatëdhjetë. Shkruan poezi e prozë, përfshirë fëmijë dhe për të rritur. Agim Isaku punon pranë Fondacionit "Soros". Ka botuar: "Pranvera e lumiut tim", "Mosha", "Përralla e burokratit që u bë punëtor", "Vizitë në Krujë", "Gurët", "I shtati", "Pesëdhjetë poezi", "Kështjella dimërore", "Hija", "Fëmijë në një qytet të vogël", "Mos kujtoni se jam një vizitor i vonë", etj.

### **Natë dimri (Fragment)**

1.

**K**ontinentet e reve shahen me gjëmime  
dhe topusë vetëtimash hedhin mbi malet e  
larta

Mbi shkopinj ujrash qiejt udhëtojnë drejt  
veriut

Nën sqetull shtegtojnë  
etyde peizazhesh boreale.

Unë shpërshtjell pyjet nga poemat e Naimit  
dhe gjithshka gjelbërohet në çast.

2.

Mbledhjet e stërshtetëve vazhdojnë  
Ekranet e TV-ve janë bërë mavi.  
Shkëmbohen replika dhe komentohen në çast.  
shajnë njeri-tjetrin dhe venë buzën në gaz  
tinzisht.

Mbi tavolinat e tyre,  
si e harruar rastësish  
u shfaq shkëlqim i një kokrre të vetme molle.

S'është globi ajo mollë,  
sigurisht.

3.

Vajza ime e vogël pesë vjeçë  
zgjat dorën dhe në pemën e parajsës naimjane  
të qeshurën e saj  
si një frut të rrallë shton.  
Gjithshka përreth e ndriçon  
me një vjershë të thjeshtë  
për xixëllonjën.

.....

6.

Drerë që kolliten posht pyjeve pa fletë,  
liqenë alpinë si piktura surrealistë të ankthit  
rëndojnë.

Plaja të shkreta. Vrima e ozonit. Gadishuj  
pa zogj e pa bimë.

Gurë antik që zbuten,  
squllen dhe rënohen në shi.  
Nëpër laboratorë analizën e smogut  
e bëjn me lehtësi  
Acid i përqendruar, thonë se është, jo shi?

.....

8.

Ver sa të duash shami në gojë,  
pi sa të duash qumësht antidotë,  
aparatet hedhin helmin e përditshëm  
dhe njeriun e tmerron pamja e vet në pasqyrë  
Ç'është smogu  
para helmit të tyre?

9.

Unë vazhdoj të mbështjell nga poemat e Naimit  
pyjet, çukat e bleruara, lisat e lartë  
që mbështetur pas hardhive, ëndërrojnë  
lulet e verës, manushaqet, qengjat rënë në  
gjunjë  
që pinë sisë...

Pastaj vjen vajza ime e vogël pesë vjeçë  
dhe të gjitha i ndriçon  
me një vjershë të thjeshtë për xixëllonjën.

***“Mos kujtoni se jam një vizitor i vonë”, Tiranë  
1990, 107-112***



**Kostandin Dhamo  
(1950)**

Ka lindur në Tiranë më 17 Janar 1950. Që prej viti 1972 punon në Radiotelevizion. Filloi të batojë në vitet 70' prej atëherë ka botuar vëllimet: "Përshëndetje", "Pak blu nga qielli", "Fundshekull", "Duke pritur zogjtë", "Planet i lodhur", "Pranvera e fundit".

**Kronologji e jetës  
së Naim Frashërit**

Lindi në Frashër më 1846

Binjaku i tij vdiq; Naimi sigurisht jetoi...

Më 1855 merr mësime nga hoxha i fshatit,

Sëmuret nga tuberkulozi më 1871

Më 1874 drejtor dogane në Sarandë;

Punët, thonë i shkonin mbarë...

Më 1878 tronditet nga Kongresi famëkeq i Berlinit,

Tronditje poeti; boton menjëherë

"Gramatikën e Gjuhës Shqipe"

Poemën monumentale "Bagëti e bujqësi"

"Fjalët e Qiririt", "Historinë e Skënderbeut"

Linte testamentin Poeti - "Qerebelanë"

Bënte kohë shqiptare, një fenomen ishte ai...

O, harrova t'u them:

Vdiq më 1900....

**1986**

**"Fundshekull", Tirana 1994, f.32**

## *Shqiptarët*

**Ka** shumë dritë në bulevardin “Dëshmorët e Kombit”

Kafenetë çdo ditë pushtojnë lulishtet.  
S’flitet për dashurinë në to, ndërnofulla e përtyp.

Mes pemësh pa prerë ende mezi shquhen  
në errësirë  
Vëllezërit Frashëri.

S’kujtohet njeri për ta t’u ndezë pakëz  
dritë mbi ballë.

Sështë fjala për elektriçistin e Bashkisë,  
që t’u kthejë një  
prozhektor,  
Për ndërgjegjen e kombit fjala është...

Kafenetë verbueshëm ndriçojnë,  
non stop ato punojnë;  
Shqiptarët duke pirë kafe  
Në mijëvjeçarin e ri po hyjnë...

**1993**

**“*Planeti i hidhur*, Tirana, 1995, f.31.**



## Petrit Ruka (1954)

Lindi në fshatin Turan të Tepelenës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen në Tepelenë ndërsa studimet e larta Dega Gjuhë e Letërsi Shqipe në Institutin e Lartë Pedagogjik të Shkodrës. Për një kohë të gjatë punoi mësues në Tepelenë dhe më pas si skenarist në Kinostudion Shqipëria e Re, ku punon njëherësh si skenarist dhe regjisor. Ka botuar librat: "Rinia ime", "Atdheu fillon te zemrat", "Mirupafshim hënë e vëndlindjes". Me skenarët e tij janë ekranizuar filmat artistik: "Eja", "Skulptura", "Lumi i jetës nuk shteron", "Një djalë dhe një vajzë", "Vazhdojmë me Beethovenin". Filma dokumentare: "Nositi", "Shëmbja e idhujve", "Të burgosurit e galerisë", "Njeriu flamur, Ismail Qemali". Filmat vizatimore: "I vdekuri dhe i gjallit", "Ekuilibër". Ndërsa me skenar dhe regjii të tij ka realizuar filmin: "Qind për qind", "Plumbi prej plasteline".

## Bejtexhinjtë e Beratit

Shanin sa u skuqej gryka me divane,  
Fshikur nga raki mejhanesh në Berat,  
Si kapsolla plasnin grindjet nëpër klane  
Ndër gazele frynte botë e vogël gjatë.

Shqipëria kishte halle, mezi mbante frymën,  
Popullit nëkëngë i fryhej ngulçi i gjakut,  
Ju shërbet myftinjsh lëpinit dhe këndonit  
"Mahmude e Sulejmanit shkon sokakut...

Ju thartonte buzët trahanaja e Zykos,  
Për një art modern çërronit si gjinkalla,

Bënët zhbënët lista, kafeneve lehnit  
Pas lavdisë si qentë për kokalla.

Njeri-tjetrin shanin, mburrnin klanet  
"Ç'di të shkruajë Nezimi ky mediokër fshati..."  
Jashtë kafeneve art i madh me dhimbje  
Priste Naim Shqipërinë t'i qeshte fati.

<sup>11</sup> *Mirupafshim hënë e vendlindjes*, Tirane, 1990,  
f.54.

## ***Qiriri i shenjtë i kombit***

**- N. Frashërit -**

I dua eshtrat këtu, thërriste Nëna për birin,  
shkollarët e zbehtë me vjershat e tij në gji.  
Ai digej në teqen e largët Myrdeven,  
ia hollonte kockat malli yt, Shqipëri.

E shtruan për shqyrtim, ka harxhime, tha Zogu,  
s'ka plan rregullimi, ku ta vëmë ne,  
s'i gjenin dot vend atij që kish mbajtur mbi supe  
tërë atdheun kur qe gjallë, me male dhe re.

Unë e dua këtu, thëriste Shqipëria,  
parlamentit i vinin me mijëra telegrame,  
e hodhën në votë, po Naimi "s'fitoi"  
tamam atë ditë që u ngritën rrugat e  
xhandarëve.

Nuk patën turp, i zunë në gojë lekët e popullit,  
i thanë: është rruga e gjatë, do kaq  
shpenzime,  
Shqipëria u drodh po as qau, as heshti  
se ti ke kokën tënde, o Shqipëria ime.

Mbreti s'paskej lekë dhe nisej në Evropë,

ku hante drekat nuk i hante darkat,  
po ne do ta sjellim, thanë në Elbasan  
normalistët  
dhe binin pa darkë, grumbullonin qindarkat.

Në s'kini ju lekë do rrimë ne pa bukë,  
do lexojmë këngët e tij që të harrojmë urinë,  
çdo qindarkë një pikë gjaku tek ata trupa të  
njormë,  
çdo qindarkë shkollari një plumb për  
mbretërinë.

Dhe e prunë ata Qiririn e tyre të shenjtë  
të digjej ku u ndez, i bukur, mahnitës,  
po pa i lëmuar mirë dheun e varrit të ri  
u derdh vreri i bejlerëve me dorën e Konicës.

E shanë poetin... Medet - briti Nëna,  
një djalë t'm'ia marr hakun, se se tret balta  
ime,  
një djalë Përmeti u ngrit, një Bulk'i mençur  
qëlloi  
se ti ke kokën tënde, o Shqipëria ime..

*Nëntori, Nr. 12/1988/f.34-35.*



***Naimi me mbesën***



## *Veremi*

Mundje nuk mundje e vetmisë  
Që rron në baltë e në mungesë  
Vajin var në derë të shtëpisë  
Fundit të mbramë i jep shpresë.

Në ditë zije të pa Naimi  
Si fike dritën pa pritesë  
Mallit pashuar zbriti vegimi  
Mbi shikim paloi një vesë.

Verdh vtmia të del në fleta  
Si shkëlqim dylli në gji  
klith pikëllim fijen ta gjeta

Hija e kulmit të bie përmbi  
Aty ku loti i pik shtegtarit  
Ia thotë era vajin barit.

## *Sabri Hamiti*

(1950)

Ka studuar gjuhë e letërsi shqipe në Prishtinë, kurse letërsi botërore në Zagreb e në Paris. Poet e prozator kritik e dramaturk, doktor në letërsi, ka dhënë një kontribut të shquar i studimin dhe botimin e letërsisë shqipe. Ka botuar me dhjetra vël të cilat janë vlerësuar dhe me çm të ndryshme. Kohëve të fundit ka botuar monografitë: "Faik Konica jam unë", "Bilal Xhaferri".



**Iliriana Sulkuci  
(1951)**

Ka lindur në qytetin e Elbasanit. Mbasi mbaroi gjimnazin "Dhaskal Todri" në qytetin e lindjes, vazhdoi studimet e larta në Akademinë Ushtarake të Forcave Tokësore në Tiranë. Është diplomuar në vitin 1971. Ka filluar të botojë poezi që në vitin 1966. Ciklin e parë të plotë e ka botuar në gazeten "Zeri i rinisë" në vitin 1971. Në vitin 1986 botoi vëllimin "Më kërkojnë sytë e nënës" Për shumë vite ka punuar në strukturat e ngryshme të ushtrisë në Tiranë dhe në organet e shtypit ushtarak. Për arsyen shëndetësore sot është e tërhequr në jetën civile. Vazhdon: të merret me krijimtari.

## **Kur them "Të dua!"**

**M**e gjuhën e Dhaskalit<sup>1)</sup>  
Të them: "Të dua!"  
me gjuhën e Naimit  
"Të dua" sërisht  
"Të dua" të them  
me gjuhën e nënës  
dhe brenda kam futur  
gjithë dashuritë...

*"Do të jetoj". Tiranë, 1994, f. 89.*

1) Dhaskal Todri, mësues martir.

## **Vrasjen tënde s'e durokam dot!**

(Djalit 9-vjeçar Milot Kryeziu që  
serbët e vranë në prag të shtëpisë)

Çështë ky arkivol pesë pëllëmbë e ca?

Ç'peshë ka...

që kaq shpatulla burrash  
dot nuk e mbajnë...

Ç'është ky zë fëmije që rënkon  
e gjithë Kosovës i jep dhimbje?

"Ku po më çoni?!"...

O nënë, kam ftohtë!  
trupi im gjak pikon...

O Nënë,

më jep me vete çantën me libra,  
nesër do të shkoj në mësim,  
Së paku librin e këndimit,  
përgjysmë kam lënë vjershën e Naimit...

Mos harro

lapsat me ngjyra,  
fletoren e vizatimit...

Flamurit s'i kam vënë shqiponjën,  
qiellit s'i kam vizatuar diellin...

Mos harroni:

Nesër ejani më merrni!

Nesër nga gjumi më zgjoni!

Të them dhe një herë vjershën  
e Naimit

Dhe pastaj bëni ç'të doni

Varmëni ose pushkatomëni.



### **Sami Milloshi**

*Ka lindur në Macukull të Matit. Kreu studimet për gazetari dhe ka punuar për disa vjet si gazetar. Krijimtarinë poetike e ka përbledhur në vëllimet "Blerimi", "Dafinë e ditës" etj.*

### **Profeci për tim bir**

**U**në s'jam profet, o biri im,  
po dua të bëj një profeci,  
që ti do të bëhesh djalë me nam,  
shkencëtar me famë kush e di...

Dhe ndoshta lulet do të rrrethojnë,  
o biri im, me madhështi,  
atëherë ti mua më kujto,  
kujtomë në malet me sharki.

Në ndodhtë të mos më kujtosh mua  
për hir të luleve të botës,  
do t'i bëj zë Naimit  
të të mallkojë me dhjetërrrokësh.

Ti mund të mbetesh njeri i thjeshtë,  
pa famë, pa nam e pa lavdi,  
po ja që unë ta kam borxh  
si ati yt këtë, profeci.

**"Dafina e ditës", Tirana 1988, f.55.**



### ***Demokrat Anastasi***

*Ka lindur në Gjirokastër. Mbaroi Shkollën e Lartë për Oficer, shërbue për shumë vite në shtypin ushtarak. Ka botuar disa vëllime poetikë. Punon si kryeredaktor i gazetës "Shkëndija demokratike" në Tiranë.*

### ***Pasion***

***- Arsimtarit B. Miftari në Gostivar -***

**R**rugët e gjata të mërgimit  
s'ta mplakën shpirtin asnjëherë;  
gjuha e ëmbël e Naimit  
ta kthente dimrin në pranverë.

Kudo që shkove në Evropë,  
në Bon, Stamboll e Bratislavë,  
askund, akurrë nuk gjete prehje  
siç gjen këtu në Gostivar.

E gjatë, e gjatë, kjo udhë e shqipes,  
por sytë s't'i lodhi asnjëherë,  
me të në shpirt, si një Naim  
e kthen dimrin në pranverë.

***"Plagosja e shpirtit", 1989, f.76.***



### **Hamit Alija (1954)**

*U lind në Kasaj të Tropojës. Ka kryer degën gjuhë-letërsi shqipe në Universitetin e Tiranës. Ka botuar librat poetikë "Bjeshkët janë mbiemri im", "E ruaj një fjalë pér ty", "Lotin nuk ta fal". Njëkohësisht ai merret dhe me kritikë letrare dhe publicistikë. Punon mësues letërsie në shkollën e mesme "Asim Vokshi" në Bajram Curri.*

## **Përse Odiseu?...Naimi Përse?...**

**T**i po rritesh në qytet, vajza ime,  
elektronika e shekullit i zvogëlon peizazhet  
fshatin, yllin, detin, t'i sjell në ekranin e vogël,  
si në syrin e përrallës së gjyshes që shihte  
në fund të botës,  
të dielave a verës kur shkon në shtëpinë time  
të vjetër,  
shoqeve u thua me atë shprehjen që më dhemb  
“Isha në fshatin e babait”

.....

Unë do të iki një ditë  
re e bardhë do të bëhem, hartë a diçka tjetër,  
ndoshta pa pasur lumturinë të tregoj përralla  
(për të treguar përralla duhet të bëhesh gjysh)  
po ti asgjë tjetër s'je veç harta e vendlindjes  
që ka jetuar në mua,  
enigma ke për të zgjidhur që mua të më zërthesh  
Përse dinaku më i madh i botës, Odiseu, u kthue  
prapë në Itakë,

(thonë aty ka vdekur. Njëqind herë po të lindej,  
në Itakë vdes prapë).

në Stamboll ku e pat varrin Naimi,  
thonë toka dridhej natë për natë,  
qyshse i erdhën eshtrat në Iliri  
dridhje toke s'ka ndjerë kush më në atë copë  
  Stambolli,

Përse Odiseu, Naimi përse?...

S'janë të lehta pyetjet e ne në brenda pyetjeve  
vajzë e shekullit modern!

**“Lotin nuk ta fal”, Tirane, 1990, f.14-15**

## *Lindja e Naim Frashërit*

Një ditë e tri net kishte rënë shi,  
36 herë kishte gjëmuar gjuha e lashtë, gërmë  
për gërmë,  
marsi në trupin e vajzave, druve, reve, fjalëve  
lindje të madhe thoshte.

(Mars ka qenë, çfarëdo muaji të ketë qenë).

36 herë ish dridhur toka,  
36 herë kish thënë të pavdekshëm  
gërmë për gërmë të shqipes.

Lisat që nënshkruanin qiej në zgjim  
u drodhën nga imazhi i një djepi,  
u zgjua zjarri i fjetur në lis, pena  
engrirë në zog. Zogu  
i gjëzuar në qiell. Qielli  
i ngujuar në gur. 36 herë.

Tokë me emër zogu. Sa i dashke qiejt! Po urat  
kalatë me trupa nusesh i mban!  
Tokë e çuditshme, 36 herë  
36 herë e pavdekshme. Njeriun,  
njeriun aq herë e lind. Po vjen Naimi  
të mos e lerë Skënderbeun të vdesë  
të të thotë se Dhe plus Atë bëjnë Shqipëri,  
të të thotë dy fjalë e ti të mos flesh njëqind  
vjet.

*“Lotin nuk ta fal”, Tirana 1990, f.106.107*

## *Udhëtim për në Dhërmi (Fragment)*

Ka një zonë te toka ime  
e banuar me heshtje mitologjike  
e lugët si kurri zivejë  
me një tym vulkani mbi krye  
porsi bisht shqiponje.  
Vrubullit ujvari i lumenjve,  
kërceu shkuma si lepur,  
ulurin era dhe përhapet  
nëpër shpinat e vargaveleve.  
Atje unë u ndodha kalimthi  
një ditë të djegur nga gushti,  
e vinin ndaj meje  
nëpër kullotat e gjelbrta  
të asaj mbretërie t'egër  
rapsodi i madh, i verbër  
e pas tij Pindari e Teokriti,  
Skënderbeku dhe Naimi.  
I zhytur tek ajo habi  
nuk dalloja shekujt  
e mendoja se qytetërimi i vërtetë  
duhet të ketë këto ngjyra dhe  
aroma,  
këtë rini të përjetshme.

.....  
**"Hapma derën zonja mëmë",  
Tiranë 1990, f.68**



**Voreo Ujko**  
*(Domenico Bellizzi)*  
**(1918-1989)**

*Emri i vërtetë është  
Domenico Bellizi, lindi në  
fshatin Frasnitë dhe vdiq në  
fshatin Firmë të Kalabrisë.  
Punoj profesor i gjuhës  
frëngje në fshatin Frimë.  
Është ndër krijuesit letrarë  
arbëreshë që u paraqit  
herët me shkrime. Botoi në  
shtypin në gjuhën shqipe në  
Itali, Shqipëri dhe Kosovë.  
Ishte redaktor i revistës  
"Zëri i arbëreshëve".  
Shkroi vjersha, kritikë  
letorraine, eseistikë etj. Botoi  
veprat : "Zgjimet e gjakut",  
"Kosovë", "Mote moderne",  
"Ankth", "Stinët e mia",  
"Këngë arbëreshe",  
"Burimi".*



### **Musa Ramadani (1944)**

Lindi në Gjilan. Shkollën fillore dhe atë të mesme i kreu në vendlindje, ndërsa shkollën e lartë Pedagogjike, Dega Gjuhë e Letërsi Shqipe, në Prizren. Që nga viti 1965 punon në "Rilindje" gazetar, bashkëpunëtor, redaktor. Shkruan kryesisht për të rritura: poezi, prozë, dramë, kritikë etj. Vjershën e parë e botoi më 1963 në revistën letrare "Jeta e re". Musa Ramadani jeton në Prishtinë. Ka botuar: "Mëkatet e Adamit", "Tirravaje", "Neurosis", "Romani pa kornizë", "Muza nuk flejnë", "Fluroma", "Zezona", "Fjala në skenë", etj.

### **Gjakimi në vargje Naimit**

Thërras muzat e jetës  
Pegazin të ma shalojnë  
Të shtegëtoj te burimi,  
Një frymëzim për Naimin

Lus rrimën e asonancës  
Nëse ia behnin këtij lumi,  
ta flakin ngurimin-  
Vargun e lirë e zuri gjumi.

Kërkoj një metaforë  
të gjerë fushë e të lartë bjeshkë  
të padalë nga krahasimi  
Ta amshoj së dyti Naimin.

Ndërroj një simbol  
Veshur asosacionesh  
E që një kuptim ndryn.  
(Një kyç të stërmadh  
Që i ngjason botës sonë  
E një çelës të vogël  
Që i shembëllen njeriut)

Gjakoj një varg mitar  
Të lidhur apo të lirë  
Thërras muzat e jetës  
Pegazin të ma shalojnë.

***Vullnet Mato***

Êshtë i njohur si poet dhe si prozator.  
 Ka botuar: "Tinguj malesh", "Krahët e  
 erës", "Ujsinor", "Ninullat e hekurit", "Era  
 e kësaj kohe".

***Këndoi Naimi***

**Këndoi** ai me oshëtimin e malit që i mban kryet përpjetë;  
 dhe mali tha: Djep do të bëhem  
 të përkund krismat

Vjershëroi ai me gurgullimën e burimit ku shihen retë,  
 Dhe burimi tha: gurë do të bëhem të rrit lisat.

Rimoi ai me jehonat e pyllit të gjelbëruar;  
 dhe pylli tha: Pemë frutore do të bëhem  
 të mbush prezaret

Ligjëroi ai me zërin plotë ëmbëlsirë të bilbilit:  
 Dhe bilbili tha: Këngë gëzimi do të bëhem  
 të ngre fole edhe në buzët e djelmoshave  
 Shpërtheu ai me dufin erëmirë të trëndafilit;  
 dhe trëndafili tha: Lulishte do të bëhem  
 të çel edhe në fustanet e vashave bukuroshe

Shfreu ai me tingujt e fyellit të bariut zemërmirë;  
 dhe bariu tha: Lëndinë do ta bëj zemrën

që të shtoj qumështin, të shumoj qengjat.  
Dihati ai me gjoksin e papërtuar të bujkut  
të djersirë,  
dhe bujku tha: Me krahë të rinj do të bëhem  
të lëroj gjithë djerrinat.

U shkri ai për pakëz dritë si Qiriri i përvëluar  
dhe Qiriri tha: fontanë drite do të bëhem  
të ndez edhe ujrat e lumenjve netve.

***“Ninullat e hekurit”, Tirana 1984, f.10-11***

## **Petro Çerkezi**

*Ka lindur në Gjirokastër. Mbaroi Fakultetin për Gjuhë-Letërsi Shqipe dhe ka punuar në arsim dhe sektorin e kulturës. Ka botuar vëllimet: "Dhjetë yje", "Kur shtrin hapin kompania", "Në tokën e stërgjyshërve", "Gëzimet e ditëlindjes", "Lulet e çelikut", "Duarshtërngime", "Dridhet palë e fustanellës".*

## **Pashë Naimin...**

**Ditë të mbushura me këngë,  
ditë marramendëse nga vallet,  
thesari madhështor i artit  
një nga një shfaq brilantet.**

në këto ditë, diku, atje mjedis spektatorëve,  
pash Naimin  
me faqet trëndafil nga lumturia,  
duke sjellë pas vechtes vargan-vargan  
fushat dhe lëndinat plot me lule vere,  
duke sjellë me vete malet e mëdha  
me lisat e bleruar të poemave.

Pash Naimin duke mbledhur nga lëndinat  
e verës,  
duke mbledhur nga sken' e festivalit...  
Pash Naimin...

**"Ylli", Nr, 12/1985, f.24**



**Xhevahir Spahiu  
(1945)**

Lindi në fshatin Malind të Skraparit. Ka kryer studimet e larta në Degen Gjuhë-Letërsi Shqipe të Universitetit të Tiranës. Punon pranë Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve të Shqipërisë ku është Sekretar i Përgjithshëm i saj. Është autor i disa librave. Shumë poezi të tij janë përkthyer në disa gjuhë të botës. Është vlerësuar me çmime brenda dhe jashitë vendit. Ka botuar vëllimet: "Mëngjes sirenash", "Vdekje perëndive", "Zgimi i thellesive", "Agime shqiptare", "Nesër jam aty", "Heshtje s'ka", "Poezia shqipe", "Kohë e krisur", "Ferrparajsa", "Pezull".

Xhevahir Spahiu

Eje

Eje

Kom eje

Po km  
ku  
arëtë

Zini mi

Dal jahtë  
verbaz  
këskoj

Takoj  
Nëi miam

Stamboll, 22 may 1995

## **Poeti i gjuhës së zjarrtë**

Ecja maleve në verë,  
ulja torbën me lajthi:  
atje poshtë një pирг gërmadhash  
që dikur kish qenë shtëpi.

N'atë prag dikur pat lindur  
një poët nënë Emineja:  
Në Kokojkë këmborët binin,  
si ujëvarë varej kopeja

Zbrazi pushkë frashërioti,  
përtej grykash krisma mbrriti;  
vetë stërgjyshi im pat thënë:  
“Prapë me djalë u bë Haliti!”

I dëgjoi djaloshi këngët,  
fjalët e dheut të ndritur,  
tok me qumështin e nënës  
gjuhën shqipe pati thithur.

Dhe e shkroi me pikë gjaku,  
herë të ëmbël, herë të ashpër,  
të kthjelluar si pikë e lotit,  
si burimet përmbi Frashër.

Në çdo varg ish baltë e vendit,  
ishte mali me lajthi,  
trimat dhe lulet e verës,  
shpirti yt, o Shqipëri!

Ato fjalë që t'i tha zemra  
o bilbil, kumbojnë mes nesh;  
qysh fëmijë, “Mbaj vesh! tha nëna,  
dhe babai më tha:”Mbaj vesh!”

Futi brenda kraharorit,  
 thuaj, siç themi ne ngaherë  
 që kur lindim, gjersa vdesim:  
 "Ti, Shqipëri, më jep nder!...  
 "Ekrani i kaltër", 1982

## *Lumi i vendlindjes*

Kudo që shkoj  
 më duhet të hedh vahun e një lumi.

Uji i lumit tim rrjedh në të gjithë lumenjtë,  
 shtrati i lumit tim shtrihet në të gjithë  
 shtretërit.

Rrjedh mes maleve  
 dhe në trupin tim;  
 ja, e mori kthesën. Tok me të edhe hëna.  
 Ai më ka parë i pari  
 siç më pat bërë nëna.

Më thotë zëri i lumit tim  
 holluar prej ujit të pakët të burrimeve në verë:  
 mos na harro!  
 Më thonë gjethet vjeshtore të rrepevedegëgjerë:  
 ktheu në pranverë, biro.

Ktheu, të shikosh lisat me pjergulla ngarkuar.  
 që fshatarëtve të tu u pëlqen t'i quajnë "kuaj",  
 tokën e re ku gruri halëzi  
 me rrënjet në gëzhojat e luftës ka bleruar.

Të kujtohet?  
 Ç'trishtim të kapte

kur lumin e vendlindjes s'e gjeje n'asnje hartë!

I vogël vërtet,  
po ujrat e tij  
buronin prej shtëpisë së Naimit të madh.

Kudo që shkoj  
i dëgjoj këta zëra  
e para syve më shfaqet fytyrë e bukur e nënës  
që dritë nuk lypte,  
po jepte dritë,  
një fytyrë që rilindte në të gjitha dashuritë.

Kudo që shkoj,  
si lumi që këndon këngën e tij,  
në buzë një motiv unë vërshëllej:  
Ne japim dashuri kur dashuria kthehet,  
ne rritim bij që kanë gjakun e gjakut tonë në  
deje.

**“Poezia shqipe”, Tiranë, 1990, f.75-76**



### **Petraq Risto (1952)**

Ka lindur në Durrës. Kreu studimet në Universitetin e Tiranës për gazetari. Punoi gazetar dhe libretist. Aktualisht është drejtor i Shtëpisë Botuese "Globus R". Ka botuar vëllime poetike, tregime, romane, letërsi për fëmijë. Veprat e tij janë: "Zjarre që rriten", "Dallgë e detit tim", "I them shekullit mirëmëngjes", "Sytë e ditës vizatoj", "Vdekja e palaços", "Qerosi dhe Pinoku në plazh", "A protestojnë të vdekurit", "Zgjohu princesha ime", "Avioni i parajsës Baterflaj"

### **Baden**

Në këtë qetësi të shtrirë buzë liqeneve mes bukurisë së ftohtë të peisazhit ëndërronte dhe këndonte me zë mjellme tretur nga sëmundja Naim Frashëri.

I thithnin mushkëritë ajër të pastër po prapë në të mungonte diçka.

Oksigjenin që s'mund ta gjente në ajër krijonte në poemat e mëdha.

**Vjenë, korrik 1980**

**"I them shekullit, mirëmëngjes!", Tiranë 1981**

## **Lazar Rumnici**

*Ka lindur në Urën Vajgurore, ka punuar në shtypin lokal.Jeton në Berat.*

## **Ndërsa vështron te malet...**

*- Naim Frashërit -*

**Dhe** ecte ngadalë i menduar Poeti  
Agut të mëngjeseve pragut të mbrëmjes  
Në rrugicat e gurta të këtij qyteti  
Që malin kanë në krye lumin poshtë këmbëve

Ç'mendonte ashtu vallë me vështrimin nga malet  
Ja Tomorri! Dhe s'ngopej duke parë  
Mbi ballin e tij karvani i reve ndalej  
Bardhësinë e tij qyteti e paska marrë.

Malet madhështorë! - mendonte Naimi  
Mbi supe mbajnë yje, në emra - legjenda;  
Dhe Osumi mes tyre e ka burimin  
Edhe Berati mbi shkëmb i ka themelet.

Ndërkohë Shpiragu mbështillej me shtresë  
mjegulle  
- E Tomorri mbulohej me çarçafë bore,  
"O malet e Shqipërisë!..." - bluante Naimi në  
mendje  
Vargun e parë të poemës madhore.

*"Kushtrimi" Berat 2 Nëntor, 1985, f.4.*



## Koçi Petriti (1941)

Ka lindur në Sovjan të Korçës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen pedagogjike në Korçë, kurse studimet e larta Dega Gjuhë- Letërsi Shqipe në Universitetin e Tiranës. Për shumë vite, ka punuar në Librazhd si mësues i gjuhës dhe i letërsisë shqipe në shkollën e mesme. Ka punuar në Lidhjen e Shkrimitarëve dhe Artistëve të Shqipërisë dhe aktualisht është pedagog në Fakultetin Histori Filologji. Krijimtaria e tij poetike është përbledhur në vëllimet: "Lirikat e Majit", "Përsëri në udhë", "Firma e popullit tim", "Prush nëpër shekuj", "Të dashurova ty", "Poezi", "Lulëkuqet" (Prishtinë)

"Tre vëllazrit Frashëri"  
Sa për tre Tomorrit  
Në tre kontinente  
Shkelin për rreth Vlorës"

E grekve qafte", ç'tha Homeri  
she e shqiptarëve  
ç'tha Naimi  
të dy, si krahe të nj'yllberi,  
i pastë edhe njerezimi  
Koçi Petriti.

## Balada e Atentatorëve

Njeri me De Radën,  
tjetri me Naimin,  
hipur mbi baladën  
kalëzemërimin.

Njeri matanë deti,  
tjetri mëkët anë,  
si dy krerë shpendi,  
shpendi mitik janë.

Ç'thotë atentatori  
me atentatorin?  
Njeri sqepoi mbretin,  
tjetri perandorin.

Njeri Ferdinandin<sup>1)</sup>  
tjetri Emanuelin<sup>2)</sup>  
nëpër shteg naganti  
dy messhekuj shkelin.

Në paradë, kur mbretin,  
gjithë e përshëndetën,  
rend Axhezilao  
i ngul bajonetën.

Ç'mesazh trëndafili  
që "ta përkëdheli"  
nis me plumb Vasili  
drejt nj'Emanueli?

Dhe fluturoi zërin  
si zog të pastrukur:  
Sillmëni krëhërin  
që të vdes i bukur!

Arbërisht i pari,  
shqiptarisht i dyti,  
asnje lak litari  
zërin dot s'ua mbyti.

njeri me de Radën,  
tjetri me Naimin  
hipur mbi baladën,  
kalëamëshimin...

**1986**

*1,2) Arbëreshi Agezilao i bëri atentat mbretit Ferdinand i Dytë më 1850. Në meshekullin tjetër u qëllua perandor Emanueli...*



### **Rudolf Marku (1952)**

Ka lindur në Lezhë. Shkollën fillore dhe atë të mesme i kreu në vendlindje. Studimet e larta në Degën Gjuhë e Letërsi Shqipe i kreu në Universitetin e Tiranës. Për një kohë të gjatë punoi në Lezhë ku dha mësim për gjuhë e letërsi shqipe. Më pas ka punuar në gazeten "Drita" si redaktor. Përveç krijimtarisë letrare ai është marrë dhe me përkthime të poesisë të autorëve botërorë. Ka botuar vëllime poetik: "Shokët e mi", "Rruga", "Sërishti", "E dashur", "Udhëtim për në vendin e gjérave që njohim""Vdekja lexon gazeten", "Fëmijët dhe Pogu i padukshëm", "Tokë e shkretë". Ka qenë deputet në Kuvendin Popullor.

### **Naim Frashërit**

**E**rdhi në Shqipëri. Thonë nëpunës i zakonshëm dogane,  
Veçse qenë të tepërt për një zyrtar  
              sytë ëndërrues e të trishtë të tij,  
Në shpirt kishte plot vargje dhe valixhet bosh  
Duke e ditur me kohë se veç shpirtit  
Doganë e taksë s'mund të vejë asnjeri.

Qe natë dhe nata qe plot e përplotë me gabime  
Një henë e ngrënë orientale  
              ndriçonte gjithçka,  
Ai rrinte zgjuar si një roje  
              Filloi të bënte inventarin e çdo gjëje  
Duke thirrur zëlart: Male, kodra;  
              brigje, gërxhe dhe fusha të mëdha!

Kish frikë se mos i kishin vjedhur  
në natën e errët,  
Kontrabandistët karieristë, bejtexhinjtë ziliqar  
Nën dritën e një qiriri në natën me gabime,  
Ekte drejt poetit peisazhi shqiptar.

Lumenjtë, drurët, dhe ti, qiell i kulluar;  
Ecnit në natën e errët pa përfilluar askënd  
Ku t'i conte, ku t'i shpinte nëpunësi i doganës!  
Shtëpia e tij ishte e vogël

At'herë ai u bë VEND.

***“Drita”, 1990, 21 tetor, f.8***



### *Halit Shamata*

(1954)

Në vitin 1973 mbaron shkollën e mesme në Kavajë dhe në vitin 1977 përfundon Fakultetin Histori-Filologji, Dega Gjuhë-Letërsi. Pas mbarimit të shkollës, për arsyen biografike, dërgohet mësues në Lekbibaj të rrethit Tropojës. Në vitet 1980-1981 mbetet i papunë, ndërsa në vitet 1982-1990 punon mësues në Kryevihë të Kavajës. Në vitet 1990 dhe në vazhdim është zgjedhur deputet në Parlament. Ka botuar vëllimin poetik: "Autograf", "Tatuazh".

### *Pa asnje relikt*

**Një** copëz

nga Qiriri i Madh i Naimit  
 Peshku-postum i De Radës,  
 Një Fletë e Gjelbër Shelgu  
 Nga varri i Lasgush Poradecit,  
 Autoportreti në Vizatimet e Migjenit  
 Më duhen çdo ditë për të kuptuar  
 Se s'kam asnje relikt  
 Në tryezën time të punës.

*"Autograf", Tirana, 1990, f.19*





**Lindita Ahmeti  
(1974)**

*Ka lindur dhe jeton në Shkup në një familje intelektualësh. Studion për greqishten e vjetër dhe latinisht. Ka botuar vëllimin poetik "Mjedra dhe bluz" është një nga penat më premtuese të letërsisë shqipe*

### **Vrimat e Fyellit të Naimit**

**Një** shkëlqim i beftë  
i vetëtimtë  
shpërthen në fytyrën e motrës sime  
motrës poeteshë  
e derdhet poshtë  
kur shikon nga dritarja e kullës  
drejt lumit tonë  
pastaj  
përnjëherë drita u bie  
punëtorëve që thejnë gurë në mjegull  
grave që lajnë kujtimet e hidhura  
shelgjeve të pikëlluara  
kaçubeve rreth lumit  
lumit që rrjedh  
të gjithë atëhere  
marrin ilaçin e mirë  
të gjithë  
vetëm motrës sime  
motrës poeteshë  
i mbetet nata lasgushjane  
vetëm vrimat e fyellit të naimit  
vetëm vetëm vetëm  
*"Mjedra dhe Bluz", Shkup, 1993. f.33*

## Takim mbi dallgë

*-Naimi dhe Çajupi të vetmin takim  
e bënë mbi det-*

Mbi valë kokë më kokë,  
Dallgë sy më sy...  
Thua dy gisht tokë  
S'kish për ju të dy.

Era s'ndahet kicit,  
Deti valë-valë,  
Në mollëz të gishtit  
Boja e patharë

Në dy palë sy  
Gjithë Shqipëria  
Ç'dritë n'ata sy!?  
Rrezellen Liria!

Malet arbërore  
Në dy gjokse shkrirë  
Me çerdhe shqiponje  
Dhe krojet e dlrë.

Që nga gjokset vargu  
**Çan si meteor,**  
Ç'vjen që nga Shpiragu  
Kthehet në Tomorr.

Pa do shkundnin varjet  
Pragjet atdhetare,  
Flakë do ndeznin malet,  
Vratat shqipëtare.

Dallgët- mal në shpirt,  
Dallgë mbi kuvertë...  
Horizonti ndrit,  
Ndahan dy poetë!



## Ibrahim Gani

*Ka lindur në Progonat të Tepelenës. Ka mbaruar shkollën e lartë ushtarak për oficerë. Punoi për shumë vite në shtypin ushtarak. Jeton në Tiranë. Ka botuar vëllimet poetike: "Yjet dhe malet", "Në lindje të meridianit 19", "Ngrohtësi ushtare", "Ballë për ballë", "Pisha jonë e gjelbër", "Udhët plot diell".*



**Pirro Tase  
(1933)**

Ka lindur në Leshicë të Përmetit në një familje me ndjenja atdhetare. Që nga viti 1938 familja e tij u vendos në Tiranë. Prej vittit 1955-1993 punoi si gazetar në "Zërin e rinisë", në botimet e KPBPSH dhe Shtëpinë Botuese "Pasqyra" deri sa doli në pension. Tregimin e parë e botoi kur ishte nxënës i klasës së pestë në gazetë "Pionieri" dhe që atëherë ka botuar në shtypin e përditshëm periodik.

**Ndritur nga shpirti i madh i Naimit!**

**U**shembën kalatë prej shkëmbi dhe gurësh...  
Mbeti kështjella e fundit e gjuhës!

Gjalloj ndër shekuj mes zjarrit e flakës,  
Me gjakun e zemrës, me majën e shpatës:

Kështjellë s'e shemb as gjylja e topit:  
Themel mëmëdheu, themeli i Kombit!

Por shqipen shqiptari me frikë e fliste:  
Pushtuesi, shoveni, gjuhën ia priste.

Fetë e shumta si mjergull i rrinin:  
Shqipen e ngrinin, shqipen e grinin!...

Nga hiri Feniks shpërtheu Naimi,  
Kraharorin zhuritur me zjarr frymëzimi,

Vullnetin pa anë e fund të Sizifit,  
Dashurinë, therorinë e shpirtit të Krishtit,

Ligjëroi në shqip, në gjuhën e mëmës,  
E shqipja shkëlqeu si drita e hënës!

Me gërma të arta, te e bardha fletë,  
U shkrua, flakëroi e ndezi rrufetë

Gjuha që foli në botë Kastrioti,  
Ballshajt, Araniti edhe Vrana Konti,

Shqip, në beteja, briti Pirro Burri!  
Shqip klith shqiponja, që lart, nga Flamuri!

\* \* \*

Shemben kalatë prej shkëmbi dhe gurësh...  
Mbetet kështjella e fundit e gjuhës!

Fortesë s'e shemb as gjylja e topit:  
Themeli i Atdheut, themeli i Kombit!

Vatër Vllazërimi, Flamur i Bashkimit,  
Ndritur nga Shpirti i madh i Namit!...

*"Njëqind poetë për Naimin" Tiranë, 1995, f.151*



**Petraq Ballabani  
(1954)**

*Ka lindur në Kosinë të Përmetit. Pas mbarimit të Gjimnazit "Sami Frashëri" në Përmet, mbaroi një shkollë të mesme ushtarake. Shërbuej oficer për 15 vjet në Përmet dhe Leskovik. Ka shkruar vazhdimisht poezi por deri sot s'ka trokitur në asnjë derë redaksie. Megjithatë poezitë e tij kanë shumë ndjenjë dhe nerv poetik. Për Naimin ka krijuar një cikël të tërë. Jeton në Përmet.*

## Gjenezë

**S**a më thellë që rëmon dhenë, rrjedhën time do qëmtosh, ja tek ke dhe Skëndrbenë, shihmë mua që ta njohësh.

Po më tej do gjesh Dardanët, fisi ilir dhe ata ishin, që të gjithë i bëj të gjallë, edhe pak po ta pres gishtin...

Labirinthe janë damarët gurgullojnë atje ku janë vetëm pak ma prisni gishtin, çdo bulëz gjaku Naim kanë.

## **Takim me Naimin në fshatin Kostrec<sup>1)</sup>**

Nuk do të flas për erën e lajthishtë  
për atë që ndjeva në fshatin Kostrec  
S'dua t'ia prish portretin Dangëllisë,  
do haja penelin si një piktor i keq.

Veç kur shkova në një dasmë,  
pash se mungonte vetëm Naimi,  
pritej të vinte nga çasti në çast,  
që s'do mëngonte, të gjithë e dinin.

**Shtator, 1995**

"Njëqind poetë për Naimin" Tiranë 1995, f.153.

### **Portret**

Mund të mos kesh kasketë klasike  
as gravatë fjongo mbi këmishë,  
të mos pozosh ulur në karike,  
të mos mbash tespie me fildish.

Edhe pas vdekjes të mos kesh përmendore  
ku të falet çdokush me nderim  
mendushëm... me fëmijët prej dore,  
as vjersha të mos lësh në këndim.

Mund të mos të ngjajë as hija  
veç trashëguar të jetë mendimi...,  
mund të mos jesh sozia e tija  
e prapë mund të jesh Naimi.

**31.8.1996.**

- *Botohet për herë të parë -*

**1)Fshat në Dangëlli**

***Naimi***

**Sikur të ndodhët për një çast çudia  
të kthehej koha mbrapa me revan,  
këtë ta bënte vetë historia  
ti bënte sfidë jetës anë e mbanë;**

**Të shuheshin vitet një nga një me radhë,  
të anullohej gjithshka që ka ngjarë,  
çdo fletë të mbetej krejt e bardhë,  
magjishëm jeta të kthehej në përrallë;**

**Të jetonim në një shekull mbrapa,  
atëher kur lluksi matej nga karrocat,  
kur nuk shkruhej as me stillolapsa,  
kur qiriri ndrinte mbi rogoza,**

**Ta shihnim ne stërgjyshin tonë  
ta njihnim dhe ta preknim sado pak,  
pastaj të iknim si zanë e si jehonë,  
të iknim porsi ëngjëll fluturak.**

**Por ja që koha kurrë nuk merr kthesa  
por ecën vetëm drejt si një shigjetë,  
që lind e vdes pafundësi krijesa,  
e bën të rrjedhë lumin që quhet jetë.**

**Naimi lindi vetëm për të rendur  
më shpejt se koha dhe se drita  
(këtë ligj thonë Ajshtajni e ka gjetur)  
nuk ka mure ta ndalin edhe prita.**

**Sepse e kemi kaq përparrë  
s'kemi si mbrapa ta kthejmë historinë,  
për t'ja aritur me çdo kusht qëllimit  
vëllezër, na duhet ta arrijmë!**

**25.8.1996**

***Botohet për herë të parë***

## Murat Isaku

Lindi në fshatin Gajre afër Tetovës. Punoi si profesor, gazetar e redaktor në RTV e Shkupit. Ka botuar një sërë vëllimesh si: "Zani i malit", "Buzëqeshjet e mesditës" dhe "Kurora e trollit", "Drithma" dhe "Blana", romanet: "Dielli i di rrugën e vet", "Gjaku i sharraxhinjve", "Zjarri i vonuar", "Reckajt", "Etje", "Unaza e djerrinës", "Gërshteta", "Fatprerët". Këtë vit fitoi çmimin "Naim Frashëri".



## Kthehu në kullën time

Kthehu n'kullën time, Naimi shtratin shtron,  
Kruja pret Skënderben' t'i kthehu n'kullën time...  
Rozafa n'kështjellë gjoksin e mbulon me gur,  
pritmë të vij, or mik i mirë, më paç urime...

Kthehu n'kullën time, Kosova m'thërret n'shpat,  
n'dasëm do t'i shkoj-ti rri n'kullën time!  
Naimi ka qiri të ndezur, atje s'do t'rri gjat'  
sakaq do t'kthehem, or mik, me mustaqe të thime...

**"SHUTA", botim "Flaka e vllazërimit" Shkup, 1995, f.70.**



***Shaip Zeqiri***  
**1959**

*Lindi në Orllan të Podujevës, Kosovë. Shkollën fillore e ka mbaruar në vendlindje, ndërsa të mesmen në Podujevë. Ka studjuar për gjuhë dhe letërsi angleze në Universitetin e Kosovës në Prishtinë në vitet 1978 deri më 1981 dhe më pas ka mbaruar Institutin Gëte në Gjermani.*

## ***Ndezja e qiriut***

**Zgjohu, nënë, dhe ndiz qiriun,  
Dua ta njoh mirë njeriun,  
Që e do përparimin  
Dhe idol ka Naimin.**

Ai është vëlla me mua  
Kemi burimin nga një krua:  
Rjedhë e shkrepave dhe e gurit  
Gjakun si ngjyra e flamurit.

- Botohet për herë të parë -

## *Qiriri*

Në altarin e faltore së dheut  
ditë e natë digjet qiriri,  
pikë pikë pikon lotë;  
pikë pikë pikon diell.



Në altarin e faltore së dheut  
ditë e natë digjet qiriri,  
pikë pikë pikon lotë  
pikë pikë pikon diell.

Ky qiri ditëlindja e shekujve,  
martirët që treten në flakë.

Në altarin e faltore së dheut  
Qiriri i zemrës  
shkrihu!  
Qiriri i diellit  
digju!

**26.5.96**

**Botohet për herë të parë**

### *Halil Qendro* (1936)

Ka lindur më 22 shkurt  
1936 në Progonat të  
Kurveleshit. U diplomua  
për gjuhë-letërsi në  
Universitetin e Tiranës. Ka  
punuar gazetar dhe pastaj  
redaktor në Shtëpinë  
Botuese "Naim Frashëri".  
U internua për më shumë se  
njëzetë e dy vje. Ju ndalua  
botimi dhe librat e tij hynë  
në listat e zeza. Ka botuar  
përbledhjet poetike:  
"Dashuri e shqetësuar",  
"Këngët e Progonatit",  
përbledhjen me tregime e  
novela "Si në balada",  
"Rrësimet e pas mesnatës"  
dhe "Ezopi në gjyq"  
(fabula).

## *Vdekja e Poetit në fundshekull*

**D**o të priste fundin shekulli  
që pa këngëtarin të mos mbetej memec.

U duk një çast sikur u mek frymëmarrja  
në kraharor të poetëve,  
kujen vuri Çajupi,  
te “Baba Tomorri” dhimbja pikonte pika floriri.  
malet një çast e ndienin veten jetimë  
me lotët e gurrave qanë.

Naimi më s’do të ishte.

Digiej qiriri  
brumë dite gatuar në natën e gjatë,  
nga balli i zbehtë  
shkundte ndryshkun e vdekjes Poeti.

Te strofat e mallit,  
si mbi truallin e vendlindjes shtrirë,  
mbi çdo varg si mbi një vig  
nga Stambolli Naimi  
drejt vendlindjes shtegtonte.

Mbarim shekulli,  
fillim poeti.

**1983**

*“Njëqind poetë për Naimin”, 1995, f-154*



## **Vehbi Skënderi (1929)**

Lindi në Strelcë të rrëthit të Korçës. Mësimet e para i mori në vendlindje. Që në moshë të re doli partizan në rrëthin e Dibrës. Mbas Çlirimt ka punuar në organet e ndryshme të shtypit si në revistën "Ylli" në Sh. Botuese "Naim Frashëri" etj. Punoi për një kohë në Hidrocentralin e "Vaut të Dejës". Ka mbaruar studimet e larta për Gjuhë e Letërsi Shqipe. Boton vazhdimisht krijimtari poetike e cila është vlerësuar me çmime. Përbledhjet e tija poetike janë: "Këngët e para", "Vjersha", "Fletë nga ditari im", "Vjershat e poemat e Drinit", "Vazhdim i një bisede", "Shqiponjat e Vermoshit", "Përsëri mëngjez", "Poezia shqipe", "Kumbojnë vitet", "Nxitoj", "Po sikur!". Jeton në Tiranë.

## **Vdekja e Qiririt**

Qiriri digjet! Një çerek gishto paska mbetur.  
Thua po dënes? Thua loton duke u tretur?  
Im'nip e vren. Vështrimi vrik mbi të i mbetet.  
E i vjen keq, që flaka pakngapak po meket...

E pranë tij, vocraku, gjithë mërzi vjen e pështet.

Flaka nën hije, si gjethë krahët përpëlit.  
Befas qiriu i duket si frymor me shpirt  
E plot mërzi vështron vogëlushi kokëvarur.  
Qiriu në terr, dridhet posa një zokth i mardhur.

"Babush, po vdes"!- ai gjithë drithërim më thotë.  
Në sytë e bukur, i rrëzëllijnë curka lotë!

I qaset pranë, mjaft i trondit tur, për ta parë  
Duke thërrit tur me tërë zërin e duke qarë...

Edhe në çast, sipas zakonit qytetar  
Rrotull qiririt, (që po jep shpirt) sajon një varr  
Një varr në dhomë... nën sfond me hije nate,  
Me disa lodra e disa shishe arancate.

Mblidhemi gjithë, s'ja mbushim mendjen kursesi:  
Që s'mund të flasë dhe s'mund të vdesë një qiri!  
Po s'di përse, qiriri i varfër, që sa u shua  
Më ngjan sikur, nuk flet me nipçen, po flet me mua.

E duke vrejtur n  p  r tektuke, grimcat e hirit  
Se m   u kujtua Naimi i   mb  l,  
bashk   me "Fjal  t e Qiririt".

*Tiranë 2 nëntor 1994*

*“Njëqind poet për Naimin”. f.155*



## ***Myslim Pasha*** **(1945)**

Lindi në Kremenar të Mallakastrës. Fëmijërinë e kaloi në vendlindje, kreu shkollën ushtarake "Skënderbej" dhe më pas Shkollën e Lartë të Oficerëve për topograf. Ka përfunduar dhe studimet e larta në Universitetin e Tiranës për gjeodezi. Është doktor i shkencave teknike. Kahas detyrës ushtarake është marrë dhe me krijimtari poetike. Ka botuar vëllimet "Mallakastra", "Në tokën time", "Gura e fjalës". Eshtë njëkohësisht autor i një sërë studimesh shkencore në fushën e gjeodezisë.

## ***Ardhja e Naimit***

Rrotull malet e Tyrolit, të tejdukshëm nëpër mjergull  
Ti më lutesh të them shqip, një varg këngë nga ky  
shekull.

...Veshët mpreh.

Unë s'jam unë.

Vargu shkon mbi Albanide

Buzët s'qenkan vetëm buzë, qenkan gurra të çuditshme.  
Gjuh' e gjuhës shqipëron.

Unë harroj të gjitha dhimbjet...

Edhe bëhem më i çlirët, më fluror, se vjen NAIMI.

Nëpër odat e përrallave, shfaqen zanat cicërone  
Flor' e shpirtit shqipëtar, stisur që në kromozome.  
Vdes njëmijë herë i etur...

Njëmijë herë lind si Feniks

M'i thërret dikush bilbilet dhe kur shpresat janë  
shprishur.  
Bëhem shqipëtarisht i mirë se në krah shfaqet NAIMI.

Mjalt i tingujve në hoje, rrjedh në gojën e Moisiut<sup>1)</sup>  
Zonjë,

tani jam i gremisur...

Në çast zgjohem i harlisur

Qenkam i pushtetshëm sonte, thotë gjindja e Insbrukut  
Shqip thuren dashuritë, mbirë nga ligjirim i trungut.

Rrotull malet NAIMNIA vijnë si profetë të bukur...

*Insbruck, korrik 1995*

*“Njëqind poet për Naimin” f.157*

## ***Moikom Zeqo***

**(1949)**

Lindi në Durrës. Shkollën fillore dhe atë të mesme i kreu në vendlindje, ndërsa studimet e larta në Degën Gjuhë-Letërsi Shqipe në Universitetin e Tiranës. Ka punuar redaktor në Gazeten "Drita" dhe më pas në Rrogozhinë. Ka kryer detyra shtetërore si kryetar i Komitetit të Kulturës dhe të Arteve. Ka qenë deputet në Kuvendin Popullor. Është bashkëpunëtor shkencor në sektorin e Artit Antik e Mesjetar të Akademisë së Shkencave të RSh. Veprimtaria e tij është shumë e gjërë si në fushën shkencore dhe krijimtarie letorraine. Ka botuar mbi tridhjetë e ca vëllime me poezi, studime shkencore për arkeologjinë, historinë, traditat, publicistikë si dhe përkthime të ndryshme. Jeton në Durrës.



## ***Ribërja e Atdheut***

**Atdheu që në shekuj  
koha dhe hapësira  
nisnin me të.**

Po gjeografia e gjakut dhe djersës  
duhej ribërë  
dhe në poezi!

Të parët qenë ata-të paemërtit, të lashtët,  
e epeve ilire- poetizuan strallin,  
ujëvarat, ajrin.I shpikën tërë fjalët,  
u dhanë eshtrat, mishin e shqipsat e tyre.

Në këtë kozmogoni të veçantë  
hëna dhe dielli, shtrëngatat, bora  
kishin përkatësi etnike si toka.

Shumë më parë se Adami dhe Eva,  
Mujin dhe Ajkunën- stërgjyshërit viganë  
i krijuan për zanafillat e këngës.

I emëruan trojet ashtu si yllësitë:  
Lugjet e Verdha, Qafa e Botës,  
Bjeshkët e Namuna.

Pastaj erdhi Naimi- demiurgu i madh  
prej fjale i ngriti përfundimisht vargmalet  
i mbolli me pyllnajat e shpresës...

De Rada bëri detet, u përtériu  
ujin çdo shekull. Te lisi i Milosaos  
ringjalli orakujt pellazgjike të Dodonës,  
metaforat qenë gjethet legjendafolëse!

Serembja këmishën e kripur të shtegëtarit  
e bëri velë për erërat e mallit.

Çajupi lartësoi Tomorin  
me vetëtima ironie e sarkazme.

Asdreni e rriti lilëkuqen e madhe  
ku shqiponjat  
rrinin të çelnin zogjtë.

Lasgushi e përjetësoi një gllënë dhimbjeje  
dmth liqenin,  
ku Drini buron te baladat e kombit.

Pastaj një relief vrapi Marathonomaku i Nolit  
me fleshet e mëdha të shekujve  
për të mos vdekur,  
për të mos heshtur.

Migjeni ndërkohë me bindje  
 bëri shumë përbysje të domosdoshme,  
 perënditë i shpërbëu në pluhur,  
 mollët e ndaluara  
 ua shpérndau brezave!

Të tërë së bashku  
 e ribënë atdheun.  
 Pastaj të sigurtë ja dorëzuan së ardhmes!

## ***Binjaku***

**N**ë shekullin e XIX një nënë  
 lindi dy binjakë:  
 njeri vdiq që ditën e parë,  
 tjetri rrojti sa të tëra ditët;

U quajt Naim.

9 vjeç shkroi poezinë e parë,  
 atë çast mosha  
 ju bë si toka, deti.

Forca e fjalëve  
 ja shumëfishonte sendet,  
 në pejsazhet e historisë hingëllinte  
 kali i Skënderbeut.

Ai qe kalorësi i tij i dytë

Penën e njësoi me shpatën  
 më të fuqishme e kuptimplotë  
 se stemat heraldike.

Alfabetic e shqipes e përfshakur lart  
 zodiak të vetëdijes!

Po tērē jetēn i vinte ndēr mend  
binjaku i vdekur,  
e kērkonte,  
s'e gjente.

Mendonte pēr tē,  
pērfytyronte  
sikur tē qe i gjallē,  
tē thinjej  
duke lēnē pas fēmijē.

Fjala e Naimit nē trupin tonē mbinte-  
pemē e shpresēs.

Te brezat degēt duke hapur.

Te secili nga ne  
qē u bēmē nē kohéra  
binjaku i tij i ringjallur!

Te monumenti i Frasherellive

Kunz  
Kuixtimis i tyre  
Ketin se mazarom

tombarak  
u turren  
tē shindruor nē grifomē !

1974

Moilem Zegz  
n / o ,



**Allaman Hysa**  
**(1927)**

Ka lindur në Libohovë. Për shumë vite u ndoq dhe u persekutua. Punoi në ndërtim. Poezitë e shkruara nëpër vite i mblođhi në "Këngët e dhimbjes". Jeton në ShBA.

### **Tre buste**

**Tre buste** ngrihen në kodrinë,  
për tre vëllezër atdhetarë.  
Ata e deshën Shqipërinë  
pa shtypës dhe pa sundimtarë.

Tre buste bronxi atje rrinë,  
për tre vëllezër mendimtarë.  
Ata urrenin robërinë,  
që kish pllakosur mbi shqiptarë.

Tre buste trimash për njerinë,  
që ngjitet n'kodër për t'i parë.  
Ata na falën diturinë.  
Të tre për ne janë pishtarë.

**Tiranë, 1980**  
**"Këngët e dhimbjeve" Tiranë, 1995, f.44.**

***Fatmir Sulejmani***

## ***Do bëhemë***

***Do bëhemë, po si s'do bëhemë  
edhe ne do piqemi një ditë  
kur t'na përshkojë flaka e Naimit  
Si Migjeni kur të kërkojnë Dritë***

***do bëhemë, të tjerët si u bënë  
jemi më të lashtit n'këto troje  
s'dua t'dijë për katër sytë e fqiut  
lum për delet që pijnë ujë ndër kroje***

***do bëhemë, se ashtu është shkruar  
do t'arrijmë të tjerët me një hap  
po sot na mundojnë do zgiebe t'vjetra  
plus: shprehia e t'ecurit prapë***

***do bëhemë, topi nuk e luan  
se bota bosht tjetër, dihet s'ka  
për inate të fqiut që ec tokës  
ne do të notojmë nëpër "hava"***

***do bëhemë, këtë le ta dijnë  
ata që nuk duan t'flenë si ne  
sa të hyjmë në kor me delezezat  
do t'ia marrim hymnit me bee!, bee!***

***do bëhemë, çka se s'bëri dushku  
dardhat që u desh t'i bëjë parvjet  
më hyp nervat Nëna kur mërzitet:***

-Kur do bëhesh, biri im, MEDET!

do bëhem, kët' e di dhe bot  
dhe na e ka frikën, palca i dridhet  
kur na sheh në BAR me gotat lartë  
tek e hamë gjimadhen kur përdridhet

do bëhem, le të lehë Sokrati  
do t'vashojmë "sefanë" gjer në skaj  
e n'na daltë sërish gjimadhja mashkull  
kem' përvojën e t'shkrehurit n'vaj.

do bëhem, po si s'do bëhem  
edhe ne do piqemi një ditë  
kur t'na përshkojë flaka e Naimit  
si Migjeni kur të kérkojmë DRITE.

(1994)



### ***Valbona Gaçe***

**(1968)**

*Ka lindur në Llakatund të Vlorës. Ka botuar vëllimin poetik: "E pafajshme". Vazhdon studimet në Universitetin e Tiranës, Dega Gjuhë-Letërsi.*

### ***Naim Frashëri***

Këtë mbrëmjevere në Frashër  
recitoj vargje nga Naimi...  
Më duket në qellin e pastër  
se shpirti i tij shkrihet si qiriri!

***"E pafajshme", Tiranë, 1994, f.17***



## ***Albert Abazi***

**1950**

*Ka lindur në Tërbaç të Vlorës. Ka mbaruar studimet ushtareke dhe shërbën nërradhët e ushtrisë. Ka botuar vëllimet poetike: "Stina e vajzave" dhe "Natë me hënë"*

## ***Në Sarandë me Naimin***

Mbrëmja e Verës, në Sarandë  
ngjyrë jargavani bie,  
s'di pse në buzët e mia  
çelin vargje poezie

Vala që më vjen tek këmbët  
sjell muzikë perëndimi,  
tek shtëpiza buzë detit  
flasin vargjet e Naimit.

Në shkëmb, mbi dallgë deti,  
është Homeri i vendit tim...  
Ndër vite këndon Atdheut  
muze e të madhit Naim...

***"Stina e vajzave", Tirana 1994***



### **Sazan Goliku**

(1942)

Është emri letrar i Pandeli Koçit. Ka lindur në Vlorë në një familje të ardhur nga Tepelena. Ka mbaruar Degën e Gjuhë-Letërsi Shqipe në Tiranë. Ka punuar si mësues, punonjës kulture, gazetar dhe redaktor letrar në Shtëpinë Botuese "Naim Frashëri". Prej viti 1970 është marrë në mënyrë të veçantë me përzgjedhjen dhe redaktimin e librave nga letërsia shqiptare e botuar në Kosovë e Maqedoni dhe ka ligjëruar pjesë të kësaj letërsie në Universitetin e Tiranës. Nga viti 1981 punon në sektorin e shtypit në Kuvendin Popullor. Ka disa vëllime me poezi dhe prozë.

### **Akrostik**

Nuk di kush jam,  
**A** jam a s'jam  
**I** humbur mes njerëzve  
**Mekam.**

**F**al teje Qiri pash veten Njeri  
**R**rugën pas Fyellit e gjeta...  
**A**tje njoha veten me emër e nder  
**S**hqiptar me rrënje në tokë e në qiell.  
**E**shtë mjaltë është dritë ky emër i tij  
**R**ilind si fjala Liri  
**I**shenjtë nuk është, mirësi veç ndjell.

1989

"Njëqind poet për Naimin" 1995, f. 164

## Në Frashërin e Naimit

**E**rdhëm mbushur mall,  
që nga larg këtu!  
Frashëri i Naimit  
nën qiellin blu.

Na ngjan e dëgjojmë,  
nga çdo zë në fletë,  
ku vallë ta shikosh  
Qiririn që u tret?!

E takojmë ndër lisa  
në zogj e korie...  
-Tungjatjeta, themi,-  
kopshtar poezie!

**“Lumi im s’fle gjumë”, Tiranë  
1995**



### **Bardhosh Gaçe (1953)**

Ka lindur në Tërbaç të Vlorës. Kreu gjimnazin në Selenicë, Fakultetin Histori Filologji, Dega Gjuhë-Letërsi Tiranë. Ka punuar për dy vjet mësues në rrëthin e Kukësit. Pastaj punoi për një kohë të gjatë në aksionet e rinisë në Hekurudhën Laç-Hani Hotit, Fier Vlorë. Gjatë vitit 1987-1992 ka qenë shef i kulturës në rrëthin e Vlorës. Është kryetar i shoqatës patriotike kulturore "Ismail Qemali". Përveç krijimtarisë poetike është marrë dhe me studime folklorike. Ka botuar: "Dëshira e Anilës", "Xha Selimi i Bratit", "Kënga popullore e Selim Hasanit", "Vogëlushet e Tërbaçit" etj.



### Vasil Dilo

*Ka lindur në Gjirokastër. Mbaroi shkollën e lartë për aktor dhe ka lojtur në teatrin "Zihni Sako" të qytetit. Njëkohësisht merret dhe me krijimtari poetike. Ka botuar vëllimet poetike: "Mikpritja", dhe së fundi ka nxjerrë në shqip dhe në greqisht librin "Shenjtë im"*

## Përkulje e Thellë

(*Naim Frashërit*)

**N**ga Frashëri në Janinë  
e nga Janina në Frashër  
sa herë me vëllezërit kaloje  
mes maleve të lartë e lisave të gjatë  
Nuk mund të fantazoje  
se pas një shekulli, grupe atdhetarësh  
këtë rrugë do ta rrihnin shpesh  
jo për të studiuar në gjimnazin "Zosimea"  
po me ngulm për të kërkuar  
një punë të thjeshtë...

Ca nga ndjenja e astinomisë  
ca nga ankthi i pasigurisë  
Duke mos patur mundësi  
të ulin një buqetë me lule malore  
me mirënjoyje atdhetare të mbështjellë...  
Te shkolla ku ke mësuar  
ata, një vështrim të gjatë  
kuqtimplate të përcjellin  
një përkulje të thellë.

*Janinë, maj 1992.*

*"Shenjtë im", Athinë, 1996, f.58*

***Arben Kondi***

## ***Para një biliboteke***

**B**allë bibliotekës tënde  
Si para një thesari,  
Befasohesh.

Shumëkatëshe. Me rrimeso arre.  
Ku një shkallëz e vogël  
Me rrotëza lëviz si lodër.

Kapakë luksozë. Blu, rozë  
Emra të huaj sipër  
Mordenistë e realistë.

Po sytë shpejt humbin  
shkëlqimin  
E si mund të ndrijnë bebzat,  
Kur aty mungon Naimi, Migjeni!

***“Takim dashurie!”, Tirana 1995,***  
***f.58***

***Nase Jani*  
1947**

Lindi në Stegopull të Lunxhërisë në rrithin e Gjirokastrës. Ka mbaruar shkollën e lartë për oficer dhe ka shërbyer për shumë vite në Berat. Banon në Sarandë. Ka bashkëpunuar për shumë kohë me organet e shtypit letrar dhe atij ushtarak. Ka botuar përmblehdhjet poetike "Po, nesër" dhe "Unë dhe ti".

***Naim Frashëri***

**U**dogj një jetë,  
shpirti i madh i poetit.  
Gjithë netët: për qiejt.  
Gjithë ditët: për njerëzit.

\* \* \*

Gjithë lulet e botës,  
I shpiku poeti.  
Me lule gjallohet.  
Mbi lule të vdesi.

"Po nesër?", Berat 1995.

## **Naim ta vodha lindjen tënde**

*-I lindur edhe unë më 25 maj,  
101 vjet pas Poetit-*

Naim ta vodha lindjen tënde.

Tek lindja jote unë u linda.

Îjosa më tha vjershat e tua

Piva në Vjosë dhe u mbyta.

U mbyta dhe jetoj i mbytur.

Kollitem tek kolla jote.

Në ngopje mbeta i uritur,

Shpirti është këngë, me këngë s'ngopet...

Sarandë, nëntor '95

"Unë dhe ti", Berat 1996.

***Skënder Blokaj******Brenga e Naimit***

Në oborr të shkollës në një skutë  
 Rri i menduar Naimi i urtë;  
 Fëmijët me top, poeti i mvrenjtur  
 Jam në dheun tim a diku i tretur?!

Hidhet topi, vocërrit mes veti  
 Shtyhen, thirren-mua çka më gjeti,  
 Asnjë emër s'më del shqiptarë  
 Ja shqipen flitka botë mbarë!

Në dhe të arbërit je o i miri,  
 Që ndrite e u dogje si qiriri,  
 Kështu Europës i jemi afruar,  
 Gëzohu pra, mos rri i menduar!

Or fjalarti ynë i mirë,  
 Në zinxhir a gjysmë të lirë  
 vargjet e tua, bukë e lotë  
 Kem' përtypur gjer më sot:

Që Shqipëria na jep nderë,  
 Që është mëma jonë me vlerë;  
 Thoje "Shqipëri pse s'qe e zonja  
 Të bënje tri- katër shkronja..."

Sikur të paskëshe shkruar  
 Gjësendi s'të ish harruar,  
 Do të kishimë Pllatonë,  
 Aristotel e Strabonë.  
 Omir, Pindar e Esqillë,  
 Dant'e Senek e Virgjillë.  
 Do të ish sot Shqipëria  
 Që t'i mir botën zilia"

Vendi ynë kësi emrash plot  
 Dhe bota zili na e ka sot.  
 Në daç godite, në daç queshe,  
 Del se vendi u bë siç deshe.

Ngryset një fytyrë e bëhet burg,  
 Faqesh lotët i rrjedhin çurg  
 Emri e gjuha shenjë e parë  
 Të dallojnë që je shqiptar.

Për nga emrat në Shqipëri  
 Koha juaj del gati Azi;  
 E fjalët tua kush s'i kujton  
 Që dita jonë lind nga perëndon.

Mos gjyko për emrat tonë,  
 Qoftë larg jush koha jonë,  
 Në robëri, pa shkollë e shtet,  
 Tash i kemi qe njëqind vjet.

Shoh Shqipëria u bë e zonja,  
 Bëri libra, bëri shkronja  
 Të qytetërimit rrugë ka marrë  
 Po emrash s'i njeh si shqiptarë.

Arbërit kreun zenkan në planet  
 Me mish-mash të emrave të vet,  
 Porositë që tanët kanë lënë  
 Duket se prapthi qenkan zenë.

S'ka dobi të këqyrim mbrapa,  
 Shih, pra ne kemi bërë hapa,  
 E me emra bote kur pagëzojmë  
 Zhele të shpirtit sikur mbulojmë.

U përpoqa të bëj pak dritë  
 E drita vlen kush i ka sytë,  
 ...Po të shkuarat i lerë  
 E mëso ment për tjatër herë!"



## ***Basir Bushkashi***

**1953**

*Ka lindur në Mallunxës të Matit. Studimet e larta për Gjuh-Letërsi i kreua në Tiranë. Prej vitesh ka punuar arsimtar. Ka botuar vëlimet poetike "Kur nisin udhët. "Ditët duan këngë", si dhe mjaft shkrime publicistike. Jeton në Burrel.*

## ***Djegur nëpër vite***

***Naim Frashërit***

**D**jegur nëpër vite për një fjalë, një varg Flinte a nuk flinte me shpirtin tërë plagë Eh, sa halle e brenga i thernin tek gjiri Dufin derdhë vargjeve me një zë bilbili Rrugëve të Stambollit çapitej ngadalë Nën një kollë gërryes pëshpëristë fjalë Dhe rënkonte thellë për Atdheun e largë Për fushat, për malet, për lisat e gjatë Dhe tundte krahët madhërişhëm frymëzimi “Lum kush të rrojë”, ngazëllehej Naimi Dhe kokën e ngrinte e bëhej erë...  
“Ti Shqipëri më ep nderë...”  
Djegur nëpër vite nga malli i zjarrtë Dora pa fuqi heshti përmbi kartë...  
Dhembshuri mbylli sytë, dy pikë loti ranë Qenë vargjet e fundit që të plotë s'u thanë...  
Djegur nëpër vite u tret si qiriri Dritë e flakës tij na shkreptin tek syri...

**- Botohet për herë të parë -**



## ***Martin Cukalla***

(1943)

*Ka lindur në Progonat. Përfundoi studimet e larta për inxhinieri miniere në Universitetin e Tiranës. Në vitin 1966. Ka punuar në minierat Memaliaj, Bulqizë e Spaç. Tani punon në Institutin e Minierave dhe mban titullin "Doktor i Shkencave". Ka botuar herë pas herë qysh nga viti 1964 në shtypin letrar cikël vjershash dhe poema. Në vitin 1995 botoi përbledhjen "Paguaj yjet".*

## ***Naimi***

**F**rashërlli je kënga e parë  
dhe e ashpër, dhe e rrallë,  
dhe si flakë dhe si akull,  
dhe si hon dhe majëpërflakur.  
Si një lot!

Stambollin në shpinë e kishe,  
Nër këmbë mërmërit Bosfori  
Syri Shqipëri të ndriste  
Gjallë si diell!

Kënga klithmë e zemrës tënde  
Shqipëri! thërrit si dhimbje  
Shqipëri thërrit si shpresë  
Besa, besë!

Si dhe shpatë e Skënderbeut  
Që rend marrëzisht nér shekuj  
(Rend e rend, rend i paqetë)  
Edhe shqipja e këngës tënde  
Oshëtin e i shkund vendet

Dhe zgjon ritmet e Lirisë  
(Si zë që rëngon nga retë)  
Cep më cep të Ilirisë.  
Kënga-klithmë e zemrës tënde  
Shqipëri! thërret si dhëmbje  
Shqipëri! Prerë në besë  
Shqipëri! Bërë copë-copa  
Kënga-klithmë e zemrës tënde!

Edhe shqipja e këngës tënde  
Qëmtuar nëpër zjarre zemre  
Zemre zjarr të përvëluar  
Derdhet t'hu pér t'na pushtuar  
Si një det,  
Si Mot i Madh!

- **Botohet pér herë të parë** -

## **Mumin Zeqiri**

(1950)

*Ka lindur në fshatin Llojan rrethi i Kumanovës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen në Preshevë, ndërsa fakultetin filozofik për gjuhë dhe letërsi shqipe e kreu në Universitetin e Kosovës në Prishtinë. Është mbledhës dhe studjues i folklorit. Ka botuar vëllimin poetik. Jeton në vendlindje, qëkur u largua me dhunë nga proçesi mësimor në Kosovë.*

## **Një fjalë dashurie për poetin**

*-Naim Frashërit në 150 vjetorin e lindjes-*

etje ka poeti  
dhe në amshim ka etje  
nëpër plasat e çatisë së shekullit  
shtegton si kalorës me hesht lapsi

në oborr sulltanati të mykur  
që e han virus morti  
udhton e venitet  
plagës mëmëdheut  
errësirë ferri  
bredhje  
ndrin mbi regiment pene  
/strumbullar Ringjallje Kombëtare  
shend drite në pirlgator  
erupcion popullor  
shkapërdredh kristal mendje  
shelbon pergamene ardhmërie  
e dashurie persekutohet  
mbi pllaja shtrinë shtrat shkronjash  
mbi gjak  
arqitekt vizionesh  
legjendë madhështie  
që frymon ndër breza  
dinjitet fisi  
supesh ngarkuar mëmëdhen  
dyer mendje të etur  
rrin hapur  
në kujdestari  
si legion roje.

- **Botohet për herë të parë-**

## **Novruz Dervishaj**

**(1936)**

*Ka lindur në Ramicë të Vlorës. Mbası mbaroi shkollën e lartë të oficerave shërbeu për shumë vite në radhët e ushtrisë në disa në garnizonet më të largëta, ku kreu detyra të rëndësishme ushtarake. Ka botuar vëllimin poetik "Meloditë e vendlindjes".*



### **Vite të asaj kohe...**

**V**ite në skamje, prapë pa darkë.  
“Mbështete kokën, biri im,  
të flemë nën tëndë bashkë,  
të të ngroh në sharkun tim!”

Babai më fliste në ato vite,  
rruthte ballin mes thëllimit,  
bënte ç'bënte më tregonte  
ca nga vargjet e Naimit.

Dhe vargje bukur ligjëronte  
për kodra, ara, trimëri,  
me mua veç ëndërronte  
për një këngë,  
një ledh are  
e një shtëpi...

**“Meloditë e vendlindjes”, f. 3.**



### **Ali Podrimja**

(1942)

Ka lindur në Gjakovë. Shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në vendlindje ndërsa studimet e larta i kreu në Degen Gjuhë-Letërsi Shqipe në Prishtinë. Ka punuar në të përditshmen "Rilindja" si dhe redaktor në ndërmarrjen botuese "Rilindja". Është autor i një sërë vëllimesh poetike të cilat janë përkthyer dhe në gjuhë të huaj dhe vlerësuar me çmime të ndryshme.

### **Hapja e një poezie në kohë trishtimi**

F.

**N**a përzunë nga qyteti

Taverna hotele porta na mbyllën

Na ndoqën forca të blinduara policia sekrete

Tjetërku kërkojeni fatin thanë

U përbiruam nëpër sytë ëndërrues të Naim

Frashërit

Malit të borërave i ramë poshtëlartë

Me shpirtin tënd unë në shuplakë

Ti me fyellin magjik

Askund kasollë e perëndive të Sharrit

Pas shumë vitesh nuk di cila kohë a perandori  
ishte

Na gjetën në një poezi inxhi

Dhe na thyen dritare kulme heshta

Njeri tjetrin tani shikojmë atje në sfond të zenë  
nga objektivi vezullues i Marubit

Dhe dëgjojmë shiun

Si na zgjon nga harrimi trishtues.



## *I dashuri Naim...*

**Kur** isha i vogël,  
dy pëllëmbë e pak,  
im at'një gështenjë,  
preu me merak.

Nga gjith' trungu mori,  
ç'i duhej për vete,  
aq sa mund të bënte,  
për mua një djepë.

Kur e bëri gati,  
për të tundur djepin,  
te koka i gdhendi,  
Naimit portretin.

Nëna ime Zoge,  
kur më ipte gji,  
ç'kishte bërë për mua,  
një ninull flori.

Eh, ç'qe ajo ninull,  
që më thoshte Zoga:  
“M'u rritsh bir' i nënës,  
me flori te koka!...

## *Arben Duka*

(1957)

*Ka lindur në Labovë të Odries në Gjirokastër. Mbaroi shkollën e lartë të oficerëve në, si dhe Degën Gjuhë-Letërsi Shqipe në Universitetin "Aleksandër Xhuvani", Elbasan. Për shumë vite ka shërbyer në radhët e ushtrisë. Ka botuar vëllimet poetik: "Nektari i këngëve", "Njëmijë puthje", "E bardha dhe e zeza", "Sytë e pranverës". Eshtë autor i dhjetra tekstesh këngësh që janë nderuar me çmime të para në festivalë kombëtare.*

Vitet shpejt kaluan,  
si një fllad i lehtë,  
pak nga pak fillova, të këndoja vetë  
Atë nina-nana,  
që më thoshte nëna,  
deshë ta kuptoja,  
si ma deshte zemra.

Floriri i rrallë,  
te jasteku im,  
s'mund të ishte, veç  
i madhi Naim!...

Prap'kaluan vitet,  
si një fllad i lehtë,  
nisa ndonjë këngë,  
të thurrja dhe vetë.

Ç'u mundova shumë,  
sa që unë e di  
t'i vidhja Naimit,  
sadopak flori.

Naim zemërmadhi,  
thesarin ç'ma hapi,  
m'i hodhi në dorë,  
gjith'florinjtë që pati.

E, moj nënë shpirti, *møj nene shpirti,*  
Naimi ç'më bëri, *Naimi ç'më bëri,*  
nga ai u vesha, *Nga ai u vesha,*  
me flori i tëri. *Me flori i tëri...*

1987.



## *Bibila Si Naimi*

*-Letrarëve të vegjël*

*M*e ç'zogj m'i çoni këto letra,  
që vijnë sikur kanë krah'  
që mbajnë brenda: vargje, shpresa  
edhe plot èndrra të mëdha?

Në vjershat tuaja të thjeshta  
këndoja në tërë zogjtë e pyllit  
dhe çelin nëpër fjalë e rreshta  
të gjitha lulet që ka prilli.

Dhe shoh pas fjalës e pas rreshtit  
një èndërr porsi ju të bukur,  
edhe shkëndijën e poetit,  
që krahët nis e rreh si flutur!


Ju do të bëheni poetë,  
do t'ju burojë frymëzimi...  
U bëfshi miqtë e mi të vegjël  
bilbila si Naimit!



## *Odhise Grillo*

(1933)

Lindi në Vuno të Himarës. Ka kryer studimet për gjuhë letërsi në Universitetin e Tiranës si dhe studimet për gazetari. Ka punuar si mësues, gazetar dhe redaktor në organet e ndryshme të shtypit dhe në Shtëpinë Botuese "Naim Frashëri". Është një nga autorët më prodhimtarë për letërsinë përfëmijë. Nga vitit 1955, kur boton vëllimin e parë "Shtatë ngjyrat" dhe deri në ditët tona me dhjetra janë vëllimet e tij me poezi, poema, përralla, në vargje si dhe ka bërë shumë përshtatje të veprave të rëndësishme nga letërsia shqipe dhe e huaj për moshën e fëmijëve. Veprat e tij është nderuar disa herë me çmime të ndryshme. Jeton në Tiranë.



## **Pano Koço Taçi 1929**

*Lindur në Gjirokastër. Shkollën fillore e ka kryer në qytetin e lindjes, të mesmen në Tiranë. Ka marë pjesë në Luftën Nacional*

*Çl. si partizan i inkudruar në Brig. 23S. Kalvari i vuajtjeve ka filluar që më 1946 duke e ndjekur herë pas here me 24 vjet burg e internim. Më 1994 boton vëllimin "Blerimi..." me poezi të shkruara nga viti 1946 deri në 1994.*

*Shkruan drama, librete baleti, dhe disponon një ditar me bashkëbisedime me personalitetet e shquara të fushës letrave.*

## **Apostullit tim**

*- Naim Frashërit -*

**Sh**pirt i dlirë, tungjatjeta.  
Tempull që koha s'të tret.  
Unë Ty idhtar të mbeta.  
Amator e ca poet.

Vështroj tej edhe përhumb nëpër tis të poezisë.  
Ti më rri si një pëllumb në altarin e mirsisë.

Mar lexoj Ungjillin tënd  
thyej gjunjët mëkatar,  
edhe ndjej se përnjimend  
pastrohem e vishem n'ar.

Brenda vehtes ndjej një himn.  
Të Qiriut tënd bej rit.  
Ç'terr që kam, o shejt Naim:  
fjala tënde ma bën dritë.

Në ëndra na feks e ndizet  
toka amë si ç'qe një herë.  
Presim ne sërisht të ngjizet,  
katër copash na kan' prerë.

Mbi lëkurën tonë  
bota bëri tregëtinë.  
Katër copash e shtrim hapin  
duke klithur për lirinë;  
o i shejti yn'NAIM.

*- Botohet për herë të parë -*

## Trokitje në mesnatë

**M**bi sup dikur m'ulej pëllumbi  
e sot një korrb vjen e më rri,  
ka kohë që më humbi gjumi,  
me shpirtra flas e natën gdhij.

Naimi më troket në derë  
me Statusin e Pafajsisë:

- Ndihamomë, - më thotë, - letrat me vlerë,  
ku t'ia këmbejmë Abaz Alisë?

Vetvaret hëna mbi një blir,  
troket një fllad, me flet një zë.  
Shikoj De Radën; i them: - Hyrë...  
Po Milosane ku ma le?

Më bëhet se Serembja vjen;  
Kërkon Atë se mos ia pamë.  
- Binjak me ty në dert, - i them -  
të bëhem shok, t'i gjejmë ku janë.

Rrufe zhgjetare Oso Kuka,  
në derë ia beh si dallgë deti.  
Më thotë: - Helm t'u bëftë buka,  
ne se s'ia gjejmë eshtrat poetit.

Korbin e Poes, Imzot Nol,  
si ta përze, qafe ta heq?  
- Ç'bëhet këtu? - më thotë, - Folë!  
Ungjillin shqip Juda ma ndreq?

Me konen pas zoti Lazgush  
me qaset tek vallzoj yjxitë.  
Më ulet shesh gotën ma mbush  
me ambrozi nga poezitë...

Mbi sup dikur m'ulej pëllumbi;  
e sot një korb vjen e më rri.  
Ka kohë që më humbi gjumi,  
me shpirtra flas e natën gdhij.



## **Kalosh Çeliku**

*[ 1951 ]*

*Ka lindur në fshatin Cërvicë të Kërçovës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje dhe Strellcë, ndërsa shkollën e mesme - normale në Shkup. Studimet e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe i ndoqi në Fakultetin Filozofik në Universitetin e Prishtinës. Vjershat e para i shkroi dhe i batoi që në bankat e shkollës fillore. Është fitues i disa çmimeve letrare për poezi, tregime dhe pjesë teatrore. Ka botuar shumë veprat letrare: Punoi vite me radhë në arsim. Në fillim në Glogovc të Drenicës e më vonë në malësinë e Shkupit (15vjet), ku pas ndjekjeve dhe presioneve të papara deri më sot, në shenjë proteste e lëshon përgjithmonë arsimin. Që nga viti 1995 punon dhe jeton si shkrimtar me profesion të lirë në Shkup.*

## **Zjarr flakë shpuzë e dritë**

**Eci** me vdekjen e kurrë në varr  
matanë bregut më mbeti Laura  
një barkë e gëlltiti liqeni plumb.

Vdisni yje se më varën për këngë  
pasardhësi i Naim Frashërit ndezi  
zjarr me vargje.

Zemër,  
pasardhësi i Naim Frashërit  
ndezi shtratin e thatë...



## Skënder Sherifi (1954)

Lindi në Viti Kosovë. Që prej më shumë se katër dekadash jeton në Bruksel. Ka punuar si gazetar i radiove dhe i shtypit bleg (për sektorin e kulturës e artit) dhe si profesor i gjuhës dhe letërsisë frëngjishtë e i marrëdhënieve publike. Ka botuar në Paris dy vëllime poetike "Diku, dikush" dhe "Oksigjeni". Ka përkthyer në frëngjisht një antologji të poesisë shqiptare në ish-Jugosllavi me titull "Dega e pikëlluar". Libri "Ora e meteorëve" është botuar në Shqipëri në vitin 1995.

## Vëllezërit Frashëri

**Vëllezërit Frashëri thyenë mitologjinë shekullore  
Duke ecur në kalë maleve e pllajave shqiptare**

Sa rëndë shkel koha në këtë jetë lavire...  
Ata krijonin me djersë dhe me gjak të tyre  
Një alfabet, një art, një kulturë, një zemër  
Duke zgjuar popullin e zhystur në èndërr  
Me heroizëm ruajtën rrëth tryezave rrumbullake  
Malet që rrinin e vinin nga një kohë e largët  
Balenat janë të pangishme në këtë botë lavire...  
Ata do ta shpëtojnë trashëgiminë e Skënderbeut  
Duke ia treguar popullit thesarin e këtij dheu  
Vështirë e ka tigri të ringjallë njeriun  
Tradita nuk të kujtonte Parisin e Romën  
Vëllezërit Frashëri lanë peng jetën  
Duke krijuar aq sa mundnin një të tyre atdhe

"Ora e meteorëve", Tiranë, (Globus R.), 1995, f.70.



### *Ramadan Sinani*

Ka lindur në Tetovë. Studimet e larta në Beograd dhe pasuniveritaret në Fakultetin Filologjik të Prishtinës ku magistroi në degën e letërsisë. Prej vitit 1995-96 punon në Gjimnazin e Tetovës dhe njëherësh merret me veprimitari shoqërore, letrare, botuese. Ka çelur Shtëpinë Botuese "F. Konica" éshtë botues i revistës "Vlera" si dhe ka botuar vëllimet poetikë: "Kavallete e Sharit" dhe "Emblemë ilirie"

### *Pa një dritë*

-Naim Frashërit -

**P**orosi e Madhe

Në Kosovë

Nga Qiriri

Prodhon lot

Kombi

Mendja zbardhëlloi

Me imazhe Mëmëdheu Naimi

Si mund të diheshin të gjitha o Rexhep  
Pa një dritë.

"*Emblemë Ilirie*" (Tetovë), 1995, f.29.

## ***Idajet Jahaj*** **(1949)**

Lindi në Mesaplik të Vlorës. Ka kryer studimet në Institutin Pedagogjik të Shkodrës në vitin 1971 dhe në atë të Gjirokastrës në vitin 1981. Ka punuar si mësues në fshatrat e Mesaplikut. Ka shkruar vazhdimit për pasqyrimin e traditave historike të zonës ku jeton. Ka botuar dy libra: "Zigur Lelo", "Mendimet", "Lumi i Vlorës" si dhe librin "Mësuesit patriot të Lumit të Vlorës" etj.



## ***Panteizmi i Naimit***

Perëndia në çdo lule, në çdo pemë, në çdo bar,  
Tek burimi, tek një rreze, tek filizi në ugar.

Tek njeriu, gjithësia, tek çdo gjë që ndrit në botë,  
Tek çdo qënie e gjallë si në det edhe në tokë.

Ajo është brenda nesh e kudo rrotull n'eter,  
Në çdo grimcë të universit dritë e kaltër frymë merr.

Aty ku shpërthen filizi që nga kokrr' e dheut del,  
Aty uratë e bekuar, shenjtëria zemrën çel.

Është vetë e njëjtësuar ajo rreze me natyrë,  
Me çdo gjë që ka një emër, ka një dritë, një fytyrë.

Dritë e saj në zemrat tonë pluhur jete është shkrirë,  
dhe rreh botën që ta bëjë më të bukur, më të mirë.

Dhe së fundi, në Atdheun tonë të dashur  
Shqipëri.  
Ka një frysme, ka një etje, brënda saj një  
perëndi.

"*Meditimet*", *Tiranë*, 1994, f.65.

## ***Prapë për Naimin***

**N**aimi s'ka vdekje kurrë  
sepse malet vdekje s'kanë;  
E nxorrën nga thelb' i tyre,  
këndo bir, tani, i thanë.  
I dhanë kartën në duar  
edhe fjalëzën e artë,  
Me shpirtin e përvëluar  
këndoi me mallin e zjarrtë.  
U duhej bilbil - Naimi  
maleve kurrise-blertë,  
Ndaj e ngurosën bilbilin  
nëpër lisa monument.  
Malet gjetën tek Naimi  
krehërin e një pasqyre,  
që të krihnin nëpër shekuj  
flokët e gjelbër të tyre...

1968

"*Hujnore*", *Tiranë*, 1996.

## *Qiriri s'është shuar*

Në kodrën kupore mbi pllaj  
 Një ditë kur dielli sa leu  
 Çajupi më bëri të qaj  
 Për bilbilin që këngën e preu.

Syska me kokën mënjanë  
 Vështron te lotët e mi  
 Sikur më thoshte: pse qan?!  
 Ç'thonë ato vargje mavi?

Shijoje këngën e zogjve  
 Dëgjo: u ndez gjelbërimi  
 Përzier me zile, këmbore  
 Po dirigjon vet Naimi.

Shqerka që loz mbi kodrinë  
 Flutur larushe e lehtë  
 Duket e ndjen melodinë  
 Dhe "mikun" me valle e pret.

Pa lidhi sytë përmbi ilqe  
 Vështroje atë turtulleshë  
 Ashtu e lëmuar, nazike  
 S'të duket si një mbretëreshë?!

Po lulet poshtë tek burimi  
 Ku rritet i bollshëm bostani  
 S'dukan sikur vetë Naimi  
 Ka sjellë një qylym nga Irani?



***Qerim Skënderi***  
*(1948)*

Lindi në Mallakastër. Ka mbaruar arsimin e lartë ushtarak në dhjetor 1969. Është autor i vëllimeve poetike: "Me gotë pikëllimin", "Mendimet më çmenden", "Qielli në pikën e lotit".

Tretë vështrimin përtej  
Në pyllin e mbushur me dushk  
Ai lis që matet me qiej  
Ngjason apo jo me një krushk?!

Puhiza që ndihet mes malesh  
Thellë ku rrëzohet ujvara  
Rrënqeth si fllad shtojzavallesh  
Kur shkundin ondet e bardha.

E pra Qiriri s'është shuar  
Jo, bukuria nuk vdes  
Kur lulet i prek me duar  
Naimit i thua: "Mirmëngjez!..."

**Shtator 1996**

**- Botohet për herë të parë -**

## *Zhaneta Ogranaja*

(1943)

Ka lindur në Korçë. Ka mbaruar Fakultetin Histori-Filologji dega gjuhë-letërsi në Universitetin e Tiranës. Për pikpamjet e saj disidente kaloi shumë vite persekutime dhe internime. Ka botuar disa cikle poetike brenda dhe jashtë vendit. Jeton në Tiranë.



## *Naim Frashëri tek unë!*

**F**illimisht, në vargjet e mijë...  
Për gjithshka imitova Naimin si tim Zonë.  
Kështu shtigjeve nisi rrugë poezia,  
Portreti i Tij për mua - Ikonë.

Pikërisht kësisoj në këto anë  
Motivi i tij, ku dot nuk u fut  
Me "Lulet e verës" e kisha atë pranë  
Me "Qiririn" dritë më bën çdo minut.

"Bagëti e bujqësi" me krenari më mbushi,  
Për Shqipërinë, për emrin shqiptar.  
Pikërisht për këtë e dua si askurkushi,  
Paçka se me sy dot nuk e kam parë.

Për Naimin shpirti mall më ndjell  
Ashtu si ndjeu ai n'Turqi për këto vise,  
Si frysë ëmbëlsie në vargun tim vjen  
Dhe fjalë e yjeve zjarr në varg më ndizet.



*Jaho Margjeka*

(1961)

Ka lindur në fshatin Bujan të Tropojës. Shkollën tetëvjeçare e kreu në vendlindje, të mesmen në Kuçovë. Studimet e larta për gjuhë-letërsi shqipe i kreu në Universitetin "Luigj Gurakuqi" të Shkodrës, në vitin 1989. Prej kësaj kohe punoi mësues letërsie në shkollën e mesme në Llugaj të Tropojës. Prej vitit 1993 është gazetar në Radiotelevionin Shqiptar.

*Në një orë mësimi  
me Naimin...*

**L**indita<sup>1)</sup> po flet për "Bagëtinë e bujqësinë" ...  
Unë deles poezi po i grah' në rudinë,  
Rrugës së bjeshkës po dëgjoj kaherë...  
"Ti Shqipëri më ep' nderë" ...

Më fal profesor, të lutem... isha me Naimin...

Shkodër, 1984.

*Botohet për herë të parë*

*1,2,3,4,5) - bashkëstudentë të kursit*

## *O bilbili i Dangëllisë!*

**K**ëtë mbrëmje buzë detit  
seç kam rënë në mendime,  
nga Frashëri vjen e ulet  
në Vlorë-zogu i zemrës sime.

Naimi Veshur me dritë  
që u dogj për Mëmëdhenë,  
zog i plagosur në erë  
këngën kurrë s'e ka prerë.

Dhe në vatra Labërie  
derdhi zjarrin tërë muzë,  
nëpër shkolla tek fëmijët  
vargu yt u rri në buzë...!

O bilbil i Dangëllisë  
vargu im çeli me këngë,  
në pyllin e poezisë  
si lis na qëndron më këmbël!

- *Botohet për herë të parë -*



**Hiqmet  
Mehmetaj**  
(1943)

*Ka lindur në Drashovicë të Vlorës. Kreu mësimet në Shkollën Pedagogjike "Luigj Gurakuqi" Elbasan më 1967. Mbaroi studimet në Institutin e Lartë Pedagogjik, Dega Gjuhë - Letërsi, Shkodër më 1975. Nga viti 1961-1993 ka punuar mësues dhe drejtore shkolle në vendlindje - Drashovicë. Ka botuar vëllimin poetik "Shqipëri përse s'ë zë gjumi"*



## Ferhat Çakerni

(1929)

Ka lindur në Vlorë dhe banon po në vendlindje. Prej vitit 1960 firma e tij del në gazeta dhe revista si dhe në 24 librat e botuara prej tij. Ai është disa herë fitues i çmimeve në konkurse lokale.

## Qiriri i Naimit

Qiriri i Naimit u dogj,  
por lindi në çast përsëri,  
në shekuj me pakëz dritë,  
ndriçon nënën Shqipëri!...

**Paskal Zoto**  
**(1936)**

*Ka lindur në Grabovë të Përmetit  
 Mbaroi ,shkollën e mesme pedagogjike,  
 ,me korrespondecë Fakultetin Histori-  
 Filologji Dega Gjuhë-Letërsi Shqipe të  
 Universitetit të Shkodrës. Ka punuar  
 mësues 30 ujet deri sa doli në pension.  
 Është nderuar me medaljen "Naim  
 Frashëri. Ka botuar herë pas here poezi.*



**Naimi u shkrua në zemra**

**Një** komision akademik  
 Për dhënie titujsh e grada shkencore,  
 Shtangu si i ngrirë një ditë  
 Për një harresë që s'duhej të harrohej

Në ballë të titujve "Mësues i popullit"  
 Emri i Naimit mungonte.  
 Ndërsa Ai nga Pantheon  
 Porsi një diell ndriçonte.

-Gafë e madhe, - tha një profesor.  
 -Çfarë mo? - S'bëhet qameti - tha një tjetër

Kishte të drejtë. E ç'nevojë ka Naimi për tituj  
 Kur gjithë Shqipëria e ka futur në zemër

## *Nuri i poetit*

**M**jaltë e balsam  
A ç'je ti?  
Ky hyri në zemër  
te çdo njeri.

Kush të bëri ty  
Kaq të ëmbël, vallë?  
Mos gjuha shqipe  
Që rrjedh si ujëvarë?

Mos shpirti yt  
Si Qiriri shkrirë,  
Mos mendimi yt  
Që bredh Shqipërinë?

Që të gjitha bashkë  
Ngizur në flamur  
Burojnë prej teje  
Dashuri e nur.

Nur e dashuri  
Qëndrojnë kurorë  
Mbi lisat e gjatë,  
Mbi malet me borë.

Te çdo gjë shqiptare,  
Ndrit ti, Naim,  
Si hëna e plot,  
Si diell në prill.

***Botohet për herë të parë***

## Arian Kadiu

Lindi në qytetin e Peshkopisë. Ka mbaruar Universitetin e Tiranës, degën e gjuhë-letërsisë shqipe dhe një kurs pasuniversitar për pedagogji-psikologji.

Ka punuar si mësues, gazetar dhe tanjronjës shkencor në Institutin e Studimeve Pedagogjike, me gradën Doktor i Shkencave. Është autor i disa librave me tregime si: "Takimi i parë", "Pse dridhej harku i violinës", "Një ndodhi në det", "Pendimi i arushit pa bisht" dhe "Qyteti prej rëre dhe pallati i vërtetë".



## Pesha e vatanit

**Ku** janë malet e blerta me pishat shekullore,  
 ku janë krojet e bardha e fushat pjellore,  
 ku janë tufat e grigjat me qingjat si lule  
 që ti, o bilbil, u këndove me pekule.

Edhe në Përmet e në Dibër njëherë janë,  
 se toka e vatani kudo një peshë kanë,  
 me ashkun e shpirtit, oh, si ligjërove ti,  
 zemra t'u dogj për nënën, për Shqipëri.

S'i njohe dibranët e besës e trima Naim,  
 derën çelë Abdyli<sup>1)</sup> atje ku dilte tym,  
 vargjet e tua jehojnë shpatesh deri n'Korab,  
 si n'ujsrat e kristalta e shuajmë etjen prapë.

1)Abdyl Frashëri, vëllai i Naimit, ka shkuar disa herë në Dibër e sidomos në Dibër të Madhe, ku e kanë pritur si mik të nderuar. Ai ka pasur miqësi me Iliaz Pashë Dibrën (Qokun) kryetari i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, sepse i bashkonin idealet kombëtare.



***Abdyl Kraniqi***  
**(1935)**

*Ka lindur në Drenoc të Vlashit në Kosovë. Punuai si mësues historie. Ai se bashku me shokë të tjerë nxori eshtrat e luftëtarit të shqar Azem Galicës nga shpella dhe i rivarrosën me nderimet e duhura. Për ketë akt, ai dhe familja e tij vazhdimisht është ndjekur dhe burgour disa herë nga regjimi shovinist sërb i Beogradit. Ka botuar librin me cikle poezish që përbëjnë një poemë heroike "Shpella"*

## ***Akuzë nga varri***

**Unë jam po Ai-Naimi  
Dij edhe të rënkoj!  
Ku është mesazhi im dhe bekimi;  
Nga varri akuzoj!**

O ju fusha, male me lisa të gjatë  
U këndoja Lisave që nuk u bien gjethet as dimrit  
Nuk i dua ata lisa që gjethet u bien edhe verës  
Edhe këtu por edhe atje përtej Drinit!

Edhe varrin ma betë gropë,  
Kështu kryhet amaneti?  
Vendi im copë-copë,  
Thua u çkërmiq nga tërmeti?

Ku është Kosova?  
Po Çamëria?  
Thika më arriti në asht!

E plotë të jetë Shqipëria!  
Liria s'fitohet nga jashtë

Robëria si shumë ka zgjatë,  
Atdheu im copë-copë  
U kujtoj ditë e natë  
Edhe eshtrat m'u ben gropë!

Deri kur pra, deri kur?  
Populli im mbështetë për mur,  
Të mbytur nga hekuri,  
të rrahur me drur!  
Nuk kushton koka, nuk vlen lëkura!

Edhe emrin e betë varr  
Kur do t'ishit e LAPIDAR

*Nga një i vrarë-ende i pa varrosur*  
*- Abdyl Krasniqi*

**10.10.1996**

*Tiranë*

*Botohet për herë të parë*



### **Flutura Ačka (1966)**

Ka lindur në Elbasan. Ka mbaruar studimet e larta për Statistikë në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tiranës në vitin 1988. Pasi punoi tre vjet në profesion filloi punë si gazetare në gazeten e rrethit të Elbasanit "Fjala e lirë". Tani është redaktore në shtëpinë Botuese "Onufri".

Në gusht të vitit 1993 botoi librin e parë me poezi "Tri vjeshta larg", në shkurt të 1995 "Mure vetmie". "Monopati",

### **Naimit**

**M**errma zemrën,  
në dhet ma shtjerë

Ver', o e bukura Verë!

Se s'më deshën,  
kur desha njëherë

Ver', o e bukura Verë!

*Se s'më deshën,  
kur desha njëherë*

*Ver', o e bukura Verë!*

*Flutura Ačka  
Fjala e lirë*

*7 gershor 1996  
Tetovë*

"Monopati, "Onufri"- Elbasan, 1996, f.64.

## Petraq Kolevica

(1934)

Lindi në Korçë ku mbaroi gjimnazin dhe më 1957 u diplomua inxhinier ndërtimi në Universitetin e Tiranës. Ka punuar për shumë vite si inxhinier akritekt. Ka botuar librin me poezi "Këngë nga koha e keqe", "Lasgushi më ka thënë" (kujtime), si dhe përbledhjet me përkthime: "Demoni" (M. J. Lermontov), "Poezi gjermane dhe austriake", "Poezi japoneze", "Perla nga perlat" dhe "Nektar poetik".



## Naim Frashërit

**F**jalën shqipe të kulluar  
Plot gëzim na fale  
Si të ish gur i latuar  
Shqipen krejt për ta ndërtuar  
Si një katedrale.

"Këngë nga koha e keqe", Tirana, 1994.

### *Teheran... mesnatë...*

Opo, ç'është kjo dritë që ecën  
drejt meje këtë mesnatë?  
... Po afrohet te dritarja  
mu në katin më të lartë...

Një Kandil në formë zambaku,  
një Kandil me dritë të zbehtë...  
...Ja, u ndal tani tek xhami...  
Unë dritaren e çel lehtë.

- O Kandil, po kush të solli  
në këtë natë plot èndërrime?  
Ndjehem vetëm dhe kam mall  
për vajzën... Tiranën time.
- More bir - foli Kandili,  
erdha ca të rri me ty,  
kësaj ane ka poetë  
më të mirë nga ne të dy.

Po... Për ty u ngreçë nga varri  
Vallë, kam lënë pas bilbila?  
Unë jam shpirti i Naim Frashërit  
Dhe... endem ndër tehajyla...



*Riza Latifi*

(1950)

*Ka lindur në Shkodër, ka  
shërbyer si pilot i forcave  
Ushtarake-Ajrore të  
Shqipërisë. shtë autor i  
librave "Lëgjenda e  
zerdelisë", "Kosova e  
fejuara ime", "Ledia në  
një natë me hënë",  
"Golgota shqiptare"  
(përkthim), "Trëndafilë".*

**Faruk Myrtaj**  
1955

Lindi në Selenicë, Vlorë. Është diplomuar për inxhinieri minierash, pas 5 vjetëve si punëtor miniere dhe kryerjes së shërbimit ushtarak. Prej vitit 1989 punon si gazetar. Ka botuar: "Dielli i nëntokës", (poezi), "Njerëz që kam njohur", (tregime), "Rroba e fjalëve gjithnjë ngushtë më rri", (poezi) "Marrëveshje për të jetuar", (tregime), "Përse druhemi nga nacionalizmi", (esse), "Nudo zyrtare", (tregime).



### **Naimi në "faj"!**

Kalëruan maja kohësh, e prapë "....O malet e bukura...!"

Kaq kohë rrodhë, e prapë "... Ju o lumenjtë e gjatë...!"

Përtej maleve e fushave Naim Shqipeëmbëla  
I malluar, i tretur, i shkrirë... atje larg!

Që atje larg bënte dritë e Shqipëria prapë terr  
Nga Bosfori, fosfor e dritë shqipe buronte  
I ngazëllyeri prej ëndrrës, frashërlili u vrer  
I bëri me faj, largësia zbulonente!

A thua nga afër do terrej edhe kënga nga syri  
Nga afër, këtu, romantiku thua do vdiste  
Manushaqe e brishtë, e struktur ndën ferrë  
Afër syrit e dorës së poetit do vyshkej?

Po si kështu, i dashuruar së largu  
 S'guxoi të afrohej, ndjehej ngushtë në të  
 Të vinte, dhimbjet e shpirtit i nisnin  
 Ikur, e malli eshtrën ia zhbën

Po ç'është kështu, me ty Shqipëri?  
 E dashur së largu, afër e ftohtë  
 Naimi ta sillte gjuhën që atje larg  
 E ti as "Eja..." s'i thoshe dot

Vet "qengji manar e linte kopenë"  
 Pas "zëthit të sëmës..." merrte rrugë  
 Po s'guxonte ta gjente, e tretej Qiri  
 E veç si Qiri na mjaftonte këtu!

Nga larg Naimit i dukej e bukur  
 Nga afër shqiptarëve: Manushaqe ndë ferrë  
 O zonjëz e pasur me mungesën e bijve  
 Bëhu një çast e bukur, sa ëndrra e tjerrë!

*Naimi efir, akoma përmallur.  
 Ende marrok, i vdekur në ëndërrt.  
 E ne largohemi nga dheu, që larg  
 Ti ndjejmë që andej vargjet e ëmbëll!*

Naimi efir, akoma përmallur  
 Ende marrok, i vdekur në ëndërr  
 E ne largohemi nga dheu, që larg  
 Ti ndjejmë që andej vargjet e ëmbëll!

- *Botohet për herë të parë* -

## *Visar Zhiti*

Ka lindur në Lushnje. Shkollën e lartë Institutim Pedagogjik e kreua në Shkodër. Punoi për disa vjet mësues në Kukës. U dënuar me 10 vjet burg për bindjet e tija politike kundër pushtetit monist. Ka botuar vëllimet potike "Kujtesa ajrit", "Hedh një kafkë te këmbët tuaja", "Mbjellja e vetëtimave", "Dyert e gjalla", "Këmba e Davidit". Veprat e tij janë vlerësuar me çmime si brenda dhe jashtë vendit. Është deputet në Kuvendin Popullor, njëkohësisht atashe kulturor i RSh në Ambasadën Shqiptare në Romë



Grafikë nga  
Ibrahim Kodra

## *Bariu i poezisë*

Naimi-bari

kopenë e madhe të deleve  
të poeziave të veta

kullot nëpër bregoret bukuroshe të ardhmërisë.  
Kullojnë yjet mjaltë dhe magjepsja  
avitet si drithamt

e dashurisë.

Çasti bëhet fyell

(me vrimat e piklave diellore dhe  
shirave)

që kërkon buzt e bardit- bari  
Zilet e zemrave kumbojnë  
jashtë kraharorit të ditëve

ndërsa Naimi bëhet me flatra

dhe shndërrrohet në Shqipëri

N. F.

Ndau Nadein Naau  
 Ng Ndazi Ndajant  
 Néper Néntaka Ndogi Némén

Nuset. Nisen Nina-nuat  
 Ngjetheni Nga Ngazzellmet Ngjyrn-ugjyr  
 Né Néntakosé

Nje Ngajest Nguréen  
 Ndau

Nérsa Nid Nijet Neser

Fusianella Fanteclike  
 Flaknje Flakst  
 Fytja Fémjach Fekim Fusave  
 Fräcketi Fessförm Fusi Fjälch  
 Farn Poljek Fundue Frati

Faludarri Fukarejto  
 Fal Fajtrot  
 Filene Färmet Funebra

Formorhet Fryma.

## **Fantazma e poetit**

*(tregim)*

**N**ë pallatin tim të persekutuar,  
mure-rrjepur si një kalë pas beteje  
vdiste plaka e fundit të shekullit të kàluar.  
Rënkonte. Vinin fqinjët. Ngjarjet. Mjekët.  
Fantazmat. Zbardhej ajo sikur shpirtin ta kish fërgëllimë  
çarçafësh.

Fliste përcart plaka. Vajzëria e saj dhe  
Naimi ishin nga i njëjtë fshat si dy kroje,  
Si dy sorkadhe. Kujtonte dashurinë. I dhashë  
një tufë me manushaqe të ndrojtura  
thash, një tufë... çastesh mërgimtare... gjithë  
jetën... prita... Naimin... Mbrëmja...  
më sillte mjekrrën e tij... Nëpër qirinj  
digjeshin sytë e tij, balli.

Ka dashur Naimin kjo, thosha  
unë, fëmija, dhe qaja. Qaja nga që kish dashuruar  
Naimin

Qanin dhe të tjerët. Se plaka mbylli sytë.  
Me gishtrinj dridhës dora e Naimi  
uli qepallat e shekullit. Sërisht  
vdiq Naimi. Sepse vdes ai me çdo njeri  
që vdes. Është njëra kokë e shqiponjës  
në flamurin tonë Naimi, tha një burrë  
në funeral, kurse koka tjetër - Gjergj  
Fishta. Varri i hapur priste. Hidhnim  
grushte dheu dhe ne, fëmijët. Pastaj  
erdhi mbrëmja - mjekër naimjane.  
Erdhi mërmërima prej toke e poetit.  
Erdhi vetë ai. Nga të gjitha varret  
del Naimi. U ngrit fati i Shqipërisë.  
Pastaj erdhi mëngjesi dhe  
unë isha bërë burrë i ngjashëm me Atë.  
**- Botohet për herë të parë -**



**Sherif Bali**  
1950

Ka lindur në fshatin Balaj të Lushnjës. Ka mbaruar në vitin 1969 gjimnazin në Lushnjë. Ka filluar të botoj që në vitin e parë të gjimnazit, 1964, por pastaj i është ndaluar e drejtë e botimit. Ka dhetra vëllime me dorëshkrim të pabotuar. Botoi në vitin 1994 vëllimi poetik Koncert sipas kërkesave të dëgjuesve". Ka në proces vëllimin poetik "Bis"! Eshtë në vitin e fundit të Universitetit në Elbasan.

## ***Reja me daktilografist***

Lisat,  
Si mjekra jote,  
Dalin prej dheut.

Fytyra jote, Naim, territor i Atdheut  
Madje dhe reja  
Bën në qiell një "n2-  
Gërmën e parë të emrit tënd  
Me ngjyra  
Stolisur.

Për të shkruar emrin tënd të shenjtë  
Shqipëria qiellin me daktilografist e ka paisur.

Një N të tillë boje  
Bëmë në ballë, moj re.  
(Shqipëri: udhëroje!)

## ***Obelisk për vëllezërit Frashëri***

1

**Abdyl Frashëri**

*I shqetësuar ai,  
Brodhi  
Nëpër Europë*

Trëndafilit në petale i kishin hapur një gropë...)

Në njerën anë  
Gjysmëhëna,  
Në anën tjetër 2 komshinjtë”

(Me libra meshe në duar po afroheshin priftërinjtë)

E sfidoi,  
Ai,  
Europën

(Trëndafilit ia mbushi me Prizren pak gropën!)

2

**Naim Frashëri**

**Qiririn e rimave**  
Në Stamboll  
Ai ndezi.

Qiri i jashtëzakonshëm (Me fitil mëngjesi!)

Luhatej, luhatej,  
Drita e tij,  
Nga thellimi.

Fu- e shuante Stambolli (Fap- e ndiste Naimi!)  
I ndezur qiriri,  
Prej tij,  
U mbajt.

Tiranë: ja tek ta vë çdo natë mbi Dajt!

3

### **Sami Frashëri**

**N**ë një dhomë të errët  
E izoluan atë,  
Për mos ta parë kurrë Shqipërinë.

Por ai shpiku një tavolinë.

Një tavolinë rrrotulluese,  
Që i jepte urdhëra,  
(I jepte udhëra ashtu si dinte ai!)

Hop: ikte me të nga Turqia dhe vinte në  
Shqipëri.

S'e lanë t'u hipë kuajve,  
S'e lanë t'u hipë anijeve,  
Se kishin frikë mos vinte e shihte Shqipërinë.

Por ai ua hodhi:  
erdhì këtu me një tavolinë!

4

### **Shënim në Obelisk**

**A**bdyli dhe Naimi  
Varret tani  
I kanë këtu.

(Guacka të zeza. Margaritarë blu)

Veç eshtrat e Samiut,  
Ata,  
Nuk na i japin.

Ende mundohen të na e pengojnë vrapin.

Por ai prapë ua hodhi  
(Ah, vesh le ta marrin!)

Me tavolinën rrotulluese e solli në Shqipëri  
varrin!

*Botohet për herë të parë*

## NAIM FRASHËR

Qirixin e rimave  
Në Stamboll/  
Ai ndezit.

Qiri i jashtëzakonshëm. (Me fitil menjëzit!)

Luhatej, luhatej,  
Drita e fiti,  
Nga thëllimi.

Fu - e shuante Stamboll/  
Fap - endiste Naimi!,

I hdezur qiriri,  
Prej tij,  
U mbajt.

Tiranë: ja tek fa vë çdo natë mbi Dajt!

# *More Naim shqipëria!...*

## *Ngrehu o Abdyl Bej nga Varri*

*Ngreu Abdyl bej, nga varri,  
zgjo Naimin dhe Saminë  
të shikojnë Shqipërinë!...  
Adriatik'i thellë, pa anë,  
Shqipërinë e copëtuanë!  
Shqipëri tre vilajente,  
i thonë: "Jepe dyfeknë!"  
"Nuk e jap, e kam për vete!"*

***Arrëz(Korçë)***

\* \* \*

*Ngehu, o Abdyl nga varri,  
të shikosh se ç'ka ngjarë!  
Zgjo Naimnë dhe Saminë  
të shikoni Shqipërinë:  
Shqipëria anë e mbanë  
mbushur jezitë e xhandarë.  
Po do marr' përpjetë malë,  
do luftojmë për vatanë.*

***Bitinckë(Korçë)***

## **Naim Tretur kulluar**

**Qaj, zemër, mos rri po qaj,  
 Naimi tretur, kulluar!  
 Vaj, e zeza jetë, vaj,  
 ti në dhe kë ke mbuluar!  
 Diellë, hënë edhe qielli,  
 Naim Frashërin e njihni,  
 për liri ai përpiquej,  
 ç'kini tani që i fshihni!  
 Vinçan, Korçë**

**“Këngë popullore të Korçës”, Tirana 1982,  
 f.105,114,118,163**

## **Priti Gjirokastër këngët -vallet tona**

**Këngët vallet tona vin' në Gjirokastër,  
 Derdhen në kështjellë si burim i pastër  
 Çjanë këta bilbila, kështu ku po venë?  
 Naimi, Samiu ulen në bedenë.  
 Kush është ky burrë, që vjen si gjëmimi?  
 Vjen në Gjirokastër Abdyl Frashër trimi...**

### **Përmet**

**“Truall me këngë”, f.1983, f.11**

## **Tre vëllezer...**

*I*

*Ishin tre vëllezer,  
Që të tre pishtarë  
Nëna që i lindi  
Ç'grua qënkej vallë?*

*Nënë Shqipétare  
Nënë Heroinë  
Tre Yje të bukur  
dha për Shqipérinë.*

*II*

*Nuk do vdesi kurre  
Kënga e Naimit  
Ajo rrjedh e ëmbël  
Në zerin e bilbilit*

*Nuk do të tretet, jo,  
Trupi i Naim Beut  
Ai është shpérndarë  
Në çdo grimcë të dheut.*

*Kur vajta një ditë  
Te shtëpia jote  
Një thëllëzë e bukur  
Për të tre këndonte*

*Me zërin e saja  
Zerin tim bashkova  
Këndova për ty,  
Për të tre këndova*

*Kënga ecte gjym  
 Shtëpia gjëmonte  
 E gjithë Shqipëria  
 Bashkë me ne këndonte.*

*III*

*Naim të keqen të penës  
 Kam kohë që s'kam kënduar  
 Një e keqe më ka zënë  
 Më ka djek e përvëluar  
 Po sot po këndoja për ty  
 Hidhërimin për ta shuar  
 Se shumë djem shqipëtarë  
 Lënë kockat në dhe të huaj  
 Kthehuni florinjtë e nënës,  
 Kthehuni në tokën tuaj  
 Se sado t'u dojë bota  
 S'u bëhet si toka juaj.*

***Grabovë-Përmet, 1996***

## *Bilbil i vendeve të mia!*

Ku peshon më shumë guri?  
 Ku s'ka të vdekurë burri,  
 more Naim Shqipëria,  
 peshon në vendin e tija,  
 ku të flet gjuhën fëmija,  
 bilbil, i vendeve t'mia.  
 O pena me flori larë,  
 mbi botë lulja e parë,  
 more Naim Shqipëria,  
 Hënë yjesh, hën' behari,  
 ç'u bë Naim Shqipëria?  
 Gjuh' e zogjve nëpër djepe,  
 zgjove kombin, drithë derdhe,  
 bilbil, i vendeve t'mia  
 bilbil-o, bilbil-o, bilbil-o,  
 more Naim Shqipëria.  
 O i ëmbli për të gjallë,  
 i gjalli për shqiptarë,  
 more Naim Shqipëria,  
 pak jetove, shum'na le.  
 shumë more dhe në dhe.  
 Bilbil, i vendeve t'mia,  
 bilbil-o, bilbil-o, bilbil-o,  
 bilbil, i vendeve t'mia  
 s'të mban dot dhei përbrenda,  
 del nga varri e nis nga kënga,  
 more Naim Shqipëria.  
 Nëna jonë shamikuqe,  
 shtatin mal veshur si nuse,  
 bilbil i vendeve t'mia  
 bilbil-o, bilbil-o, Naim-o.  
 Shqipëri, o shkëmb i sertë,  
 ti bilbila i bën djemtë,  
 shekujt vin e vitet shkojnë,  
 Naim, djemtë ligjërojnë.



100

101

***Shënjë mirënjohje ndaj poetit  
të mbarë Shqipërisë,  
bilbilit të gjuhës sonë...***

**- Fragment nga letra e Mësuesit të Popullit,  
Profesor Jup Kastratit dërguar autorit të antologjisë "Njëqind  
poetë për Naimin"**

**Shkodër, më 2 shtator 1996**

*Inderuar Koleg,*

*Sipas kërkesës Suaj gojore më 31 gusht 1996, po Ju  
dërgoj disa shënime bio-bibliografike (2 faqe të  
daktilografuara). Është shumë e vështirë të përmblidhet një  
jetë e tërë kushtuar e përkushtuar shkencës. Po Ju çoj edhe  
një fotografi. Ju falënderoj përzemërsisht për konsideratën  
Tuaj të lartë ndaj meje.*

*Gjithashtu, e ndjej për detyrë morale t'Ju shpreh  
falënderimet e mia më të singerta për dedikimin Tuaj autograf  
tepër të ngrohtë në antologjinë: **Njëqind poetë për Naimin:**  
"Profesor Jup Kastratit në shenjë respekti të veçantë për  
gjithëçka i ka dhënë kulturës shqiptare. Me respekt e  
mirënjohje! Mehmet Gëzhilli, Tiranë, 30.8.96."*

*Libri Juaj është një vepër tepër e vyer nga ana  
shkencore e letrare dhe shumë e dobishme nga ana  
edukative. Ju jeni një kërkues sistematik. Ju përgëzoj me*

*plot gojën. Është shenjë mirënjojësie ky homazh Juaji ndaj Poetit të mbarë Shqipërisë, Bilbilit të gjuhës sonë. Keni bërë shumë mirë që, në vend të parathënies, keni vënë prozën-poetike të Faikut. Përcaktimet e tij për Naimin, të botuara më 20 prill 1901, pak kohë pasi u nda prej nesh, Poeti i Madh dhe i Pavdekshëm, janë përkufizimet më adekuate për Figurën e "Njeriut të mirë zemërqëruarë, mendjehollë, fjalëkripur, yll aq i ndritshëm e aq i rrallë në quell të Shqipërisë, burrë me fletë për kombësinë tonë", ai që "e mësoi, e ngjalli, e rriti pak kombin shqiptar, e gatiti udhën për një propagandë kombëtare më përparimtare."...*

*Ju uroj me plot gojën suksese Juaji, me nderime  
**Jup Kastrati***

## ***...poezi e frysmezuar aq gjerë, aq dendur...***

*- Letër e Aleksandër Zotos, profesor  
i Universitetit të Saint Etienne - Francë -*

Përmblehdha 100 Poetë pér Naimin, e

përgatitur me devotshmëri të flaktë nga  
Zoti Mehmet Gëzhilli, përbën një homazh  
shumë të prekshëm dhe që i takonte poetit  
kombëtar shqiptar. Në fakt, s'besoj të ekzistojë  
një vend tjetër ku vëtë poezia të ketë  
frysmezuar aq gjerë, aq dendur, poezinë, ku  
ndërgjegjja kombëtare të jetë njësesuar ose  
identifikuar me krijuesin që e ngriti gjithë  
amtare në majat e saj në të larta.

Aleksandër Zoto  
Universitet i Saint-Etienne .FRANCE

Tiranë, më 31. 08. 1996

Përmblehdha "100 Poetë pér Naimin", e përgatitur me  
devotshmëri të flaktë nga Mehmet Gëzhilli, përbën një homazh  
shumë të prekshëm dhe që i takonte poetit kombëtar shqiptar.  
Në fakt, s'besoj të ekzistojë një vend tjetër, ku vëtë poezia të  
ketë frysmezuar aq gjerë, aq dendur poezinë, ku ndërgjegjja  
kombëtare të jetë njësesuar ose identifikuar me krijuesin, që e  
ngriti gjuhën amtare në majat e saj më të larta.

**Aleksandër Zoto**

## Punë shëmbullore për brezat që do të vijnë...

- Letër e Profesor ISUF LUZAJ,  
dërguar autorit nga  
SHBA -1724

Dr. Jose J. Luzay, Ph.D., LL.D.  
Professor Emeritus

President of President of the National Council of Education  
President of National and Professional Council of the Chamber of the  
Professionals of Engineers and Architects of the United States  
President of American Society of Civil Engineers  
President of American Society of Architects  
President of American Society of Structural Engineers  
Member of the Board of Governors of the American Society of Civil Engineers  
Member of the Board of Governors of the American Society of Architects  
Member of the Board of Governors of the American Society of Structural Engineers

1724 North Oak Park Avenue  
Chicago, Illinois 60633 USA  
Tel: 312 745-3783

Zotit Mehmet Gëzhilli, 10 Çanadoni 96

I dashur bashkatdhetar

Ditë te shkuara mura Antologjinë, për kujtim  
te Shkencës, që është prejardhje. Biçuhem inderit  
Puna e madhe që kini kryer, fener shëmbullor për  
meriton, edhe rrethuar me ndërmarrje serioze që  
meriton t'i quie rind me tempullin e uldhedashurisë  
të shkencës. Tole, rast, vullnet, guxim i se  
misioni që kati morjan t'a vazhdoni edhe  
për yjet e tjera shqiptare që mëthmen kohë  
nike i dogjnë si meteore.

Mos e mendoni dy herë të më shkruani, me  
i llo pikpyetje të Historisë t'one, të këtij  
shekulli që fu mbledh dorcat e lamtumirës.

Me simpati intelektuale  
Dr. Isuf Luzaj.

**Zotit Mehmet Gëzhilli,**

I dashur bashkatdhetar!

Ditë të shkuara mura Antologjinë, për kujtim të Naimit  
që ti përgatite. Të faleminderit! Puna e madhe që kini kryer,  
fener shëmbullor për brezat që do të vijnë, është një  
ndërrmarrje serioze që meriton të zerë vend në tempullin e  
atdhedashurisë.

Të dhëntë Zoti fat, rast, vullnet, guxim dhe iniciativë  
që këtë mision ta vazhdoni edhe për yjet e tjerë shqiptarë që  
rrëthanat historike i dogjnë si meteore.

Mos e mendoni dy herë të më shkruani, mit çdo  
pikpyetje të Historisë t'one, të këtij shekulli që po mbledh  
boçat e lamtumirës.

Me simpati intelektuale  
Dr. Isuf Luzaj

Z. Mehmet Gëzhilli!

Duke ju falenderuar  
 për ndarin që më bëtë  
 (kë gjith në një antologji  
 për Naimiq tonë tërtejat),  
 Ju lutem, si po pëjdot  
 mija ai libër, nëse më  
 dërgoni një kopjo, unq,  
 (ose disa pë t'i shqiptarë  
 nëpër personalitetë tu t'hal).

Me iurisdrifulloj  
Gjilani

Visar Zhiti  
 Ambasciata d'Albania  
 Via Asmara, 5  
 ROMA

*Z. Mehmet Gëzhilli!*


*E kam çmuar shumë idenë tuaj origjinale. Ju jam tepër mirënjo hës që më keni përfshirë dhe mua në antologji. Ju uroj që ky veprim fësnik të marrë çmimin e merituar nga koha.*

*Me respekt  
Pertef Liçi*

Tepelenë, tetor 1996.

*Jehonë  
dhe vlerësime  
për antologjinë  
"100 poetë për  
Naimin"*






... u vremenu kada je

# *Naim Frashëri mbledh poetët shqiptarë*

Këshilli i rrethit Përmet, në kuadrin e 95 vjetorit të vdekjes së Naim Frashërit dhe të 150 vjetorit të lindjes, botoi antologjinë me titulin "100 poetë për Naimin". Duhet thënë se puna kryesore dhe komplimentet përveç këshillit bashkiak i përkasin edhe zoti Mehmet Gëzhilli i cili pas një pune disavjeçare i dha në dorë lexuesve këtë antologji disi të veçantë.

Ky libër nuk do të shitet, por do t'i jepet të gjithë bashkive të rretheve, (me sa duket për t'i nxitur të ndërmarrin iniciativa të tillë) bilbiotekave dhe 100 potëve që kanë shkruar për Naimin. Hartuesi i kësaj antologjie, Mehmet Gëzhilli, tha për AKS se: "është momenti t'i tregojmë vetes sonë dhe të tjerëve se kemi një traditë që duhet respektuar". Eshtë hera e parë që poetët shqiptarë, të përçarë dhe të ndarë në klane më keq se sa partitë politike, mblidhen më në fund së bashku. Këtë mund ta bëjë vetëm Naim Frashëri. Nr.43(73)28-29 nëntor 1995.





*Në 95 vjetorin e vdekjes së Naim Frashërit*

*Botohet antologjia  
“Njëqind poetë  
për Naimin”*

Kjo përbledhje e përgatitur nga studiuesi Mehmet Gëzhilli që përfshin krijimtarinë e pothuaj një shekulli kushtuar Frashëriut të Madh, hapet me shkrimin “Naim H. Frashëri” të Faik Konicës botuar në “Albania” më 20 prill 1901, dhe mbyllitet me një fragment të librit “Porosia e Madhe” të Rexhep Qoses.

Këto ditë Shtëpia Botuese “Albinform” e Tiranës nxorri në qarkullim antologjinë e re “Njëqind poetë për Naimin “botim i Këshillit të rrethit të Përmetit me rastin e 95-vjetorit të vdekjes së Naim Frashërit.

Përbledhja është përgatitur nga studiuesi Mehmet Gëzhilli dhe përfshin pothuaj krijimtarinë e këtij shekulli të 100 autorëve shqiptarë kushtuar Frashëriut të Madh, e cila

tregon se figura, personaliteti dhe vepra poliedrike e Naimit ka qenë, jo vetëm fryshtëzim dhe motiv i fuqishëm për shkrimtarët tanë, por edhe një referim i përhershëm për veprën e tyre intelektuale dhe artistike.

Antologjia e porsabotuar "zbulon" edhe një fakt tjetër me domethënien të shumëfishtë: Naimi i kthyer që në gjallje, e sidomos pas vdekjes së tij, në një simbol të Rilindjes kulturore e shpirtërore të kombit shqiptar, ishte dhe mbetet njëherazi edhe njeri nga artistët e përkushtuar të fjalës shqipe, me rrezatim dhe ndikim të thellë në letërsinë dhe kulturën shqiptare, privilegji vetëm i punëtorëve të mëdhenj të mendjes, i atyre krijuesve të rrallë e të jashtëzakonshëm që lenë pas vepra letrare e kulturore me vlera universale. Hartuesi i kësaj antologjie ka qëmtuar të gjitha krijimet poetike që i janë kushtuar Naimit, të cilat i ka marrë nga librat autorialë, përbledhjet e ndryshme si dhe nga faqet e shtypit të kohës. Libri, në vend të parathënieve, ka shkrimin "Naim H. Frashërit" të Faik Konicës të botuar te "Albania" më datën 20 prill 1901, të botuar me rastin e vdekjes së poetit, i cili fillon me këto fjalë: "Të tjerë, që patmë lumtësinë ta shihin t'i qasen e ta dëgjojnë, do të thonë se ç'njeri i mirë, zemërqëruar, mendjehollë, e fjalëkripur ish Naimi bez Frashëri. Të tjerë, në të bukura e të përmallshme vjersha, do të qasjnë për shojtjen e një ylli aq të ndritshëm - aq të rrallë - në quell të Shqipërisë. Unë dia vetëm në pak fjalë të them se ç'punë të fortë e të palodhur bëri, ky burrë me fletë, për kombësinë tonë".

Pas këtyj shkrimi të Konicës vijojnë me radhë "Vajtim i zemrës mbi varr" e Abdyl A. Ypit e vjeshtës së dytë, e djelë 1900, vjersha e Koto Hoxhit "Tre djem nisurë prej arit" kushtuar Abdyl, Naimi e Sami Frashërit, "Naim Beut" e Lef Nosit, "Lutje" e Adham Shkabës, "Vajtim për Naim Benë" e Dushi H. Jorgobabës për të vazhduar me poezi të Filip Shirokës, Çajupit, Jani Vruhos, Shtjefën Gjeçovit, Hil Mosit, Petro Nini Luarasit, Mihal Gramenos, Asdrenit, Poradecit, Et'hem Haxhiademit, Sejfulla Malëshovës, Kristo Floqit,

Petro Markos, Sali Butkës etj. Vend të konsiderueshëm në këtë përbledhje zenë kushtimet ose referimet e poetëve të njohur bashkëkohorë si të Ismail Kadaresë, Dritëro Agollit, Jorgo Bllacit, Bilal Xhaferit, Qerim Ujkanit, Teki Dervishit. Rrahman Dedajt, Ndoc Paplekës, Agim Vincës, Adem Istrefit, Fatos Arapit, Agim Isakut, Sabri Hamitit, Xhevahir Spahiut, Rudolf Markut, Murat Isakut, Odhise Grillos e deri te poetët më të rinj, Visar Zhiti etj.

Krijimtaria kushtuar Naimit e renditur në këtë antologji të re është mjaft e larmishme për sa i përket këndvështrimeve motiveve, interpretimeve si dhe strukturimeve figurative poetike.

Libri, në vend të pasthënies, ka një fragment të shkëputur nga libri "Porosia e madhe" e Rexhep Qoses në të cilin theksohet se "vepra letrare e Naim Frashërit është vepër e mendimtarit që di të shqetësojë me bukurinë e fjalës dhe i vjershëtorit që di të qetësojë me mençurinë e mendimit". Në mbyllje, hartuesi pëmbledhjes poetike, në shënimin e tij të shkurtër e lë të hapur botimin e antologjive të tjera të kësaj natyre. Prezantimi i këtij libri do të bëhet së shpejti në Përmet dhe në Tiranë.

**Gjovalin KOLA**

E përmëte  
17.11.1995  
Nr. 267 (14.487)  
Viti 54 i botimit  
**Çmimi i lekës 20  
200 DPK**

# ZERI DODULLIT

Gazetë e Partisë Socialiste të Shqipërisë

NJEQIND POETË  
për  
**NAIMIN**



Antologji

**Antologjia  
"Njëqind poetë  
për Naimin"**

Eshte meritë e veçantë e su-  
përdoruesit te pasionuar Mehmet  
Gëzhilli qe përgjithësi gjatë an-  
tologji te pasur te poetëve per  
korifësim e poeziës shqipe Naim  
Frasheri. Libri eshte sponsorizuar  
nga keshilli i rethit te  
Permetit dhe eshte botuar nga  
shtepia botuese ALBINFORM

*Një monument  
kulture para  
të cilit duhet  
të përulemi*

*Promovohet libri "100  
poetë për Naimin"*

Eshtë ky libri, promovimi i të  
cilit u bë dje paradite, në Lidhjen e  
Shkrimitarëve dhe Artistëve në  
Kryeqytet.

I hartuar nga studiuesi Mehmet  
Gëzhilli, libri është antologjia e  
poetëve, që kanë shkrujtur për  
kryepoeten, janë vjersha, poezi,  
copëza poeme etj., të cilat mbajnë  
firmën e Konicës, Çajupit,  
Poradecit, Agollit, Kadaresë.  
Bardhyl Londo në fjalën e tij  
nënvizoi se poetët e kësaj antologjje

kanë nderuar Naimin e madh, poi dhe veten e tyre. Sipas Londos, ky është një shembull unikal, pasi nuk mund të gjendet poet shqiptar, që të mos ketë shkruar qoftë dhe një vjershë a varg për Naim Frashërin. Poeti Xhevahir Spahiu, botimin e këtij libri e quajti si një bibliotekë të veçantë në librat e gjithsecilit. Për Spahiun, në këto kohëra bisnesmenësh e statistikash duhet të krijohet kulti i artit dhe artistit, pasi siç shprehet Dostojevski i madh, bukuria është ajo që përtërin botën. Poeti e cilësoi më tej punën e autorit një përpjekje pasionante e me vlerë, Naimi siç e cilësoi më tej punën e autorit një përpjekje pasionante e me vlerë. Naimi siç na ka bashkuar dje, na bashkon edhe sot e do të na bashkojë nesër, përfundoi Xhevahir Spahiu. Për poetin Dritëro Agolli, "Naimi mbetet një monument kulture, përpara të cilit duhet të përkulemi të gjithë. Koha do të kalojë,- tha Agolli, do të ndërrojnë brezat, qeveritë, partitë, por vetëm Naimi i madh do të qëndrojë gjithmonë atje, për t'ju përkulur të gjithë, pavarësisht nga bindjet dhe ngjyrimet politike".

Rreth librit dhe vlerave të tij, folën më tej Fatos Arapi, Jorgo Bllaci, Vehbi Skënderi. Në takim u cilësua se vepra e Naimit është vepra e mendimtarit që di të shqetësojë me bukurinë e fjalës dhe vepra e mendimtarit që di të të qetësojë me mençurinë e mendimit. Për studjuesin Rexhep Qosja, mendimi i të cilit është vendosur në pasthënien e librit, është e kuptueshme se vepra e tij është bërë vepra e letërsisë shqipe me ndikimin më të madh, në jetën e popullit shqiptar". Sipas Qoses "vepra e Naim Frashërit ka ndikuar në popullin shqiptar më shumë se një sërë institucionesh të tjera kulturore dhe politike. "Në takim u cilësua se poeti është bërë mësues i popullit shqiptar. Kurse vepra e tij pjesë e pandarë e vetqënies së tij shpirtërore dhe morale. I botuar nën kujdesin e këshillit të rrethit të Përmetit, me mbështetjen e sh.b.Albinform, libri u cilësua si një nisje serioze për libra të tjerë, që në të ardhmen do t'u kushtohen figurave të mëdha.

# Një Antologji dinjitoze

Dalja e antologjisë poetike "100 poetë për Naimin", përgatitur me seriozitet e dashamirësi nga Mehmet Gëzhill, është një ndër botimet më serioze për të madhin Naim. Hulumtimet e shumta që nga Rilindja e deri më sot të pasqyruara në vepra letrare, apo në shtypin periodik flasin sa për popullaritetin e veprës naimjane, aq edhe për njohjen dhe punën sistematike të studiuesit. Në këtë antologji është



dhënë Naimi sa patriot i kulluar, aq edhe poet i fuqishëm, sa mësues e pedagog, aq edhe mendimtar i shquar. Me veprën e tij letrare, jo vetëm që ka ndritur mendjet e shqiptarëve, por ka qenë gurë fryshtimi për popullin që e deshi si pakkush. Lexuesi i veprës naimjane plotëson boshësitë e njohjes për një sërë autorë të ndaluar dikur(Konica, Abdyl Ypi, Lef Nosi, Dushi, H.Jorgobaba, Adham Shkaba, Sali Butka, Sefulla Malëshova, Et'hem Haxhiademi, Isuf Luzaj, Kristo Floqi, Mediha Frashëri, M.A.Përmeti etj) e për një mori pjesësh është e zgjedhur me kujdes dhe ka vlera jo vetëm për sasinë e saj, por edhe për cilësinë. Megjithatë, pa cënuar vlerat e antologjisë, mendoj se autori, po të kishte bërë më tepër kujdes, do të

kishte nxjerrë një vëllim edhe më të plotë, se antologja do tē kishte më tepër vlera po tē kishte më tepër vjersha nga poetë përmetarë që nuk janë tē paktë, se antologja po tē kishte një kapitull tē veçantë pér tē pasqyruar këngën popullore kushtuar Naimit nuk do tē ishte aq e paktë sa është paraqitur. Po ashtu po tē kishte edhe një kapitull "Njerzit e mëdhenj pér poezinë e Naimit", antologjisë do t'i shtoheshin vlerat. Përpos vërejtjeve dashamirëse, që autorë po t'i mirëpresi dhe t'i ketë parasysh në ndonjë ribotim, lexuesi e plotëson kërvshërinë me leximin e antologjisë dhe më tepër do tē shtojë nderimin pér poetin e madh Naim.

*Niko Tyto  
Fjala Sot (Tepelenë),  
Prill (2), 1996, f.4*



**Revistë e Rinisë Shqiptare, Nr. 36 (4686),**

## *Paraqitje librash të rindj*

### *Antologji: Njëqind poetë për Naimin*

Në këtë antologji me poezi kushtuar Naim Frashërit, bashkohen 100 poetë përmes poezive të tyre. Autor i përbledhjes është studiuesi Mehmet Gëzhilli dhe sponsorizues, Këshilli Bashkiak i qytetit të Përmetit. Libri "Njëqind poetë për Naimin" u paraqit në sallën e L.Sh. ku merrnin pjesë një sërë krijuesish të përbledhur në antologji. Vëllimi përmban nga ndjesitë më të mira të krijuesve tanë për Naimin si poet i rilindjes sonë kombëtare duke nisur që nga Konica, Gjeçovi, Shiroka, Poradeci, Kadare, Bilal Xhaferri, Agolli, Arapi, Shehu deri tek poetët e viteve 70 e këtej si Kostandin Dhamo, Sabri Hamiti, Rudolf Marku e Visar Zhiti.

E veçantë për këtë botim, është përfshirja e krijimtarisë gjithëshqiptare duke krijuar kështu një Buqetë të vërtetë shqiptare të pacunguar.


Edhe poetët e rindj përvijojnë tradicionalisht dashurinë ndaj poetit të flakës së qiririt tashmë proverbiale.

Libri siç thotë autor i përbledhjes, është botuar në përkutjim të 95 vjetorit të vdekjes së Naimit, gjithashtu vitin tjetër do të botohet një libër tjetër antologjik me poezi për Naimin me rastin e 150 vjetorit të lindjes. Përveç botimeve për Naimin lexuesi do të njihet me botime të reja nga Naimi sidomos ajo pjesë e krijimtarisë Naimjane, fetare dhe mistike që ateistët s'mund t'i botonin.

"Zëri i Rinisë", Nr. 36 (4686), 22 nëntor 1995, f.2.

**“Njëqind poetë për Naimin”**

*Një antologji  
me diapazon të ri*



Ja titulli simbolik i antologjisë së studiuesit të talentuar Mehmet Gëzhilli. Ndoshta e para e llojit të vetë në fondin e vyer të letërsisë e të historisë së pasur shqiptare, posaçërisht për “Bilbilin e Kombit” poetin e madh mbarëkombëtar Naim Frashërin. Panteoni i vargjeve për Naimin e bukurisë shpirtërore, atdhetare e natyrore si një album poetik, i dhurohet Atdheut, gjithë shqiptarëve kudo shtrihen, në nderim të veçantë për çka trashëgojnë e ushqejnë ndaj poetit të dashur të Rilindjes Kombëtare. Eshtë një homazh i njëhershëm për 95-vjetorin e vdekjes dhe 150-vjetorin e lindjes (25 maj 1996). Seria e parë, që përmend një botim të plotë të patriotit, mendimtarit dhe veprimtarit të shquar të arsimit e të kulturës sonë kombëtare.

Autori me një kujdes e pjekuri të pazakontë, ka përzgjedhur krijimet më të bucura të autorëve më të përqafuar nga kombi. E nis me Faikun për të shkuar te Çajupi e Gjeçovi, nga Veriu në Jug, nga Lindja e Largët kosovare deri në Perëndimin bregdetar, që nga viset e vet poetit atdhetar e deri në trojet e Çamërisë. Që këtej fluturon me mall e me dashuri në adhuruesit e Naimit në milionat e diasporës shqiptare nëpër kontinente. Nga Sejfulla Malëshova, pa asnje paragjykim citon Mustafa Greblleshin...

**Maj 1996!**

**Alternativa**

Gazetë e PSDSH

Viti i 6<sup>ë</sup> i Botimit

Nr. 13 (406)

E premte, 16 shkurt 1996

Çmimi 10 lekë

# *Kur do ta fillojë Korça vitin naimjan?*

Viti 1996 është viti i 150-vjetorit të lindjes së poetit tonë kombëtar, Naim Frashëri. Ishte një nismë e mrekullueshme ajo e Këshillit të Rrethit të Përmetit, që me studjuesin e pasionuar, z.Mehmet Gëzhilli, bëri të mundur botimin e një antologje poetike për Naim Frashërin.

Antologjia "100 poetë për Naimin" me të drejtë nga shtypi ynë pluralist u mbështet dhe u vlerësua njëzëri si një libër i menduar, plot atdhedashuri dhe me një mesazh të qartë: Mbi gjithçka Shqipëria... Studjuesi që i mblodhi këta 100 poetë me poezitë e tyre për Naimin, të kohëve të ndryshme e të bindjeve të ndryshme, e ka menduar mirë këtë antologji. Naimi, si një panteon i Shqipërisë, bashkon në një libër edhe poetët demokratë, edhe ata socialistë,

socialdemokratë, ballistë apo monarkistë qofshin. Po të vësh re me kujdes librin listën e autorëve, që janë përmbledhur në të, shikon se 20 autorë nga 100 gjithësej, janë nga Korça, duke filluar nga poeti i Rilindjes Kombëtare, Adham Shkaba e deri tek poeti i shquar i ditëve tona, Dritëro Agolli. Dhe me të drejtë Korça me Naimin ka lidhje të fuqishme shpirtërore, mbështetje dhe respekt të ndërsjelltë. Poezia "Lumja ti, Korçë, o lule", është një manifest i brendshëm i universit të ndritshëm naimjan. Dhe tani, që filloi viti 1996, viti i 150-vjetorit të ditëlindjes së Naimit, a nuk i takon Korçës që ta çelë këtë vit jubilar? Përmeti e dha shembullin e tij të shkëlqyer. I takon tanimë Korçës së kulturuar të vazhdojë e të ngrejë në një nivel më të lartë këtë nismë për vitin 1996, si vit naimjan... Nr.13 (406), 16 shkurt 1996, f.4.

***Arbër Josa***

# ZERAIKO SOVIES



ט' ט' ט'

## «Si Naimi s'ka tē tjerē»

# “Si Naimi s’ka të tjerë”

**-100 poetë (nuk) e bëjnë një Naim-**

70 vjet më parë, pikërisht në vitin 1925, një grup studentësh shqiptarë që studjonin në Grac të Austrisë, ndërmorën nismën për të përkujtuar poetin kombëtar në një mënyrë disi të veçantë, duke shkruar secili nga një poezi për poetin e madh. 70 vjet më vonë, si një homazh për 95 vjetorin e vdekjes dhe në prag të 150 vjetorit të lindjes së Naimit, një hulumtues i zellshëm i vlerave kulturore dhe historike, Mehmet Gëzhilli, nxori në dritë këto ditë antologjinë “100 poetë për Naimin”. Ka gati një shekull që nga dita kur pushoi zemra e zjarrtë e poetit, që dishepujt, në fakt të gjithë poetët shqiptarë, nuk rreshtin së shkruari për Mësuesin e tyre. (Autori i antologjisë ka marrë poezi për Naimin edhe në ditët kur libri gjendej në procesin e botimit në shtypshkronjë, madje ndonjë prej tyre ka qenë i detyruar ta batojë si faksimile, pra, ashtu siç ka ardhur në momentin e fundit). Kaq i madh është pushteti i këtij sovrani të gjuhës dhe të poezisë shqipe, sa që nuk gjendet asnjë krahinë apo segment kohor, ku dhe kur të mos jetë shkruar një varg për Naimin. Nga Jugu në Veri, nga vendlindja në trevat e mbetura jashtë trungut amë, në të gjitha mjediset ku flitet shqip, toskë dhe gegë, muslimanë dhe të krishterë, poetë dhe luftëtarë, të rinj dhe pleq, jo vetëm kanë kënduar këngët e Naimit, por edhe kanë marrë guximin për t’i kënduar atij. Tek Naimi takohemi të gjithë në sajë të Naimit edhe ne kemi kartën tonë të identifikimit sigurisht sot do të ishim më pak shqiptarë, për të mos thënë diçka më ogurzezë. Eshtë interesante të vëresh nëpërmjet

kësaj antologje vlerësimet e poetëve për Poetin. Autori i parë, Abdyl Ylli, e konsideron Naim Frashërin si "Ati i gjuhës", "udhërrëfyesi i kombit" Lef Nosi e quan "Mali i Tomorrit", Jorgobaba: "Ati vjershërisë", "poet i Shqipërisë". Çajupi e thërret "bilbil të gjuhës tonë", Jani Vruho e përcakton si "Zog i Zotit". "Burr shpirt-madhi", thotë Shtjefën Gjeçovi. Për Mihal Gramenon Naimi është "zemër e Shqipërisë", Kristo Floqi e quan "Naim Dituria", ndërsa Asdreni e konsideron si "Burimi shpëtimtar". Lasgush Poradeci e përcakton "rapsod i lasht' i kombit" (Ti rapsod që pranë shqipes/dit e nat' i lodhe ballët), ndërsa Et'hem Haxhiademi e quan "këngëtar hyjnor". Për Isuf Luzajn, Naim Frashëri është "Apostull i kombit shqiptar", ndërsa Ferit Vokopola i thotë Ti, je "Dritë e kombësisë". Sipas mënyrës së vet, Dritëro Agolli e thërret Naimin si "Sulltan i poezisë", apo "Gjeneral poet Naimi". Xhevahir Spahiu thotë se Neimi është "burimi", poeti i gjuhës së zjarrtë". Në gjuhën e vet, Moikom Zeqo e quan "demiurgu i madh". Vulën e të gjithë këtyre përcaktimeve duket se e bën rapsodi anonim popullore kur në këngën e tij Naim Frashërin e quan "Naim Shqipëria" pa asnje hezitim.

Sidoqoftë, ashtu si për çdo poet të madh, edhe për Naimin tonë çdo epitet, çdo përcaktim nuk na i ngjall dot ato emocione dhe mendime që të përcjell vetë vepra e poetit. Por në këto raste nuk ka nevojë gjeni për ne, nuk ka nevojë Poeti për poetët, por poetët kanë nevojë për kryemjeshtin. Duke shkruar dhe nderuar Naimin nuk është nevoja të nderohet Naimi, por ky është testi vendimtar për t'u marrë vesh me lexuesin shqiptar. Duke shkruar për Naimin, poetët vetënderohen. Ky është një ligj i paravendosur dhe shoqëron vetëm njerëzit e rrallë të kësaj toke.

Në botë janë hartuar dhe botuar lloj-lloj antologjish, po kështu edhe në Shqipëri. Antologjia e re me titull 100 poetë për Naimin" jep dëshmi me interes për figurën e Naim Frashërit dhe lidhjet e tij me gjeneratat e reja të poetëve, ashtu siç dëshmon edhe një herë për hierarkinë e figurave

të letërsisë shqiptare.

Nuk ka asnje poet tjetër shqiptar që mund të krahasohet apo që mund të zbehë sadopak sovranitetin e Naim Frashërit si poet kombëtar. Këtë dëshmi ë jepin vetë poetët, pa shpehur as zilinë dhe keqardhjen më të vogël, përkundrazi. Eshtë Naimi, pastaj jemi ne, konkludojnë ata. Naim Frashëri nuk është thjesht poeti kombëtar, në të vërtetë Naimi përbën një institucion kombëtar, ku arsimohen, edukohen breza të tërë shqiptarësh. Naim Frashëri përbën gati-gati një institucion kulti: tek Naimi mund të falen edhe mëkatet. Ja, si shkruan Josif Bageri, në një vjershë botuar më 1910: "Vjershat ç'ke shkru, Ti o vjershëtor!? Dhe tradhtori sot pendohet..."

Një poet tjetër i kësaj antologjje i kërkon falje Naimit "për gabimet që ka bërë dikur"!

Në të vërtetë për Naim Frashërin mund të hartohen dhjetëra antologji, si "100 kritikë për Naimin". "100 gjuhëtarë për Naimin". Por mund të botohen edhe antologji duke marrë si bazë gjethet poetike që ka krijuar Naimi, - si "Antologji për vendlindjen". "Antologji për natyrën", "Antologji për gjuhën shqipe", etj. etj. Shumica e poezeve të krijuara me këto tema nga poetët e mëvonshëm kanë në bazë gjethen poetike naimjane.

Në fund të librit hartuesi i antologjisë M. Gëzhilli ka vënë një fragment nga monografia e Prof. Rexhep Qoses për Naim Frashërin të tilluar "Porosia e madhe": "Platoni thotë se Homeri e ka edukuar krejt Greqinë. Po ashtu mund të thuhet edhe për Naim Frashërin, vepra e tij ka ndikuar në popullin shqiptar më shumë se një sërë institucionesh të tjera shoqërore, kulturore dhe politike.

Të ndikosh aq shumë në një popull- kjo domethënë të jesh më tepër se sa vjershëtor, - kjo domethënë të jeshë më tepër se sa shkrimitar, - kjo domethënë të jesh mësues i tij".

Ne jemi këta që jemi, domethënë jemi shqiptarë, kryesish në sajë të pendëartit frashërlidhur.

NAIM ZOTO

## “100 poetë për Naimin”



stu  
në  
nisn  
koml  
veçai  
një po  
më vo  
vjetorin  
150 vjet  
hulumt  
kulturore  
Gëzhilli,  
“100 poet

Ka gati  
kur pushoi  
që dishepuj  
shqiptarë, n  
për Mësue... e tyre.(Autori i  
antologjisë ka marrë poezi për  
Naimin edhe në ditët kur libri  
gjendej në procesin e botimit në  
shtypshkronjë, madje ndonjë prej  
tyre ka qenë i datyruar ta batojë si  
faksimilë, pra ashtu siç ka ardhur  
në momentin e fundit). Kaq i madh

pushteti i këtij sovranit të  
dhe të poezisë shqipe sa  
gjendet asnjë krahinë apo  
nt kohor ku dhe kur të mos  
ruar një varg për Naimin.  
u në Veri, nga vendlindja  
e mbeturja jashtë shtetit  
ë gjitha mjediset ku flitet  
ë dhe gegë, muslimanë  
rishterë, poetë dhe  
rinj dhe pleq jo vetëm  
arkëngët e Naimit, por  
marrë guximin për t'i  
Te Naimi takohemi të  
të Naimit edhe ne  
onë të identifikimit,  
Pa Naimin sigurisht

le ishim më pak shqiptarë,  
për të mos thënë diçka më  
ogurzezë.

Eshtë interesante të vëresh  
nëpërmjet kësaj antologjie  
vlerësimet e poetëve për Poetin.  
Autori i parë, Abdy Ypi, e konsideron  
Naim Frashërin si “Ati i  
gjuhës”, “udhpërrëfyesi i kombit”,  
Lef Nosi e quan “Mal” i Tomorrit”,

# *Universi naimjan në vizionin e njëqind poetëve*

*Antologja për Naimin-  
homazh  
për 95 vjetorin e vdekjes së  
poetit*

Eshtë madhësia e veprës së Naim Frashërit që ka zgjuar tek poetët mendime nga më të ndryshme. A janë të rëndësishme apo të parëndësishme këto mendime? Janë për gjëra të mëdha apo gjëra të vogla, të drejta apo të padrejta, kjo varet nga pozita ideore dhe fuqia artistike e tij, siç shprehet Ismail Kadare"- ai është një zgjues universal mendimesh jo për vogëlima, por për gjëra të menduar Shqipërinë dhe kjo është cilësia e parë e tij, madhështia dhe fati i tij".

Ka kaluar një shekull nga dalja në dritë e një varg vjershash e poemash si "Bagëti e Bujqësi"

Ë Dëshmi e Dukatit

Numbri i parë - 14 Maj 1995

E Marte 5 Dhjetor 1995  
Viti i pestë i botimit  
278 (789)

Çmimi 20 Lekë



1886, "Lulet e verës" 1890, "Parajsa dhe fjala fluturake" 1894, "Historia e Skënderbeut" 1898 dhe vepra të tjera të cilat pa frikë përbëjnë universin naimjan. Eshtë ky univers që bashkoi poetët tanë pa dallim ideje në krijimin e kësaj antologjie mbarëkombëtare. Kjo sepse në të përfshihen poëtë të ndryshëm të Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë e fiseve arbëreshe të cilët i këndojnë veprës së Naimit. Një e veçantë tjetër e kësaj antologjie është se përmbledh një shekull poezi. Eshtë Koto Hoxhi i pari që hedh vargun përkëtë poet të madh të Rilindjes kombëtare.

Janë domethënëse për kohën në të cilën po jetojmë fjalët në vend të parathënies të Faik Konicës, si homazh në vdekjen e Naim Frashërit...

Mesazhi që koha i ngarkoi të sillte Naim Frashëri ishte mesazh madhor. Kjo figurë universale "U tret si qiriri" përtë parë "Zonjë" Shqipërinë. Por dhe ajo i bekoi vargjet e tij duke i dhënë përjetësinë.

Nr. 278 (789), 5 dhjetor 1995.

***Etleva Kuqi***



## *100 poetë bashkohen në një zë*

Këto ditë, në sajë të punës së palodhur të studiuesit Mehmet Gëzhilli, doli nga shtypi antologja poetike 100 poetë për Naimin. E sponsorizuar nga Këshilli i rrethit të Përmetit dhe me kujdes personal të Kryetarit të tij Vasil Pano. Kjo antologji mund të themi, është prologu i veprimitarive që do t'i kushtohen 150 vjetorit të lindjes së Naim Frashërit (1846-1995).

Kur për Naim Frashërin profesori i madh Rexhep Qose ka shkruar veprën madhore Porosia e madhe dhe profesor Dhimitër Shuteriqi ka shkruar monografinë Naim Frashëri, të duket sikur të tjerët nuk kanë çfarë të shkruajnë më për këtë shkrimitar bilbil të Kombit. Dhe e vërteta kështu është. Përpara këtyre kolosëve të letërsisë shqipe, të tjerët me sfidime dhe krijime mund të shprehin vetëm mirënjoyje për Naim Frashërin dhe veprën e tij atdhetare si rrallë kush tjetër, Dhe ma merr mendja që edhe studiuesi Mehmet Gëzhilli nga ky synim u nis për këtë antologji brilante që i jep në dorë lexuesit dhe studiuesve, që do të merren sot dhe në të ardhmen me veprën letrare të Naim Frashërit. Vepra letrare e Naim Frashërit është kaq madhore dhe kaq universale, sa me të drejtë mund të themi që ajo ka pushtuar vëmendjen e studiuesve, të krijuesve dhe të

lexuesve shqiptarë.

Kudo që ndodhen, përpara së cilës askujt nuk i mbetet e drejta për të bërë kritikë, por vetëm ta nderojë dhe ti shprehë mirënjojen. Në këtë kuadër është një fat i madh dhe unik që pothuaj nuk ka poet (dhe prozatorë në gjininë e tyre) që të mos i ketë kushtuar një poezi nga muza e tij veprës naimjane. Mjafton të themi që kjo antologji nuk ka pak, por 100 poetë që, në vargjet e tyre, shprehin një obligim të madh për Naim Frashërin, të lenë të mendosh se, pavarësisht nga shkalla artistike, edhe antologji të tjera mund të përmblidhen. Pararendëse e këtij mendimi janë edhe ato fjalë aq të mençura të të madhit Faik Konica tek thotë “Të tjerë më të bukura e të përmallshme vjersha, do të qajnë për shojtjen e një ylli aq të ndritshëm e aq të rrallë në qiell të Shqipërisë.

Duke informuar lexuesit e gazetës “Kombi” për këtë antologji të re, mendojmë njëkohësisht se është në të mirë të punës që t’u japim disa vargje nga disa poetë. E përbashkëta e tyre është mendimi për të ndriçuar të gjitha pamjet dhe vlerat e veprës naimjane.

Krahas vargjeve të zjarrtë të 100 poetëve të kësaj antologjie të Naim Frashërit, studiuesi Mehmet Gëzhilli me punën e tij të palodhur, ka shprehur një obligim të rrallë që koha dhe lexuesit do t’i shprehin mirënjojen. Studiuesi me këtë përbledhje antologje, e sjell të gjallë para nesh me fjalët e tij jetësore: ”Jam i gjallë dhe jam në jetë / jam në dritë, të vërtetë”.

Lexojmë antologjinë dhe çmallemi me Naimin, njëkohësisht u shprehim mirënjojen poetëve dhe studiuesit për çfarë ata kanë shkruar për Poetin.

Nr.86(361), 10 nëntor 1995, f.3.

**Sadik Muraj**

# *Vepra e Naimit- Monument kulture*

Naimi mbledh sërisht së bashku artistët dhe shkrimtarët. Kështu, të enjten, Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve në bashkëpunim me Këshillin e Rrethit organizuan ceremoninë e promovimit të librit poetik Antologjik "Njëqind poet për Naimin" i përgatitur për botim nga studiuesi i letrave shqipe Mehmet Gëzhilli dhe i botuar nga Shtëpia Botuese "Albinform".

Kryetari i LSHA, poeti Bardhyl Londo, i cili hapi takimin



theksoi se vepra e Naimit është një mesazh. "Përbledhja e vogël do të dijë të paraqesë edhe në të ardhmen vlerën e kulturës kombëtare". Më pas hartuesi i Antologjisë, studiuesi Gëzhilli e quajti veprën si jo të plotë. "Kam një peng-tha ai-që ta bëj me të plotë me shkrimtarët e tjerë nga Kosova, Maqedonia e diaspora". Në tej ai shtoi se është munduar të përzgjedhë poezi mbi bazën e një kriteri cilësor, por nuk la pa falenderuar sponsorët dhe botuesit, që në këtë 95-vjetor të vdekjes, të përkujtojmë poetin "që na mësoi të flisnim shqip,- siç u shpreh poeti Jogo Bllaci.

Një iniciativë që i kalon kufijtë e sponsorizimit është dhe shpërndarja e librit falas për studjuesit e letërsisë, albanologët, pedagogë të letrave, brenda e jashtë vendit. Kështu Këshilli i Rrethit Përmet stimulon një mënyrë të re për autorët që kanë ushtruar ndikimin e tyre në fushën e kulturës dhe ndërgjegjen kombëtare. Njëherësh janë ngritur monumente për veprën e Naimit. “Çfarëdo që të bëjmë ne këmbësorët e kësaj toke, nuk ngjitemi dot në atë shkallë” - pohon poeti Xhevahir Spahiu duke theksuar njëkohësisht se vëllimi antologjik i hap rrugën një bibliotekë të veçantë me vëllime të tilla të ngjashme për Fishtën, Migjenin, Poradecin e tjerë. Agolli e ka cilësuar veprën e Naimit si një “monument kulture”. “Ai monument do të qëndrojë atje dhe të gjithë do t'i përulemi”.

“Shkolla e Naim Frashërit i ka rezistuar kohës” pohoi Stefan Çapaliku dhe më pas shtoi, se çdo poet ka në qënien e tij Pak Naim. “Kryeqyteti i kulturës sot është Përmeti-theksoi Çapaliku dhe shpresojmë që ky kryeqytet kulture në të ardhmen të jetë Pogradeci apo ndonjë qytet tjetër”, duke përkrahur kështu idenë për botime antologjike të ngjashme me atë për Naimin. “Nuk është ide- pohon për “Ditën” studiuesi Gëzhilli, por diçka për të cilën unë kam punuar”. Ai ka gati libin për Fishtën, Migjenin etj. Njëkohësisht në planet e tij janë edhe autorë, të cilët i kanë dhënë këtij kombi artin e tyrte, shpirtin e tyre. Por, priten sponsorizimet nga institucionet kulturore, sidomos për Fishtën, që në dhjetor ka përvjetorin e vdekjes.

Gjithsesi e enjtja, për artistët, ka qenë jo vetëm një përkujtim i 95 vjetorit të vdekjes së Naimit, por njëherësh edhe një nderim për veprën e tij, që ka ndikuar aq dukshëm në kulturën Shqiptare, për t'u kthyer për shqiptarët në një “Porosi të madhe”- siç shprehet Qosja.

Nr.233 23 nëntor 1995, f.8

***Bujar Karoshi***



# Koha e Re

F. përvjetorja e Bashkimit Demokrat Shqiptar

46(107)

Viti III

E prente 11.12.1995

Cenimi 10 lekë

## *Homazh për "Bilblin e kombit"*

Kështu titullohet antologjia e studiuesit të talentuar pasionant e përkushtues ndaj idealeve dhe kulturës kombëtare Mehmet Gëzhilli. Ndoshta e para e llojit të vetë në fondin e vyer të letërsisë e të historisë së pasur shqiptare, posaçërisht për poetin e madh kombëtar Naim Frashërin.

Panteoni i vargjeve: Naim Frashëri si një album poetik i dhurohet Atdheut, mbarë shqiptarëve ku sot shtrihen fizikisht, në nderimin e veçantë që ata trashëgojnë e ushqejnë për poetin më të madh të Rilindjes Kombëtare. Ishte një homazh me rastin e 95 vjetorit të vdekjes, seria e parë që pararend një botim të plotë për 150 vjetorin e lindjes (25 maj 1996) të atdhetarit, mendimtarit dhe e veprimtarit të shquar të arsimit e të kulturës sonë kombëtare. Rolin e parathënies autorit e ka zëvendësuar me lartësimin që Faik Konica i bën poetit në "Albania" me emërtimin Naim H. Frashëri. Ndjenjat si atdhetar e bashkëkohësi i së njëjtës fushë Konica i formuloi: "Të tjerë që patën lumtësinë ta shohin, t'i qasen e ta dëgjojnë do të thonë se ç'njeri i mirë, zemërqëruar mendjehollë e fjalëkripur ish Naim Bej Frashëri. Të tjerë në të buklura e të përmallshme vjersha do të qajnë për shojtjen e një ylli aq të ndritshëm e aq të rrallë në qiellin e Shqipërisë. Ç'punë


të fortë e të palodhur bëri ky burrë me fletë, për kombësinë tonë. Gjuhëtar i shëndoshë, i ditur, i mbaruar në gregishtë të vjetër e në persishtë e në shumë gjuhë të tjera, mëndjelëruar e ndjesëhollë. E mësoi, e ngjalli e rriti pak kombin shqiptar, e gatiti udhën për një propagandë kombëtare". Autori me një kujdes e pjekuri të pazakontë ka përzgjedhur krijimet më të bukura të autorëve më të përqafuar nga kombi. E nis me Faikun për të shkuar te Çajupi e Gjeçovi, nga Veriu në Jug, nga Lindja e Largët kosovare deri në Perëndimin bregdetar, që nga trojet e poetit atdhetar në Mal të Zi deri në ata të Çamërisë. Që këtej fluturon me mall e me dashuri në adhuruesit e Naimit në diasporën e kontinenteve. Nga Sejfulla Malëshova, pa asnë paragjykim citon Mustafa Greblleshin dhe që nga një tjetër i madh e popullor si Dritëro Agolli rrëmbejn një pot tjetër më të madh aq simpatizues nga brezat e rinj si Ismail Kadareja, Bilal Xhaferri i harruar nga Çamëria e Fatos Arapi aq i dëgjuar zënë vendet e merituara. Dhe më i freskët na vjen Sabri Hamiti nga Prishtina. Po Xhevahir Spahia sikur tingëllon si pasardhës i dishepujve të Naimit. Ja dhe Murat Isaku që shkruan nga Shkupi për të ardhur tek një i nderuar si Pirro Tase e Moikom Zeqo e gjer tek Visar Zhiti i ripërtërirë në mjedisin e një klime demokratike.

Standartizimi i një libri kërkonte një epilog. Po autorri në vend të mendimeve përmbyllëse ja jep fjalën personalitetit poliedrik, atdhetarit të madh dhe prodhimtarit më të bollshëm, profesorit Rexhep Qosja. Ndaj po perifrazojmp: "Veprat letrare e Naim Frashërit është vepër e madhe e letërsisë shqiptare në përgjithësi, për arsyen e është vepër e qëllimeve dhe vlerave të mëdha që qëllimin e kërkon dhe e gjen jashtë vetes, në jetën historike dhe bashkëkohore të një populli, Platonit thotë se Homeri e ka edukuar krejt Greqinë. Po ashtu mund të thuhet edhe për Naim Frashërin. Të ndikosh aq shumë në një popull, kjo domethënë të jesh më tepër se sa shkrimitar, kjo domethënë

të jesh mësues i tij". Dhe autor i me modestinë e maturinë që e karakterizon, në "Dy fjale" mirënjojje nënshkruan: "Duket sikur antologjisë i erdhi fundi, por unë çfarë të them më shumë për Naimin dhe poezitë e tij? Të gjitha i thanë poetët. Duket sikur antologjisë i erdhi mbyllja, por jo. Do të thosha, ajo përherë mbetet e hapur... Ndaj i urojmë përzemërsisht Mehmet Gëzhillit, mik e shok të idealeve kombëtare punëmbarësi të mëtejshme. Po të presim me kënaqësi, në maj 1996".

Nr.46(107), 1.12.1995, f.2-3.

***Dr. Vangjel Kasapi***



# *Naim Frashëri's Work- A Monument of the Albanian Literature*

Writers and literature lovers discussed the influence of Naim Frashëri, an Albanian poet of the end of last century, in the Albanian literature, as an anthology of poets writing on him was promoted, at the Writer's Union last week.

"Naim Frashëri is a monument of the Albanian culture", said Dritëro Agolli, an important Albanian novelist and poet". All of us should respectfully bow in front of this monument. Time passes by but Naim's monument will eternally remain there".

Naim Frashëri, who was member of the Bektashi Shiia'sect of Islam, wrote important poems and didactic works, which were very influential in the National movement which led to an independent Albanian in 1912.

Vehbi Skënderi, a poet, talked about the echo Frashëri left through the words of critics and readers of his work.

"Naim was a prophet", he stressed, "and whatever we, the common creatures of this world do, does not match his work".

Frashëri wrote poetry where scholars found traces of Persian poetry. The sect he belonged to was installed in the Ottoman Empire from Persia, from where the sect's peer, Hadji Bektash Wali, moved in the 13th century. Bektash's writings were in Persian, thus a knowledge of the language was requested among his educated followers. Frashëri wrote his first poem in Persian, but also grabbed from other cultures as he knew French, Arabic and Ottoman Turkish, besides that he didn't loose his impeccable Albanianess in his verses.

The Bektashis played a very important role in the formation of a national conscience of the Albanians, as the latter took control of the sect, and the sect itself was persecuted by the Ottoman Sultan's administration.

Together with the Franciscan Gjergj Fishta, Frashëri was regarded as one of the country's national poets.

And he left an undoubted influence and impression in the future generations of the Albanian literature.

"His works is a national school of the Albanian literature", said Alfred Çapaliku, a student of Albanian literature.

Researchers of Frashëri works presented the book on Frashëri, entitled "100 poets for Naim" gathering poetries dedicated or written about him and his life.

The book was sponsored by the municipality of Përmet, where Frashëri was from, and was published in the 95th anniversary of his death.

Poet Fatos Arapi said that this volume can precede other publications as for example, "The Albanian culture to Naim", "At that time Naim, as a great Renaissance writer, outlined the spiritual and cultural shape of Albania".

"Albanian", Nr.177, 21 december 1995, f.4.

# *Viti i Naimit...*

Punë të lavdërueshme  
 ka bërë edhe studiusi  
 Mehmet Gëzhilli, që ka  
 botuar në një libër  
 krijimet e autorëve të  
 ndryshëm shqiptarë për  
 Naim Frashërin.

*Ilia S. Vasili,  
 Egnatia Nr. 32  
 korrik 1996, f.8.*



**Fjala e 100 poetëve**

## Për Naimin e madh

# Nga Konica te Londo e Isaku

Naim Frashëri ka qenë dhe mbetet një poet pishtar, që u ka thithur mendjet e zemrat në radhë të parë poetëve, duke ndikuar fuqimisht, në frysëzimin dhe ndjekjen e hullisë së tij të mbarë. Veprat e Naimit, siç thotë akademiku Rexhep Qosja, ka ndikuar në popullin shqiptar më shumë se një sërë institucionesh të tjera shoqërore, kulturore dhe politike, sepse ai ka qenë dhe mbet më shumë se vjershëtor, më shumë se shkrimtar, ai ka qenë dhe mbetet mësues i shqiptarëve. Mendoj se, Naimi, ka qenë, kryekreje një mësues i poetëve, një themelvënës i fjalës shqipe të thënë bukur, një modeldhënës i përimit të stilistik dhe i përkushtimit të poetëve shqiptarë ndaj mjeshtërisë së vjershërimit me theks të qartë atdhetar. Këtë na e dëshmon më së miri dhe antologjia e re që sapo ka rënë në duart e lexuesve e që mban titullin sa tërheqës aq domethënës "Njëqin poetë për Naimin".

Së pari, më duket me rëndësi të vihet në dukje se Mehmet Gëzhilli, i cili prej

# GAZETA SHQIPTARE

EDISUD Spa - Rrugë e Dibrës, 370  
Tiranë

Kryeredaktori: ARMAND MERO. Redaktores: Rrugë e Dibrës, 370, Tel & Fax: 042 / 62546 [Tiranë]. Për-klamëni drejtohuni në zyrën e Marketingut pranë redakcise tone. Shypur në shqipshkronjen "Demokrat", Rrugë "Jordan Misja" Tiranë

Viti III - Nr. 414 - F. mart 11 aershori 1997


shumë vitesh i është dhënë me përkushtim hulumtimit rrëth Naimit, në ideimin dhe realizimin e kësaj antologjë është nisur nga një mbështetje e sigurtë e pikërisht nga dashuria dhe nderimi që kanë pasur e kanë, gati masivisht, mbarë poetët e shkrimtarët shqiptarë për Naim Frashërin. Mund të thuhet se ndër ne, nderimi për bilbilin e gjuhës shqipe” është ndjerë jo vetëm si një ushqim i parë shpirtëror, por edhe si një detyrë e një gur i parë, që vihet në ngrehinën e çdo personaliteti që mëton të lëvroat për së mbari në fushat e artit letrar e të kulturës shqiptare. Kjo antologji na bën të shohim se Naimit i janë blatuar fjalët dhe vlerësimet më të mira, qysh nga bashkëkohësit e tij e deri tek poetët e ditëve tona. Për të kanë folur kritikët e historianët e letërsisë shqiptare. Më duket një gjetje e përshtatshme nga ana e Gëzhillit, që këtë antologji, në të cilën përmblidhen poezi dhe shkrime poetike të “njëqind poetëve” e fillon me një vlerësim të Faik Konicës për Naimin “Në vend të parathënies” dhe me një sintezë të vlerësimit të R.Qoses tek “Porosia e madhe”, të cilën e ka vënë “Në vend të pasthënies”.

Së dyti, duhet vënë në dukje se kjo antologji përbën edhe një mjet të ri pune, që do t'u vlejë shumë sidomos shkollarëve dhe mësuesve të letërsisë në shkollat e mesme, po edhe më gjerë hulumtimeve rrëth Naimit dhe vendit të nderuar që ka merituar ai në letrat shqipe.

Uroj që Shtëpia Botuese “Albinform” dhe simotrat e saj, tashmë aq të shumta ndër ne, të ndërmarrin edhe në të ardhmen botimin e antologjive të tillë për poetët dhe shkrimtarët e tjera.

Nr.414, 1 qershor 1996

**GJovalin Shkurtaj**





- Në vënd të pasthënies një intervistë me autorin e antologjisë "Njëqind poetë për Naimin", nisur nga gazeta "Java" vazhduar nga gazeta "Mirësia" -

- Zoti Rrapush Xhaferri, President i fondacionit Bamirës "Demokracia Popullore - Xhaferri" e shleu "borxhin" ndaj Naim Frashërit -

- Atdhedashuria, bujaria dhe fisnikëria e tij duke sponsorizuar për botimin e veprës kushtuar Naimit, mundësoi çeljen e Shtëpisë Botuese "Argeta - LMG" e cila fillon botimet e saja me Bibliotekën "Vellezërit Frashëri" -

"Java": Si u lindi dëshira dhe si e realizuat një antologji të tillë?

**Përgjigje:** Ende pa shkuar në shkollë, kur nuk kisha filluar të

mësoja ABC-në, në shtëpi nga vëllezërit më të mëdhenj, por edhe nga miqtë dhe shokët që, shpesh në dasma dhe gostira, por edhe mbrëmjeve të gjata, sidomos gjatë dimrit, i vetmi gjësim dhe dëfrimi i ynë, ishte kënga. Kënga më e preferuar në shtëpinë tonë që këndohej dhe hiqej në valle ka qenë: "Ngreu o Abdyl Bej nga varri se t'u mbarrua qëllimi!". Në këtë këngë ka një varg që thotë: "Zgjo nga gjumi i rëndë Naimnë dhe Saminë, të shikojnë Adriatiknë që u bë i Shqipërisë!..."

Kur vajta në shkollë mësova se kush ishte Abdyli, Naimi dhe Samiu. Fillova të grumbulloj gjithçka që shkruhej dhe flitej për vëllezërit Frashëri. Interesi m'u shtua dhe diçka më shtynte të bënja për ta. Të shkruaja një libër për Naimin? Po çfarë të thosha më bukur se sa e ka thënë Musine Kokolari që në vitin 1942, ku me "Naim Frashëri - poet kombëtar", mbrojti doktoratën në Universitetin e Romës?! Profesor Shuteriqi e çoi dhe më tej duke shkruar një monografi tjetër. E pasuroi literaturën naimiane Profesor Rexhep Qosja, duke e parë në mënyrë sa më të gjérë po dhe aq thellë jetën dhe veprën e Naimit në "Porosia e madhe". Por, megjithatë, ende më mundonte një gjë: të bëja diçka sado modeste për Naimin dhe vëllezërit Frashëri.

*Përveç një tufë lulesh mbi varrin e poetit me rastin e 95 vjetorit të vdekjes u përpoqa të vinja në duart e adhuruesve të Naimit edhe një buqetë me vargje. Ato poezi nuk u shkruan me porosi apo sipas një direktive a qarkore. Ato kanë buruar nga shpirti i popullit, shpirti i poetëve, thjesht për të shlyer sado pak një "borxh" sado të vogël të përhershëm që ka çdo shqiptar ndaj Naimit.*

**Pyetje: Çfarë përmban antologjia?**

**Përgjigje:** Në antologji janë shkrirë njëherësh disa linja: *Naimi - njeri, Naimi - poet, Naimi - shenjt, Naimi - themelues i gjuhës letrare shqipe*. Vetëm po të marrësh linjën e atdhedashurisë apo simbolin e Qiririt mund të nxjerrësh disa esse të veçanta. Por dhe llojet e poezive, llojshmëria e vargjeve, stilet, koha kur janë shkruar, duke filluar këtu e më shumë se një shekull, që më 1879, kur Koto Hoxhi botonte poemthin e tij për tre vëllezërit Frashëri, përbëjnë një shkollë më vete: Shkollën Naimiane.

**Pyetje: Ju jeni shprehur në pronovimin e librit se kjo antologji do të jetë për ju si një parathënie për gjithçka keni preqatitur dhe vazhdoni të punoni për 150 vjetorin e Naimit?**

**Përgjigje:** Kështu është: Vepra e Naimit është botuar disa herë por kjo nuk mjaftron. Vërtet duhet studjuar vepra origjinale e Naimit dhe kjo është lënda e parë, burimi; po aq vlerë ka dhe studimi

dhe botimi i gjithçkaje që është shkruar për të. Për Naimin janë shkruar mbi pesëqind e ca studime, artikuj, kujtime, esse që përbëjnë një thesar për kulturën tonë kombëtare. Kjo pasuri e shpërndarë gjithandej nëpër libra, gazeta, arkiva, biblioteka, në kujtesën e njerëzve, duhet mbledhur dhe ekonomisur si një nënë e dhimbë, që i dhimben edhe dy gram miell që të mos deredhet kot nëpër tokë. Kështu që gjithë këtë krijuar të qindra autorëve brenda dhe jashtë vendit jam përpjekur, me aq sa kam mundur, ta mbledh ta redaktoj, ta sistemoj duke krijuar një korpus të tërë tash për tash të ndarë në tetë vëllime, të cilët përmblajnë:

Vëllimi i parë: Naimi - Antologji poetike; e cila ka si bazë antologjinë që ka dalë por e pasuruar edhe me shumë autorë të tjera si dhe e pajisur me shënimet e nevojshme.

Vëllimi i dytë: Naimi-Kujtime, përsiatje, reportazhe letrare, etj.

Vëllimi i tretë: Naimi-Artikuj, studime për probleme të veçantë

Vëllimi i katërt: Naimi-Artikuj, studime për vepra të veçanta (Bagëtia e Bujqësia, "Lulet e verës", "Historia e Skënderbeut", "Qerebelaja", etj.)

Vëllimi i pestë: Gjuha e Naimit

Vëllimi i gjashtë: Naimi për shkollën shqipe (artikuj studime)

Vëllimi i shtatë: Naimi në studimet dhe botimet botërore (artikuj, studime)

Vëllimi i tetë: Naimi-Biobibliografia.

Ky korpus përbëhet prej rreth 3000 faqesh daktilografike të shtrira një kohë prej mëse 120 vjet. Në gjysmëshekullin e fundit ishin lënë mënjanë dhe nuk u referoheshin studiuesve të tillë siç janë shkrimet dhe kujtimet e Mit'hat Frashërit nga më të hershmet, por nga më të bukurit dhe më të saktit. të Karl Gurakuqit, Safet Butkës, Kristo Floqit, Gjergji Çakos, Zoi Xoxes, Selaudin Totos, Ernest Koliqit, Terenc Toçit etj., etj. Dikush mund të ketë pretendime për ndonjërin nga këto figura për vendin e tyre dhe rolin që kanë lojtur në politikën shqiptare, por në rastin konkret, kur ne shikojmë gjykimet, vlerësimet dhe analizat e tyre për një figurë të caktuar qoftë kjo për Naimin apo për cilindo tjetër, atëherë do të bëjmë shkencë dhe jo politikë. Askush s'ka të drejtë as t'i fshehë as të shtojë apo të heq nga një studim një dokument apo një mendim të shprehur për një fenomen apo për një person të caktuar. Kështu duhet të bëhet edhe me dhënien e gjithë

dokumentacionit të krijuar deri më sot për Naimin; pra pa e retushuar atë.

**Pyetje: Si i keni menduar zgjidhjen e problemit të sponsorizimit dhe botimit të këtij korpusi?**

**Përgjigje:** Rëndësi ka që ne kemi Pirro, Teutë dhe Skënderbe, kemi Abdyl, Naim, Sami, Ismail Qemal, Isa Boletin dhe Hasan Prishtinë, kemi Faik Konicë, Gjergj Fishtë, Çajup, Mqedë dhe Migjen, kemi Fan Nol dhe Lasgush, kemi Dritëro Agollë, Ismail Kadare, Rexhep Qose, Esat Mekulë, Ali Ali, Ali Podrimë, Francesko Altimar, etj., etj. Kur kemi këta dhe shumë të tjerë që do të vinë pas tyre, do të kemi dhe aq para sa të botohet vepra e Naimit dhe e bashkëluftëtarëve të tij. Për këtë do t'u drejtohem institucioneve shtetërore, shkencore, fondacioneve, firmave të ndryshme dhe besoj se do ta realizoj një detyrim që ka cilido ndaj Naimit në 150 vjetorin e lindjes. Ashtu siç u gjet një nënë si Emineja dhe një baba si Halil Frashëri që lindën djem si Abdyli, Naimi dhe Samiu, do të ketë një nënë që të ketë lindur një djalë apo vajzë që të ketë bujarinë që të japë një grusht para dhe kjo vepër të shkojë te lexuesi.

Ata që do të bëjnë këtë, do të kenë nderin dhe urimin e të gjithëve, njëkohësisht do të kenë edhe bekimin e Naimit.

**(Vazhdon biseda me gazeten "Mirësia")**

**Mirësia:** Si u lidhët me zotin Rapush Xhaferri, Presidentin e fondacionit dhe të gazetës sonë?

**Përgjigje:** Kisha dëgjuar dhe kisha lexuar për bujarinë dhe fisnikërinë e tij, por asnjëherë s'isha takuar me të. Një koleg i vjetër njëkohësisht që punonte në gazeten e tij më kërkoi diçka për të botuar në gazeten "Mirësia" për 150 vjetorin e Naimit. I sugjerovala që të ribotonte të vetmen bisedë që e kishin kthyer në intervistë që ka dalë duke pirë një kafe me disa shokë, pa e ditur se ajo do të botohej një ditë. Gazeta "Mirësia", përvjetorit të Naimit, i kushtoi një faqe të tërë botuar me shumë dashamirësi dhe kujdes. Zoti Xhaferri e kishte lexuar, i kishte bërë përshtypje dhe kërkonte të më takonte. Kjo m'u duk e pabesueshme. Insistimi i tyre që unë të takoheshha me të përsëri më dukej si e pabesueshme. Mos qe kjo një shaka! Por një ditë, pas disa muajsh, u ndodhëm në një kafene pranë njëri-tjetrit. Kolegu i vjetër i bëri me shenjë se unë isha personi që ai kërkonte. Ai sikur të ishim njohur prej vitesh m'u drejtua: "More unë po të kërkoj dhe kemi kaq kohë që s'të gjejmë dot." U ulëm duke shtrënguar duart miqësisht dhe pyetja e parë që bëri ishte: "Tani më thuaj, çfarë ke përgatitur për

Naimin?". I shpjegova shkurt. Ai u mendua një hop dhe tha në mënyrë të prerë: "Për Naimin nuk kursej asgjë, nuk më dridhet dora mua as për Naimin as për vëllezërit Frashëri dhe për ndonjë tjetër. Ti bëj një, dy, tre vëllime, sa të kesh mundësi, gjej shtypshkronjën më të mirë, bëj një libër "hak", më sill preventivin sepse kam unë para për ta.Ta nxjerrim shpejt, por bukur!"

Nuk nënshkruam as kontratë,asgjë tjetër,përveç një kafe që pimë dhe kjo qe e gjithë biseda dhe kontrata jonë. Nuk më mbetet gjë tjetër vetëm ta falenderoj për këtë bujari, fisnikëri dhe mbi të gjitha atdherashuri që tregoi pa të cilën nuk mund të realizohej kjo vepër, që ka kushtuar, jo vetëm mua disa vjet, por gjithë atyre qindra autorëve që kanë vënë në ato shkrime mendjet dhe zemrat e tyre, për të edukuar jo vetëm ne, brezin tonë, por dhe ato që do të vijnë pas.

Kur thashë në fillim se do të gjendet një bir nëne që do të kishte një dorë para për të sponsorizuar këtë vepër, nuk u gabova. Tani për tani për mua ky është Zoti Rrapush Xhaferri. Më tutje nuk e di...

**Pyetje: Po ndonjë diçka tjetër për të thënë,si për të mos mbetur merak.**

**Përgjigje:** Po dua ta mbyll me një befasi të bukur që më ndodhi para do kohe me një poeteshë kosovare të cilën nuk do të harroj kurrë.E takova rastësisht . I dhurova një kopje të antologjisë. Ajo nxori pasaportën dhe e futi në mes të librit duke thënë:"Ti Shqipëri për jep nder"! pastaj shtoi:<sup>14</sup>"Tani kam dy pasaporta: njerën pasaportë që trgon identitetin tim që jam shqiptare, dhe tjetrën, pasaportën e atdherashurisë naimjane.

Tani më duket vetja sikur jam shumë më e fortë dhe më e vendosur për të ecur në rrugën time. Do të jem mirënjohëse dhe në qoftë se do të kem rast, uroj të ta shpërbujej me gëzime dhe me befasira të tillë..."

Nuk dua shpërblim dhe vlerësim tjetër!

Përfitoj nga rasti t'u kujtoj autorëve, të afërmëve të tyre, gjithë dashamirësve, për çdo mangësi që vënë re si për krijimet, shënimet biografike, fotografitë çdo vrejtje dhe sugjerim, të kenë mirësinë të m'i dërgojnë,me shpresë se ndoshta në ndonjë botim të mëvonshshmëm, do të bëjmë plotësimet e nevojshme.

Për gjithshka do t'u jem mirënjohës.

Mirësia: Diçka për gazetën tonë ?

Përgjigje: Mirësia është e përjetshme, këtë fat pastë edhe kjo gazetë.

Mirësia: Ndonjë kërkesë apo premtim?

Përgjigje: Dua vetëm një cep të vogël të gazetës suaj që të fiksoj atje shpirtin bujar e fisnik të popullit tim, mirësinë e çdo njeriu të mbledhur si me pikatore nëpër vite.

Do të jem bashkëpunëtori juaj i përhershëm. Ky do të jetë fat e lumturi.





## Rrapush Xhaferri

President i Përgjithshëm i Fondacionit Bamirës  
"Demokracia Popullore- Xhaferri"



# *Përherë mirënjohje të shenjtit Naim!*

*Kam fatin dhe lumturinë që Fondacioni im është vendosur në rrugën "Naim Frashëri". Kjo është një rastësi, por edhe rastësitë kanë bukurinë e tyre. Rastësish isha këtë qershori në Tetovë. Pashë se ishin mbledhur atje shumë burra dhe gra të mençura që po përkujtonin 150 vjetorin e lindjes së Naimit. Për tre dit dhe net rresht u bisedu, u recitan dhe u kenduan këngë e vjersha për Naimin. Më la shumë mbresa ky akt i madh atdhetar.*

*Gjatë gjithë rrugës për t'u kthyer në Tiranë nuk më hiqej nga mendja një kengë:*

*Lule Abdyl Frashëri,  
Prishe një barrë flori,  
për të shtrenjtën Shqipëri...*

*Këngët thonë se diku prishi një barrë flori, diku një torbë, e diku tjetër një okë; ndoshta prishi një dorë para, por e rëndësishme është se vëllezërit Frashëri gjithë pasurinë, jetën, shëndetin, mendjen dhe zemrënja falën Shqipqërisë.*


*Gjatë rrugës për të ardhur në Tiranë por edhe më vonë, më ngacmonte një ndjenjë e fuqishme : çfarë mund të bëja unë për vëllezërit Frashëri. Mësova se njeriu i letrave, Mehmet Gëzhilli, përgatiste prej*

vitesh një vepër për Naim Frashërin. Nuk hezitova. Menjëherë desha ta shoh këtë vepër, jo vetëm në dorëshkrim, por edhe në libër, për ta patur si një pasuri të vyer për vete, për fëmijët e mi, për çdo shqiptar dhe çdo dashamirës të Shqipërisë.

Falenderoj autorin që pergatiti një vepër të tillë, gjithë autorët e tjerë që kanë dhënë kontributin e vet për studimin dhe njojen e jetës dhe veprës së Naimit që sa më shumë e studiojmë atë, aq më afér na vjen Ai; gjithnjë e më i shenjtëruar Naimi ynë i Madh!

Për Naimin, Vëllezërit Frashëri dhe për çdo shqiptar që ka punuar dhe punon për Shqipërinë, kurrë nuk do të më dridhet dora për të harxhuar dhe qindarkën e fundit për begatinë dhe lumturine e atdheut, të kombit e të popullit tim.

**President i Fondacionit Bamirës  
"Demokracia Popullore-Xhaferri"  
RRAPUSH XHAFERRI**



Tiranë, 17. 10 1996

*Biblioteka "Vëllezërit Frashëri"*  
*Naimi 1*  
*Antologji poetike*



*Argeta -LMG*

*Shtypur , Tiranë, nëntor - 1996*